

**RAPORT I MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË BUXHETIT 12 M VITI 2025
BASHKIA SHKODER**

Shkurt 2026

REALIZIMI I BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2025	3
TË ARDHURAT E VETA VENDORE	6
Realizimi i të ardhurave të veta vendore	6
Kategorizimi i të ardhurave	7
Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin e vitit 2025	10
Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative	15
Analiza e peshës specifike sipas kategorive	18
Analiza e peshës specifike sipas zërave	18
Realizimi i të ardhurave 2025, krahasuar me vitet e kaluara	20
REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2025	29
Shpenzimet e përgjithshme me fondet e veta	29
Shpenzimet nga transfertat e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta vendore	38
Transferta e pakushtezuar sektoriale	45
Donacion	49
Transferta e kushtëzuar	51
VETËVLERËSIMI FINANCIAR PER PERIUDHEN 12 M 2025 PER SITUATEN E GJENDJES FINANCIARE TE BASHKISË SHKODER.....	57
PROGRAMI AA141 -MENAXHIMI DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE.....	59
PROGRAMI AB141- SIGURIA PUBLIKE DHE MBROJTJA CIVILE.....	87
PROGRAMI AC141 : MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK	97
PROGRAMI AD141 - PLANIFIKIMI DHE KONTROLLI I TERRITORIT DHE MJEDISI.....	123
PROGRAMI AE141 - SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE.....	144
PROGRAMI AF141 - KULTURA, SPORTI, ARGËTIM.....	165
PROGRAMI AG141 - PËRKUJDESI SOCIAL.....	225
PROGRAMI AI141 - ARSIMI.....	287

Realizimi i buxhetit të 12 M te vitit 2025

Realizimi i buxhetit të 12 M te vitit 2025, është bërë, duke respektuar nenin 64 të ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr 68/2017 datë 27.4.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” të ndryshuar, ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjin nr. 115/2024 datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar; udhëzimet e Ministrisë së Financave nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të qeverisjes vendore”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar.

Bashkia Shkodër, administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve në zbatim të Udhëzimit nr.7, datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Shtojca nr.1 që përban listën e programeve që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore ka ndryshuar nëpërmjet riklasifikimit të programeve, duke ulur numrin e tyre nga 36 në 20 dhe për vitin 2025 kemi 9 programe referuar Udhëzimit Plotësues nr.3 datë 28.02.2024 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” struktura e programeve të buxhetit vendor Shkodër do të jetë si më poshtë:

Nr	EMERTIMI I PROGRAMIT
1	AA141 -Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse
2	AB141- Siguria Publike dhe mbrojtja civile
3	AC141- Mbeshtetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural
4	AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit
5	AE141 - Shërbimet Publike Vendore
6	AF141 - Kultura, Sporti, Argëtim
7	AG141 - Përkujdesi Social
8	AH141 - Fond Rezerve dhe Kontigjencë
9	AI141 - Arsimi

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë, vijnë nga dy burime:

1. **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksa të tjera vendore, tarifa vendore, të ardhura nga asete dhe aktiviteti ekonomik, të tjera administrative, të ardhurat nga taksat e ndara, grante të huaja dhe të ardhura që trashëgojnë.
2. **Nga burimet qendrore** ku përfshihen :

- a. **Transferta e pakushtëzuar** është një formë financimi që qeveria qendrore i jep njësisve të qeverisjes vendore **pa vendosur kushte specifike për mënyrën e përdorimit të saj**. Kjo do të thotë se njësitë vendore kanë **autonomi të plotë** për të shpërndarë dhe përdorur këtë fond sipas prioriteteve dhe nevojave të tyre lokale, si për mbulimin e shpenzimeve operative ashtu edhe për investime kapitale.

Transferta e pakushtëzuar përcaktohet dhe shpërndahet në bazë të një formule që merr parasysh faktorë si:

- popullsia,
- sipërfaqja gjeografike,
- niveli i të ardhurave vendore,
- tregues të nevojave sociale dhe ekonomike.

- b) **Transferta e pakushtëzuar sektoriale** është një formë financimi që qeveria qendrore i akordon njësisve të qeverisjes vendore, **me destinacion të caktuar për një sektor specifik** (si arsimi parashkollor, shërbimet sociale, etj.), **por pa vendosur kushte të rrepta mbi mënyrën e përdorimit të fondeve brenda atij sektori**.

Ndryshe nga transfertat e kushtëzuara (ku përdorimi është i përcaktuar saktësisht nga qeveria qendrore), transferata e pakushtëzuar sektoriale **i jep bashkisë një liri relative për të menaxhuar burimet brenda fushës për të cilën është dhënë**, në përputhje me përgjegjësitë që ligji i ka deleguar në atë sektor.

- c) **Transferta e kushtëzuar** është një formë financimi që qeveria qendrore i jep njësisve të qeverisjes vendore **me kushte të përcaktuara qartë mbi mënyrën dhe destinacionin e përdorimit të fondeve**. Kjo do të thotë se fondet mund të përdoren **vetëm për qëllime specifike dhe në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga qeveria qendrore**. Kjo është transferte me kusht përdorimi dhe që nuk trashëgohet vitin pasardhës.

Transferta e kushtëzuar është dhënë vetëm si informacion plan dhe fakt 12 M 2025 por që nuk është e përfshirë në tabelat përmbledhëse , kjo sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave .

Buxheti i 12 M të vitit 2025 , në total në 000/leke me burimet e veta të financimit , paraqitet si më poshtë:

	Burimet Buxhetore	2025 (Janar- Dhjetor)		
		Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Fakti Kumulativ
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	1,125,924	1,125,924	1,093,254
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	267,668	267,668	255,982
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	297,000	297,000	289,810
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	47,000	47,000	58,566
1.4	TARIFA VENDORE	457,712	457,712	428,644

1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	5,044	5,044	2,913
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	51,500	51,500	57,339
2	TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR	1,601,938	1,635,425	1,635,425
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	1,039,175	1,066,289	1,066,289
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	938,456	938,456	938,456
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	100,719	100,719	100,719
2.1.3	Fond shtesë nga Kuvendi	0	27,114	27,114
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	562,763	569,136	569,136
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	63,930	63,930	63,930
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	199,468	199,468	199,468
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	67,533	67,533	67,533
2.2.4	Arsimi parauniversitar	31,884	31,884	31,884
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	67,343	72,458	72,458
2.2.6	Mbrojtja sociale	44,503	44,503	44,503
2.2.7	Administrimi i pyjeve	14,084	14,084	14,084
2.2.8	Rrugët	23,784	23,784	23,784
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	33,257	33,257	33,257
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	16,977	16,977	16,977
2.2.12	Të tjera	0	1,258	1,258
3	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	136,035	136,035	188,523
4	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	620	1,906	2,986
5	HUAMARRJA	0	0	0
6	TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR	70,385	1,651,612	1,651,612
6.1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	70,385	1,000,273	1,000,273
6.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	0	469,897	469,897
6.3	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	0	175,552	175,552
6.4	DONACIONE	0	5,889	5,889
	TOTALI	2,934,902	4,550,901	4,571,800

TË ARDHURAT E VETA VENDORE

Realizimi i të ardhurave të veta vendore

Bashkia Shkodër, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve. Financimin e buxhetit të saj, bashkia e realizon nga:

- a. burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen;
- b. grantet e projekteve të huaja dhe donacionet;
- c. burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar dhe transferta specifike.

Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Objektivat kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Janë ndërtuar bazë të dhënash gjithnjë edhe më të sakta duke dhënë edhe një panoramë më të saktë të taksapaguesve biznes dhe familjar. Gjithashtu mundësi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet zyrave me Një Ndalese dhe agentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin. Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbështetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulantët etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit si dhe Vendimit nr.25, datë 26.06.2020 “Për disa ndryshime në VKB NR.1, datë 22.1.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar përjashtimin nga taksat dhe tarifat vendore për një periudhë tre mujore të vitit 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve individë, familje, persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF, institucione publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por

edhe për vetë rritjen e arkëtimit nga viti në vit. Keto politika të lehtësimit fiskal dhe inçentivues, shoqëruar paralelisht me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2024 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimi i regjistrave të sakte elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultate shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave. Kujdes të veçantë gjatë vitit 2025 ju kushtua përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësisht dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Sot është e mundur hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të IMT dhe Policisë Bashkiake, bashkëpunimi me Policinë e Shtetit për hedhjen në kohë të gjobave nëpërmjet sistemit e-gjoba, llogaritja automatoike e kamatvonesave, llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë Z1N për subjektet shfytëzuese të hapësirave publike, parkingjeve, ambulantëve etj. Vazhdon përdorimi i aplikacionit për smartphone “Taksat e Mia Shkodër”, ku mundësohet llogaritja e taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore sipas adresave, vitit fiskal, dhe kategorisë familjare. Objektivi kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara është realizuar në masën **102% (taksa dhe tarifa vendore)**, referuar planifikimit buxhetor. Referuar arkëtimit mjorë gjatë vitit 2025, është siguruar njëtrajshmëri në nivelet e të hyrave mjorë, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor. Të ardhurat e veta u realizuan nga administrata e bashkisë, Njësitë Administrative, Institucionet dhe agjentët tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë. Realizimi i të ardhurave për vitin financiar me 102% tregon përparime në disa sektorë dhe sfida të vazhdueshme në sektorë të tjerë. Për të përmirësuar performancën do të bëhet përqendrimi në digjitalizim, forcimi i kapaciteteve administrative dhe bashkëpunimi ndër-institucional. Këto masa do të sigurojnë një mbledhje më efektive të të ardhurave dhe një menaxhim më të mirë të burimeve financiare vendore.

Bashkia Shkodër me burimet e veta arriti të menaxhojë situatën dhe të ofrojë shërbimet e duhura ndaj qytetarëve në të gjithë territorin e saj.

Kategorizimi i të ardhurave

- Taksa e pasurisë së paluajtshme:
 - Taksa mbi ndërtesën
 - Taksa mbi tokën bujqësore
 - Taksa mbi truallin


- Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme
- Taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- Taksa të tjera vendore
 - Taksa vendore mbi biznesin e vogël
 - Taksa vendore në shërbimin hotelier
 - Taksa e tabelës
 - Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament..
 - Taksa e përkohshme
- Tarifat vendore
 - Tarifa e menaxhimit të mbetjeve
 - Tarifa për zënien e hapësirës publike
 - Tarifa për ndriçimin publik
 - Tarifa për gjelbërimin
 - Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë
 - Tarifa të institucioneve të arsimit
 - Tarifa të institucionit të kulturës dhe sportit
 - Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime
 - Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit
 - Tarifa të përkohshme
 - Tarifa e parkimit
 - Tarifa të tjera
- Të ardhura nga asetet dhe aktiviteti ekonomik
 - Të ardhura nga ndërmarrjet publike
 - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë
 - Të ardhura nga partneriteti publik privat
 - Shitja e mallrave dhe shërbimeve
 - Shitja e aseteve financiare
 - Shitja e aseteve fikse të prekshme/paprekshme
 - Të tjera
- Të tjera administrative:
 - Kamatëvonesat
 - Gjoha, sekuestre dhe zhdëmtime
 - Të tjera
- Të ardhura nga taksat e ndara
 - Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura
 - Renta minerare
 - Tatimi mbi të ardhurat personale
 - Të tjera
- Grante të huaj

Realizimi i të ardhurave nga të ardhurat vendore 2025 ne 000/leke

Burimet Buxhetore	2025 Fakt
TË ARDHURA GJITHSEJ	1,284,763
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	1,093,253
TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	255,982
TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	289,810
TAKSA TË TJERA VENDORE	58,566
TARIFA VENDORE	428,644
TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	2,913
TË TJERA ADMINISTRATIVE	57,339
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	188,523
GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	2,986

Rritja e të ardhurave të veta vendore në kuadër të konsolidimit të ecurisë së decentralizimit por gjithashtu ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertave gjatë vitit 2025 krijoi kushtet e favorshme për Bashkinë Shkodër për të nxitur politika të reja në drejtim të cilësisë së shërbimeve publike. Duke marrë në konsideratë rëndësinë që kanë burimet e financimit për përmirësimin e jetës së qytetarëve, në këtë seksion janë analizuar të gjitha burimet kryesore të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

Ecuria e treguesve fiskalë të Bashkisë Shkodër ka rezultuar pozitive në mbledhjen e të ardhurave ku të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2025 u realizuan në vlerën **1,093,253 mijë Lekë** të ardhurat nga burimet e veta dhe **1,284,763 mijë Lekë** nga të ardhurat gjithsej. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, nga taksa të tjera vendore, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura nga asetet dhe aktiviteti ekonomik dhe të tjera administrative, të ardhura nga taksat e ndara dhe nga grante dhe transferta të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga tarifat vendore me **33%** dhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me **23%** të të ardhurave gjithsej. Grafiku i mëposhtëm tregon peshën e të ardhurave sipas kategorive.



Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin e vitit 2025

Realizimi i planit të të ardhurave në total është në masën 102%


mijë/lek

	Burimet Buxhetore	2023	2024	2025			% Realizimi mit mbi planin 2025
		Fakti	Fakti	Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Fakti Kumulativ	
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	701,774	855,217	1,125,924	1,125,924	1,093,253	97%
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	205,978	206,122	267,668	267,668	255,982	96%
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	171,488	171,114	201,932	201,932	207,938	103%
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	8,226	6,785	22,986	22,986	9,409	41%
1.1.3	Taksa mbi truallin	15,614	18,644	23,750	23,750	22,643	95%
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	10,650	9,579	19,000	19,000	15,992	84%
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	65,703	176,295	297,000	297,000	289,810	98%
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	65,703	176,295	297,000	297,000	289,810	98%
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	42,620	52,912	47,000	47,000	58,566	125%
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	1,898	2,558	1,000	1,000	1,767	177%
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	26,609	33,960	30,000	30,000	40,778	136%
1.3.3	Taksa e tabelës	14,113	16,394	16,000	16,000	16,021	100%


1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0%
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0%
1.4	TARIFA VENDORE	358,162	374,072	457,712	457,712	428,644	94%
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	184,424	180,171	220,320	220,320	215,995	98%
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	0	66,721	0	65,000	52,511	81%
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	47,610	50,148	69,478	69,478	60,756	87%
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	25,589	26,789	30,410	30,410	29,837	98%
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	79,383	26,003	104,213	28,213	17,339	61%
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	15,859	17,081	22,351	22,351	18,072	81%
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	5,297	7,159	6,930	6,930	7,807	113%
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0%
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	4,000	4,000	0	0%
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0%
1.4.11	Tarifa e parkimit	0	0	0	11,000	26,326	239%
1.4.12	Tarifa të tjera	0	0	10	10	0	0%
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	6,131	3,776	5,044	5,044	2,913	58%
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0%
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	3,302	3,714	2,874	2,874	2,860	99%
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0%
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	1,800	1,800	0	0%
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0%
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0%
1.5.7	Të tjera	2,829	62	370	370	54	14%
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	23,180	42,040	51,500	51,500	57,339	111%
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	5,086	0%
1.6.2	Gjoha, sekuestre dhe zhvendëtime	23,180	42,040	51,500	51,500	52,253	101%
1.6.3	Të tjera	0	0	0	0	0	0%
2	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	156,227	166,796	136,035	136,035	188,523	139%
2.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	101,350	105,131	91,000	91,000	115,457	127%
2.2	Renta minerare	1	310	35	35	24	69%
2.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	54,876	61,355	45,000	45,000	73,042	162%
2.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0%
3	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	83,028	2,127	620	1,906	2986	157%
3.1	TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE	29,156	0	0	0	0	0%
3.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	29,156	0	0	0	0	0%
3.2	GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME	0	0	0	0	0	0%
3.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0	0	0%

3.3	GRANTE TË HUAJA	53,872	2,127	620	1,906	2,986	157%
3.3.1	Grante të huaja	53,872	2,127	620	1,906	2,986	157%
TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV		941,029	1,024,140	1,262,579	1,263,865	1,284,763	102%

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas kategorive kryesore.



Grafiku i mëposhtëm pasqyron përqindjen e realizimit të ardhurave për zërat kryesorë, në raport me planin.



Zërat kryesorë, që janë me tejkalim në krahasim me planin e vitit 2025 janë: të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat, taksa vendore në shërbimin hotelier, , taksa e ndikimit në infrastrukturë në proces legalizimi, kontributi i subjekteve private në fondin publik të banesave sociale, të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve të përdorura, të ardhura nga tarifa e parkimit të mjeteve të licensuara dhe parkimeve të rezervuara si dhe të ardhurat nga kundravajtjet administrative që vijnë si rezultat i

mbledhjes së detyrimeve aktuale po ashtu edhe atyre të prapambetura nëpërmjet bllokimit të llogarive të biznesit apo akt-marrëveshjeve për pagesë me këste.

Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkalim si rezultat i zgjerimit të bazës së taksapaguesve si efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe konkretisht realizimit të **5095 akt-kontrolleve**, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore me rreth **3040** bllokime llogari bankare biznes dhe **1153** bllokime llogari bankare individ, **126** Urdhër Ekzekutime dhe **100** akt-marrëveshje për detyrimet e prapambetura. Gjithashtu sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i taksapaguesve nëpërmjet njoftimeve në media dhe në web, nëpërmjet dërgimit të rreth **5051** njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyrën me 1-Ndalesë, rivlerësimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatimorë etj.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksa e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore. Këto diferenca në të ardhurat buxhetore totale plotësohen nga zëra të tjerë me tejkalim dhe kanë ndikuar në realizimin e mbledhjes së të ardhurave në masën **102%** për Taksa & Tarifa , Taksa të ndara dhe Grante.


Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative

Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2025, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik në 000/lekë.

	Burimet Buxhetore												
		Realizimi viti 2025	Njësia Qendër	Postribë	Guri I Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajç	Ana e Malit	Rrethin a	Pult	Shosh	Shalë
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	1,093,253	882,380	10,642	10,009	16,819	127,641	8,651	5,518	24,826	260	662	5,846
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	255,982	167,085	4,927	5,231	9,098	51,879	4,617	2,744	8,111	230	235	1,826
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	207,938	139,076	3,086	3,665	5,879	45,939	2,329	1,812	4,487	36	195	1,434
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	9,409	0	1,180	658	753	2,584	1,882	659	1,505	188	0	0
1.1.3	Taksa mbi truallin	22,643	12,017	661	908	2,466	3,356	406	273	2,119	6	40	392
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	15,992	15,992	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	289,810	278,660	115	84	464	8,271	0	0	2,154	0	0	63
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	289,810	278,660	115	84	464	8,271	0	0	2,154	0	0	63
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	58,566	32,449	32	115	1,052	20,569	28	62	1,161	0	278	2,820
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	1,767	1,767	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	40,778	17,513	32	78	0	19,544	0	0	513	0	278	2,820
1.3.3	Taksa e tabelës	16,021	13,169	0	37	1,052	1,025	28	62	648	0	0	0
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.4	TARIFA VENDORE	428,644	346,832	5,487	4,373	5,823	46,109	3,975	2,691	12,130	30	119	1,075
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	215,995	180,856	2,497	3,270	4,342	10,940	3,258	1,688	7,920	30	119	1,075
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	52,511	22,385	0	0	0	30,126	0	0	0	0	0	0
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	60,756	51,068	886	842	986	3,824	717	596	1,837	0	0	0
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	29,837	28,830	0	57	75	798	0	0	78	0	0	0

1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	17,340	11,557	2,089	204	420	421	0	400	2,249	0	0	0
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	18,072	18,072	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	7,806	7,806	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	26,326	26,258	15	0	0	0	0	7	46	0	0	0
1.4.12	Tarifa të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	2,913	2,913	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	2,860	2,860	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	53	53	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	57,339	54,442	82	206	382	813	31	21	1,270	0	30	62
1.6.1	Kamatëvonesat	5,086	5,086	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestime dhe zhdëmtime	52,253	49,356	82	206	382	813	31	21	1,270	0	30	62
1.6.3	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	188,523	153,862	3,470	2,315	5,779	6,356	1,732	2,309	9,236	1,732	577	1,154
2.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	115,457	80,820	3,464	2,309	5,773	6,350	1,732	2,309	9,236	1,732	577	1,154
2.2	Renta minerare	24	0	6	6	6	6	0	0	0	0	0	0
2.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	73,042	73,042	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	2,986	2,986	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.1	Grante të huaja	2,986	2,986	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	1,284,763	1,039,229	14,112	12,324	22,598	133,997	10,383	7,827	34,062	1,992	1,239	7,000


Grafiku paraqet realizimin e të ardhurave në % për secilën Njësi Administrative më vehte.



Analiza e peshës specifike sipas kategorive

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga tarifatat vendore me **33.4%** dhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë me **22.6%** të totalit.


Grafiku i mëposhtëm paraqet peshën e të ardhurave sipas kategorive:



Analiza e peshës specifike sipas zërave


Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga të ardhurat gjithsej për vitin 2025 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me **17%** të të ardhurave gjithsej, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesa me **16%**, taksa mbi truallin **2%**, taksa e ndikimit në infrastrukturë **23%**, taksa vjetore e mjeteve të përdorura **9%**, tarifa për zënie dhe hapësirë publike **4%**, tarifa e ndriçimit publik **5%**, tarifa e gjelbërimit **2%**, taksa e tabelës **1%**, tarifa nga institucionet e arsimit me **1%**, taksa e fjetjes në hotel **3%**, të ardhurat nga kundravajtjet administrative me **4%**, etj.

Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara për vitin 2025.



Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2025

Falë fokusimit për zgjerim të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, marrjes së masave shtrënguese, lidhjes së akt-marrëveshjeve ndërmjet bashkisë dhe subjekteve debitore biznes/individ, të ardhurat kanë ruajtur një nivel konstant të arkëtimeve. Në këtë mënyrë është siguruar plotësimi buxhetor dhe fluiditeti i nevojshëm financiar për ushtrimin e funksioneve të veta.




Referuar arkëtimeve të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Qershor, Korrik, Gusht dhe Dhjetor, periudha të përcaktuara për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi sipas VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar dhe falë efektit të njoftimit, sensibilisimit dhe fillimit të ndjekjes së masave administrative shtrënguese të ushtruara ndaj subjekteve debitore.


Realizimi i të ardhurave 2025, krahasuar me vitet e kaluara

Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Fakt
TË ARDHURA GJITHSEJ	970,365	941,029	1,024,140	1,284,763
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	782,593	701,774	855,217	1,093,253
<i>TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME</i>	206,889	205,978	206,122	255,982
<i>TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA</i>	121,182	65,703	176,295	289,810
<i>TAKSA TË TJERA VENDORE</i>	35,572	42,620	52,912	58,567
<i>TARIFA VENDORE</i>	353,967	358,162	374,072	428,644
<i>TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK</i>	45,319	6,131	3,776	2,913
<i>TË TJERA ADMINISTRATIVE</i>	19,664	23,180	42,040	57,339
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	99,633	156,227	166,796	188,523
GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	88,139	83,028	2,127	2,986

Krahasuar me vitin 2024, realizimi i të ardhurave ka një rritje me rreth **+260,623 mijë Lekë** të të ardhurave të veta, ose **25%** më shumë se viti i kaluar. Kjo rritje vjen si rezultat i realizimit të disa taksave dhe tarifave mbi nivelin 100%, ndjekjen e afateve të akt-, marrëveshjeve dhe lidhjen e akt-marrëveshjeve të reja si dhe punës sensibilizuese me bizneset për respektimin e afateve të pagesave.



Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë ndër vite



Detyrimi i taksës së pasurisë për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjetellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor.

Taksa e pasurisë së paluajtshme, krahasuar me vitin e kaluar, kemi një rritje në nivel arkëtimi me një diferencë me **+49,860 mijë lekë**.

Ky nivel arkëtimi i të ardhurave nga ndërtesat për qëllimi biznesi, ka ardhur si rezultat i ndërgjegjësimit të bizneseve për shlyerjen e detyrimeve vendore, rritjes së numrit të njësive të bizneseve të reja, zgjerimit të aktiviteteve të bizneseve si dhe ndjekjes dhe arkëtitimit të detyrimeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave shtrënguese.


Gjatë vitit 2025, janë regjistruar rreth **798 biznese të reja**, të cilat janë faturuar për taksat dhe tarifat vendore sipas VKB Nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar.

Taksa e truallit, krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje arkëtimi më shumë me **+3,999 mijë Lekë** më shumë se vitin e kaluar.


Taksa e tokës bujqësore, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar një rritje me **+2,624 mijë Lekë** më shumë. Për efekt të lehtësimit fiskal për fermerët, në gjithë Bashkinë Shkodër niveli i taksës së tokës bujqësore është ulur me **30%**, pra deri në nivelin e lejuar të referencës ligjore, me ndikim nxitjen e fermerëve, por dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Mosmbulimi i plotë i territorit të Bashkisë Shkodër nga ana e agentit tatimor Ujësjetellës Kanalizimi, sidomos në Njësitë Administrative ka sjellë për pasojë nivel të ulët në lidhje me taksën e tokës bujqësore por krahasimisht me vitin e kaluar kemi një rritje në arkëtime si rezultat i marrjes së masave shtrënguese dhe zgjerimit të bazave të të dhënave.

Zgjerimi i bazës taksapaguese dhe rritja e arkëtitimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terren


me subjektet dhe familjarët, nxitjes së marrjes së masave shtrënguese të vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese dhe sensibilizuese të Bashkisë.




Kjo taksë zë një nga zërat më të rëndësishëm tek të ardhurat e veta të bashkisë. Në raport me vitin e kaluar kjo taksë ka një rritje në arkëtim me **+113,515 mijë Lekë**, si rezultat i rritjes së kërkesave për ndërtime në territorin e bashkisë. Gjithashtu Bashkia Shkodër ka bërë lajmërimet në të gjitha Njësitë Administrative dhe është bërë marrja e masave shtrënguese nëpërmjet bllokimit të llogarive bankare të kësaj takse për legalizimin e ndërtimeve pa leje.



Këto taksa përfshijnë taksat vendore mbi biznesin e vogël, taksa vendore në shërbimin hotelier, taksa e tabelës, taksava vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament etj., si dhe taksa e përkohshme, ku vendin kryesor e zë taksa e shërbimit hotelier. Në krahasim me vitin e kaluar kemi një rritje me **+5,654 mijë lek**.




Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, konkretisht plazhi Velipojë, pastaj vijnë zona e Shalës dhe Njësia Qendër, të cilat faturohen bazuar në monitorimet dhe verifikimet e herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve në terren. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat kanë një rritje prej **20%** ose e shprehur në lekë **6,818 mijë**. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së kapaciteteve të bizneseve, monitorimit të vazhdueshëm në terren si dhe rritjes së numrit të vizitorëve të huaj të cilët kanë ardhur për arsye turistike në vendin tonë.




Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2025 kanë një rritje prej **+54,572 mijë lekë** ose **15%** më shumë se viti 2024.

Tarifa e menaxhimit të mbetjeve




Tarifat vjetore të menaxhimit të mbetje (tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave) arrijnë vlerën e arkëtuar prej **215,995 mijë lekë** të ndarë sipas kategorive konkretisht: nga biznesi për vitin 2025 arrijnë në total vlerën e **112,449 mijë Lekë** dhe nga taksapaguesit familjarë në vlerën **103,546 mijë Lekë**. Krahasimisht me vitin 2024 kemi një rritje prej **+35,824** mijë lekë ose **20%** më shumë.

Tarifa për ndriçimin publik



Tarifat vjetore të ndriçimit, që janë arkëtuar për vitin 2025 arrijnë në total vlerën e **60,756 mijë Lekë**. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë **+10,608 mijë Lekë** ose **+21%** më shumë si rezultat i zgjerimit të bazës së taksapaguesve dhe ndjekjes së masave shtrënguese.


Tarifa për gjelbërimin




Tarifat vjetore të gjelbërimit, që janë arkëtuar nga biznesi dhe familjarët për vitin 2025 arrijnë në total vlerën e **29,837 mijë Lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje me vlerë **3,048 mijë Lekë**.

Rritja e të ardhurave nga tarifat vendore ka ardhur edhe si rezultat i zgjerimit të bazës së taksapaguesve si dhe ndjekjes së subjekteve debitore, marrjes së masave shtrënguese dhe ndjekjes së afateve të subjekteve që kanë lidhur akt-marrëveshje për shlyerje detyrimesh.

Të ardhura nga tarifa e institucione të arsimit






Edhe pse tarifat për shërbimet që ofrojnë këto insitucione kulturore, arsimore, sportive etj. kanë një tendencë rritje duke dhënë lehtësi fiskale kryesisht për disa kategori të veçanta përfituese si nxënës, studentë, grupe rinore etj, falë përmirësimit të shërbimit me efekt rritjen e fluksit të përfituesve të shërbimeve, shfrytëzimit me efikasitet të ambjenteve si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve kryesisht kulturore në përgjithësi, ka rezultuar që në total gjatë vitit 2025 janë krijuar rreth **7,806 mijë Lekë** të ardhura.

Nëpërmjet mbledhjes së tyre dhe gjetjes së burimeve të reja, këto tarifa lehtësojnë dhe mundësojnë shërbimin më cilësor dhe më të standartizuar të vetë atyre ndaj qytetarëve, pavarësisht se institucionet nuk kanë qëllim në vetvete krijimin e të ardhurave.

Të ardhura nga asetet dhe aktiviteti ekonomik



Të ardhurat nga asetet dhe aktiviteti ekonomik përbëhen nga të ardhura nga ndërmarrjet publike, të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë, të ardhura nga partneriteti publik privat, shitja e mallrave dhe shërbimeve, shitja e aseteve financiare, shitja e aseteve fikse të prekshme/paprekshme dhe të tjera. Për vitin 2022 vlera 45,319 mijë lekë përbëhet nga të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë si dhe shitja e aseteve financiare. Ndërsa për vitet 2023,2024 dhe 2025 kemi të ardhura vetëm nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë.

Të tjera administrative



Të ardhurat e tjera burojnë nga kamatvonesat, gjobat, sekuestime dhe zhdëmtime dhe të tjera, ku për vitin 2025 janë arkëtuar në vlerën **57,339 mijë lekë**.

Taksat e ndara

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura grumbullohet bazuar në ligjin 9975, dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, ku përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimorë. Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton një rritje e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë **+10,326 mijë lekë**, ose **10%** më shumë.

Taksa e rentës minerare që grumbullohet bazuar në ligjin 9975, dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, dhe shpërndahet si taksë e ndarë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Rezulton me të ardhurave në vlerë **24 mijë lekë**.

Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si taksë e ndarë, duhet të transferohet **2%** bashkisë. Gjatë vitit 2022 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka transferuar vlerën prej **28,847 mijë lekë** në favor të bashkisë, gjatë vitit 2023 ka transferuar vlerën **54,876 mijë Lekë**, gjatë vitit 2024 vlerën **61,355 mijë lekë**. Ndërsa për vitin 2025 janë realizuar të ardhura me vlerë **73,042 mijë lekë**.

Në total të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar **+21,727 mijë lekë** më shumë se vitin e kaluar.

Të ardhurat nga Grante dhe Transferta të tjera

Të ardhurat nga grante dhe transferta të tjera për vitin 2025 janë në vlerën **2,986 mijë lekë** me sistem të plotë thesari. Këto donacione kanë ardhur nga projekti “Fuqizim I komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen” dhe “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe zhvillimit të komunitetit”.


Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të 12 M te vitit 2025

Shpenzimet e përgjithshme me fondet e veta


Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të 12 M vitit 2025, nga burimet e veta të financimit, arritën 2 764 280 mijë lekë me një nivel realizimi prej 61 për qind.

TOTALI I SHPENZIMEVE ME BURIMET E VETA

Emertimi	Plani Korrigjuar	Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	1,521,380	1,085,677	71%
Shpenz. Operative	1,422,453	968,690	68%
Subvencione	705	-	0%
Transferime	408,962	240,840	59%
Investime	1,197,399	469,073	39%
Totali shpenzimeve me Thesar	4,550,901	2,764,280	61%



Peshen më të madhe të realizimit në përqindje e zënë shpenzimet për paga në 39.3 % shpenzimet operative në masën 35 %, shpenzimet kapitale në 17 % dhe transferimet në masën 8.7 %.







Shpenzimet per paga rreth 66.77 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta , rreth 33.12 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale dhe 0.10 % me Donacion.

Shpenzimet operative rreth 85.02 % jane realizuar me Burimet e veta, 14.89 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale dhe 0.09 % me Donacion .

Shpenzimet per transferime jane realizuar me 81.6 % me burimet e veta dhe 18.4 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale.

Shpenzimet per investime 93.98 % jane realizuar me Burimet e veta dhe 6 % me transferte sektoriale dhe 0.02 % me Donacion .

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:




Realizimi i shpenzimeve sipas matricës së programeve, 12 M per vitin 2025 paraqitet si me poshte:

000/leke

Nr	Emertimi i Programit	Paga dhe Sigurime		Shpenzime operative		Transferime & Subvencione		Investime		Totali	
		Plani korrigjuar 2025	Realizimi 2025	Plani korrigjuar 2025	Realizimi 2025	Plani korrigjuar 2025	Realizimi 2025	Plani korrigjuar 2025	Realizimi 2025	Plani korrigjuar 2025	Realizimi 2025
1	AA141 -Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	245,810	205,408	134,561	82,522	11,071	7,289	50,893	29,169	442,335	324,389
2	AB141- Siguria Publike dhe mbrojtja civile	177,559	115,333	21,058	11,336	58,353	2,029	21,172	3,238	278,141	131,936
3	AC141- Mbeshtetje per zhvillim ekonomik vendor dhe rural	33,685	24,098	20,787	12,530	55,357	50,660	97,395	17,593	207,225	104,880
4	AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli I Territorit dhe Mjedis	115,038	67,310	16,391	2,648	871	166	473,156	147,953	605,456	218,078
5	AE141 - Shërbimet Publike Vendore	176,138	131,117	790,979	582,796	15,132	15,082	144,240	64,303	1,126,489	793,297
6	AF141 - Kultura, Sporti, Argëtim	118,126	85,067	112,783	81,560	107,050	102,588	55,285	37,773	393,244	306,987
7	AG141 - Përkujdesi Social	80,991	55,014	25,108	14,956	60,001	47,370	30,104	98	196,204	117,437
8	AH141 - Fond Rezerve dhe Kontigjencë	-	-	-	-	84,234	-	-	-	84,234	-
9	AI141 - Arsimi	574,037	402,328	300,787	180,343	17,597	15,656	325,154	168,947	1,217,576	767,273
Totali		1,521,382	1,085,674	1,422,456	968,690	409,667	240,839	1,197,399	469,073	4,550,901	2,764,280

Pesha specifike e programeve ne Plan/Fakt e 12 M 2025



- AA141 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse
- AB141 - Siguria Publike dhe mbrojtja civile
- AC141 - Mbeshtetje per zhvillim ekonomik vendor dhe rural
- AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli I Territorit dhe Mjedis
- AE141 - Shërbimet Publike Vendore
- AF141 - Kultura, Sporti, Argëtim
- AG141 - Përkujdesi Social
- AH141 - Fond Rezerve dhe Kontigjencë
- AI141 - Arsimi

Raporti: M1 - Shpenzimet e Programeve: Fakt – Plan (Janar - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Viti: 2025

Vlerat paraqiten në: ALL

Programi		2024	2025 (Janar - Dhjetor)			Ndryshimi (%)	
Kodi	Emërtimi	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Fakti	Fakti vs. Fillestar	Fakti vs. Rishikuar
AA141	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	279,088,238	340,157,987	442,333,564	324,388,813	95.36%	73.34%
AB141	Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	99,821,640	195,049,422	278,141,196	131,936,319	67.64%	47.44%
AC141	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural	65,138,746	47,702,000	207,225,049	104,880,463	219.87%	50.61%
AD141	Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit	218,773,857	296,692,883	605,455,934	218,078,146	73.50%	36.02%
AE141	Shërbimet Publike Vendore	626,780,747	835,331,065	1,126,489,118	793,296,987	94.97%	70.42%
AF141	Kultura, Sporti, Argëtim	263,155,181	289,270,000	393,244,227	306,987,990	106.13%	78.07%
AG141	Përkujdesi Social	96,652,353	160,359,042	196,203,628	117,436,774	73.23%	59.85%
AH141	Fond Rezerve dhe Kontigjencë	0	31,031,000	84,234,288	0	0.00%	0.00%
AI141	Arsimi	504,568,525	739,307,164	1,217,574,464	767,275,069	103.78%	63.02%
	Totali	2,153,979,287	2,934,900,563	4,550,901,468	2,764,280,561	94.19%	60.74%

Raporti: M2 - Shpenzimet e Programit sipas Llogarive Ekonomike Fakt – Plan (Janar - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Viti: 2025

ALL

Vlerat paraqiten në:

LLOGARITË EKONOMIKE		2024	2025 (JANAR - DHJETOR)			NDRYSHIMI (%)	
KODI	EMËRTIMI	FAKTI	BUXHETI FILLESTAR	BUXHETI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR
Shpenzime Personeli (600-601)		913,142,034	1,267,219,126	1,519,442,740	1,084,548,005	85.58%	71.38%
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	779,846,075	1,092,824,126	1,304,892,072	930,471,738	85.14%	71.31%
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	133,295,959	174,395,000	214,550,668	154,076,267	88.35%	71.81%
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)		983,329,392	1,323,176,437	1,826,976,144	1,208,687,235	91.35%	66.16%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	796,754,312	1,069,813,395	1,417,308,583	967,847,151	90.47%	68.29%
603	Subvencionet	0	0	705,064	0	N/A	0
604	Transferime korrente te brendeshme	142,501,458	213,950,042	303,331,869	231,710,433	108.30%	76.39%
605	Transferimet korrente jashte	1,277,699	0	0	0	N/A	N/A
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	42,795,923	8,382,000	21,396,340	9,129,651	108.92%	42.67%
609	Rezervat	0	31,031,000	84,234,288	0	N/A	N/A
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)		255,077,640	343,885,000	1,196,688,022	468,975,527	136.38%	39.19%
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	5,970,295	15,288,000	132,732,083	38,927,597	254.63%	29.33%

231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	249,107,345	328,597,000	1,063,955,939	430,047,930	130.87%	40.42%
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)		202,680	0	711,145	98120	N/A	13.80%
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	282,709	0	N/A	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	202,680	0	428,436	98,120	N/A	22.90%
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)		1,331,861	360,000	1,938,101	1,128,600	313.50%	58.23%
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	1,149,567	306,000	1,580,067	980,499	320.42%	62.05%
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	182,294	54,000	358,034	148,101	274.26%	41.37%
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)		895,680	260,000	5,145,316	843,074	324.26%	16.39%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	895,680	260,000	5,145,316	843,074	324.26%	16.39%
Totali		2,153,979,287	2,934,900,563	4,550,901,468	2,764,280,561	94%	61%

Fondi rezerve në buxhetin e viti 2025 është planifikuar në shumën prej 31 031 mijë lekë i ndare në fond rezerve në shumën 11 281 mijë leke dhe fond kontigjence në shumën 19 750 mijë lekë. Jane trashëguar nga viti 2024 gjithsej 26 381 mijë i ndare në fond rezerve në shumën 6 631 mijë leke dhe fond kontigjence në shumën 19 750 mijë lekë. Ne fund të vitit 2025 janë akorduar shtese transferite të pakushtezuar 27 114 mijë leke në zbatim të aktit normativ nr. 11 datë 19.12.2025 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, dhe pasi të shlyen detyrimet përdoresh për shpenzime të tjera, shtese transferite sektoriale në zbatim të aktit normativ nr. 10 me shkresën e MF nr. 14505/11 datë 24.10.2025 në shumën 5 115 mijë për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi, shtese transferite sektoriale për grantin të bazuar në performancë për vitin 2025 në shumën 1 258 mijë leke alokuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 18133/1 datë 24.12.2025. Këto fonde janë shtuar të gjendjes së fondit rezerve për vitin 2025.

Gjatë 12 M të vitit 2025 kemi përdorim të këtij fondi rezerve & kontigjence sipas tabelës së mëposhtme.

Vendime		Qellimi
Nr.	Date	
51	04.08.2025	Për një ndryshim në Buxhetin e Bashkisë miratuar me VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar (20,000,000 lekë nga të cilët përdorim fondi rezerve 6 631 mijë)
63	31.10.2025	Për miratimin shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar. (Projekti "REUSEFUL" 1. Shtesë Buxheti me burim financimi donacion 24,029,209 lekë 2. Bashkefinancimi me staf ekzistues 4,240,449 lekë 3. Bashkefinancimi me burim financimi fondet e veta 4,290,066 lekë nga të cilët përdorim fondi rezervë 1,982 lekë për vitin 2025)
65	31.10.2025	Për miratimin shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar. (Projekti "Territory" 1. Shtesë Buxheti me burim financimi donacion 9,315,581 lekë 2. Bashkefinancimi me staf ekzistues 1,542,584 lekë 3. Bashkefinancimi me burim financimi fondet e veta 727,600 lekë nga të cilët përdorim fondi rezervë 32,390 lekë për vitin 2025)

Në zbatim të pikës 4 të VKB nr. 76 dt 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2027 të Bashkisë Shkodër" i ndryshuar gjatë 12 M të vitit 2025 janë miratuar 20 vendime për rishpërndarjen e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program; rishpërndarjen ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program; rishpërndarjen brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese.

Konkretisht si më poshtë:

Vendime		Qellimi
Nr.	Date	
PBA 2025	223,712	98,784	7,269	10,393	340,158
Plani fillestar 2025	242,344	134,253	9,034	58,381	444,011
Plani i rishikuar 2025	245,810	134,560	11,071	50,893	442,334
Realizimi viti 2025	205,409	82,522	7,289	29,169	324,389
% e realizimit	83.6%	61.3%	65.8%	57.3%	73.3%



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 73.3%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korrente	75.41 %
Shpenzime kapitale	57.3 %



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa fondeve të planifikuara:

Faktorët kryesorë janë fondet e trashëguara të cilat kanë rritur planin e vitit 2025 (vlerë e mbetur nga vitet e mëparshme)

Disa nga aktivitetet janë në proces zbatimi kontrate dhe do të realizohen gjatë vitit 2026:

Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër & të trashëguara është një aktivitet i cili nuk u realizua këtë vit për shkak të ndryshimit të sistemit të taksave të Bashkisë. Për vitin 2025 sistemi aktual është mirëmbajtur nga specialistët e bashkisë, ndërsa në vitet në vazhdim do realizohet me procedurë për sistemin e ri që po vendoset në punë.

Shërbimi i mirëmbajtjes së godinave administrative realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, institucion varësie në Bashkinë Shkodër e cila ka lidhur kontratën me nr 901/16 prot dt; 18.11.2025 për këtë shërbim dhe është në proces realizimi.

Aktiviteti Blerje paisje TIK. është në proces prokurimi. Vijimi i saj ka pësuar një zgjatje kohore për shkak të paraqitjes së ankesave nga operatorë ekonomikë, të cilat janë trajtuar sipas legjislacionit në fuqi.

Detyrime dhe kompensime legale & të trashëguara (Proçese gjyqësore me efekte financiare , nga ku një pjesë e fondit është e trashëguar nga viti paraardhës).

Raporti: M3 - Shpenzimet dhe Sasitë e Produkteve: Fakti - Planit (Janar - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AA141 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse

Viti: 2025

Vlerat paraqiten në: ALL

KODI	PRODUKTI		KUMULATIVE DERI NË FUND TË PERIUDHËS			NDRYSHIMI (%)		
			PLANI FILLESTAR	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR	
Funksioni 01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi								
V111AAA	Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim		Sasia	241	248	220	91.29%	88.71%
	Njësia e Matjes	nr. punonjesish të adm. dhe kryet. të fshatrave	Shpenzimet	221,027,987	248,824,343	199901458	90.44%	80.34%
V111AAB	Akte te Miratuara nga Këshilli Bashkiak		Sasia	70	85	85	121.43%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr.i akteve	Shpenzimet	20,531,000	21,116,912	18241833	88.85%	86.38%
V111AAD	Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi I Aparatit të Bashkisë		Sasia	12	12	12	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr.i godinave administrative	Shpenzimet	42,419,000	69,769,137	31645604	74.60%	45.36%
V111AAG	Përmbushja e Detyrimeve Gjyqësore		Sasia	12	12	9	75.00%	75.00%
	Njësia e Matjes	nr.vendimesh gjyqsore	Shpenzimet	10,000,000	18,854,962	7109242	71.09%	37.70%
V111AAH	Nëpunës të Trajnuar		Sasia	50	180	192	384.00%	106.67%
	Njësia e Matjes	nr.punonjësish	Shpenzimet	785,000	1,785,000	448394	57.12%	25.12%
Funksioni 01120 - Çeshtjet financiare dhe fiskale								
V112AAB	Subjekte Tregtare të Inspektuara		Sasia	4,800	5,095	5,095	106.15%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr.subjekte dhe individë	Shpenzimet	45,245,000	52,480,955	44448906	98.24%	84.70%
Funksioni 03600 - Marrëdhëniet me komunitetin								
V360AAA	Transparenca Publike		Sasia	6	6	6	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr.faqe web dhe nr video spot informativ	Shpenzimet	150,000	5,705,534	91000	60.67%	1.59%

M6: Raporti i Realizimit të Objektivave

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AA141 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse

OBJEKTIVI 1.1

Burime Njerezore cilesore dhe eficente për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi. Shërbime të deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.1.A	Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile. Numri i punonjësve që kanë qëndruar ne te njejten	nr	134	133	140	119	89.47%
TP 1.1.B	Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë. Masa disiplinore të marra	nr	0	0	0	10	N/A
TP 1.1.C	Numri i punonjësve/të zgjedhurve të trajnuar nga Akademia e Pushtetit Vendor	nr	0	138	138	0	0%
TP 1.1.D	Permbushja e detyrimit ne baze te ligjit Nr.139/2015"Për vetqeverisjen vend	leke	1,000	1,000	1,000	1,000	100%
TP 1.1.E	Persona përfaqesues të institucione vendase dhe të huaja	nr	627	500	500	154	30.8%

OBJEKTIVI 2.1

Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 2.1.A	Vendimarrje bashkiake e konsultuar me publikun. Numri i konsultimeve të realizuara kundrejt totalit	%	133	167	167	134	80.38%
TP 2.1.B	Bashkia angazhon qytetarët në vendimarrje. Numri total i mbledhjeve të KB të hapura për qytetarët ku	%	100	100	100	100	100%
TP 2.1.C ^[2]	Rritja e konsultimit me publikun. Numri i vendimeve bashkiake që janë marrë mbas konsultimit me publ	%	N/A	N/A	14	9	N/A

OBJEKTIVI 3.1

Shërbimet mbështetëse për administratën vendore sigurimi planifikimi e zhvillimi të njësisë, menaxhimin e financave të administrates vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 3.1.A	Eficensa e shërbimeve mbështetësë bazë - buxheti i shpenzuar per mirembajtje ne mije leke/numri te	leke/nr.ndërtes	1,380	1,461	2,241	1,644	112.53%
TP 3.1.B	Ndërtesat administrative të siguruara (NjA , Bashkia Qendër dhe Lagje) në numër	nr	11	12	11	11	91.67%
TP 3.1.C	Sipërfaqe në m2 ndërtesa të mirëmbajtura (NjA , Bashkia Qender dhe Lagje) - Sipërfaqja e mirëmbajt	%	7	23	16	13	57.02%
TP 3.1.D	Eficienca e shpenzimeve për mjetet e transportit në pronësi të Bashkisë - buxheti i shpenzuar në mi	leke/nr.mjete	463	612	902	774	126.47%
TP 3.1.E	Numri i njësive administrative me akses në internet	nr	36	31	31	33	106.45%
TP 3.1.F	Pajisjet TIK të reja dhe të mirëmbajtura kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	%	39	23	67	45	197.37%
TP 3.1.G	Numri i shërbimeve administrative elektronike	nr	69	69	69	69	100%
TP 3.1.H	Numri i sistemeve teknologjisë së informacionit Web Based me aksesueshmeri kombëtare dhe vendore në	nr	8	8	8	8	100%

OBJEKTIVI 3.2

Përbushje detyrimesh për ndjekje dhe përfaqësim procese gjyqësore ,shlyerje e detyrimesh qe rrjedhin nga vendime gjyqësore te formes se prere.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 3.2.A	Numri i proceseve gjyqësore në ndjekje	nr	132	121	121	110	90.91%
TP 3.2.B	Vendime gjyqësore të formes së prerë me efekte financiare në numër	nr	9	12	12	9	75%

OBJEKTIVI 3.3

Burime Njerezore të trajnuara , të kualifikuara të mbështetura për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 3.3.A	Rritja e kapaciteteve / burimeve njerëzore të bashkisë. Raporti i personave të trajnuar kundrejt to	%	103	34	115	143	425.6%
TP 3.3.B	Dite/dieta për person në vit udhëtime brenda dhe jashtë vendi - dite dieta ne vit	nr	272	163	163	189	115.95%

OBJEKTIVI 3.4

Zbatimi i ligjit per transferimin e komisionit per agjentin tatimor

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 3.4.A	Nr biznese dhe individe bllokim i pasurive te palujtshme dhe te luajtshme	nr	152	500	500	106	21.2%
TP 3.4.B	Shuma per pagesen e agjenteve tatimore ne mije leke ,shuma e paguar ne v	lekë	5,221	4,996	6,291	3,752	75.1%

OBJEKTIVI 3.5

Sigurimi i transparencës sa më të plotë me publikun

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 3.5.A	nr.i moduleve elektronike online në shërbim të qytetarëve	nr	11	11	11	11	100%
TP 3.5.B	Numri i kërkesave të procesuara për shërbime administrative elektronike gjatë vitit	nr	12,954	24,000	30,000	32,869	136.95%
TP 3.5.C	Numri i njësive administrative që ofrojnë shërbime elektronike	nr	11	11	11	11	100%

Për 12- mujorin e vitit 2025 në programin “Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2025 nga Administrata e Bashkisë janë parashikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë :

Tabela e produkteve / aktivitete ne ne 000/leke dhe realizimi i tyre

Produktet	Aktivite/Projekte	Institucioni	Statusi I aktivitetit	Plani Fillestar 2025	Plani I Rishikuar 2025	Realizim i 2025
				Totali	Totali	Totali
V111AAA. Shërbimi i Stafit të Administrim&Menaxhim (Nr.i punonjesve te administrates me burimet e veta dhe kryetarëve të fshatrave)	P.AA141.Q1.O1.A1. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe honorare për kryetarët e fshatrave & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimësi	216,835	241,523	195,276
	P.AA141.Q1.O1.A2. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	420	870	660
	P.AA141.Q1.O1.A3. Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	500	2,630	2,130
	P.AA141.Q1.O1.A4. Kuota Akademia e Pushtetit Vendor	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	773	773	-
	P.AA141.Q1.O1.A5. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut	Bashkia Shkodër	Realizuar	1,000	1,000	1,000
	P.AA141.Q1.O1.A6. Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja .& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimësi	1,500	2,028	835
V111AAB. Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak (Nr. i akteve)	P.AA141.Q2.O1.A1. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshillit Bashkiak)shpenzime korente dhe kapitale .& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimësi	20,531	21,117	18,242
V111AAD. Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë (Nr. i godinave administrative, NJA , Lagje , Bashkia Qendër)	P.AA141.Q3.O1.A1. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimësi	3,900	5,629	3,180
	P.AA141.Q3.O1.A2. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar në vazhdimësi	6,000	6,000	5,696
	P.AA141.Q3.O1.A3.Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	6,334	6,963	3,979
	P.AA141.Q3.O1.A4. Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	800	800	208

	P.AA141.Q3.O1.A4. Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)- TË TRASHËGUARA	Bashkia Shkodër	Vlerë e mbetur nga vitet e mëparshme	-	332	-
	AA141.Q3.O1.A5. Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	498	7,163	6,667
	P.AA141.Q3.O1.A6. Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	960	962	959
	P.AA141.Q3.O1.A7. Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Në proces realizimi kontrata nr.901/16 prot. datë 18.11.2025	3,100	3,100	-
	P.AA141.Q3.O1.A7. Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës- TË TRASHËGUARA	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	4,000	3,644
	P.AA141.Q3.O1.A8. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	4,284	6,315	5,416
	P.AA141.Q3.O1.A9. Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Marëveshje e kuadër 3-vjeçare	1,700	2,466	1,332
	P.AA141.Q3.O1.A10. Mirëmbajtje pajisje Informatike& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	614	760	564
	P.AA141.Q3.O1.A11. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Ne proces prokurimi(ankimimi)	9,461	13,401	-
	P.AA141.Q3.O1.A12. Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të bashkisë Shkodër & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	4,768	9,936	-
	P01110.Q3.O1.A12. Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive -TË TRASHËGUARA	Bashkia Shkodër	Fonde të ngurtesuara	-	1,943	-
P111AAS - Rikonstruksion godina ish konvikti Safet Spahia	Rikonstruksion godina ish konvikti Safet Spahia-TË TRASHËGUARA	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	22,503	22,502
V111AAG Përmbushja e Detyrimeve Gjyqësore (Nr.i vendimeve gjyqësore të formes së prerë	P.AA1410.Q3.O2.A1. Detyrime dhe kompensime legale & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimësi	10,000	18,413	7,109
	P.AA141.Q3.O2.A2.Shlyerja e detyrimeve te prapambetura & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Gjatë vitit	-	442	-
V111AAH. Nëpunës të trajnuar (Nr.punonjesish)	P.AA141.Q3.O3.A1.Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	100	800	-
	P.AA141.Q3.O3.A2. Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimësi	685	985	448

V112AAB. Subjekte Tregtare të Inspektuara (Nr.subjekte dhe individe)	P.AA141.Q3.O4.A1 .Paga per drejtorine e te ardhurave ,pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore dhe shpenzime korente dhe kapitale & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimës i	40,249	46,220	40,697
	P.AA141.Q3.O4.A2. Pagesa e komisionit si agjent tatimor & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	4,996	6,261	3,752
V360AAA. Transparenca Publike (Nr.faqe web dhe nr.video spoti informativ)	P.AA141.Q3.O5.A1. Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	-	56	-
	P.AA141.Q3.O5.A2. Sherbim hostimi per faqet web nen administrimin e bashkise	Bashkia Shkodër	Realizuar	150	150	91
	P.AA141.Q3.O5.A3. Informimi I qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	-	500	-
	P.AA141.Q3.O5.A4 Blerje licenca software	Bashkia Shkodër	Kontrate e lidhur nr.19428/1 1 datë 17.12.202 5	-	5,000	-
P111AAY- Per zgjerimin e sistemit te Integruar te Zyrave me nje Ndalese-SiZ1N-Grant nga DLDP	Per zgjerimin e sistemit te Integruar te Zyrave me nje Ndalese-SiZ1N-Grant nga DLDP -TË TRASHËGUARA	Bashkia Shkodër	Vlerë e mbetur nga vitet e e mëparshme	-	926	-
P111AAZ- Bashki te Forta nga Helvetas Ekspertize konsulence per keshillin bashkiak	Bashki te Forta nga Helvetas Ekspertize konsulence per keshillin bashkiak -TË TRASHËGUARA	Bashkia Shkodër	Vlerë e mbetur nga vitet e e mëparshme	-	319	-
P111ABA - Implementimi i dokumentacionit të integruar i qendërzuar për të gjithë Bashkinë Shkodër në platformën Microsoft 365, Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar në Cloud	Implementimi i dokumentacionit të integruar i qendërzuar për të gjithë Bashkinë Shkodër në platformën Microsoft 365, Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar në Cloud	Bashkia Shkodër	Vlerë e mbetur nga vitet e e mëparshme	-	50	-
P.AA141 Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse				340,158	442,334	324,389
Të trashëguara				103,853	-	-
Totali				444,011	442,334	324,389

Gjendja Civile

Produktet	Aktivite/Projekte	Institucioni	Statusi i aktivitetit	Plani i rishikuar 2025	Realizimi 12- mujori 2025
				Totali	Totali
Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim (Numri i punonjësve të Gjendjes civile)	P01170.Q1.O1.A2. Shërbimet e deleguara Gjendja Civile-burim financimi transferte e kushtezuar	Bashkia Shkodër	Realizuar në vazhdimësi	28,153	27,775

Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës.

Për 12-mujorin e vitit 2025 në programin **AA141 “Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse”** në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2025, nga administrata e Bashkisë janë analizuar si më poshtë aktivitetet:

P.AA141.Q1.O1.A1. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe honorare për kryetarët e fshatrave & te trasheguara

Synimet e këtij projekti janë :

Qeverisje e mirë lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv, eficient dhe profesional të burimeve njerëzore.

Shpenzime efikase për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të nëpunësve të administratës vendore.

Shpërblimi i kryetarëve të fshatit të njësive administrative në formën e shpërblimit (honorareve), në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me pagesën e punonjësve të administratës vendore dhe pagesa e honorareve për kryetarët e fshatrave.

Me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar , ndërsa niveli i pagave me VKB nr. 54, datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”,

Paga dhe shtesat mbi paga. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të pagës bazë minimale në shkallë vendi, Vendimit nr.113, datë 01.03.2023 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar, në mbështetje të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar ; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Për pagesën e këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave :

nenit 51 ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar – Të drejtat e këshilltarit ku thuhet – Këshilltari kryen funksion me shpërblim mujor të barabartë me 10 % të pagës mujore të

Kryetarit të Bashkisë përkatëse.

nenit 9 të ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike ku thuhet : shpërblimin mujor të kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pages mujore të kryetarit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Për shpërblimin e kryetarëve të fshatit të Njësisë Administrative në territorin e Bashkisë Shkodër, zbatohet ligji nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar, i cili rregullon efektet e masës së shpërblimit për kryetarët e fshatrave të Njësisë Administrative.

Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Realizohet në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 10383 datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyruar të kujdesit shëndetësor” dhe udhëzimin nr 23 dt 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore”

Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim në familje

Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, i ndryshuar , VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24.12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit.

Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës. Në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, për gjithë vitin 2025 është realizuar menaxhimi efektiv dhe shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve si dhe shpërblimi i honorareve të kryetarëve të fshatit të Njësisë Administrative në territorin e Bashkisë Shkodër , në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

P01110.Q1.O1.A2. Shërbimet e deleguara (Gjendja Civile) transfertë e kushtëzuar

Është realizuar në vazhdimësi prodhimi i dokumentave në shërbim të qytetarëve dhe mbështetja e funksionimit të strukturës së Gjendjes Civile në Bashki Qendër dhe Njësi Administrative, miratuar sipas Vendimit nr.1299, datë 26.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/ njësi administrative dhe në degët e qarqeve”, i ndryshuar ; përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. , operative dhe transferime

P.AA141.Q1.O1.A2. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve & të trashëguara

Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qënë pjesë e administratës vendore

përmes procedurave të përcaktuara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve. Këto rekrutime realizohen me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar dhe është realizuar rekrutimi për vendet vakante të shpallura Sipas ligjit konkurimi ndjek disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimi. Anëtarë të këtij komisioni, nga të cilët disa prej tyre ekspertë të jashtëm, të cilët në bazë të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar paguhen në vlerën 10.000 lekë për çdo procedurë konkurimi. Anëtarët e KPLP dhe KPND, paguhen në vlerën 5.000 lekë për çdo procedurë konkurimi. (janë realizuar pagesat për ekspertët e jashtëm : 21 procedura rekrutimi për kategorinë ekzekutive, 9 procedura rekrutimi për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe 2 procedura për kategorinë e lartë drejtuese)

Këto shpenzime përballohen nga buxheti i Bashkisë Shkodër bazuar në planin vjetor të nevojës për rekrutime.

P.AA141.Q1.O1.A3 Anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

Me vendimin nr.5 datë 20.12.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës për Autonominë Vendore u bë ndryshimi i emrit nga "Shoqata për Autonominë Vendore" në "Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë", ndryshimi i Logos dhe Selisë së Shoqatës, shfuqizimi i Statutit dhe rregullores së vjetër të Shoqatës, miratimi i dhe hyrja në fuqi i Statutit dhe Rregullores së re. Në këtë Shoqatë aderon edhe Bashkia Shkodër. Kjo Shoqatë është një shoqatë jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse. Shoqata është një bashkim vullnetar dhe i pavarur i Bashkive dhe mban statusin e një organizate jofitimprurëse (OJF) me një shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e vendit. Përpjekjet e saj të vazhdueshme kanë synuar sensibilizimin e strukturave dhe institucioneve të pushtetit qendror për përsheptimin e procesit të decentralizimit, si dhe konsolidimi i rolit të bashkive në ushtrim të rolit të tyre qeverisës, duke dhënë në vazhdimësi rezultate konkrete. Roli dhe kontributi i shoqatës sot është mjaft i vlerësuar dhe i njohur jo vetëm nga anëtarët e saj por edhe nga institucionet në pushtetin qendror, donatorët, shoqatat ndërkombëtare të autoriteteve vendore.

Qëllimi i saj është që të lehtësojë vendosjen e kontakteve ndërmjet Bashkive brenda vendit dhe partnerëve të tyre jashtë vendit, si shoqata simotra e institucione ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e informacioneve, eksperiencave dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta të bashkëpunimit. Anëtare e Shoqatës, mund të jetë çdo bashki e RSh, e cila pranon statutin e shoqatës, angazhohet të punojë për realizimin e misionit dhe qëllimeve të shoqatës, si dhe të paguajë kuotën e anëtarësisë sipas kushteve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe Statusi i Shoqatës, nenin 7, pika b) dhe nenit 11 pika k) Realizuar pagesa e kuotës së anëtarësisë.

P.AA141.Q1.O1.A4. Kuota Akademia e Pushtetit Vendor

Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV), në mënyrë që ato të ushtrojnë këto funksione sipas ligjit,

standarteve, me efektivitet, efencë dhe në përputhje me strategjitë e zhvillimit kombëtar. Ky ligj kërkon qartë trajnim sistematik dhe të buxhetuar të trupës legjislativë dhe ekzekutive të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64/h), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak, për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë efektive dhe efikase, ndërkohë financimi i trajnimeve dhe kualifikimeve do të bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi (Neni 51/4). Kushtet e shërbimit të punonjësve të NJVV-ve duhet të jenë të tilla që të lejojnë rekrutimin e personelit të cilësisë së lartë, në baza të meritave dhe kompetencave, dhe për këtë qëllim ata gëzojnë të drejtën për të marrë trajnime përmes NJVV-ve, pasi trajnimi si shërbim thelbësor i çdo politike për burimet njerëzore, u mundëson punonjësve përditësimin e diturive dhe aftësive të tyre.

Trajnimi është një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u siguruar që të zgjedhurit vendorë do t'i kryejnë detyrat e tyre me efikasitet. Duke qenë se këshillat vendorë ndryshojë vazhdimisht mbas cdo mandati, NJVV-të pritët që t'u ofrojnë përfaqësuesve të zgjedhur, posaçërisht këshilltarëve të zgjedhur rishtas, programe trajnuese për rolin, detyrat dhe kufizimet e politikanëve të zgjedhur. Programe të tilla pritët që të ofrojnë njohuri për çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e autoriteteve vendore si financat, transparenca, të qenit të hapur, kodi i etikës, konflikti i interesit, konsultimi publik dhe llogaridhënia.

Nisur nga sa më sipër pritët që NJVV-të dhe Qeveria Qendrore duhet të mbështesin në mënyrë më të qëndrueshme trajnimet e detyrueshme, zhvillimit profesional dhe platformave për shkëmbimin e njohurive mes stafeve dhe të zgjedhurve vendorë, për të rritur performancën e qeverisjes vendore. Alokimi i këtij buxheti për trajnimin e punonjësve dhe të zgjedhurve vendorë është bërë edhe në reference të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 3 datë 28.02.2024 Për përgatitjen e PBA-së Vendore 2025-2027 dhe i përket programit buxhetor “*Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse*” ku përfshihen sipas përshkrimit “Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë NJVV apo palë të treta (p.sh. ASPA, projekte të ndryshme, etj.).

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr 56.dt 25.09.2025 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”. u miratua marrëveshja për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Procesi i integritetit evropian kërkon angazhimin e fortë të NJVV-ve për përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadër të anëtarësimit. Ky proces do t'u mundësojë NJVV-ve të përfitojnë nga programet dhe projektet mbështetëse të Bashkimit Evropian, dhe në të këtë kuadër profesionalizmi i zyrtarëve të NJVV-ve dhe e TALGA merr një rëndësi parësore.

P.AA141.Q1.O1.A5. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut

Në zbatim të udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore, kuotat e miratuara nga këshilli i qarkut bëhen pjesë e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore. Mes Bashkisë Shkodër dhe këshillit të qarkut Shkodër është lidhur akt- marrëveshja për detyrimin vjetor ndaj këshillit të qarkut dhe mbi bazën e faturës për arkëtim të lëshuar nga këshilli i qarkut. Është realizuar transferimi i brendshëm nga Bashkia Shkodër në favor të këshillit të qarkut nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin në

sistemin informatik financiar të qeverisë.

P.AA141.Q1.O1.A6 Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja.

Ky aktivitet ka si synim që në kuadër të bashkëpunimit me shtete të tjera, në nivel lokal, rajonal dhe më gjërë, të vendosë dhe nxitë bashkëpunimet midis qyteteve dhe partnerëve lokal, rajonal dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat, për zhvillimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe. Në kuadër të eksperiencave për arritjen dhe zhvillimin e kontakteve të krijuara nga përfaqësuesit tanë kemi synim arritjen e standarteve në nivele të përafërta me qytetet e tjera evropiane. Gjithashtu për rritjen e harmonisë fetare në qytetin e Shkodrës është shtruar Iftar për komunitetin mysliman dhe qytetarët e Shkodrës me rastin e Muajit të Madherueshëm të Ramazanit për 154 persona dhe është realizuar blerja e dhuratave për personalitete që vizitojnë Bashkinë Shkodër

P.AA141.Q2.O1.A1. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshillit Bashkiak) shpenzime korente dhe kapitale & te trashëguara

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Këshilli Bashkiak përbëhet nga 51 këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Është siguruar mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore dhe realizuar shpërblimi mujor në mënyrë sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e Këshillit Bashkiak.

P.AA141.Q3.O1.A1. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës & te trashëguara.

Është realizuar në vazhdimësi funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si: Shërbime postare ;Shërbime telefoni celulare; Shërbime të printimit dhe publikimit në media; Shërbim higjeno sanitar; Larje tapeta, automjete; Shpenzime të tjera (buqeta, kurora,lule) ; Rimbushje fikëse zjarri; Shërbime përkthimi etj

P.AA141.Q3.O1.A2. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës

Është realizuar në vazhdimësi pagesa për funksionimin normal të administratës së Bashkisë Shkodër nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike nga Institucioni ndjekës Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike , institucion varësie në Bashkinë Shkodër.

P.AA141.Q3.O1.A3. Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës & te trashëguara

Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj. sipas kërkesave të drejtorive. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, dhe bojëra për printera e fotokopje dhe shtypshkrime i mundëson punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave. Është lidhur kontrata dhe po bëhet furnizimi dhe marrja në dorëzim e materialeve Gjatë vitit 2025 është lidhur kontrata, dhe ka vijuar furnizimi me kancelari, letër, bojëra për printera dhe fotokopje, si dhe shtypshkrime, sipas kërkesave të paraqitura nga drejtoritë dhe njësitë përkatëse për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të detyrave funksionale dhe objektivave

institucionale.

P.AA141.Q3.O1.A4. Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)

Është realizuar dhe siguruar në vazhdimësi mbështetja për shërbimet mbështetëse bazë për mirëmbajtjen dhe furnizimin me materiale elektrike dhe hidraulike nga institucioni ndjekës Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike , institucion varësie në Shkodër.

P.AA141.Q3.O1.A4. Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)- të trashëguara.

Është realizuar dhe siguruar në vazhdimësi mbështetja për shërbimet mbështetëse bazë për mirëmbajtjen dhe furnizimin me materiale elektrike, hidraulike nga institucioni ndjekës Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike . Vlera tek aktivitetet të trashëguara është vlerë e mbetur nga vitet e mëparshme.

AA141.Q3.O1.A5. Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara

Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm për funksionimin normal të administratës së Bashkisë Shkodër me pajisje zyre si kondicionerë, tavolina, raftet etj.

Ky aktivitet është realizuar

P.AA141.Q3.O1.A6. Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës. & të trashëguara

Bashkia Shkodër ka detyrim ligjor për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet e tjera të pronave dhe inventarit të saj ekonomik. Sigurimet e ndërtesave reduktojnë barrën financiare dhe lehtësojnë vazhdimësinë e institucionit duke ulur kostot publike në rast të ndodhjes së fatkeqësive.

Ky shërbim është realizuar për ndërtesën e Bashkisë Qendër, magazinave dhe Njësive Administrative.

P.AA141.Q3.O1.A7. Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës

Ndërtesa e Bashkisë Qendër dhe e Njësive Administrative duhet të jetë në kushte fizike normale të pranueshme për administratën, me qëllim kryerjen e detyrave të përditshme si edhe për qytetarët të cilët paraqiten në ato ambiente për të marrë shërbimin e nevojshëm. Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike , institucion varësie në Bashkinë Shkodër ka lidhur kontratën me nr 901/16 prot dt; 18.11.2025 për mirëmbajtjen e godinave administrative dhe është në proces realizimi.

P.AA141.Q3.O1.A7 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara

Ndërtesa e Bashkisë Qendër dhe e Njësive Administrative duhet të jetë në kushte fizike normale të pranueshme për administratën, me qëllim kryerjen e detyrave të përditshme si edhe për qytetarët të cilët paraqiten në ato ambiente për të marrë shërbimin e nevojshëm.

Është realizuar përgatitja e projektit teknik; Përgatitja e preventivit dhe dokumentave përkatëse të nevojshme për prokurimin e shërbimit ; Kryerja e shpenzimit; Monitorimi i zbatimit të projektit teknik nga grupi i specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

institucion varësie në Bashkinë Shkodër dhe realizimi i shërbimit.
Në proces realizimi kontrate nr.901/16 prot. datë 18.11.2025

P.AA141.Q3.O1.A8. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara

Janë siguruar në vazhdimësi dhe realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave në Bashkinë qendër, Njësi Administrative etj. shlyerja e të gjitha taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës. Ky aktivitet është realizuar

P.AA141.Q3.O1.A9 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara.

Gjatë vitit të kaluar është realizuar prokurimi dhe ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje). Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem të qendërzuar të marrjes së shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagje dhe Qendra Komunitare në total 31 pika shërbimi. Zgjidhja e implementuar ofron 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Sistemi siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që transmetohet në linjat e komunikimit. Të gjithë pikat e furnizuara të Bashkisë Shkodër kanë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim.

Ky shërbim ka rritur shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ka ulur kostot operative për komunikimin e informacionit, ka garantuar mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që Bashkia ka implementuar dhe ka shtrirë në të gjithë njësitë e saj administrative, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendërzuar kombëtar i shërbimeve të Ndihmës Ekonomike, e- Lejet, Sistemi AFMIS, portali i Transparencës së Buxhetit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al, menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj. Ky aktivitet realizohet në vijimësi të marrëveshjes kuadër 3 vjeçare.

P.AA141.Q3.O1.A10. Mirëmbajtje pajisje Informatike & të trashëguara

Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Është bërë vazhdimisht një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjeve dhe Qendrave Komunitare, ku janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI. Ky shërbim i siguruar sistematikisht çdo vit nga buxheti i Bashkisë Shkodër, ka mbështetur administratën vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Ky aktivitet është realizuar

P.AA141.Q3.O1.A11. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) & të trashëguara

Nevoja për ripërtëritje të pajisjeve ekzistuese TIK ka qenë vazhdimisht dhe është e nevojshme për t'u bërë gradualisht nga viti në vit. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licensuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI- t për Komunikimet Elektronike, asaj të Blerjeve

të Pajisjeve TIK dhe plotësimit të standarteve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike.

Bashkia ka mundësuar pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në mbështetje të punës së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit

Ky aktiviteti është në proces prokurimi. Vijimi i këtij aktiviteti ka pësuar një zgjatje kohore për shkak të paraqitjes së ankesave nga operatorë ekonomikë, të cilat janë trajtuar sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkinë Shkodër. Janë rivlerësuar paisjet dhe kërkesat e stafit dhe është përfunduar përgatitja e dokumentacionit .Aktualisht procedura është në proces prokurimi (ankimimi) për shkak të paraqitjes së ankesave nga operatorë ekonomikë, të cilat janë trajtuar sipas legjislacionit në fuqi

P.AA141.Q3.O1.A12. Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të bashkisë Shkodër & të trashëguara

Një tjetër iniciativë inovative e Bashkisë Shkodër është ajo e përfshirjes së qytetarëve në buxhetim përmes përdorimit të platformës online Transparenca e Buxhetit, një instrument Open Data i realizuar për herë të parë dhe të vetme në Shqipëri. Ky instrument online informon publikun për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve si dhe i fton ato të shprehen online për kërkesa apo pakënaqësi të mundshme t'i drejtohen zyrave përkatëse përgjegjëse në Bashki për zgjidhjen.

Bashkia Shkodër ka arritur ofrimin e shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente. Kjo ka rritur llogaridhënien financiare dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Sistemet e Integruara kanë përmirësuar rrjedhën e punës ndërmjet drejtorive duke pasqyruar në mënyrë të thjeshtë secilin hap për trajtimin e aplikimeve të qytetarëve. Mirëmbajtja e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër & të trashëguara është një aktivitet, i cili nuk do të realizohet këtë vit për shkak të ndryshimit të sistemit të taksave të bashkisë. Për vitin 2025 sistemi aktual do të mirëmbahet nga specialistët e bashkisë, ndërsa në vitet në vazhdim do realizohet me procedurë për sistemin e ri që po vendoset në punë.

P01110.Q3.O1.A12. Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive -të trashëguara

Është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik “*Infosoft Software Developer*” dhe janë kryer disa nga pikat kryesore të saj, si instalimi i sistemit në postet e punës, konfigurimi i planit kontabël apo i artikujve të ndryshëm të magazinës, trajnimet bazë mbi disa nga modulet kryesore të saj. Duke qenë se nuk janë plotësuar specifikimet teknike sipas kërkesës nga Drejtoria e Financës, fondet janë të ngrira në thesar dhe do merren masat ligjore për zgjidhjen e kontratës.

P01110.Q3.O1.A14 Rikonstruksion godina ish konvikti Safet Spahia-të trashëguara

Ky aktivitet është ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve publike. Është realizuar kontrata.

Drejtoria Juridike

P.AA1410.Q3.O2.A1. Detyrime dhe kompensime legale & të trashëguara

Nga drejtoria juridike për 8- mujorin e vitit 2025, janë realizuar veprimtaritë si më poshtë :

Janë ndjekur 110 procese gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

Nga ky total i çështjeve gjyqësore 84 janë procese me efekte financiare.

Kemi administruar 8 (tetë) vendime gjyqësore të formës së prerë me efekte financiare.

Kemi derguar për likuidim 8 (tetë) vendime gjyqësore të formës së prerë.

Janë shpenzuar për pagesë tarifë pulla (njoftimi/tërheqjevendimi/depozitim padie/depozitim ankimi

.

Janë realizshpenzuar për likuidim vendime gjyqësore dhe tituj ekzekutiv/gjoba të institucioneve kompetente .

Nuk është depozituar asnjë kërkesë padi me palë paditëse : Bashkia Shkodër

Janë zbatuar me rigorozitet dispozitat ligjore në fuqi, sa i takon ndjekjes së të gjitha shkallëve të gjykimit për të gjithë proceset gjyqësore me efekte financiare.

P.AA141.Q3.O2.A2.Shlyerja e detyrimeve të prapambetura & të trashëguara

Ky fond është me transfertë sektoriale sjellë nga Ministria për të paguar detyrimet e prapambetura nuk është realizuar për shkak se nuk kemi detyrime që mund të paguajmë me dokumentacion të rregullt financiar dhe ligjor.

P.AA141.Q3.O3.A1.Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara

Ky aktivitet synon që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryejnë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Për 4 mujorin e dytë të vitit 2025 janë realizuar disa trajnime për punonjësit me status nëpunësi civil nga ASPA, trajnimet e detyrueshme për punonjësit në periudhë prove si edhe trajnime të tjera me kërkesë të institucionit dhe të vet punonjësit si:

- Higjena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë;
 - Prokurime publike (fusha menaxhim);
 - Lidershipi;
 - Roli i burimeve njerëzore në zbatimin e ligjit dhe konsolidimin e administratës publike;
 - HRMSI- Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Regjistri Qendror i Personelit) dhe platforma e Bashkëpunimit (Collab);
 - TAIEX Workshop roli i bashkive në procesin e integrimit europian;
 - Roli i bashkive të Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Europian;
 - Trajnim i përbashkët për dy FD-të për mbrojtjen nga zjarri dhe shuarjen e zjarreve në zonat pyjore;
 - Familje të qëndrueshme-një hap jashtë varfërisë;
 - Hartimi i planeve vendore sociale dhe planeve vendore për barazinë gjinore;
 - Fuqizimi i menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel lokal-LOCAL DRM;
 - Roli i aktorëve lokalë në fuqizimin dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe të rinjve.
- Rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional në parandalimin e dhunës dhe kriminalitetit

tek të rinjtë dhe fëmijët;

- The role of open data for sustainable and eco-sustainable mobility;
- Navigating the GGP - path project orientation in Albania;
- Forcimi i aftësive financiare për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel lokal - Projekti Local DRM;
- Trajnim në kuadër të UrbanEx;
- Migracioni në Shqipëri;
- Mbështetje për task forcen e qeseve plastike njëpërdorimshe;
- Migration Governance at the local governance;
- Fuqizimi i përgatitjes - gatishmërisë financiare në nivel vendor;
- Tranzicioni i gjelbër dhe rruga drejt një ekonomie qarkulluese në bashki (EU4green);
- DAPHNE nën programin GERV;
- Seminar për Migrimin dhe Diasporen;
- Shërbimet Publike dhe riintegrimi social-ekonomik i personave të rikthyer nga emigracioni;
- Fuqizimi i grave për zhvillimin rural në Shqipërinë e veriut;
- Qasje të integruara dhe shumësektoriale për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve;
- Moduli “Sigurimi i cilësisë”;
- Bashkëpunimi ndërinstitutional për adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore në nivel vendor;
- Punësimi i fëmijëve dhe ligji për mbrojtjen nga punësimi. etj.
- Të drejtat themelore të njeriut dhe administrata publike në Shqipëri;
- Etika, integriteti dhe konflikti i interesave në administratën publike;
- Energy Community Accelerator;
- MS – Excel niveli i avancuar;
- Edukimi për IA për Zyrtarët e Qeverisjes Vendore në Shqipëri;
- Vlerësimi, kontrolli dhe audit;
- Konflikti i interesave;
- Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore në BE;
- Procesi i vlerësimit të punës në zbatim të ligjit për shërbimin civil;
- Njohja me institucionet komunitare. Gjykata e Audituesve;
- Marrëdhëniet individuale të punës, të drejtat, detyrimet dhe përparësitë e normave juridike;
- Transparenca dhe aksesimi në informacionin publik;
- Deklarimi i pasurive, llojet dhe afatet e deklarimit të pasurive;
- Praktikat më të mira audituese;
- Liderhipi organizativ (individual dhe kolektiv);
- Aftësitë menaxheriale për zhvillimin e burimeve njerëzore;
- Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve;
- Menaxhimi i fondeve të Bashkimit Europian;
- Inteligjenca Artificiale në Administratën Publike;
- E ardhmja e menaxhimit të projekteve, certifikimi, digjitalizimi dhe transformimi i profesionit;
- Sistemi elektronik i Prokurimit Publik (Tema 1);
- Sistemi elektronik i Prokurimit Publik (Tema 2);
- Liderhipi i bazuar në vlera dhe etikë;
- Konsultimi Publik i Draft/Akteve;

- Fazat e procedurës administrative, fillimi i procedurës dhe hetimi administrativ;
- Përmirësimi i sistemit e-Leje;
- Digital innovations for soil and crop health;
- Menaxhimi i Rastit në Procesin e ribashkimit të fëmijës me familjen biologjike;
- Vendosje e kufinjve personal dhe profesional. 2-Parandalimi i konsumimit profesional Burnout dhe bore-out. 3- Forcimi i bashkëpunimit në ekip;
- Ndërtimi i kapaciteteve për punën me autorët e dhunës;
- Standartet e punës me dhunuesin në familje;
- Këshillimi në Karrierë;
- Trajnim lidhur me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe sigurinë online;
P.AC141.Q1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor realizohet në fund të çdo viti buxhetor.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026 - 2028, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është realizuar kuadri logjik i PBA-së dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Prandaj monitorimi i ecurisë së zbatimit u bë mbështetur në informacionet për gjendjen e zbatimit dhe të financimit të projekteve të strategjisë deri në fund të vitit buxhetor.

Për të adresuar 5 objektivat strategjike të planifikuara në këtë plan janë parashikuar 198 projekte. Në përfundim të monitorimit të zbatimit të strategjisë territoriale Shkodër, deri në fund të vitit buxhetor 2025 raportohen 41 projekte të zbatuara, 90 projekte në proces zbatimi dhe 67 projekte me ecuri të ulët zbatimi. Pjesa më e madhe e projekteve të parashikuara në matricën e projekteve strategjike janë projekte infrastrukturore.

Në kuptim të zbatimit të objektivave të strategjisë, objektivat 1, 2 dhe 3 vlerësohen me ecurinë më të mirë të zbatimit, Objektivat 4 dhe 5 vlerësohen me ecurinë më të ulët të zbatimit.

P.AC141.Q1.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe e zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD). Ky program përfaqëson vazhdimësinë e fazave të mëparshme ReLOaD1 dhe ReLOaD2, të cilat u zbatuan gjatë periudhës 2017–2024.

Faza e tretë e programit ka nisur më 1 shkurt 2025 dhe do të zbatohet për një periudhë katërvjeçare në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë. Në kuadër të këtij programi rajonal, Bashkia Shkodër është përzgjedhur si një nga shtatë bashkitë partnere në nivel kombëtar, duke u shpallur fituese në procesin e përzgjedhjes.

Në kuadër të zbatimit të ReLOaD3, Bashkia Shkodër ka shpallur thirrjen publike të dedikuar për organizatat e shoqërisë civile. Thirrja është publikuar më 16.12.2025 në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër, si dhe në rrjetet sociale përkatëse, dhe qëndron e hapur për aplikime deri më 20 janar 2026. Fondi total i vënë në dispozicion për vitin 2026 është 4,500,000 lekë nga të cilat 2,300,000 leke janë bashkefinancim i Bashkisë Shkodër.

Gjithashtu, gjatë muajit dhjetor 2025 është organizuar Takimi Konsultues me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), me qëllim përcaktimin përfundimtar të fushave prioritare për thirrjen. Nga tre propozimet fillestare për fushat prioritare dhe nënprioritetet, gjatë këtij takimi u miratuan tre fusha prioritare, së bashku me nënprioritetet përkatëse, si më poshtë:

- **Prioriteti 1:** Fuqizimi i rinisë, kreativiteti digjital dhe inovacioni social
- **Prioriteti 2:** Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, marketingut lokal dhe ekonomisë qarkulluese
- **Prioriteti 3:** Ndërgjegjësimi dhe edukimi për Integrimin Evropian

P.AC141.Q1.O1.A3. Brandimi i territorit të Bashkisë Shkodër

Bashkia Shkodër ka ndërmarrë procedurën për hartimin dhe zbatimin e strategjisë së brandimit territorial dhe institucional, me qëllim ndërtimin e një identiteti autentik, të qëndrueshëm dhe tërheqës, i cili shërben si bazë për promovimin e vlerave lokale dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe turistik të territorit. Ky proces synon të promovojë trashëgiminë historike, kulturore dhe natyrore të Shkodrës, duke i integruar ato në një narrativë të qartë dhe të dallueshme që rrit dukshmërinë dhe konkurrueshmërinë e territorit.

Si një pikë kyçe për investime rajonale dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, Shkodra tashmë disponon një identitet të unifikuar dhe profesional në komunikimin institucional dhe në prezantimin ndaj partnerëve strategjikë, investitorëve potencialë dhe aktorëve të tjerë të interesit. Brandimi territorial shërben si një mjet strategjik për konsolidimin e imazhit të vendit, duke krijuar një perceptim të unifikuar dhe konkurrues ndaj investitorëve, vizitorëve dhe partnerëve strategjikë.

Ky proces brandimi ka për qëllim të kontribuojë në forcimin e imazhit të Shkodrës si një territor me potencial të lartë zhvillimi, duke mbështetur krijimin e mundësive të reja ekonomike, promovimin e sipërmarrjes lokale, tërheqjen e investimeve dhe rritjen e flukseve turistike. I gjithë procesi ka përfunduar dhe jemi në fazën e zbatimit të rezultateve të strategjisë së brandimit territorial.

P.AC141.Q1.O1.A4. Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj

Procesi i integritit evropian përkthehet në negocimin e 33 kapitujve të Acquis së BE dhe kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, ku një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Pothuajse 50-70% e kuadrit ligjor të BE-së duhet të zbatohet në nivel vendor prandaj acquis-i i BE-së ka një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Integriti në BE konsiderohet si perspektiva më e mirë e zhvillimit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i integritit evropian është mbulimi i shpenzimeve për projektet që përfitojnë financim nga BE dhe donatorë të tjerë. Kjo përfshin implementimin e projekteve konkrete që jo vetëm përmirësojnë infrastrukturën dhe shërbimet publike, por gjithashtu rrisin mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social në nivel lokal. Mënyrë Bashkia Shkodër ka aplikuar deri tani në programet: INTERREG SOUTH ADRIATIC Itali - Shqipëri - Mali i Zi (2), CERV-2025-CITIZENS-TOWN-NT (1), Programi WiFi4Western Balkan (1), Reload3 (1), CERV-2025-CITIZENS-CIV, ERASMUS-EDU-2025-PEX-COVE, URBACT IV, CREA-CULT-2025-COOP, CERV-2025-DAPHNE, Programi Adrion, EUKI programme, CERV-2025-CITIZENS-TOWN-TT, HORIZON-CL2-2025-01-HERITAGE-08, Fondo per le Comunità Europee dell'Energia, Granti i asistences se Ambasadës Japoneze, Sunny Schools & Local Energy Community, etj. Nga të cilat 26 janë aplikime me donator BE, 7 projekte në aplikime kombëtare dhe 2 projekte aplikime në ambasada. Gjithashtu vazhdon të jetë anëtarëtare në Rrjetin e Qyteteve Ballkanike B40 Balkan Cities Network.

Një tjetër aktivitet i realizuar ishte “Dita Ndërkombëtare e Solidaritetit Njerëzor”, i cili u zhvillua në kuadër të promovimit të ditëve evropiane dhe ndërkombëtare.

P.AC141.Q1.O1.A5. Bashkia për BE-në

Programimi dhe zbatimi me efikasitet i fondeve të Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë përbën një nga prioritetet strategjike të Bashkisë Shkodër, në funksion të forcimit të kapaciteteve institucionale. Ky angazhim pasqyrohet në mënyrë konkrete përmes veprimtarisë së vazhdueshme të Sektorit të Integritit Evropian, i cili, në përputhje me planifikimin vjetor dhe kalendarin e ditëve evropiane dhe ndërkombëtare, organizon çdo muaj të paktën dy aktivitete informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuere.

Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me aktorë të rëndësishëm lokalë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, institucionet arsimore 9-vjeçare dhe të mesme (të përgjithshme dhe profesionale), Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, si dhe institucione të tjera vendore. Në fokus të këtyre iniciativave ka qenë promovimi i vlerave themelore të Bashkimit Evropian, rritja e ndërgjegjësimit qytetar mbi procesin e integritit evropian dhe inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe grupeve të interesit.

Gjatë vitit raportues janë realizuar një sërë aktivitete tematike, ndër të cilat: Dita e Tokës; takime informuese me nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme; Dita Botërore e Konsumatorit; aktiviteti “Integrimi Evropian dhe Siguria Kibernetike”, me fokus sfidat dhe mundësitë në epokën digjitale; si dhe aktiviteti edukativ për fëmijë “Duart e vogla mbjellin lule”, i cili synoi edukimin mjedisor në mënyrë kreative për moshat e vogla.

Në kuadër të Javës Evropiane 2025, u organizua me sukses **Shkolla Pranverore Evropiane**, një iniciativë që synoi fuqizimin e të rinjve dhe afrimin e tyre me procesin e integritit evropian. Aktiviteti krijoi një hapësirë ndërvepruese për edukim, reflektim dhe pjesëmarrje aktive, duke kontribuar në rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimit mbi perspektivën evropiane të Shqipërisë.

Programi i Shkollës Pranverore përfshiu një seri sesionesh tematike të zhvilluara përgjatë disa ditëve, ku u trajtuan çështje si: mundësitë që ofron Bashkimi Evropian në fushën e sportit, trashëgimisë kulturore dhe turizmit; roli i startup-eve dhe sipërmarrjes rinore në zhvillimin ekonomik; procesi i dixhitalizimit dhe lidhja e tij me kapitujt e negociatave për anëtarësim; si dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërkufitar nëpërmjet programeve IPA. Një vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të kulturës dhe muzikës si elementë që forcojnë identitetin dhe përkatësinë evropiane.

Shkolla Pranverore u përmbyll me një vizitë simbolike në Kishën e Shirqit, monument i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore, duke theksuar rolin e kulturës në procesin e integritit evropian. Gjatë gjithë aktivitetit, pjesëmarrësit patën mundësi të bashkëbisedojnë me ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve lokale dhe ndërkombëtare, duke u angazhuar në diskutime mbi tema me rëndësi për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit.

Gjithashtu, gjatë vitit janë realizuar aktivitete të tjera sensibilizuese që kanë sjellë në vëmendje rëndësinë e ditëve evropiane dhe ndërkombëtare, si: Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, Panairi i Gjuhëve Evropiane, etj. Realizimi i aktiviteteve është kryer në përputhje me kalendarin vjetor të ngjarjeve evropiane dhe planifikimin institucional.

P.AC141.Q1.O1.A6. Diaspora dhe migracioni

Diaspora dhe migracioni përbëjnë elementë të rëndësishëm për zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të Bashkisë Shkodër. Në këtë kontekst, prania e diasporës në Shkodër luan një rol të rëndësishëm përmes remitancave, investimeve dhe shkëmbimit të njohurive, kulturës, sportit, etj. Kjo lidhje me diasporën ndihmon në rritjen e mundësive për zhvillim dhe forcimin e lidhjeve mes qytetit dhe shqiptarëve jashtë vendit. Në përputhje me funksionet e pushtetit vendor në fushën e migracionit dhe diasporës, Bashkia Shkodër është angazhuar në mbështetjen e riintegritit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të emigrantëve të kthyer, si dhe në krijimin e kushteve për migrim të rregullt dhe të informuar.

Në funksion të këtij qëllimi, Bashkia Shkodër në partneritet me projektin “Forcimi i kapaciteteve institucionale vendore mbi migracionin në Shqipëri”, i zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ka përfituar mbështetje me ekspertizë teknike për çështjet e migracionit. Gjatë vitit raportues, mbështetja është fokusuar në përgatitjen e paketave informuese mbi Procedurat Standarde të Veprimit lidhur me migracionin për qëllime punësimi, edukimi dhe bashkimi familjar, si dhe në forcimin e sistemit të referimit dhe ofrimin e konsulencës për plane individuale të edukimit dhe punësimit. Bashkia Shkodër, si një nga 6 bashkitë pilote të përfshira në projekt, është e angazhuar të mbështesë qytetarët e saj si ata që kthehen nga migracioni, ashtu edhe ata që kërkojnë mundësi jashtë vendit përmes forcimit të shërbimeve dhe sistemit të referimit. Një tjetër takim ishte mikpritja në qytetin tonë të 40 të rinjve dhe të rejave nga diaspora shqiptare, me origjinë nga të gjitha trojet. Vizita e tyre u realizua në kuadër të programit @originalbanian, të organizuar nga GERMIN, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Prania e tyre në Shkodër është një dëshmi e bukur se kufijtë gjeografikë nuk e ndalin dot interesimin për vendlindjen e prindërve dhe gjyshërve.

Në vijim, janë organizuar tryeza diskutimi me institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile, në muajin korrik dhe dhjetor. Këto takime kanë shërbeu si një platformë për shkëmbimin e ideve dhe praktikave të mira, duke forcuar bashkëpunimin në kuadër të Rrjetit Lokal për Migracion.

Gjithashtu me 18 dhjetor, në Ditën Kombëtare të Diasporës dhe në Ditën Ndërkombëtare për Emigracion, në ambientet e Bashkisë Shkodër, u zhvillua një tryezë e përbashkët institucionale e organizuar nga Bashkia Shkodër në partneritet me IOM Albania, me qëllim forcimin e koordinimit ndërinstitutional në fushën e migracionit dhe diasporës, me fokus të veçantë procesin e riintegrit të rikthyerve. Në takim morën pjesë përfaqësues nga institucionet vendore dhe qendrore, Universiteti i Shkodrës, Policia e Shtetit, Policia Kufitare, institucione arsimore, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë relevantë. Diskutimet u përqëndruan në identifikimin e sfidave kryesore me të cilat përballen të rikthyerit, rreziqet e ri-emigrimit, mungesën e mekanizmave të unifikuar të referimit dhe nevojën për shkëmbim të strukturuar të informacionit ndërmjet institucioneve.

P.AC141.Q1.O2.A1. Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit në Shkodër.

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin e mbështetjes së përmirësimit të biznesit përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. Ky projekt ka ndikuar në fuqizimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, përmes asistencës teknike, konsulencës profesionale dhe zhvillimit të aktivitetëve kulturore e argëtuese që kanë gjallëruar zonën.

Në kuadër të këtij programi, Shoqata e Bizneseve ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e aktorëve lokalë, duke nxitur bashkëpunimin, përmirësimin e standardeve të shërbimit dhe rritjen e cilësisë së ofertës për qytetarët dhe vizitorët. Falë këtij angazhimi të përbashkët, zona është shndërruar

në një hapësirë më tërheqëse, dinamike dhe funksionale, me ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik lokal.

Përvoja e deri tanishme ka treguar se ky model bashkëpunimi krijon baza të qëndrueshme për konsolidimin e biznesit të vogël dhe për zhvillimin afatgjatë të zonës së përmirësimit të biznesit, duke mbetur një referencë e vlefshme për nisma të ngjashme në të ardhmen dhe për thellimin e mëtejshëm të partneriteteve në funksion të zhvillimit urban dhe ekonomik të qytetit.

P.AC141.Q1.O2.A2. Mbështetje për bizneset Agro

Njohja dhe promovimi i territorit në funksion të zhvillimit ekonomik janë prioritet i Bashkisë Shkodër, duke u mbështetur në integrimin e vlerave natyrore, kulturore dhe prodhuese me ofertën turistike. Falë pozicionit gjeografik dhe burimeve të pasura natyrore, territori ofron potencial të rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm, ku sektori i agropërpunimit luan një rol kyç në rritjen e vlerës së produkteve vendase, krijimin e vendeve të punës dhe promovimin e markave rajonale, në funksion të forcimit të ekonomisë lokale dhe zhvillimit afatgjatë të zonës.

Në kuadër të përpjekjeve për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor dhe për të mbështetur bizneset agro, Bashkia Shkodër ndërmori një seri aktivitesh promovuese në disa prej njësive të saj administrative, konkretisht në Dajç, Pult dhe Velipojë. Këto aktivitete synuan të krijojnë një platformë të hapur për promovimin e produkteve vendase, pasurive natyrore dhe kulturore të zonës, si dhe të ushqimit tradicional, duke rritur ndërgjegjësimin mbi potencialin zhvillimor të territorit.

Në kuadër të këtyre veprimtarive, përfaqësues të komuniteteve lokale dhe bizneseve të vogla patën mundësinë të prezantojnë produktet e tyre, të ndajnë përvoja, dhe të diskutojnë mbi mundësitë për bashkëpunim, rritje dhe përfshirje në tregje më të gjera. Fokus i veçantë iu kushtua evidentimit të vlerave unike të secilës zonë – që nga prodhimet bujqësore dhe artizanale në Dajç, te pasuritë natyrore dhe trashëgimia kulturore e Pultit, e deri te potenciali turistik dhe bujqësor i Velipojës.

Këto iniciativa përfaqësojnë një hap konkret drejt fuqizimit të ekonomisë rurale, nxitjes së sipërmarrjes vendase dhe promovimit të identitetit lokal. Ato gjithashtu shërbejnë si urë lidhëse mes komunitetit, pushtetit vendor dhe sektorit privat, duke krijuar mundësi të reja për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

P.AC141.Q1.O2.A3. Skemë granti për biznese inovative

Bashkia Shkodër ka shpallur Thirrjen Skemë granti për të rinjtë. Qëllimi i kësaj thirrje është krijimi i mundësive të reja ekonomike për sipërmarrësit aspirantë dhe bizneset ekzistuese, bazuar në një skemë granti, e cila mbështet zhvillimin e iniciativave ekonomike lokale, duke ruajtur një qasje miqësore ndaj mjedisit. Skema e grantit ka mbështetur të rinjtë e moshës 18 - 30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eko-inovative, për një projekt propozim me afat nga 6 - 9 muaj. Gjatë periudhës së hapur të thirrjes, Bashkia Shkodër ka ofruar informacion, këshillim individual, asistencë trajnimi, mentorim, etj për 150 të rinj, duke angazhuar ekspertë të jashtëm.

Publikimi i thirrjes është bërë me datë 31.10.2024 në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe shpallja e fituesve është bërë me datë 20.12.2024. Pas shpalljes së rezultateve aplikantët fitues janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas kanë nënshkruar kontratën e grantit dhe kanë filluar punën për zbatimin e projekteve. Kontratat e grantit janë nënshkruar me datë 11.02.2025 dhe kanë pasur një kohëzgjatje 6 – 9 muaj përgjatë vitit 2025. Për të monitoruar ecurinë dhe siguruar zbatimin korrekt të projekteve, është ngritur një grup monitorimi i caktuar nga Bashkia Shkodër. Ky grup kishte për detyrë të siguronte që të gjitha aktivitetet të zhvilloheshin në përputhje me udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara në kontratat e granteve. Në përputhje me kushtet e kontratës, në dy muajt e parë të projektit, të gjitha subjektet fituese kanë realizuar procedurat e prokurimit për blerjen e shërbimeve dhe materialeve të nevojshme për realizimin e projekteve të tyre. Për likuidimin e shpenzimeve subjekti fitues ka dorëzuar faturat, letrat, raportet dhe dokumentet e tjera që lidhen për projektin dhe janë paraqitur për likuidim pranë Bashkisë Shkodër. Përgjatë vitit 2025 është bërë likuidimi i subjekteve fituese me ecuri të mirë zbatimi.

Qëllimi 2

P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese

Bashkia Shkodër, në kuadër të projektit “Rikualifikimi i Merkatës Rus (Mbulesa e Tregut Shkodër)”, i financuar nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR), ka përfunduar me sukses ndërhyrjen në këtë zonë të rëndësishme tregtare. Ky projekt ka sjellë një transformim të plotë të zonës, duke e rikualifikuar atë si një hapësirë funksionale dhe të përshtatshme për qytetarët, tregtarët dhe vizitorët. Ndërtimi i mbulesës së tregut dhe instalimi i 120 banakëve të rinj kanë përmirësuar ndjeshëm kushtet e tregtimit, duke rritur standardin e shërbimit dhe duke e bërë tregun më tërheqës për frekuentuesit.

Mbulesa e ndërtuar, me një strukturë metalike dhe planimetri të rregullt prej 1500 m², ofron kushte të favorshme për mbrojtjen e produkteve nga kushtet atmosferike, si dhe siguron funksionimin e qëndrueshëm të tregut gjatë gjithë vitit. Kjo ndërhyrje jo vetëm që përmirëson infrastrukturën ekzistuese, por e kthen tregun në një atraksion për promovimin e produkteve lokale, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 19.12.2024, d pasuria me Nr. 3/1034, Zona Kadastrale 8593 “Tregu Rus” është dhënë në përdorim pa kundërshtim në favor të shoqërisë aksionere “Bio Strajca. Administrimi i tregut i është kaluar kësaj shoqërie me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve dhe menaxhimit të tij, duke siguruar të ardhura për mirëmbajtjen në vitet në vijim dhe krijimin e hapësirave të reja tregtare në qytet. Me VKB nr 28 date 29.05.2025 “ Per dhenie pelqimi, shtesa dhe ndryshime per shoqerine aksionare “ Biostrajca” ne pronesi te Bashkise Shkoder. Me kete vendim Bio Strajca ndryshon emertim dhe behet “ Skodrinon” Investimi është marrë në dorëzim nga Bashkia Shkodër.

Bashkia Shkodër me Projektin: “Rikualifikim i godinës së Merkatës Rus” është përzgjedhur për financim në kuadër të zbatimit të aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17526/3 Prot. dt. 23.12.2024, “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024”.

Ky projekt synon rikualifikimin e godinës së Merkatës Rus duke ridimensionuar zonën për ta kthyer në një mjedis të përshtatshëm dhe atraktiv, që do të ofrojë hapësira të nevojshme për tregtimin e produkteve blegtorale. Përmirësimi i kushteve të tregtimit pritet të rrisë frekuentimin e tregut nga banorët lokalë dhe vizitorët, duke e bërë atë një atraksion për produktet lokale. Procedura e prokurimit ka përfunduar dhe vijon të jetë në proces zbatimi.

P.AC141.Q2.O1.A2. Tregu i produkteve bujqësore Velipojë

Velipoja është një ndër qendrat më të rëndësishme të turizmit bregdetar, gjithsesi mungojnë tregjet dhe nuk janë në kushte cilësore përsa i përket pastërtisë dhe shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit. Përgjatë sezonit të verës në këtë njësi administrative kemi praninë e shumë vizitorëve dhe turistëve të cilët përvec shërbimeve turistike kanë edhe nevoja për të konsumuar produkte të ndryshme të cilat duhet të tregtohen në ambientet e posacme. Rrjeti i tregtisë në Bashkinë Shkodër duhet të plotësohet me tregjet lokale të shpërndara në njësitë administrative, ku do të promovohet zhvillimi ekonomik lokal veçanërisht në zonat turistike dhe bujqësore të populluara si Shkodra (të paktën nga një treg për njësi) dhe Velipoja (2 tregje të cilat do të funksionojnë gjatë periudhës së verës). Tregjet duhet të shihen përtej hapësirës së tregtimit edhe si hapësirë sociale dhe rekreative. Në këto hapësirat rekreative duhet të shërbehen vetëm produkte vendase, pra distanca nga tregu në tavolinë duhet të jetë 0 km. Duke marrë parasysh sasinë e lartë të produkteve të konsumuara si dhe nevojën për një mjedis të përshtatshëm për tregtim, nevoja për ndërtimin e tregut është shumë e madhe.

P.AC141.Q2.O1.A3 Ndërtimi i tregut multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale

Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve shihet e domosdoshme ndërtimi i strukturave të reja për tregtimin me pakicë të produkteve bujqësore e blegtorale. Fermerët/tregtarët të cilët shesin produktet e tyre sezonale në kushte jo të favorshme duhen mbajtur parasysh për tu zgjidhur, pasi edhe kërkesat e tyre janë të shumta për përcaktim të një vendi stabil me kushte të përshtatshme tregtimi. Në territorin e Bashkisë Shkodër qytet janë evidentuar rreth 450 fermerë/tregtarë informal që kane nevojë për sistemim në një vend të përshtatshëm tregëtimi. Gjithashtu në Nj.A. e Bashkisë Shkodër ka kërkesë të vazhdueshme për ngritjen e një tregu për produktet vendase. Ndërtimi i Tregut Agroushqimor në qytet apo dhe në Nj.A., si një treg shumë-funksional dhe modern, i cili respekton ambientin dhe është në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore gjithashtu rrit potencialin prodhues të sektorit bujqësor. Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plotë financiar. Në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkodër për zhvillimin ekonomik po bëhet planifikimi për ndërtimin e një tregu të shitjes me pakicë për produkte lokale agroushqimore për të zhvilluar tregti të formave të standardizuara. Krijimi i tregjeve të formalizuara ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve janë më efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standardizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të Bashkisë Shkodër.

Qëllimi 3

P.AC141.Q3.O1.A1 Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shitesë për web-sitin e turizmit.

Një ndër instrumentët më të rëndësishëm të marketingut territorial, është promovimi online. Promovimi online ofron avantazhe të shumta dhe është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt dhe nuk ka kosto të madhe. Mundësia unike që ka web-i për të bashkuar shumë elemente në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Bashkia Shkodër ka një website zyrtar që i dedikohet turizmit. Ky portal përmban materiale promocionale dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vijnë në Shkodër. Per 2025 nuk ka ze buxheti.

P.AC141.Q3.O1.A2 Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë per aplikacionin e turizmit

Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët, krijimi i një aplikacioni për smartphone, me informacionet dhe orientimet e nevojshme drejt nevojave të vizitorëve, është i domosdoshëm. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, faqes së Web-it, aksesit për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Bashkia Shkoder ka parashikuar krijimin e nje aplikacioni dedikuar turizmit.. Ky aktivitet per 2025- nuk ka ze buxheti.

P.AC141.Q3.O1.A3 Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale

Zhvillimi i turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër ka ardhur gjithnjë e më rritje. Duke parë fluksin në rritje të turistëve dhe me qëllim rritjen e kohëzgjatjes së qëndrimit në territorin tonë, Drejtoria e Turizmit çdo vit ka realizuar botime të ndryshme dhe ka prodhuar materiale promociuale (guidën turistike, hartën turistike të territorit të Bashkisë; harta të destinacioneve specifike- Shkodër; Theth dhe Velipojë; itinerare të ndryshme turistike, kalendarin e aktiviteteve kulturore dhe artistike; materiale të ndryshme promocionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj. Të gjitha materialet promocionale janë vënë në dispozicion të zyrave të informacionit turistik të Bashkisë, falas. Ky ze buxheti eshte tenderuar dhe realizuar.

P.AC141.Q3.O1.A4 Përmirësimi i aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve

Territori i bashkisë Shkodër është ndër zonat më të pasura me burime natyrore, ku përfshihen edhe destinacionet më të frekuentura për ata që takon turizmit natyror dhe atij malor. Këto zona turistike frekuentohen nga turistë kryesisht të huaj, të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe për interesimin ndaj mënyrës autentike të jetesës së banorëve të zonës. Brenda zonave turistike ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët, të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje kanë nevojë që të paisen me sinjalistikë të përshtatshme pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar. Të gjitha facilitetet, përfshirë zonat rekreative dhe shtigjet për ecje, kanë nevojë për mirembajtje të rregullt për të zvogëluar dëmin e shkaktuar me kalimin e kohës dhe nga përdorimi. Mirëmbajtja e duhur është themelore për të garantuar sigurinë e vizitorëve, lehtësi në kalim, dhe për të inkurajuar përdorimin e itinerarit të caktuar. Ky aktivitet është realizuar.

P.AC141.Q3.O1.A5 Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës

Për të promovuar ofertën turistike të territorit, Bashkia Shkodër kishte planifikuar pjesmarrjen në panaire kombëtare/ ndërkombëtare. Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Turizmit ka marrë pjesë në panairin e Prishtinës- Kosovës, ku promovoi ofertën turistike të territorit të Bashkisë Shkodër. Ky aktivitet është realizuar.

P.AC141.Q3.O1.A6 Itineraret e shijes/promovimi i Slow food

Shkodra njihet jo vetëm për natyrën e bukur, por edhe historinë, kulturën, rrugicat karakteristike, si dhe artin e gatimit, që përcillet me aq finesë. Aktiviteti- “Itineraret e shijes” është promovim i Slow Food dhe një udhëtim përmes trashëgimisë së pasur gastronomike, kulturore, artistike, historike dhe bukurive natyrore të Shkodrës. Ky aktivitet synonte t’i kthente Shkodrës vendin që i takon në rang kombëtar dhe atë ndërkombëtar, si një qytet ku turizmi zhvillohet mbi rrënjët e forta të traditës dhe pasurive të pafundme të territorit, ndërthurur me elementet që koha i dikton. Është shpallur fitues për realizimin e këtij aktiviteti nga Keshilli artistik- LUFA PRINT dhe është lidhur kontrata. Aktiviteti “Sofra Shkodrane” është realizuar me datë 27 nëntor 2025 dhe është likujduar.

P.AC141.Q3.O1.A7 Festa e Liqenit

Liqeni i Shkodrës përbën një ekosistem të rëndësishëm vlerash natyrore që ndërthuren me vlera historike e kulturore. Si liqeni më i madh në Rajonin e Ballkanit dhe zonë e mbrojtur e kategorisë IV - Rezervat Natyror i Menaxhuar, e bën një zonë me shumë vlera ekologjike me fokus zhvillimin e qëndrueshëm. Fundjava e javës së tretë të muajit qershor është përcaktuar si Dita e Liqenit të Shkodrës, e cila është një ditë e përbashkët e aprovuar nga të dy ministratë e Mjedisit respektive të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Aktivitete të larmishme, për ditën e Liqenit të Shkodrës zhvillohen për çdo vit të cilët fokusohen në aktivitete promovuese social- kulturore, sportive me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj trashëgimie të pasur natyrore të qytetit si dhe në promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Ky aktivitet është realizuar. Fitues projekti për 2025 për realizimin e Festës së Liqenit ishte Dimension Human.

P.AC141.Q3.O1.A8 Valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë së zonave malore, përmes aktiviteteve promovuese.

Rigjallërimi i trashëgimisë dhe zhvillimi i turizmit të zonave malore duke mbështetur promovimin e diversitetit kulturor dhe natyror në këtë zonë, mbetet një ndër prioritet kryesor të Bashkisë Shkodër. Qëllimi kryesor është të ngrëjë vetëdijen dhe të kuptuarit e vlerës së trashëgimisë ekzistuese si dhe të sigurohet përjetimi i kënaqësisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve të trashëgimisë nga komunitetet lokale. Zona e Alpeve është një nga destinacionet më atraktive të territorit të Bashkisë Shkodër e më gjërë. Ajo ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shumë llojeve të turizmit malor dhe të aventurës. Për 2025 fitues të projektit I shpallur fitues nga Keshilli artistik u shpall Ervin Lani. Titulli I projektit: Nur ndër Maja. Aktiviteti është realizuar dhe është likujduar.

P.AC141.Q3.O1.A9. Java e Mobilitetit

Me qëllim promovimin e lëvizjes së qëndrueshme urbane të qytetit, ku prioriteti i jepet ecjes dhe pedalimit për të nxitur lëvizjen aktive dhe të shëndetshme, Bashkia Shkodër i ka kushtuar një

vëmendje te vecante aplikimit të trendit të mobilitetit urban duke ndertuar korsite e bicikletave me nje shtrirje te gjere ne te gjithë qytetin duke u përfshirë në mënyrë aktive në promovimin dhe mbrojtjen e kësaj kulture dhe tradite. Si cdo vit, gjate javes se mobilitetit ne muajin shtator, eshte parashikur nje seri aktivitetesh qe shtrihen gjate gjithë javes me perfshirjen e shume aktoreve, nxenesve te shkollave dhe qytetareve dhe qe kulton me “ ditën pa makina”. Ky aktivitet eshte tenderuar dhe eshte shpallur fituesi LUFA PRINT. Aktiviteti eshte realizuar me date 22 shtator dhe eshte likujduar.

P.AC141.Q3.O1.A10. Lojra Popullore Fest

“Lojra Popullore Fest” është një aktivitet me karakter social-kulturor për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ata me traditat tona kombëtare me anën këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit është promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrëse. “Lojra popullore fest” gjithashtu synon që të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzore e vlerave folklorike e kombëtare e ndërkombëtare. Vetë të rinjtë konkurojnë me performanca me lojra popullore, këngë e valle të traditave kombëtare dhe enografike. Projekti nxit rininë për promovimin e vlerave turistike. Ky aktivitet është kthyer në traditë për qytetin e Shkodrës. Per realizimin e ketij aktiviteti eshte shpallur fitues shoqata The Door permes aplikimit te projektit ne Keshillin Artistik. . Aktiviteti eshte realizuar me date 27 shtator 2025 dhe fatura eshte likujduar.

P.AC141.Q3.O1.A11. Fushata marketing online

Fushata marketingut online është një aktivitet që përfshin përdorimin e kanaleve dhe mjeteve dixhitale për të promovuar një produkt, shërbim, markë ose kompani përmes internetit. Kjo lloj fushate është gjithnjë e më shumë e rëndësishme për bizneset dhe organizatat që kërkojnë të arrijnë një audiencë të gjerë dhe të përmirësojnë ndihmën për zhvillimin e shitjeve dhe rritjen e njohjes së markës. Marketingu online ka pësuar një zhvillim të jashtëzakonshëm në vitet e fundit, duke u bërë një komponent thelbësor për çdo strategji të biznesit dhe komunikimi. Si pasojë e avancimit të teknologjisë, rritjes së përdorimit të internetit, dhe ndryshimeve në sjelljen e konsumatorëve, marketingu online ka evoluar për t'u përshtatur me kërkesat e reja dhe për të krijuar mundësi të reja për të arritur audiencën. Ky aktivitet eshte fituar nga subjekti Endri Dulellari permes procedures se tenderimit. Fatura eshte likujduar.

P.AC141.Q3.O1.A12. Shkodra: Histori dhe magji ne çdo hap: promovim ne levizje

Një stendë lëvizëse për një ngjarje, panair, ose ekspozitë në Shkodër mund të jetë një element shumë efektiv për të tërhequr vëmendjen e vizitorëve dhe për të promovuar produkte, shërbime ose marka. Kjo mund të jetë një stendë që mund të lëvizë fizikisht përreth, ose një dizajn i veçantë që përdor elemente dinamike si ekrane të lëvizshëm, drita, ose efekte të tjera për të krijuar një përvojë tërheqëse. Territori i bashkisë Shkodër gjithnjë e më tepër po sheh një numër në rritje të turizmit të brendshëm. Gjykojmë një mënyrë e mirë për të ndërgjegjësuar turistët dhe për t'i informuar ata mbi atraksionet dhe mundësitë që ofron territori i Bashkisë Shkodër do të ishte ngritja e një stende të lëvizshme që do të vendosej në qytete të ndryshme të Shqipërisë në ditë të caktuara. Kjo stendë do të përmbante materiale promocionale për Shkodrën duke bërë në këtë mënyrë të rritet interesi i qytetarëve të atij

qyteti për të vizituar Shkodrën. Bashkë me stendën do të udhëtojë edhe një pjesë e stafit të drejtorisë të cilët do të kryjnë funksionin e informacionit turistik si edhe të promovimit të qytetit. Ky aktivitet është realizuar dhe është likujduar. Per 2025 u realizua instalacion I levizshem (POP- UP) ne aeroport nga fituesi DEKOR SHPK.

P.AC141.Q3.O1.A13 Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe dhe në destinacione të tjera turistike

Turizmi ka njohur një rritje të konsiderueshme vitet e fundit dhe destinacionet turistike në territorin e bashkisë Shkodër janë vizituar nga një numër i lartë turistësh të huaj nga Evropa dhe më gjerë, të cilët kanë shijuar bukuritë resurseve të shumta natyrore, që nga bregdeti, zonën e liqenit, alpet por edhe burimet kulturore dhe historike të zonës. Një nga problemet më të mprehta të zhvillimit të turizmit në vendin tonë është infrastruktura lidhëse dhe infrastruktura e dobët në destinacion. Nevojitet që të investohet në infrastrukturën bazë ndihmëse për aksesimin e këtyre destinacioneve. Mundësimi i aksesit në destinacionet turistike, përmirësimi i shërbimeve në destinacion dhe nxitja e zhvillimit të infrastrukturës turistike është një nga prioritetet për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Duke parë fluksin e lartë të frekuentimit që ka plazhi i Velipojës propozohen ndërhyrje të lehta në infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse të cilat do të jenë në ndihmë të pushuesve në plazhet publike dhe në shëtitoren e Velipojës. Ndërtimi i shkallareve që lidhin banesat dhe hotelet me pedonalen e Velipojës dhe plazhin si dhe vendosja e pedanave që përmirësojnë aksesin në plazh do të jenë dy ndërhyrjet e planifikuara të cilat do të rrisin cilësinë e frekuentimit të këtij plazhi. Gjithashtu, Bashkia Shkodër për zonën e Velipojës, ka planifikuar rritjen e sipërfaqeve publike duke krijuar akses për të gjithë vizitorët që duan të shfrytëzojnë këto hapsira. Në kuadër të mirëfunksionimit të këtyre hapsirave dhe evidentimit sa më të mirë të tyre propozohet vendosja e tabelave informuese që orientojnë vizitorët drejt këtyre plazheve publike. Gjithashtu për të pasur sa më të qartë hapsirat e shfrytëzimit të plazheve midis publikut dhe privatit por edhe për të krijuar një mjedis sa më të këndshëm dhe të rregullt parashikohet edhe vendosja e piketave për plazhet publike. Rëra e Velipojës është një nga resurset natyrore më me vlerë të territorit dhe pastrimi i saj përpara fillimit të sezonit është me shumë rëndësi prandaj parashikohet marrja me qera e mjetit që realizon pastrimin e kësaj sipërfaqeje rënore. Ky aktivitet është realizuar dhe likujduar.

P.AC141.Q3.O1.A14 Shkodra: Green Destination

Shkodra Green Destination është një iniciativë dhe koncept që synon promovimin e Shkodrës si një destinacion turistik të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin, duke theksuar vlerat e natyrës, biodiversitetit dhe traditave lokale. Ky koncept është në përputhje me kërkesat për zhvillim të turizmit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Është një destinacion që tërheq ata që kërkojnë një përvojë autentike, të qëndrueshme dhe të pasur me natyrë dhe kulturë. Me përpjekjet e saj për ruajtjen e biodiversitetit dhe për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, Shkodra ka të gjithë potencialin për të ofruar një eksperiencë të paharrueshme për turistët, duke u siguruar që ky zhvillim të jetë në harmoni me mjedisin. Ky aktivitet është realizuar.

P.AC141.Q3.O1.A15 Krijimi i kushteve për pushuesit në plazhet publike të menaxhuara

Ky aktivitet kishte si qellim të sigurojë mobilimin e hapsirave të plazheve të menaxhueshme duke përmirësuar infrastrukturën e lehtë dhe shërbimet në plazhin Velipojë. Me VKB nr 30 dt 29.05.2025 është shtuar ky ze buxheti për realizimin e aktiviteteve si me poshte: - Identifikimi i nevojave për ndërhyrje për përmirësimin e aksesit në plazhe; Konturimi i hapsirave publike me piketa dhe vendosje e tabelave informuese; Mobilimi i hapsirave të plazhit të menaxhueshme me cadra e shezlonge, pedana aksesit, shërbime higjienike etj.; Transferimi i fondit për Sh.a. SKODRINON me NIPT M369240030 për menaxhimin e dhe administrimin e këtij funksioni; Pergatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për procesin e prokurimit. Aktiviteti është realizuar dhe likujduar fondi.

Qellimi 4

P.AC141.Q4.O1.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth

Vitet e fundit gjithnjë e më tepër, territori i Bashkisë Shkodër sheh një numër në rritje të vizitorëve me origjinë nga vende të ndryshme por edhe nga kontinente të ndryshme. Të ndryshme janë jo vetëm vendet e origjinës por edhe tipologjia e udhëtimeve të tyre. Një pjesë vijnë në mënyrë të organizuar nga agjensi të ndryshme shqiptare apo të huaja, por një pjesë e mirë e tyre vijnë në mënyrë të paorganizuar. Kjo tipologji vizitorësh kanë nevojë më shumë se të tjerët për informacion. Zyrat e Thethit, Velipojë dhe Shiroke funksionojnë vetëm gjatë sezonit turistik (nga maji në tetor ndërsa zyra e informacionit turistik në Shkodër funksionon përgjatë gjithë vitit. Gjatë kësaj periudhe këto zyra kanë ofruar informacion për një numër të madh vizitorësh, që kanë marrë informacion në rrjetin e zyrave të informacionit turistik. Ky ze buxheti është në proces realizimi duke qenë se është parashikuar ndertimi i një zyre të re INFO Point dhe fondi i parashikuar për këtë ze buxheti - do të trashegohet në 2026 - për mobilimin e zyrës.

P.AC141.Q4.O1.A2. Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorive në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të mbështetjes për zhvillim ekonomik dhe turizëm

Zbatimi i Buxhetit për shpenzime personeli, bazohet tek numri I punonjësve dhe nivelin e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagën dhe në përputhje me aktet nën ligjore në fuqi brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nepunësve civilë e tëpunonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" dhe në zbatim të vendimit nr. 113, datë 01.03.2023 i KM (për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar në mbështetje të ligjit nr. 35/2023 (për kompetencat, për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarëve në institucionet e administratës publike; VKB nr. 76, datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm për fundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër - i ndryshuar, ndërsa niveli i pagave me VKB nr. 54, datë 30.09.2024 " Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nepunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varesise.

P.AC141.Q4.O1.A3. Ndërtimi i Zyrës së re InfoPoint

Në situatën aktuale të zhvillimit intensiv të turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër, është vënë re një rritje e vazhdueshme e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët vizitojnë atraksione të ndryshme

në qytet, në zonat përreth, si dhe në destinacione të njohura si Velipoja dhe Thethi. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre turistëve udhëtojnë në mënyrë të pavarur (self-guided), pa ndihmën e agjencive turistike dhe pa informacion të strukturuar mbi destinacionin.

Në këtë kontekst, informacioni turistik bëhet një komponent kyç për një përvojë pozitive turistike. Ai u shërben vizitorëve për: orientim në qytet dhe rrethina, njohjen me pikat turistike, kulturore dhe natyrore, informim mbi oraret e funksionimit të atraksioneve, akses në shërbimet publike dhe transportin lokal, rekomandime për aktivitete dhe eksperiencë lokale; Propozohet investimi për ndërtimin dhe arredimin e një Zyre të Re të Informacionit Turistik, e cila do të: jetë e vendosur në një lokacion strategjik në hyrje të zonës muzeale dhe pranë pikave të transportit, ketë pamje bashkëkohore dhe atraktive, duke funksionuar si një pikë mikpritjeje për vizitorët, përfaqësojë vizualisht dhe nëpërmjet materialeve të dizajnuara me kujdes gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, jetë e pajisur me teknologji dhe materiale të nevojshme për komunikim efikas: harta interaktive, ekranë informues, materiale promocionale, QR code me guida digjitale, etj. Ky aktivitet është shtuar si ze buxheti me VKB nr 41 dt 25.06.2025 dhe është në proces realizimi.

Qellimi 5

P.AC141.Q5.O1.A1. Trajtimi i qenve të rrugës

Bashkia Shkodër vijon trajtimin e problematikës së qenve endacakë në territorin e saj, përmes një sërë ndërhyrjesh që përfshijnë kapjen, vaksinimin, sterilizimin, matrikullimin, dehelmetizimin dhe trajtime të ndryshme antiparazitare të këtyre kafshëve.

Gjatë këtij viti janë **trajtuar rreth 580 qen endacakë**, përmes shërbimeve veterinare të përmendura më sipër.

Përveç strehëzës ekzistuese, e cila është funksionale dhe aktualisht strehon rreth 110 qen endacakë, për shkak të problematikës së mbetur është parashikuar ndërtimi i një strehëze të re me kapacitet më të madh strehimi dhe trajtimi.

Vendodhja e kësaj strehëze të re ndodhet në Njësinë Administrative **Guri i Zi**, në fshatin **Rrenc**, në një territor që me **Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 393, datë 19.06.2024**, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër.

Strehëza e re do të mundësojë strehimin e rreth **300 kafshëve** si dhe trajtimin veterinar, çdo vit, të mbi **500 qenve endacakë**, duke kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e menaxhimit të kësaj problematike në territorin e Bashkisë Shkodër.

P.AC141.Q6.O1.A1-Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të bujqesise.

Shërbimet për shpenzime personeli do të bazohen tek numri i punonjesve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 ”Përgrupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nepunësve civilë e tëpunonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe në zbatim vendimit nr. 113, datë 01.03.2023 i KM (për percaktimin e pages minimale në shkallë vendi brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar në mbështetje të ligjit nr. 35/2023 (për kompetencat, për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe perfitimeve të punësuarëve në institucionet e administratës publike; VKB nr. 76, datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm për fundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkoder- i ndryshuar, ndërsa niveli i pagave me VKB nr. 54, datë 30.09.2024 “ Per miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nepunësve civilë dhe të punonjësve administrative të Bashkisë Shkoder dhe institucioneve të varesise.

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

P.AC141.Q6.O1.A2-Krijimi dhe përditësimi i kadastrës bujqësore dhe arshives së saj dhe futja në sistem e zonave të parilevuara.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”, Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të veta”, të tilla si: Administrimin e sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP:

Drejtoria bazuar në dokumentacionin kadastral ekzistues dhe dokumentacionin e ri kadastral, që grumbullohet dhe sistemohet, plotëson “Regjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve”, të miratuar me urdhrin e përbashkët, nr.107, datë 27.3.2009 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm. Deri tani është punuar në krijimin dhe plotësimin e regjistrit kadastral vazhdon me plotësimin dhe përditësimin e njësive bujqësore në regjistrat kadastral për Njësitet Administrative.

P.AC141.Q6.O1.A3-Krijimi i informacionit bujqësor

Shtrirja territoriale e Bashkisë Shkodër, kërkon ndërtimin, standartizimin, plotësimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit informacionit të të dhënave bujqësore dhe blegtorale për gjithë territorin rural të saj. Aktualisht nuk zotërojmë një sistem përmbljedhës të dhënash në nivel Bashkie me shtrirjen e re. Të dhënat ekzistuese (nga ish komunat) të cilat në disa raste nuk ekzistojnë dhe në disa raste të tjera janë me mangësi të theksuara, duhen plotësuar, harmonizuar dhe përditësuar në nivelin territorial të Bashkisë. Nga ana e Drejtorisë periodikisht merren të dhëna nga Njësitet Administrative për strukturën e mbjelljeve, sasinë e prodhimit, mbarëshkrimin e kafshëve dhe mekanikën bujqësore.

P.AC141.Q6.O1.A4-Sigurimi i mbështetjes se fermerëve për agroindustrinë, treg dhe marketing.

Drejtoria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP ofron sherbimin keshillimor i cili mbulohet nga inspektorët e drejtorise prane Njesive Administrative. Sherbimi keshillimor u ofrohet fermereve sipas kerkesave nga inspektorët per mbjelljet sezonale, sherbimet fitosanitare, mbrojtjen e bimeve, informacione per tregtimin e produkteve, trainime nga organizata dhe institucione etj. Numri i keshillimeve te fermereve varion nga sezoni, problematikat e ndryshme dhe nga vete kerkesat e fermereve. Po ashtu mbeshtetja konsiston ne informimin dhe mbeshtetjen e fermereve per aplikimet ne skemat e grandeve per bujqesine dhe blegtorine ku nepermjet takimeve informuese dhe ndihmeses ne plotesimin e dokumentacioneve perkatese per aplikimet e mesiperme i jepet nje ndihmese fermereve per perfitimin e ketyre granteve.

P.AC141.Q6.O1.A5-Promovim produktesh bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet panaireve.

Nje pjese e konsiderueshme e tregut dominohet nga importet gje e cila sjell një konkurrencë mjaft të fortë ndaj produkteve lokale . Tregjet e produkteve lokale ekzistojnë dhe eshte bere nje permiresim i dukshem ne permiresimin e kushteve ne keto tregje megjithatë nevojat jane akoma me te medha per ti dhene mundesine prodhuesve lokal te tregtojne prodhimet e tyre. Fermerët shpesh nuk kanë akse direkt në treg, për arsye të sasive të kufizuara që ata prodhojnë dhe mungesës së afërsisë së tregjeve me prodhimin e tyre.

Tregjet janë dominuar nga tregtarët e mëdhenj dhe të vegjël dhe mungon informacioni mbi çmimet, veçanërisht për fermerët duke dobësuar pozicionin e tyre në treg. Bashkia Shkodër tashmë ka krijuar traditën e promovimit të produkteve dhe prodhuesve nëpërmjet organizimit të panaireve të ndryshme me qëllim promovimin dhe mbështetjen e prodhuesve.

P.AC141.Q6.O1.A6 - Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi te sherbimit te ujitjes dhe kullimit

Gjatë ketij viti, Drejtoria e Bujqësisë , Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP ka ushtruar veprimtarine në realizimin e qëllimit :Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit:

Hartimi i projekteve të ndërhyrjes për pastrim/reabilitim të Kanaleve Kullues bazuar në Planifikimin e miratuar në Planin e Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit , ndërhyrje pastrimi dhe vendosje në gjëndje funksionale të K.K. të dyta dhe të treta.

Drejtoria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP me ane te specialisteve te saj ka kryer verifikimin e gjendjes dhe nevojave per nderhyrje pastrimi ne rrjetin e kanaleve te dyta dhe te treta kulluese dhe hartuar projektet perkatese per nderhyrje ne Njesite Administrative Dajç, Guri i Zi, Berdice, dhe Velipoje. Keshtu gjate kesaj periudhe nga ana e drejtorise jane hartuar 140 projekte zbatimi te cilat jane derguar per zbatim Drejtorise se Sherbimeve dhe Puneve Publike per nderhyrje ne Njesite administrative.

Keto nderhyrje kanë sjelle permiresimin e siperfaqes se tokes bujqesore me kullim dhe duke pasur impakt direkt ne prodhimin bujqesor te ketyre zonave.

Bashkia Shkodër në përgjigje të thirrjes për aplikim për projekte zbatimi për financimin e objekteve të ujitjes dhe kullimit të bashkive, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 226 datë 09.04.2024 “ Për Shpërndarjen dhe Detajimin e Fondit për Financimin e Projekteve të Bashkive nga Programi “ Menaxhimi I Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes” dhe Vendimin nr. 559 datë 11.09.2024 “ Për një ndryshim në Vendimin Nr. 226 datë 09.04.2024 “ Për Shpërndarjen dhe Detajimin e Fondit për Financimin e Projekteve të Bashkive nga Programi “ Menaxhimi I Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”, ndryshuar me Vendimin Nr 392 date 10.07.2025 “Për një ndryshim në Vendimin Nr 226 datë 09.04.2024 “ Për Shpërndarjen dhe Detajimin e Fondit për Financimin e Projekteve të Bashkive nga Programi “ Menaxhimi I Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”, Të Ndryshuar, ka përfituar financimin e 3 (tre) projekteve të zbatimit për rehabilitim të skemës ujitëse:

- Kanali Kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush; Kanali Kryesor Mjedë KU-23 Trush ; Kanali Kryesor Mjedë KU-23-1 Trush ; Kanali Kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush; Kanali Kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush me gjatësi totale 12,024 ml dhe vlerë financimi për 3 vite prej 48,142,982 lekë
- Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç, me gjatësi 6,747 ml dhe vlerë financimi për 2 vite prej 31,248,170 lekë
- KU 32-33 Bërdicë me gjatësi 6,153 ml dhe vlerë financimi për 3 vite prej 28,289,218 lekë.

Realizimi i këtyre projekteve rehabilitimi përmirëson dukshëm mundësinë e ujitjes së tokave bujqësore në një sipërfaqe prej me shume se 1700 Ha nga e cila përfitojnë rreth 1270 fermerë.

Për vitin 2025 projektet e financuara nga Ministria janë realizuar sipas tabelës së mëposhtme:

Aktivitete/Projekte	Institucioni	Statusi I aktivitetit	Totali		
			Plani fillestar 2025	Plani i rishikuar 2025	Realizimi 2025
			Totali	Totali	Totali
P04240.Q1.O1.A7. Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush - mbikqyrje dhe kolaudim	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	23,000	23,000
P04240.Q1.O1.A8.Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë- Kuç -mbikqyrje dhe kolaudim	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	16,248	16,247
P04240.Q1.O1.A8. KU-32-33-Berdice	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	22,074	22,074
04240 Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit			-	61,322	61,321

Programi AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli I Territorit dhe Mjedis

Shkodra është porta hyrëse e korridorit Veri- Jug (të transportit rrugor), që lidh Shqipërinë me zonën e rrjetit të ardhshëm të korridoreve dhe lidhjeve të tyre të transportit rrugor për Europën Juglindore, ku përfshihen: Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, etj.

Krijimi i territorit të ri administrativ të Bashkisë – shumë – qendërsh duke përfshirë qytetin e Shkodrës dhe fshatrat e 10 njësive administrative të tjera në programin e infrastrukturës rrugore si funksion i veti do të jetë ndërtimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike të tij.

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Qëllimet e këtij programi janë:

Q1. Administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Përshkrimi i objektivave:

O1: Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e mirëadministrimit të fondit pyjor dhe kullësor brenda territorit administrativ të bashkisë.

O2. Siperfaqe kullësore e pastruar /rehabilituar .

O3. Rehabilitimi , pyllëzimi investimi ne siperfaqeve pyjore

Q2 : Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Përshkrimi i objektivave:

O1. Rikonstrukcion rruge dhe sheshe urbane

O2. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Q3. Lëvizshmëri e sigurt, e mirë orientuar për banorët dhe vizitorët. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër. Përmirësim të

impaktit mjedisor nepermjet stimulimit te transportit publik dhe tradites se perdorimit te bicikletes.

Përshkrimi i objektivave:

O1. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër

Q4. Mbrojtja e mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve. Zbatimi i dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përshkrimi i objektivave:

O1: Rritja e ndjeshmerisë së popullatës ndaj problemeve të mjedisit, zvogëlimi dhe administrimi i ndotjes së mjedisit.

Për vitin 2025 në funksionin Mbrojtja e Mjedisit në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar dhe realizuar produktet/Aktivitetet: që kanë të bëjnë me Zbatimin e objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër.

Aktivitete në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit (si dita e mjedisit, dita e pyjeve etj)

Shpenzime paga të personelit për Vazhdimësi e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi për menaxhimin e mjedisit & të trashëguara

Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE)- TË TRASHËGUARA

Realizimi i këtij funksioni nuk parashikon nuk realizon të ardhura

Q5.Strategji të unifikuara për zhvillimin e integruar të territorit në funksion të krijimit të një rajoni shumëqendërs përmes krijimit e zhvillimit të infrastrukturës publike, administrative, sociale dhe kulturore.


Përshkrimi i objektivave:

O1.Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit te tij.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar:

						000/lekë
Programi AD141	Paga & sigurime	Shpenzime operative	Subvencione	Transferta	Investime	Totali
PBA 2025	90,619	9,143	-		196,931	296,693
Plani fillestar 2025	115,204	33,922	705	-	480,545	630,376


Plani i rishikuar 2025	115,038	16,391	705	166	473,156	605,456
Realizimi viti 2025	67,311	2,648	-	166	147,952	218,078
% e realizimit	58.5%	16.2%	0.0%	100.0%	31.3%	36.0%



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 36 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korrente 53%

Shpenzime kapitale 31.3%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Për Qëllimin e parë “*Administrimi i pyjeve dhe kullotave*” dhe të katërt “*Mbrojtja e Mjedisit*” nuk jemi në mosrealizim, por realizimi është sipas planit vjetor të miratuar për këto shpenzime.

Për Qëllimin e dytë “*Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale...*” sqarojmë se Investimet e parashikuara në buxhetin e vitit 2025 kanë qenë në proces projektimi dhe për këtë arsye realizimi i buxhetit është në nivel të ulët.

Raporti: M3 - Shpenzimet dhe Sasitë e Produkteve: Fakti - Planit (Janar - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit

Viti: 2025

Vlerat paraqiten në: ALL

KODI	PRODUKTI		KUMULATIVE DERI NË FUND TË PERIUdhËS			NDRYSHIMI (%)		
			PLANI FILLESTAR	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR	
Funksioni 04260 - Administrimi i pyjeve dhe kullotave								
V426AAA	Shërbimi i Stafit të Menaxhimit të Fondit Pyjor dhe Kullosor		Sasia	2	2	2	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	numer punonjesish	Shpenzimet	2,448,883	4,080,914	2,335,226	95.36%	57.22%
V426AAB	Inspektim dhe Kontroll i Sipërfaqes Pyjore/Kullosore		Sasia	336	336	251	74.70%	74.70%
	Njësia e Matjes	Numer kontrollesh	Shpenzimet	15,418,000	18,118,358	10,534,645	68.33%	58.14%
V426AAD	Sipërfaqe Kullotë e Rehabilituar		Sasia	10	10	10	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	ha	Shpenzimet	453,000	453,000	453,000	100.00%	100.00%
V426AAE	Siperfaqe Pyjore e Rehabilituar		Sasia	3,850	3,850	0	0.00%	0.00%
	Njësia e Matjes	ha	Shpenzimet	1,719,000	3,420,850	0	0.00%	0.00%
V426AAC	Sipërfaqe Kullotë e Pastruar në NJA		Sasia	10	10	10	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	ha	Shpenzimet	571,000	591,954	414,216	72.54%	69.97%
Funksioni 04570 - Transporti publik								
V457AAB	Qytetarë të Subvencionuar në Transportin Publik		Sasia	0	1	0	N/A	0.00%
	Njësia e Matjes	Nr. njerëzve të subvencionuar	Shpenzimet	0	737,471	0	N/A	0.00%
Funksioni 05630 - Ndërgjegjësimi mjedisor								
V563AAC	Promovimi i mbrojtjes së mjedisit		Sasia	10	10	10	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	numer aktivitetesh	Shpenzimet	6,896,000	7,642,087	5,155,959	74.77%	67.47%
Funksioni 06140 - Planifikimi urban vendor								
V614AAB	Inspektime të Zhvilluara për Mbrojtjen e Territorit		Sasia	16	16	16	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr punonjesish	Shpenzimet	20,198,000	22,327,000	17,968,742	88.96%	80.48%

V614AAC	Projekte të Zhvillimit Urban të Hartuara dhe Monitoruara		Sasia	14	14	12	85.71%	85.71%
	Njësia e Matjes	numer PDV	Shpenzimet	68,058,000	108,071,208	36,272,081	53.30%	33.56%

M6: Raporti i Realizimit të Objektivave

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedis

OBJEKTIVI 1.1

Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullësor brenda territorit administrativ të bashkisë.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04260 - Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.1.A	Numri i punonjësve kundrejt fondit pyjor dhe kullësor	(punonjës për 1000 ha pyje dhe kullota)	1	1	1	1	89.86%
TP 1.1.B	Rritja e monitorimit të fondit pyjor kullësor.	inpektime për 1000 ha	0	1	1	1	74.55%
TP 1.1.C	Mbrojtja e sipërfaqes pyjore nga zjarret, nepermejt sitemit Smart	nr kamera	4	4	4	4	100%

OBJEKTIVI 1.2

Sipërfaqe kullësore e pastruar /rehabilituar

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04260 - Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.2.A	Shpenzime per sherbimin e pastrimit te kullotes / totalit te sipërfaqes kullësore	leke/ha	119	121	126	88	72.73%

TP 1.2.B	Shpenzime per sherbimin e rehabilitimit te siperfaqes kullimore / totalit të siperfaqës kullota	leke/ha	0	96	96	96	100%
TP 1.2.C	Zona pyjore ne % ndaj sipërfaqes së zonave urbane	%	12	12	12	12	100%

OBJEKTIVI 1.3

Rehabilitimi , pyllezimi investimi ne siperfaqe pyjore.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04260 - Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.3.A	Siperfaqe pyjore me Plan Menaxhimi/ Totalit te siperfaqes pyjore ne %	perqindje	21	64	46	46	71.88%
TP 1.3.B	Shpenzime për shërbimin e rehabilitimit te siperfaqes pyjore/ sipërfaqes totale të fondit pyjor	leke/ha	0	56	112	0	0%

OBJEKTIVI 2.1

Rikonstrukcion rruge dhe sheshe urbane

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04520 - Rrjeti rrugor rural

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 2.1.A	Eficiencia e përdorimit të buxhetit të alokuar për rrjetin rrugor :Kosto e rikonstrukcion rrugë urba	leke/m2	99	75	88	205	273.16%
TP 2.1.B	Rrugët e rikualifikuara/asfaltuara dhe sheshe urbane (ne m2)	m2	6,650	12,540	18,863	18,863	150.42%
TP 2.1.C	Rruge urbane dhe blloqe banimi : Raporti i rrugëve të ndriçuara ne rruge dhe sheshe urbane (në m2)	m2	6,650	12,540	18,863	18,863	150.42%
TP 2.1.D	Rruge urbane dhe Blloqe banimi :Kanalizime të Ujërave të Bardha rikonstruktura ne rruge dhe sheshe	m2	1,100	1,465	2,204	2,204	150.44%

TP 2.1.E	Rruge urbane dhe blloqe banimi Kanalizimeve të Ujërave të zeza rikonstruktura ne rruge dhe sheshe u	m2	980	1,360	2,046	2,046	150.44%
TP 2.1.F	Rruge urbane dhe Blloqe banimi :Banorë direkt përfitues (në %)	numer	940	1,910	2,873	2,873	150.42%

OBJEKTIVI 2.2

Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04520 - Rrjeti rrugor rural

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 2.2.A	Eficiencia e përdorimit të buxhetit të alokuar për rrjetin rrugor :Kosto e rikonstrukcion rruge rur	leke/m2	252	135	259	799	593.02%
TP 2.2.B	Rruge të rikualifikuara/asfaltuara (në %)	m2	1,304	9,625	34,896	34,896	362.56%
TP 2.2.C	Kanalizime të Ujërave të Bardha rikonstruktura (në %)	meter linear	83	1,142	2,213	2,213	193.78%
TP 2.2.D	Banorë direkt përfitues kundrejt vitit të kaluar (në %)	numer	150	2,075	4,021	4,021	193.78%

OBJEKTIVI 3.1

Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve të Bashkisë Shkodër

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04570 - Transporti publik

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 3.1.A	Rritja e komunikimit nëpërmjet transportit publik	numer	0	0	0	0	N/A
TP 3.1.B	Numri i biletave te shitura në vit - ndryshimi ne % kundrejt vitit paraardhës	%	0	0	0	0	N/A

TP 3.1.C	Përkrahja e kategorive si nxënës, studentë dhe kategorive të veçanta që përfitojnë sipas dispozitav	%	0	0	0	0	N/A
----------	---	---	---	---	---	---	-----

OBJEKTIVI 4.1

Rritja e ndjeshmerisë së popullatës ndaj problemeve të mjedisit, zvogëlimi dhe administrimi i ndotjes së mjedisit.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

05320 - Programet e mbrojtjes së mjedisit

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 4.1.A	Aktivitetet në kuadër të promovimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim	numer	8	10	10	10	100%
TP 4.1.B	Sherbimi I stafit për Q4, promovimi I mbrojtjes së mjedisit	numer	4	4	4	4	100%
TP 4.1.C	Plane / programe/Investime që ndikojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit	numer	1	3	3	3	100%

OBJEKTIVI 5.1

Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

06140 - Planifikimi urban vendor

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 5.1.A	Numri i punonjësve Inspektoriati i mbrojtjes territoriale	numer	16	16	16	16	100%
TP 5.1.B	Plani detajuar për njësi të ndryshme kundrejt totalit të PDV sipas PPV	numer	20	23	23	20	86.96%
TP 5.1.C	Bashkia akordon leje zhvillimi mbi bazën e planeve të detajuara vendore	numer lejesh të miratuara	32	70	70	43	61.43%
TP 5.1.D	Raporti i të ardhurave nga lejet e zhvillimit të miratuara kundrejt totalit të të ardhurave të bash	%	17	16	26	27	168.75%
TP 5.1.E	Prona të regjistruara pranë ASHK në raport me pronat gjithësej të transferuara në pronësi	%	36	47	47	38	80.85%
TP 5.1.F	Numri i pronave të përfituara nga shpronësime me VKM etj	numer	0	50	50	4	8%

Tabela e aktiviteteve dhe realizimi i tyre:

Produktet	Aktivitete/Projekte	Institucio ni		Statusi i aktivitetit	Plani Fillestar 2025	Plani i Rishikuar 2025	Realizimi 2025
					Totali	Totali	Totali
V426AAA. Shërbimi i Stafit të Menaxhimit të Fondit Pyjor dhe Kullor (numri i punonjesve)	P.AD141.Q1.O1.A1 - Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi te shërbimit per administrimin e pyjeve & të trashëguara	Bashkia Shkoder		Realizuar	2,449	4,080	2,335
V426AAB. Inspektim dhe Kontroll i Sipërfaqes Pyjore/Kullorore (Numer kontrollesh)	P.AD141.Q1.O1.A2.Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullorore/shërbimi pyjor/(Inspektoriati I pyjeve dhe vrojtuesit) & të trashëguara	Bashkia Shkoder		Realizuar	15,418	18,118	10,534
V426AAC. Sipërfaqe Kullotë e Pastruar në NJA (ha)	P.AD141.Q1.O2.A1 .Pastrim dhe sistemim kullote. & të trashëguara	Bashkia Shkoder		Realizuar	571	592	414
V426AAD. Sipërfaqe Kullotë e Rehabilituar (ha)	P.AD141.Q1.O2.A2: Rehabilitim sipërfaqe kullorore Ekonomia Pyjore/Kullorore	Bashkia Shkoder		Realizuar	453	453	453
P426AAG Hartim plani i menaxhimit të pyjeve e kullotave të bashkisë Shkodër	P.AD141.Q1.O3.A1. Hartim plani i Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave të Bashkisë Shkodër(Ekonomi Pyjore)& të trashëguara	Bashkia Shkodër		Realizuar	2,229	6,577	6,422
V426AAE. Sipërfaqe pyjore e rehabilituar (ha)	P.AD141.Q1.O3.A2 Shpenzime për përmiresim të Fondit pyjor/kulloror& të trashëguara	Bashkia Shkoder		E papërfunduar	1,719	3,421	-
04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave					22,839	33,242	20,158
P626ACE Rikons truksion Rruga Mehmet Xhelil Fishta	P.AD141.Q2.O1.A1. Rikonstruksion Rruga Mehmet Xhelil Fishta - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër		Përfunduar	-	20,106	20,074
P626ACF Rikonst ruksion Rruga "Ernest Bushati"	P.AD141.Q2.O1.A4. Rikonstruksion Rruga "Ernest Bushati" - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër		Përfunduar	-	9,876	9,866
P626ACD Rikons truksion degezim rruga Marin Biçikemi	P.AD141.Q2.O1.A5. Rikonstruksion Rruga "Marin Becikemi" (degezim)- TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër		Përfunduar	-	10,343	10,284
P626ACG Rikons truksion Rruga Gjon Gazulli	P.AD141.Q2.O1.A6. Rikonstruksion Rruga Gjon Gazulli- TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër		Përfunduar	-	17,155	17,139
P626ABS - Rikonstruksion rruga Roza Lejn	P.AD141.Q2.O1.A1. Rikonstruksion Rruga Roza Lejn	Bashkia Shkodër		Në proces zbatimi (me bashkëfinancim)	20,415	21,326	1
P626ABT - Rikonstruksion rruga Selim Coba	P.AD141.Q2.O1.A2. Rikonstruksion Rruga Selim Coba	Bashkia Shkodër		Në proces tenderimi	21,192	21,192	479
P626ABU - Rikonstruksion degëzim rruge Vekshar	P.AD141.Q2.O1.A3. Rikonstruksion degezim rruge Vekshar	Bashkia Shkodër		Në proces tenderimi	10,708	10,708	280

P626ACH Rikualifikim urban blloku pallateve Rruga Vëllezerit Frashëri	P.AD141.Q2.O1.A11. Rikualifikim urban bllok pallatesh Rruga Vëllezerit Frashëri -- TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	35,491	22,299
P626ABV - Rikualifikim urban sheshi pranë shkollës Martin Camaj	P.AD141.Q2.O1.A5. Rikualifikim urban sheshi pranë shkollës Martin Camaj	Bashkia Shkodër	Në proces leje	29,536	29,536	621
P626ABX - Rikualifikim urban bllok pallatesh rruga Tafiliceve	P.AD141.Q2.O1.A6. Rikualifikim urban bllok pallatesh Rruga Tafiliceve	Bashkia Shkodër	Në proces tenderimi	25,370	25,370	501
P626ACI - Rikonstruksion rruga e Foljetave, Bashkia Shkodër	P04520.Q1.O2.A10. Rikonstruksion rruga e "Foljetave, Bashkia Shkodër".(TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	10,649	10,631
P626ACN - Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Leke Dukagjini" - (tek Rajoni nr. 2) (Investim në proces nga viti 2020) (TE TRASHEGUARA)	P04520.Q2.A64. Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Leke Dukagjini" - (tek Rajoni nr. 2) (Investim në proces nga viti 2020) (TE TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Pezullim	-	2,941	-
P626ACM - Supervizim Rr.Pjeter Gjoka	P 04520.O3.A87.16 Supervizim Rr.Pjeter Gjoka (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	11	-
P452ADD Rikons truksion Rrugët "Fermentim" (Rrethina)	P.AD141.Q2.O2.A1. Rikonstruksion rruget Fermentim (Rrethina) - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	24,135	24,098
P452ACP - Rikonstruksion rruga Bregu i Detit Velipojë, bashkia Shkodër	P.AD141.Q2.O2.A1. Rikonstruksion Rruga "Bregu i Detit" Velipojë, Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër	Në proces tenderimi	71,481	71,481	1,209
P452ADC - Sistemim Asfaltim rruga e varrezave të qytetit Fshati Golem, Bashkia Shkodër	P04520.Q1.O3.A5 Sistemim, asfaltim rruga e varrezave të qytetit "Fshati Golem, Bashkia Shkodër".(TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	10,337	7,902
P452ADE - Sistemim Asfaltim rruga Pjetrushë pranë varrezave të qytetit, Grudë e Re, Bashkia Shkodër	P04520.Q1.O3.A6 Sistemim, asfaltim rruga "Pjetrushë" pranë varrezave Grudë e Re, Bashkia Shkodër - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Pezullim për shpronësim	-	27,023	10,475
P452ADG - Kom Rrethina Sist Asfal RR Shtoj I ri - Grudë e re	P 04520.O3.A87.1 Kontrate kolKol SARR Shtoj I Ri - Grudë e Re (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	27	-
P452ADH - Sarr Bardhaj qender Nja rrethina	P 04520.O3.A87.2 Kontrate mbikqyrje Sup SARR Bardhaj Koder II (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	48	-
P452ADI - Kol SARR Bardhaj Koder II	P 04520.O3.A87.4 Kontrate kol Kol SARR Bardhaj Koder II (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	15	-
P452ADJ - Kolaudimi Investim Gjelberim	P 04520.O3.A87.5 Kontrate Kolaudimi Kol Investim Gjelberim (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	15	-
P452ADK - Kolaudimi SARR Dobraç-Rus II	P 04520.O3.A87.6 Kontrate Kolaudimi Kol SARR Dobraç-Rus II (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	20	-
P452ADL - Kol SARR Grudë Vinoteke	P 04520.O3.A87.7 Kontrate Kol SARR Grudë Vinoteke (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	84	-

P452ADM - Mbikqyrje SARR RR, Na - Golem	P 04520.O3.A87.8 Kontrate mbikqyrje SARR RR,Na - Golem (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	250	-
P452ADN- Kol SARR RR, Na - Golem	P 04520.O3.A87.9 Kontrate Kol SARR RR,Na - Golem (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	34	-
P452ADO- Kol SARR Bardhaj Koder I	P 04520.O3.A87.10 Kontrate kolaudimi Kol SARR Bardhaj Koder I (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	16	-
P452ADF- Kontrate shtese Bardhaj Koder II	P 04520.O3.A87.17 Kontrate shtese Bardhaj koder II 20% (TRASHEGUARA)	Bashkia Shkodër	Përfunduar	-	1,109	-
04520 Rrjeti rrugor rural				178,702	349,297	135,858
V457AAB. Qytetare te subvencionuar ne transportin publik (Nr njerezve te subvencionuar)	P.AD141.Q3.O1.A1: Pensioniste, studente apo grupe tjera në nevojë të subvencionuar & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Vlerë e mbetur nga vitet e mëparshme	-	737	-
	4570 Transporti publik			-	737	-
V563AAC - Promovimi i mbrojtjes së mjedisit (numer aktivitetesh)	P.AD141 .Q4.O1.A1.. Aktivitete ne kuader te promovimit dhe mbrojtjes se mjedisit (si dita e mjedisit, dita e pyjeve etj)	Bashkia Shkodër	Realizuar takimet	400	400	-
	P.AD141 .Q4.O1.A2. Shpenzime paga te personelit per Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi për menaxhimin e mjedisit & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	6,496	7,242	5,156
	P.AD141 .Q4.O1.A3 Zbatimii/Hartimi I Planeve dhe projekteve (PBZHE , Plani I Energjise dhe Klimes etj))	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	-	-
P510AAK- Investime ne kuader te projektit Bashki te Zgjuara Energjie	P005100.Q2.O1.A6.Projek ti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE)- TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	2,684	1,741
	05100 MENAXHIMI I MBETJEVE			6,896	10,326	6,897
V614AAB. Inspektime të Zhvilluara për Mbrojtjen e Territorit (numer punonjesish)	P.AD141.Q5.O1.A1 - Paga dhe sigurime Inspektoriati i mbrojtjes territorit & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	20,198	22,327	17,969
V614AAC. Projekte zhvillimit urban te hartuara dhe monitoruara (numer PDV)	P.AD141.Q5.O1.A2 - Paga dhe sigurime Drejtoria e Planifikimit& të trashëguara		Realizuar	27,637	45,431	21,844
	P.AD141.Q5.O1.A3 - Paga dhe sigurime Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit te territorit		Realizuar	9,799	9,799	5,283
	P.AD141.Q5.O1.A4 Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV.		Realizuar	-	-	-

	P.AD141.Q5.O1.A5 Publikimi i Planeve te Detajuara Vendore nepermjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit		e parealizuar	-	-	-
	P.AD141.Q5.O1.A6 Miratimi i lejeve të zhvillimit/ndërtimit		Realizuar	-	-	-
	PAD141.Q1.O1.A6 Tarifa/Taksa për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të Bashkisë Shkodër & të trashëguara		Realizuar	5,000	8,233	1,051
	P.AD141.Q5.O1.A7 - Paga dhe sigurime Drejtoria e Drejtoria e aseteve		Realizuar	8,622	8,622	4,562
	P.AD141.Q5.O1.A8 - Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër & të trashëguara		Realizuar pjesërisht	1,000	1,671	524
	P.AD141.Q5.O1.A9 - Shpronësime & të trashëguara		Realizuar pjesërisht	16,000	34,315	3,008
P614AAK .Hartim i studimeve dhe projekteve teknike në infrastrukturë rrugore dhe objekte të ndryshme	P.AD141.Q5.O1.A10.Hart im i studimeve dhe projekteve teknike në infrastrukturë rrugore dhe objekte të ndryshme		Në proces do realizohet në vitin 2026		20,000	-
P614AAG - Hartimi i studimeve te fizibilitetit ,planevezhvillimor e masterplane,projek t-ide teknike dhe projekteve teknike te ndryshme te detajuara	P06140.Q1.O1.A3 Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt - ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara-TE TRASHEGUARA		Në proces do realizohet në vitin 2026	-	60,000	924
06140 Planifikimi Urban Vendor				88,256	210,398	55,164
P452AET - PARK4SUMP- Zbatimi i projektit sipas specifikimeve te programit Horizon 2020 PARK4SUMP	PARK4SUMP-Zbatimi i projektit sipas specifikimeve te programit Horizon 2020 PARK4SUMP-TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkoder	Vlerë e mbetur nga vitet e mëparshme	-	283	-
P626ACX - Adria Muse- Printim i hartes guide turistike liqenit, Printim i broshures guide turistike liqenit(obligime)	Adria Muse- Printim i hartes guide turistike liqenit, Printim i broshures guide turistike liqenit(obligime)-TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkoder	Vlerë e mbetur nga vitet e mëparshme	-	1,172	-
P.AD141 Planifikimi dhe Kontrolli I Territorit dhe Mjedisi				296,693	605,456	218,078
Të trashëguara				333,683	-	-
Totali				630,376	605,456	218,078

Aktivitetet me burim financimi transfertën e kushtëzuar:

Projektet	Aktivitete/Projekte	Institucioni	Statusi i aktivitetit	12 MUJORI 2025		
				Totali		
				Plani fillestar 2025	Plani I rishikuar 2025	Realizimi 2025
				Totali	Totali	Totali
P626ABS - Rikonstruksion rruga Roza Lejn (Kodi I Ministrise 18AY404)	P.AD141.Q2.O1.A1. Rikonstruksion Rruga Roza Lejn (Transfertë e kushtëzuar)	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	45,136	45,136
	Totali			-	45,136	45,136

Aktivitetet me burim financimi llogari jashtë Thesarit:

Projektet	Aktivitete/Projekte	Institucioni	Statusi i aktivitetit	Totali		
				Plani fillestar 2025	Plani i rishikuar 2025	Realizimi 2025
				Totali	Totali	Totali
P426AAQ- Projekti "Building Smart Forests	P04260.Q1.O1.A5 Projekti "Building Smart Forests - LLOGARI JASHTË THESARI	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	858	761
	04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave			-	858	761

Projektet	Aktivitete/Projekte	Institucioni	Statusi i aktivitetit	Totali		
				Plani fillestar 2025	Plani i rishikuar 2025	Realizimi 2025
				Totali	Totali	Totali
P510AAK-Investime ne kuader te projektit Bashki te Zgjuara Energjie	P005100.Q2.O1.A6.Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE) & të trashëguara - LLOG JASHTË THESARI	Bashkia Shkodër	Ne proces likuidimi te fatures.	-	20,143	-
	05100 MENAXHIMI I MBETJEVE			-	20,143	-

Përshkrimi i Aktiviteteve:

Për 12-mujorin 2025 në programin AD141 “Planifikimi dhe kontrolli i Territorit dhe Mjedisi” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

PAD141.Q1.O1.A1 - Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të shërbimit për administrimin e pyjeve & të trashëguara

Administrimi i fondit pyjor dhe kullësor në territorin e Bashkisë Shkodër, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5.

Në përmbushje të detyrimit ligjor Bashkia Shkodër gjatë 12 mujorit të vitit 2025 vazhdoi punën për konsolidimin e shërbimit të Administrimit të pyjeve/kullotave nëpërmjet forcimit të strukturës për administrim dhe menaxhim të këtij fondi pyjor.

PAD141.Q1.O1.A2. Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore/ kullosore/ shërbimi pyjor/ (Inspektoriat i pyjeve dhe vrojtuesit dhe shërbimet operative) & të trashëguara

Bazuar në Ligjin nr 57/2020 “Për pyjet”, pranë bashkisë u krijua sektori i inspektimit të pyjeve një strukturë inspektuese në mbrojtje të pyjeve kjo e shoqëruar edhe me shërbimin e vrojtuesve, për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri. Nje strukturë e re e pa konsoliduar akoma për shkak të legjislacionit.

PAD141.Q1.O2.A1. Pastrim dhe sistemim kullote & të trashëguara

Mbas përcaktimit të zonës kullimore ku do të ndërhyhet dhe u realizuan projektet të cilat u miratuan pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, u realizua procesi i tenderit dhe shërbimi, dhe u realizua shërbimi.

PAD141.Q1.O2.A2. Rehabilitim sipërfaqe kullimore Ekonomia Pyjore/Kullimore

Mbas përcaktimit të zonës kullimore ku do të ndërhyhet dhe u realizuan projektet të cilat u miratuan pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, u realizua procesi i tenderit dhe shërbimi, dhe u realizua shërbimi.

PAD141.Q1.O3.A1. Hartim plani i Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave të Bashkisë Shkodër (Ekonomi Pyjore) & të trashëguara

Në këtë aktivitet parashikohet të realizohet Plan i Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave për Ekonominë Pyjore. Ky plan do të ketë një vlefshmëri prej 10 vitesh dhe do të mbulojë aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike të zonës, njohjen e problemeve lokale si erozioni, rrëshqitjet, zjarret në pyje, prerjet ilegale etj, ndërkohë që do të japë orientimet për ndërhyrjet afatgjata në zonën e planit. Plan i Investimi u realizua me sukses . Bazuar në dispozitat ligjore Plan i Miratua edhe në Këshillin e Bashkisë Shkodër me Vendimin nr. 73 datë 27.12.2025.

PAD141.Q1.O3.A2 Shpenzime për përmirësim të fondit pyjor/kullor & të trashëguara.

Ky aktivitet parashikon shpenzime kryesisht në ndërhyrje të përmirësimit (Rrallime+ Krasitje, pastrim shkurre) arrihet ruajtja e objekteve të veshura me pemë nga rënia e zjarreve në pyje, ruajtja e filizerisë së re, si edhe përmirësimi i pyjeve në përgjithësi.

Ky shërbim parashikon ndërhyrje për luftimin e sëmundjeve në pyje si gjethpëdrerësja e cila dëmton drurët pyjorë, ndërkohë ky shërbim do të sjellë përmirësimin e situatës duke rritur fuqinë vegjetative të drurit. Është realizuar Projekti për Pyllëzim me Farë të një sipërfaqe Pyjore në EP Brucaj, ky projekt u dërgua dhe u miratua pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve. Ndërkohë nuk mundëm të realizonim investim sepse nuk arritëm në kohë të Prokuronim shërbimin i cili sipas projektit kërkonte “pyllëzim me farë” një metodë që këtë periudhë nuk është përdorur dhe nuk kishim siguri në realizimin e projektit.

P.04260.Q1.O1.A3 Projekti "Building Smart Forests" – (LLOGARI JASHTË THESARI)

Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit nr. 33 “Building Smart Forests”. në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020 nën Instrumentin e

Asistencës së Para-Aderimit (IPA II), me referencë EuropeAid/171769/ID/ACT/Multi. Kohëzgjatja e projektit do të jetë 30 muaj nga data e fillimit të projektit, 1 Mars 2023. Aktualisht sipas aktiviteteve jemi duke vepruar për realizimin e tyre. Sipas planit të parashikuar aktivitetet u realizuan. Ndërkohë investimi për Blerje Set për mbrojtjen nga zjarri (Blerje Dron) është në procedurë likuidimi.

P.AD141.Q2.O1.A1. Rikonstruksion Rruga “*Mehmet Xhelil Fishta*” - të trashëguara

Statusi: I përfunduar

Projekti ka konsistuar në rikonstruksion të plotë të trupit rrugor urban, duke përfshirë përmirësimin e shtresave rrugore, sistemimin e trotuareve, përmirësimin e drenazhimit dhe garantimin e aksesit për këmbësorë dhe mjete. Ndërhyrja ka synuar rritjen e sigurisë rrugore dhe përmirësimin e cilësisë urbane në zonë.

P.AD141.Q2.O1.A4. Rikonstruksion Rruga “*Ernest Bushati*”- të trashëguara

Statusi: I përfunduar

Ndërhyrja ka përfshirë rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese rrugore, përmirësimin e shtresës mbajtëse dhe asfaltike, si dhe sistemimin e elementëve anësorë të rrugës. Projekti ka kontribuar në lehtësimin e qarkullimit dhe përmirësimin e lidhjes funksionale me rrugët dytësore.

P.AD141.Q2.O1.A5. Rikonstruksion degëzim rruga “*Marin Biçikemi*”- të trashëguara

Statusi: I përfunduar

Ky projekt ka trajtuar një degëzim rrugor urban me funksion shërbimi për banorët, duke realizuar përmirësimin e shtresave rrugore dhe aksesit lokal. Ndërhyrja ka rritur standardet e infrastrukturës në blloqe banimi ekzistuese.

P.AD141.Q2.O1.A6. Rikonstruksion Rruga “*Gjon Gazulli*” - të trashëguara

Statusi: I përfunduar

Rikonstruksioni ka përfshirë rregullimin e trupit rrugor, përmirësimin e kullimit sipërfaqësor dhe rritjen e qëndrueshmërisë së shtresave. Projekti ka ndikuar në përmirësimin e lidhjes urbane dhe kushteve të lëvizjes për banorët.

P.AD141.Q2.O1.A1. Rikonstruksion Rruga “*Roza Lejn*”

Statusi: Në proces zbatimi (me bashkëfinancim)

Projekti parashikon rikonstruksion të plotë të rrugës urbane, përfshirë shtresat rrugore, sistemimin e trotuareve dhe përmirësimin e infrastrukturës shoqëruese. Aktualisht punimet janë në zhvillim sipas kontratës së lidhur.

P.AD141.Q2.O1.A2. Rikonstruktion Rruga “Selim Coba”

Statusi: Në proces tenderimi për zbatim

Projekti synon rehabilitimin e një rruge urbane me funksion lokal, duke përfshirë përmirësimin e shtresave rrugore dhe aksesit për këmbësorë. Zbatimi do të fillojë pas përfundimit të procedurave të prokurimit.

P.AD141.Q2.O1.A3. Rikonstruktion degëzim rruge “Vekshar”

Statusi: Në proces tenderimi për zbatim

Ndërhyrja ka si qëllim përmirësimin e aksesit rrugor në zonë rurale/ periurbane, duke rritur cilësinë e infrastrukturës dhe lidhjen me rrjetin ekzistues rrugor.

P.AD141.Q2.O1.A11. Rikualifikim urban blloku pallateve, Rruga “Vëllezërit Frashëri”- të trashëguara

Statusi: I përfunduar

Projekti ka realizuar rikualifikimin e hapësirave publike ndërmjet pallateve, përmirësimin e infrastrukturës urbane, trotuareve, ndriçimit dhe elementëve të mobilimit urban, duke rritur cilësinë e jetesës në zonë.

P.AD141.Q2.O1.A5. Rikualifikim urban sheshi pranë shkollës “Martin Camaj”

Statusi: Në proces leje

Ndërhyrja synon rikualifikimin e një hapësire publike me funksion social-edukativ, duke përmirësuar sheshet, aksesin për këmbësorë dhe sigurinë për nxënësit. Fillimi i zbatimit varet nga përfundimi i procedurave të lejes.

P.AD141.Q2.O1.A6. Rikualifikim urban bllok pallatesh, rruga “Tafiliceve”

Statusi: Në proces tenderimi për zbatim

Projekti parashikon ndërhyrje në hapësirat publike ndërmjet pallateve, duke përmirësuar infrastrukturën urbane dhe kushtet e jetesës për banorët.

P04520.Q1.O2.A10. Rikonstruktion rruga e “Foljetave” - të trashëguara

Statusi: I përfunduar

Ndërhyrja ka përmirësuar infrastrukturën rrugore ekzistuese, duke garantuar kushte më të mira qarkullimi dhe akses për banorët e zonës.

P.AD141.Q2.O2.A1. Rikonstruktion Rrugët “Fermentim” (Rrethina)- të trashëguara

Statusi: I përfunduar (me bashkëfinancim)

Projekti ka trajtuar rrugë rurale me rëndësi për lidhjen e zonës së Rrethinës, duke përmirësuar aksesin dhe kushtet e lëvizjes.

P.AD141.Q2.O2.A1. Rikonstruktion Rruga “Bregu i Detit”, Velipojë

Statusi: Në proces tenderimi për zbatim

Ndërhyrja synon përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonë turistike, duke rritur standardin e aksesit dhe sigurinë për banorët dhe vizitorët.

P04520.Q1.O3.A5 Sistemim dhe asfaltim rruga e varrezave, Fshati Golem - të trashëguara

Statusi: I përfunduar

Ndërhyrja ka përmirësuar aksesin në një infrastrukturë shërbimi publik, duke rritur funksionalitetin dhe sigurinë e lëvizjes.

P04520.Q1.O3.A6 Sistemim dhe asfaltim rruga “Pjetrushë”, Grudë e Re - të trashëguara

Statusi: Përfundim për shpronësim

Projekti ka realizuar sistemimin dhe asfaltimin e një rruge lokale me rëndësi për komunitetin, duke përmirësuar kushtet e aksesit dhe shërbimit.

P.AD141.Q4.O1.A1. Aktivitete në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit (si dita e mjedisit, dita e pyjeve etj)

Janë realizuar 10 takime, por fondi nuk është përdorur. Janë aktivitete me shkollat e qytetit.

P.AD141.Q4.O1.A2. Shpenzime paga të personelit për Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorisë në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi për menaxhimin e mjedisit & të trashëguara

Në funksion të detyrave funksionale realizohen dëgjësive për efekt të projekteve që zbatohen dhe ndikimet mjedisore që ata kanë. Si detyrim ligjor për pjesëmarrje në dëgjesa publike, referuar kërkesave të subjekteve dhe në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit. Aktualisht kemi marrë pjesë në 5 dëgjesa publike, ku janë dhënë edhe opinionet.

P.AD141.Q4.O1.A3 Zbatimi /Hartimi i Planeve dhe projekteve (PBZHE , Plani i Energjisë dhe Klimës etj).

Aktualisht është realizuar plani për Energji dhe Klimë i cili është në fazë zbatimi si edhe Plani mbrojtjes së biodiversitetit që përsëri po zbatohet.

P05100.Q2.O1.A6.Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE) & të trashëguara

P510AAK- Investime në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie Aktualisht me mbikqyrjen e SECO dhe përfaqësuesve zvicerane janë realizuar procedurat e tenderimit për investimet në kuadër të projektit “Bashki të zgjuara energjie”, Investimi është realizuar me sukses dhe jemi në fazën e likuidimit.

P05100.Q2.O1.A6.Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE) & të trashëguara (LLOGARI JASHTË THESARI).

Projekti “*Bashki të Zgjuara Energjie*” (PBZE) synon të përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë, të zvogëlojë konsumin e energjisë, të promovojë burimet e energjisë së rinovueshme duke promovuar përdorimin e teknologjive energjitike inovatore dhe miqësore me mjedisin. Ky projekt nisi me iniciativën e Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështje Ekonomike (SECO), cili përmes një mekanizmi seleksionimi, përzgjodhi Bashkinë Shkodër si një ndër katër bashkitë fituese për implementimin e këtij projekti. Projekti është realizuar me sukses dhe është në momentin e likuidimit të investimit.

P.AD141.Q5.O1.A1 Paga dhe sigurime Inspektoriati i mbrojtjes territorit & të trashëguara

Për vitin 2025 janë realizuar pagesat per pagat + sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e drejtorisë.

P.AD141.Q5.O1.A2 Paga dhe sigurime Drejtoria e Planifikimit& të trashëguara

Për vitin 2025 janë realizuar pagesat per pagat + sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e drejtorisë.

P.AD141.Q5.O1.A3 Paga dhe sigurime Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit te territorit

Për vitin 2025 janë realizuar pagesat per pagat + sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e drejtorisë.

P.AD141.Q5.O1.A4 Përgatitja e Planeve të Detajuara Vendore (PDV) për zonat e parashikuara në PPV

Statusi: Në proces

Ky aktivitet ka si objekt **hartimin e Planeve të Detajuara Vendore (PDV)** për zonat e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Procesi përfshin analizën urbane dhe funksionale të zonave, përcaktimin e parametrave të zhvillimit (KSHR, KSHB, intensitet ndërtimi), strukturën e infrastrukturës publike, hapësirat publike dhe rregullat e zhvillimit.

Aktualisht projekti ndodhet në fazë përgatitore dhe koordinimi ndërinstitutional, dhe realizimi i tij është thelbësor për orientimin e zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe për dhënien e lejeve të zhvillimit në përputhje me PPV.

P.AD141.Q5.O1.A5 Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore përmes publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit

Statusi: Në proces

Ky aktivitet lidhet drejtpërdrejt me **transparencën dhe pjesëmarrjen publike** në proceset e planifikimit territorial.

Ai parashikon publikimin e PDV-ve të hartuara përmes platformave elektronike, njoftimeve zyrtare, si dhe mjeteve tradicionale të informimit, në përputhje me kërkesat ligjore për konsultimin publik.

Aktiviteti ndodhet në proces dhe do të realizohet paralelisht me përfundimin dhe miratimin e PDV-ve, duke garantuar akses të qytetarëve dhe aktorëve të interesuar në dokumentet planifikuese.

P.AD141.Q5.O1.A7 Paga dhe sigurime Drejtoria e Drejtoria e aseteve

Për vitin 2025 janë realizuar pagesat për pagat + sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e drejtorisë.

P.AD141.Q5.O1.A8 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër & të trashëguara.

Gjatë 12 muorit të vitit 2025, Drejtoria e Aseteve dhe Kadastres Urbane ka bërë 39 aplikime për 177 prona, në total **523 550 lekë**:

0 prona për të cilat është bërë aplikim për shpronësim

159 prona për të cilat është bërë aplikim për status juridik, kartelë pasurie dhe hartë treguese

18 prona të aplikuara për regjistrim pronash sipas VKM

160 000 lekë shpenzime për pagesa të komisioneve të shpronësimit për VKM shpronësimesh dalë në 2025.

P.AD141.Q5.O1.A9 Shpronësime & të trashëguara

Gjatë 12 muorit të vitit 2025 janë bërë **3 007 864 lekë** për likuidime shpronësimesh sipas VKM nr.833, datë 20.11.2019.

P06140.Q1.O2.A1 Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave, Bashkia Shkodër (të trashëguara)

Statusi: Në proces

Ky aktivitet ka për qëllim rivlerësimin, përditësimin dhe monitorimin e Sistemit të Adresave në territorin e Bashkisë Shkodër.

Ndërhyrja përfshin verifikimin e të dhënave ekzistuese, përmirësimin e saktësisë së adresimit,

integrimin me sistemet kombëtare dhe përditësimin e hartave përkatëse.

Aktiviteti konsiderohet i trashëguar dhe ndodhet në proces, duke qenë një komponent i rëndësishëm për funksionimin e shërbimeve publike, regjistrimin e pronave dhe planifikimin urban.

P06140.Q1.O1.A3 Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplaneve, projekt-ideve teknike dhe projekteve teknike të detajuara

Statusi: Në proces

Ky aktivitet është vazhdimësi e angazhimeve të mëparshme të Bashkisë Shkodër dhe synon finalizimin e dokumenteve planifikuese dhe teknike.

Ai përfshin përditësimin, plotësimin dhe harmonizimin e studimeve dhe projekteve ekzistuese me politikat aktuale të zhvillimit territorial dhe kërkesat ligjore.

Aktiviteti është në proces dhe lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e projekteve të reja investuese dhe përmirësimin e cilësisë së planifikimit urban.

Programi AE141 - Shërbimet Publike Vendore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Ndërmarrjen e shërbimeve dhe punëve publike

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimet e programit:

Q1. Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2025 është:

Q1.O1. Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, furnizim me ujë për vaditje të fermave bujqësore.

Sistemi i kullimit, si pjesë e rëndësishme e programit dhe objektivave dhe duke qenë një nga prioritetet e Bashkisë Shkodër në fushën e bujqësisë, mbështetur në Planin e Veprimit për ndërhyrje në sistemin kullues për vitin 2025 dhe me hartimin e projekteve teknike është arritur të realizohet për pastrimin e 108 km Kanale kulluese. Këto ndërhyrje janë kryer respektivisht në fshatrat Obot- Oblikë- Muriqan Njësia Administrative Ana e Malit gjithashtu në fshatrat Samrish–Rrushkull-Belaj–Dajç, Njësia Administrative Dajç, fshatin Bleran, Njësia Administrative Rrethina, kemi ndërhyrë edhe në pastrimin e Kolektori Kullues, Qytet te Shkolla Austriake po ashtu edhe te Kolektori Kullues në qendër para Hotel Rozafa. Këto ndërhyrje kanë sjellë përmirësimin e një sipërfaqeje toke bujqësore me kullim të përmirësuar prej 5,100 Ha.

Q2. Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 4-mujorin e tretë të vitit 2025 janë:

Q2.O1. Mirëmbajtja e rrugëve, shesheve dhe trotuare urbane.

Q2.O2. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Programin e infrastrukturës rrugore si funksion i veti do të jetë mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike të tij. Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Mirëmbajtja e rrjetit rrugor në qytet dhe në njësi administrative kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.

Mirëmbajtja e rrjetit konsiston në detyra që janë të nevojshme për të mirëmbajtur rrjetin rrugor funksional dhe në masa më pak të kushtueshme në mënyrë që të parandalohet degradimi i

rrugëve. Ndërmarrja do të kryejë një numër aktivitete (punë dhe shërbimi) me qëllim që të arrijë nivelin e kërkuar të shërbimit për përdoruesit e rrugës në të gjithë rrjetin rrugor në qytet.

Q3. Lëvizshmëri e sigurt, e mirëorientuar për banorët dhe vizitorët. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër. Përmirësim të impaktit mjedisor nëpërmjet stimulimit të transportit publik dhe traditës së përdorimit të biçikletës.

Objekti i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2025 është:

Q3.O1. Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë.

Për realizimin e këtij objekti është bërë plotësimi me sinjalistikë horizontale e vertikale në të gjitha rrugët e rikonstruara me financimet e Bashkisë Shkodër. Është realizuar plotësimi me sinjalistikë horizontale e vertikale, i korsive të dedikuara për biçikleta. Ky proces do të vazhdojë me zgjerimin e korsive të dedikuara edhe në rrugët e tjera.

Krahas investimeve të realizuara në korsitë të dedikuara për biçikleta gjatë vitit 2025 është realizuar edhe mirëmbajtja e infrastrukturës që dëmtohet nga mjetet dhe qytetarët.

Është punuar për ndërtimin e rrjetit të korsive të biçikletave në Bashkinë Shkodër nga punonjësit e Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe punëve Publike. Gjatë vitit 2025 janë ndërtuar 5,449 metër linear të ndara:

Sheshi Zogu i Parë	50 metër linear
Rruga Studenti	480 metër linear
Rruga Martin Camaj	430 metër linear
Rruga Qemal Draçini	490 metër linear
Rruga Europa	330 metër linear
Rruga Pogaj	100 metër linear
Unaza Lindore Rrotondo Rus-Sheshi i Spitaleve	1,000 metër linear
Unaza Lindore Rruga Hilë Mosi dhe Marije Shllaku	850 metër linear
Unaza Perëndimore Segment	1,719 metër linear

Këto korsitë janë realizuar me të gjithë sinjalistikën horizontale dhe vertikale kufizuese dhe sinjalizuese.

Për rritjen e sigurisë së kalimtarëve kryesisht nxënësve që frekuentojnë shkollat publike dhe jopublike është realizuar sinjalistika horizontale dhe vertikale në rrugët në afërsi të shkollave në qytet dhe Njësitë Administrative.

Është realizuar vendosja e 227 ml bumbesh gome për ngadalësimin e shpejtësisë në disa pika të rrezikshme në qytet dhe Njësitë Administrative.

Përsa i përket transportit, janë në funksion dy linja të transportit publik qytetas të udhëtarëve: Fermentim-Bahçallek-Fermentim, Shkodër-Shirokë-Zogaj

Krahas shërbimit qytetas në Bashkinë Shkodër realizohet shërbimi rrethqytetës me linja të rregullta që lidhin Njësitë Administrative me Bashkinë Qendër. Shërbimi kryhet me operatorë ekonomikë të licensuar nga Bashkia Shkodër sipas frekuencave të miratuara me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 44 datë 25.06.2025: “Për miratimin e rrjetit të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër”.

Sipas vendimit të mësipërm transporti i udhëtarëve realizohet në linjat si më poshtë:

- Shkodër – Velipojë
- Shkodër – Dajç
- Shkodër–Trush
- Shkodër – Gur i Zi
- Shkodër – Ana e Malit
- Shkodër – Postrinë
- Shkodër – Rrethina me 3 linja:
 - Shkodër - Bleran – Bardhaj,
 - Shkodër – Grudë e Re – Guci e Re,
 - Shkodër Shtoj i Ri – Shtoj i vjetër
 - Shkodër – Shalë me dy drejtime:

- Shkodër – Breglumi – Shalë – Theth – Shkodër;
- Shkodër- Koplik – Theth – Breglumi – Shalë – Shkodër.

Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 68 datë 06.11.2024 “Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr. 5, dt. 05.01.2022 “Për miratimin e rrjetit të linjave dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve, për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër”.

- Shkodër – Shosh – Shkodër
- Shkodër-Koplik-Theth-Breg Lumi, Shalë-Shosh-Shkodër (kalim tranzit nga Koplik dhe Njësia Shalë me dyer të mbyllura)

Q4. Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2025 janë:

Q4.O1. Përmirësimi i administrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane: Mbulimi i kostos nga tarifa e shërbimit. Norma e mbledhjes së tarifës së shërbimit.

Zona e mbulimit është rritur duke përmbushur objektivin e ofrimit të shërbimit sipas planit të miratuar dhe mbulimi i territorit administrativ të Bashkisë Shkodër.

Q4.O2. Përmirësimi i grumbullimit të mbetjeve urbane në zonën Qytet.

Shërbimi vazhdon të mbulohet me sipërmarrje private. Me miratimin e versionit të ri të Procedurës standarte të veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër realizohet më së miri përmirësimi i cilësisë të shërbimit duke rritur standartin e kontrollit dhe monitorimit të ofrimit të shërbimit të pastrimit për zonat funksionale bazuar në kontratat e ofrimit të shërbimit të pastrimit. Shërbimi i evadimit të mbetjeve me kontenierë monitorohet çdo ditë në ora 07:09:00. Në zonën muzeale/turistike, realizohet shërbimi i mbledhjes së mbetjeve derë-më-derë dhe monitorohet cdo ditë nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit në ora 13:00-16:00. Hartat e PGM-ve me karakteristikat e tyre (nr. Kazanëve, materiale, kapaciteti, etj), janë azhornuar sistematikisht në mënyrë elektronike në sistemin GIS.

Q4.O3. Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit.

Nën vëmendje përdorimi me eficiencë të burimeve financiare dhe rritja e transparencës dhe përfshirja e hallkave administrative, që sigurojnë administrimin e plotë të shërbimit, planifikimin, zbatimin, kontrollin dhe verifikueshmërinë e shërbimit të ofruar.

Është shtuar shërbimi dhe strukturuar me frekuenca të përcaktuara, sipas standartit të dakordësuar, me pika grumbullimi të përcaktuara dhe me kontenierë shtesë edhe në të gjitha Njësitë Administrative.

Q4.O4. Përmirësimi i grumbullimit të mbetjeve urbane në Nj.A.

Me kontratat që mbulojnë shërbimin e pastrimit për zonën lindore dhe perëndimore janë shtuar edhe territore ku sot është sistemuar infrastruktura, janë shtuar pika grumbullimi dhe i ofrohet shërbimi, si në: Theth, Ndërlisaj, Okol, të Njesisë Administrative Shalë.

Shërbimi monitorohet direkt pas realizimit të frekuencave në Njësitë Administrative. Kontratat e shërbimit të pastrimit për zonat Perëndimore dhe Lindore kanë parashikuar vendosjen e GPS për çdo mjet teknologjik në funksion të Bashkisë Shkodër i cili mund të kontrollohet nga zyra e monitorimit. Hartat e PGM-ve me karakteristikat e tyre (nr. Kazanëve, materiale, kapaciteti, etj), janë azhurnuar sistematikisht në mënyrë elektronike në sistemin GIS.

Q4.O5. Rritja e sipërfaqes që fshihet në zonën urbane

Sipërfaqja e fshirë manualisht dhe mekanikisht është çdo ditë 200,000 m², e cila përfshin rrugët/trotualet/sheshet e qytetit, nga të cilat akset kryesore marrin shërbim çdo ditë, ndërsa rrugët dytësore marrin shërbim 1-4 herë në javë sipas grafikut.

Q5. Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pavarësisht vendndodhjes së tyre. Përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12 mujin e vitit 2025 janë:

Q5.O1. Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.

Është realizuar shpërbliimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë. Është realizuar mirëmbajtja e të gjithë objekteve në qytet dhe në Nj.A. Është realizuar mirëmbajtje e ambienteve publike në Nj.A.

Q5.O2. Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi.

Është realizuar dhe në proces gjatë vitit shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe dëshmorëve, Zbatim i Kontratës ka objektiv kryesor shërbimin cilësor dhe me standarte shtetërore të mirëmbajtjes së varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit.

Q6. Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, objekteve publike të mirëmbajtura.

Objekti i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12 mujin e vitit 2025 është:

Q6.O1. Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, objektet publike të mirëmbajtura në të gjithë Bashkinë.

Është realizuar dhe vazhdon gjatë gjithë vitit përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes të gjelbërimit rrugor dhe lulishteve të qytetit. Shërbimi për 12 mujorin është realizuar me kontratën e shërbimit.

Q7. Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe përmirësimin e ndriçimit të mjediseve publike. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.

Objekti i programit buxhetor për përmirësimin e këtij qëllimi për vitin 2025 është:

Q7.O1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

Ky objektiv është realizuar nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit. Është realizuar puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues. Është realizuar shpërblyeri në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmirësimit të detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

Është bërë mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:

- Mirëmbajtje e 6,269 ndriçuesve të zakonshëm;
- Mirëmbajtje e 218 ndriçuesve dekorativ;

Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative;

Për Vitin 2025, sektori i ndriçimit, nëpërmjet personelit të vet (elektrici, manovratorë dhe punëtorë), investoi në rritjen e sistemit të ndriçimit në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, me linja elektrike, ndriçues të rinj dhe shtylla metalike konike të pajisura me të gjithë aksesoret. Shtrirja e ndriçimit të ri ishte në të gjithë njësitë administrative të Bashkisë, dhe në mënyrë më të detajuar si më poshtë:

1. Njësinë Administrative Bërdicë – 22 ndriçues të rinj
2. Njësinë Administrative Rrethina – 46 ndriçues të rinj
3. Njësinë Administrative Dajç – 22 ndriçues të rinj
4. Njësinë Administrative Ana e Malit – 20 ndriçues të rinj
5. Njësinë Administrative Postribë – 22 ndriçues të rinj
6. Njësinë Administrative Gur i Zi – 26 ndriçues të rinj
7. Njësinë Administrative Velipojë – 63 ndriçues të rinj
8. Rajoni 1, 2, 3, 4 dhe 5 janë vendosur 121 ndriçues të rinj

Në total, janë vendosur 342 ndriçues të rinj, me 10.44 Km rrugë të reja të ndriçuara.

Gjatë vitit 2025 u realizua riparimi i aksit të ndriçimit Ura e Bardhajve - Qendër Mes, me 280 ndriçues. Rehabilitimi i këtij aksi u mundësua në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Shkodër, i cili mundësoi blerjen e kabllit për linjën nëntokësore. Rehabilitimi u realizua me punëtorët e Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike.

Është realizuar investimi i miratuar në buxhetin e vitit 2025 me objekt “Investim në rehabilitimin e ndriçimit në rrugën Jeronim De Rada”.

Q8. Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet

përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.

Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12 mujorin e vitit 2025 është:

Q8.O1. Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë.

Ky shërbim realizohet nga Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, sh.a:

- 94,674 numri i popullsisë me shërbime sanitare (KUB)
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) është projektuar për të funksionuar i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza, por në disa seksione ka ndërthurje të dy sistemeve.
- Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve të KUB për qytetin është rreth 54 km. Rreth 37 km përbëhen nga tubacione të mbyllura dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura;
- Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Objektivat Strategjike të Departamentit të Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura

Në kuadër të përmbushjes së misionit për ofrimin e një shërbimi të sigurt, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet mjedisore, Departamenti i Kanalizimeve të Ujërave të Bardha ka përcaktuar objektivat strategjike për periudhën raportuese si më poshtë:

1. Zhvillimi dhe Modernizimi i Infrastrukturës

- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve për ujërat e bardha në zonat urbane me densitet të lartë popullsie.
- Realizimi i investimeve për ndërtimin e kolektorëve të rinj në zonat periferike dhe industriale me risk të lartë përmbytjeje.
- Përdorimi i teknologjive të avancuara për monitorimin dhe hartëzimin e rrjetit ekzistues, për identifikimin e pikave problematike.

2. Parandalimi dhe Menaxhimi i Përmbytjeve

- Hartimi i një **Hartë të Riskut për Përmbytjet Urbane**, duke identifikuar 10 pikat më të ndjeshme në qytet.
- Realizimi i masave të ndërhyrjes urgjente në të paktën **5 zona kritike**, përmes ndërtimit të strukturave të devijimit dhe rezervuarëve për grumbullim uji.

- Rritja e frekuencës së pastrimit të pusetave, grilave dhe kanaleve kulluese në sezonet e reshjeve intensive.

3. Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Zgjidhjeve të Gjelbra

- Instalimi i sistemit të filtrimit të ujërave të shiut në daljet kryesore për të ndaluar ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe ndotësit urbanë.
- Pilotimi i **sipërfaqeve të gjelbra thithëse** (biofiltra, rrugë me përthithje të kontrolluar) në 2 lagje urbane si model për menaxhimin natyror të reshjeve.
- Nxitja e përdorimit të rezervuarëve të ujit të shiut në ndërtesat publike për përdorim jo të pijshëm (p.sh. vadtje, pastrim).

4. Rritja e Monitorimit dhe Transparencës

- Zbatimi i një sistemi të integruar të monitorimit në kohë reale për rrjedhjet, bllokimet dhe prurjet në rrjetin e ujërave të shiut.
- Publikimi i raporteve tremujore mbi performancën e rrjetit dhe ndërhyrjet e kryera.
- Krijimi i një portali online për njoftimin e bllokimeve, përmbytjeve apo problematikave të tjera nga qytetarët.

5. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Qytetarëve

- Organizimi i **fushatave vetëdijësuese sezonale** për mirëmbajtjen e mjedisit urban, me fokus në shmangien e hedhjes së mbetjeve në rrjetin e kanalizimeve.
- Bashkëpunimi me shkollat për edukimin e brezit të ri mbi ciklin e ujit dhe rolin e qytetarit në mbrojtjen e mjedisit ujor.
- Përfshirja e komunitetit në inspektime vullnetare dhe aksione të pastrimit në bashkëpunim me pushtetin vendor.

Gjatë këtij tremujori është kryer mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit KUB qytet, konkretisht:

- Rehabilitim kolektori nga shkolla Austriake drejt Unazës lindore (hotel Argenti)
- Rehabilitim kolektori sheshi Demokracia (deri tek rruga “Teuta)

Përveç kanaleve të mëdha kulluese, gjithashtu ka vazhduar puna rutinë në pastrimin e kunetave dhe kanaleve në rrugica të lagjeve të ndryshme të qytetit.

Është realizuar riparimi dhe vendosje gradelash dhe pusetash të dëmtuara në rrugë të ndryshme të qytetit.

- Është realizuar riparimi i pusetave në Unazën e qytetit
- Zëvendësimin e gradelave dhe riparim pusetash të dëmtuara në të gjithë qytetin.


Përfundime dhe Rekomandime

Objektivat e vendosura përbëjnë një bazë të qëndrueshme për një menaxhim efikas dhe modern të ujërave të shiut, duke adresuar njëkohësisht sfidat aktuale dhe perspektivat afatgjata. Rekomandohet që gjatë tremujorëve të ardhshëm:

- Të përshpejtohen procedurat e prokurimit për projektet infrastrukturore.
- Të sigurohet financim i qëndrueshëm për zgjidhjet natyrore dhe teknologjite e monitorimit.
- Të thellohet bashkëpunimi me komunitetin dhe institucionet arsimore për të forcuar vetëdijen qytetare.


Realizimi i Buxhetit të planifikuara mijë lekë

Programi AE141	Paga & sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	<i>000/leke</i> Totali
PBA 2025	151,766	632,566	15,000	35,999	835,331
Plani fillestar 2025	190,684	833,732	15,021	77,524	1,116,961
Plani i rishikuar 2025	176,138	790,979	15,132	144,240	1,126,489
Realizimi viti 2025	131,117	582,796	15,082	64,303	793,297
% e realizimit	74.4%	73.7%	99.7%	44.6%	70.4%



Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 70.4%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korente	74.2%
Shpenzime kapitale	44.6%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Më poshtë pasqyrohet në mënyrë të detajuar se në çfarë faze janë aktivitetet e parashikuara për vitin 2025.

- Menaxhimi dhe funksionimi i sektorit të kullimit dhe ujitjes është realizuar.
- Pastrim kanalesh kulluese në Nj.A është realizuar.
- Pastrim kanalesh ujitëse është realizuar.
- Mirëmbajtje, rehabilitim i skemës ujitëse është realizuar.
- Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma, është realizuar.
- Paga dhe sigurime për stafin e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor urban, të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit, të gjelbërimit varreza, të mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe dekorit është realizuar.
- Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit
 - Blerje karburanti është lidhur kontrata.
 - Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit. Është realizuar shërbimi.
 - Shpenzime për sigurimin e automjeteve. Ky aktivitet është realizuar.
- Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës është realizuar.
- “A Lujmë Bashkë?” është lidhur kontrata për projektimin e investimit, zbatimi do të mbartet në vitin 2026.
- Mirëmbajtja e rrugëve rurale është realizuar.
- Blerje materiale për sinjalitike horizontale dhe vertikale është realizuar.
- F.V Kufizues shpejtësie (bume gome) është realizuar.
- Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore është realizuar.
- Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve është realizuar.
- Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale është realizuar.

- Blerje kontenierë për shërbimin e pastrimit qytet, është realizuar.
- Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve është realizuar.
- Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve është realizuar.
- Shërbime varrimi për raste të veçanta është realizuar.
- Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore është realizuar.
- Blerje aksesorë dekori për festat e fundvitit është realizuar.
- Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit është realizuar.
- Blerje materiale kancelarie për nevojat e administratës është realizuar.
- Blerje materiale hidraulike, bojë, etj. është realizuar.
- Blerje material për pastrim ambienti është realizuar.
- Mirëmbajtje objekti nuk është realizuar.
- Shërbim Interneti është realizuar.
- Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri është realizuar.
- Shërbime postare është realizuar.
- Shërbime të printimit dhe publikimit në media, është realizuar.
- Shërbime të tjera (larje automjete, tarifë parkingu, etj), është realizuar.
- Sigurimi i ndërtesës dhe inventari i tyre ekonomik nuk është realizuar.
- Mirëmbajtje pajisje informatike, është realizuar.
- Shërbim GPS është lidhur kontrata, është realizuar.
- Mirëmbajtje rrjeti dhe infrastrukture për ambientin TIK është realizuar.
- Sistem informacioni i integruar për menaxhimin financiar të NSHPP është realizuar.
- Shërbime përkthimi është realizuar.
- Pajisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve është realizuar.
- Blerje vegla pune për elektriçistë është realizuar.
- Blerje materiale për rritjen dhe modernizimin e ndriçimit, është realizuar.
- Blerje uniforma pune për punonjësit e ndërmarrjes është realizuar.
- Pagesa e konsumit të energjisë elektrike të ndriçimit rrugor është realizuar.
- Është realizuar investimi i miratuar në buxhetin e vitit 2025 me objekt “Investim në reabilitimin e ndriçimit në rrugën Jeronim De Rada”.
- Është lidhur kontrata për realizimin e investimit me objekt “Investim në reabilitimin e ndriçimit në rrugën Mikel Koliqi”.
- Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB), është realizuar.

Raporti: M3 - Shpenzimet dhe Sasitë e Produkteve: Fakti - Planit (Janar - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AE141 - Shërbimet Publike Vendore

Viti: 2025

Vlerat paraqiten në: ALL

KODI	PRODUKTI		KUMULATIVE DERI NË FUND TË PERIUDHËS			NDRYSHIMI (%)		
			PLANI FILLESTAR	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR	
Funksioni 04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit								
V424AAB	Mirëmbajtja rutinë e kanaleve Ujitëse dhe Kanale Kulluese		Sasia	240	240	108	45.00%	45.00%
	Njësia e Matjes	km	Shpenzimet	49,149,670	97,453,361	63395909	128.99%	65.05%
Funksioni 04520 - Rrjeti rrugor rural								
V452AAB	Rrjet Rrugor Rural i Mirëmbajtur		Sasia	382,800	382,800	382,800	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	m2	Shpenzimet	23,783,670	39,504,851	35253508	148.23%	89.24%
V452AAA	Shërbimi i Stafit të Mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural		Sasia	29	29	29	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr. punonjesish	Shpenzimet	30,637,000	30,637,000	23505087	76.72%	76.72%
Funksioni 04570 - Transporti publik								
V457AAA	Shërbimi i Transportit Publik		Sasia	600,000	600,000	888,505	148.08%	148.08%
	Njësia e Matjes	nr. bileta	Shpenzimet	25,047,000	36,787,902	20420925	81.53%	55.51%
Funksioni 05100 - Menaxhimi i mbetjeve								
V510AAA	Shërbimi i Stafit të Menaxhimit të Mbetjes dhe Pastrimit		Sasia	33	33	33	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr. punonjesish	Shpenzimet	28,701,000	30,074,812	28556498	99.50%	94.95%
V510AAB	Mbledhje dhe Transportim i Mbetjeve nga Zonat Urbane		Sasia	88,682	88,682	88,682	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr. banore	Shpenzimet	110,674,000	195,762,389	174834186	157.97%	89.31%
V510AAF	Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve		Sasia	42,500	42,500	36,762	86.50%	86.50%
	Njësia e Matjes	ton	Shpenzimet	88,059,725	99,097,725	56099934	63.71%	56.61%
V510AAC	Mbledhje dhe Transportim i Mbetjeve nga Zonat Rurale		Sasia	64,676	64,676	64,676	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr. banore	Shpenzimet	71,392,000	72,392,000	69901737	97.91%	96.56%

V510AAD	Pastrimi i Rugëve dhe Parqeve		Sasia	58	58	58	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	km2	Shpenzimet	45,000,000	56,720,916	11669497	25.93%	20.57%
Funksioni 06260 - Shërbimet publike vendore								
V626AAG	Trotuare të Mirëmbajtur dhe Rehabilituar		Sasia	2,680	2,680	4,530	169.03%	169.03%
	Njësia e Matjes	m2	Shpenzimet	18,182,000	33,652,961	16303956	89.67%	48.45%
V626AAA	Shërbimi i Stafit të Ndërmarrjeve Publike të Gjellbërimit, Varrezave		Sasia	2	2	2	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr. punonjesish	Shpenzimet	2,686,000	3,853,000	2468399	91.90%	64.06%
V626AAB	Mirëmbajtja e Sipërfaqes së Varrezave		Sasia	93,886	93,886	93,886	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	sip. mirembajtur	Shpenzimet	16,632,000	23,632,000	14642654	88.04%	61.96%
V626AAD	Sipërfaqe e Gjellbërt e Mirëmbajtur dhe Rehabilituar		Sasia	126,320	125,110	125,110	99.04%	100.00%
	Njësia e Matjes	sip. mirembajtur	Shpenzimet	43,535,000	43,085,000	22672285	52.08%	52.62%
V626AAH	Objekte Publike të Mirëmbajtura		Sasia	116,593	117,130	117,334	100.64%	100.17%
	Njësia e Matjes	nr. banore	Shpenzimet	765,000	3,168,000	615000	80.39%	19.41%
V626AAC	Rrugë Urbane e Mirëmbajtur dhe Rehabilituar		Sasia	4,700	4,700	3,850	81.91%	81.91%
	Njësia e Matjes	m2	Shpenzimet	25,576,000	25,576,000	5280106	20.64%	20.64%
Funksioni 06370 - Furnizimi me ujë dhe kanalizime								
V637AAA	Kanalizime të Ujërave të Bardha të Mirëmbajtura		Sasia	104,309	124,674	124,674	119.52%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr. banore	Shpenzimet	15,000,000	15,000,000	15000000	100.00%	100.00%
Funksioni 06440 - Ndrëçimi i rrugëve								
V644AAA	Shërbimi i Stafit të Mirëmbajtjes së Ndrëçimit Publik		Sasia	55	55	55	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	nr. punonjesish	Shpenzimet	83,611,000	98,439,342	65680723	78.56%	66.72%
V644AAB	Rrjeti i Ndrëçimit Rrugor Publik Urban i Mirëmbajtur		Sasia	1,800	3,700	3,700	205.56%	100.00%
	Njësia e Matjes	linja te reja	Shpenzimet	121,600,000	132,131,000	118899650	97.78%	89.99%
V644AAC	Rrjeti i Ndrëçimit Rrugor Publik Rural i Mirëmbajtur		Sasia	7,800	7,800	6,800	87.18%	87.18%
	Njësia e Matjes	linja te reja	Shpenzimet	35,300,000	56,297,838	48096933	136.25%	85.43%

M6: Raporti i Realizimit të Objektivave

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AE141 - Shërbimet Publike Vendore

OBJEKTIVI 1.1

Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, furnizim me uje për vaditje të fermave bujqësore

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.1.A	Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes & kullimit të tokave bujqësore Nr automjete	nr	3	3	3	3	100%
TP 1.1.B	Nr. km kanale kullues të mirëmbajtur dhe të përmirësuar / ndryshimi në km kundrejt vitit të kaluar	km	0	10	168	36	360%
TP 1.1.C	Sip ha përmirësuar kullimi / ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar	ha	870	220	790	890	404.55%
TP 1.1.D	Sipërfaqe e mbuluar me ujitje – ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar	ha	320	260	260	260	100%
TP 1.1.E	Sip. Toke e kultivuar në % kundrejt totalit të inventarit të tokës bujqësore	%	84	86	86	86	100%
TP 1.1.F	Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore të kultivuar (ndryshimi në ha në vite)	ha	610	240	240	240	100%
TP 1.1.G	Përmirësimi i rrjetit kullues:- Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve	%	10	27	33	15	55.56%
TP 1.1.H	Përmirësimi i rrjetit ujitës:- Km kanal ujitës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse	%	7	19	19	10	52.63%
TP 1.1.I ^[2]	Nr i punonjësve me kontratë	nr	N/A	N/A	10	10	N/A

OBJEKTIVI 2.1

Mirëmbajtja e rrugëve, shesheve dhe trotuare urbane

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04520 - Rrjeti rrugor rural

TP 2.1.A	Kosto e mirëmbajtjes m2 (buxheti në lekë për m2 rrugë, trotuare dhe sheshe të mirëmbajtura)	m2	3,425	3,455	4,560	1,946	56.32%
TP 2.1.B	Raporti i rrugëve dhe sheshe të mirëmbajtura/ndryshimi në m2 kundrejt vitit të kaluar	m2	2,279	20	0	0	0%
TP 2.1.C	Raporti i trotuareve të mirëmbajtura/ ndryshimi në m2 kundrejt vitit të kaluar	m2	40	10	1,930	3,780	37800%
TP 2.1.D	Përmirësimi i rrjetit rrugor: i) Rrugë të shtruara kundrejt rrjetit rrugor të gjithë bashkisë	%	1	1	1	1	125%
TP 2.1.E ^[2]	Numer kende lojrash për fëmijë të ndërtuara	nr	N/A	N/A	7	0	N/A

OBJEKTIVI 2.2

Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04520 - Rrjeti rrugor rural							
TP 2.2.A	Kosto e mirëmbajtjes m2	m2	369	1,195	1,195	1,772	148.26%
TP 2.2.B	Raporti i rrugëve , sheshe dhe trotuareve të mirëmbajtura rurale / ndryshimi në m2 kundrejt viti	m2	0	61	0	0	0%
TP 2.2.C	Përmirësimi i rrjetit rrugor (aksesueshmëria e tij nga përdoruesit): i) Rrugë të shtruara NJ.A	%	16	5	5	5	100%
TP 2.2.D ^[2]	Numri i urave te ndertuara	nr	N/A	N/A	0	0	N/A

OBJEKTIVI 3.1

Përmirësimi i levizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

04570 - Transporti publik

TP 3.1.A	Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësoret dhe pedaluesit: Nr i tabelave për sinjalistikën	%	5	5	5	10	200%
TP 3.1.B	Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësoret dhe pedaluesit: Nr i bumpeve për sinjalistik	nr	20	15	15	40	266.67%
TP 3.1.C	Rritja e sigurisë për pedaluesit përmes krijimit të korsive të dedikuara të plotesuara me sinjalisti	nr	2,994	2,542	2,542	0	0%
TP 3.1.D	Përmirësimi i adresarit të bashkisë Shkodër	nr	1,000	1,000	1,000	0	0%
TP 3.1.E	Përmirësimi i transportit publik. Zona e mbuluar me transport publik	nr	13	10	15	15	150%

OBJEKTIVI 4.1

Përmirësimi i administrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane: - Mbulimi i koston nga tarifa e shërbimit - Norma e mbledhjes së tarifës së shërbimit

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

05100 - Menaxhimi i mbetjeve

TP 4.1.A	Eficienca e shërbimit/mbulimi koston së shërbimit nga tarifa	%	87	68	52	66	97.06%
----------	--	---	----	----	----	----	--------

OBJEKTIVI 4.2

Përmirësimi i grumbullimit të mbetjeve urbane në zonën Qytet

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

05100 - Menaxhimi i mbetjeve

TP 4.2.A	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit: Nr i banoreve të cilëve i ofrohet shërbimi deri-me-dere	%	2	2	2	2	100%
TP 4.2.B	Ndryshimi në % e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake në qytet	%	8	9	9	9	98.9%
TP 4.2.C	Minimizimi i volumit të mbetjeve të gjelberta në qytet dhe përmirësimi i cilësisë së pastrimit	%	0	35	35	0	0%
TP 4.2.D ^[2]	Numri i qendrave të ripërdorimit, me qëllim zgjatjen e ciklit jetësor të mallrave dhe uljen e konsumit	nr	N/A	N/A	0	0	N/A

OBJEKTIVI 4.3

Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

05100 - Menaxhimi i mbetjeve

TP 4.3.A	Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara dhe të transportuara ne vendet e miratuar	ton/frym	0	0	0	0	0%
TP 4.3.B	Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuara (ne mije leke)	lek	5	5	5	6	121.95%
TP 4.3.C	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (mije lekë/ ton)	lek/ton	5	7	10	9	124.14%

OBJEKTIVI 4.4

Përmirësimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ne Nj.A.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

05100 - Menaxhimi i mbetjeve

TP 4.4.A	Permiresimi i cilesise se sherbimit ne z.turistike:% e banoreve ne Plazh- Velipoje qe i ofrohe	%	49	49	49	49	100%
TP 4.4.B	Popullata rezidente e mbuluar me shërbim ne nj.a ne raport me totalin e popullsise Nj.A	%	93	93	93	93	100%
TP 4.4.C	Ndryshimi ne % i frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake ne nj.a (here ne jave)	%	3	3	3	3	120%

OBJEKTIVI 4.5

Rritja e siperfaqes qe fshihet ne zonen urbane

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

05100 - Menaxhimi i mbetjeve

TP 4.5.A	Shtim i siperfaqes e cila fshihet manualisht ne qytet	nryshim nr	58	58	58	58	99.32%
----------	---	------------	----	----	----	----	--------

OBJEKTIVI 5.1

Përmeshja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

06260 - Shërbimet publike vendore

TP 5.1.A	Rritja e eficiencës buxhetore në ofrimin e shërbimeve operative te gjelberimit dhe varrezave	%	0	2	8	0	0%
----------	--	---	---	---	---	---	----

OBJEKTIVI 5.2

Shërbim cilësor me standarteve dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

06260 - Shërbimet publike vendore

TP 5.2.A	Zgjerimi i sip.se mirembajtjes për garantimin e shërbimit funeral- ndryshimi m2 me vitin parardhes	m2	93,836	93,886	93,886	93,886	100%
TP 5.2.B	Kapaciteti I varrezave publike për 1000 banorë	nr	8	805	802	800	99.38%

OBJEKTIVI 6.1

Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelberta dhe gjelbërimit rrugor, objektet publike te mirembajtura në të gjithë Bashkinë.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

06260 - Shërbimet publike vendore

TP 6.1.A	Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt sipërfaqes së mirembajtuar	nr	0	0	0	0	0%
TP 6.1.B	Përmirësimi i shërbimeve publike vendore - Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sip. totale	%	91	94	93	93	98.94%
TP 6.1.C	eficienca e shërbimit / mbulimi koston së shërbimit nga tarifa	%	63	64	64	128	200%
TP 6.1.D	Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset - ne % kundrejt totali	%	7	7	7	1	14.29%
TP 6.1.E ^[2]	Numri i tualeteve të ndertuara	nr	N/A	N/A	0	0	N/A

OBJEKTIVI 7.1

Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

06440 - Ndriçimi i rrugëve

TP 7.1.A	Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit ; Mbulimi shërbimit të ndriçimit publik	%	50	58	61	57	98.28%
TP 7.1.B	Zgjerimi i rrjetit të shërbimit të ndriçimit publik në zonën urbane të Bashkisë Shkoder - ndryshimi	%	1	2	2	4	200%
TP 7.1.C	zgjerimi i rrjetit të shërbimit të ndriçimit publik në Njësitë Administrative të Bashkisë	%	29	20	18	16	80%
TP 7.1.D	Rritja e mbulimit të territorit me ndriçim publik	%	68	67	67	69	102.99%
TP 7.1.E	Përmirësimi i efikasitetit të buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik	m2	149	98	107	140	142.86%
TP 7.1.F	Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit	%	23	41	39	27	65.85%

OBJEKTIVI 8.1

Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

06370 - Furnizimi me ujë dhe kanalizime

TP 8.1.A	Rritja e efikasitetit buxhetor në ofrimin e shërbimit të KUB - ndryshimi në % me vitin paraardhës	%	0	0	0	0	N/A
----------	---	---	---	---	---	---	-----

Sipas planifikimit për vitin 2025 në Programin AE141 “Shërbimet Publike Vendore” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, situata e aktiviteteve për 12 mujorin 2025 paraqitet si më poshtë:

Produktet	Aktivite/Projekte	Institucioni	Statusi I aktivitetit	Plani Fillestar 2025	Plani I Rishikuar 2025	Realizimi 2025
				Totali	Totali	Totali
V424AAB. Mirëmbajtja rutinë e kanaleve Ujitëse dhe Kanale Kulluese (km)	P.AE141.Q1.O1.A1 - Menaxhimi dhe funksionimi i sektorit të kullimit dhe ujitjes e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	14,972	16,632	11,981
	P.AE141.Q1.O1.A2-Pastrim kanalesh kulluese në Nj.A. e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	13,500	30,540	29,724
	P.AE141.Q1.O1.A3- Pastrim kanalesh ujitëse e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	6,678	36,909	10,481
	P.AE141.Q1.O1.A4-Mirëmbajtje , rehabilitim i skemës ujitëse	NSHPP	Ne proces Tenderimi	14,000	10,000	9,336
	P.AE141.Q1.O1.A5 Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma	NSHPP	Perfunduar	-	3,372	1,875
04240 Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit				49,150	97,453	63,396
V452AAA. Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit rrugor Rural	P.AE141.Q2.O1.A1 - Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes - Rrjeti rrugor urban e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	30,637	30,637	23,505
V626AAC. Rrugë urbane e mirëmbajtur dhe rehabilituar	P.AE141.Q2.O1. A2.Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për mirëmbajtjen e infrastruktures e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	25,576	25,576	5,280
V626AAG. Trotuarë të mirëmbajtur dhe rehabilituar.	P.AE141.Q1.O1.A3- Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	18,182	33,653	16,304
P452AEV A Lujmë Bashkë	P.AE141.Q2.O1.A4 A Lujmë Bashkë?	NSHPP	Projektimi është lidhur kontrata Zbatimi do mbartet ne 2026	-	32,274	-
V452AAB Rrjet Rrugor Rural i Mirëmbajtur (m2)	P.AE141.Q2.O2.A1. Mirëmbajtja e rrugëve rurale e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	23,784	39,505	35,254
04520 Rrjeti rrugor rural				98,179	161,645	80,343
V457AAA.Shërbimi i Transportit Publik (Numri i biletave të shitura në vit)	P.AE141.Q3.O1.A1: Paga dhe sigurime të stafit e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	11,009	14,410	7,545
	P.AE141.Q3.O1.A2: Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	2,038	2,038	168
	P.AE141.Q3.O1.A3: Levizshmëria dhe sinjalistika e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	12,000	20,300	12,708
	P.AE141.Q3.O1.A4. Permiresimi i Sinjalistikës Horizontale dhe Vertikale në segmentet kryesore e të trashëguara	NSHPP		-	40	-

	P.AE141.Q3.O1.A4. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër e të trashëguara	NSHPP		-	-	-
04570 Transporti Publik				25,047	36,788	20,421
V510AAA.Shërbimi i Stafit të Menaxhimit të Mbetjes dhe Pastrimit	P.AE141.Q4.O1.A1. Shërbimi i Stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	28,701	30,075	28,556
V510AAB. Mbledhje dhe Transportim i Mbetjeve nga Zonat Urbane	P.AE141.Q4.O2.A1. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	3,825	3,982	551
	P.AE141.Q4.O2.A2. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	106,849	191,780	174,283
	"P.AE141.Q4.O2.A3. Minimizimi i volumeve të mbetjeve të gjelbërta dhe përmirësimi i cilësisë të shërbimit të pastrimit në zonën Qytet "	NSHPP				
P510AAU Projekti REUSEFUL	P.AE141 Q4.O2.A4. Projekti REUSEFUL- Promovimi I reduktimit të mbetjeve përmes qendrave të ripërdorimit në zonën e Adriatikut të Jugut.	NSHPP			949	
V510AAF. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	P.AE141.Q4.O3.A1.Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	88,060	99,098	56,100
V510AAC. Mbledhje dhe Transportim i Mbetjeve nga Zonat Rurale	P.AE141.Q4.O4.A1-A2. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	71,392	72,392	69,902
V510AAD. Pastrimi i rrugëve dhe parqeve	P.AE141.Q4.O5.A1. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	45,000	56,721	11,669
TOTALI QELLIM 1				343,827	454,997	341,062
V626AAA.Shërbimi i Stafit të Ndërmarrjeve Publike të Gjëlberimit, Varrezave	P.AE141.Q5.O1.A1. Paga dhe sigurime të stafit - Gjëlbrim Varreza e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	2,686	3,853	2,468
V626AAB. Mirëmbajtja e Sipërfaqes së Varrezave	P.AE141.Q5.O2.A1.: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	16,632	23,632	14,643
V626AAD. Sipërfaqe e Gjëlbert e Mirëmbajtur dhe Rehabilituar	P.AE141.Q6.O1.A1. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjëlberta e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	43,535	43,085	22,672
V626AAH. Objekte Publike të Mirëmbajtura	P.AE141.Q6.O1.A2. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	765	3,168	615
TOTALI QELLIMI 2				63,618	73,738	40,398
V644AAA - Shërbimi i Stafit të Mirëmbajtjes së Ndriçimit Publik (Numri i punonjesve)	P.AE141.Q7.O1.A1: Shërbim i stafit të mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe dekorit e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	66,398	79,476	56,051
	P.AE141.Q7. O1.A2 Dekorimi i mjediseve publike e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	5,000	5,400	4,612

	P.AE141.Q7.O1.A3 Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet bazë të NSHPP e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	6,310	7,660	4,124
	P.AE141.Q7.O1.A4 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e NSHPP e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	5,903	5,903	894
V644AAB. Rrjeti i Ndriçimit Rrugor Publik Urban i Mirëmbajtur	P.AE141.Q7.O1.A5: Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	121,600	132,131	118,900
V644AAC. Rrjeti i Ndriçimit Rrugor Publik Rural i Mirëmbajtur	P.AE141.Q7.O1.A6: Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Njësi Administrative e të trashëguara	NSHPP	Perfunduar	35,300	45,100	39,881
	P06260.Q3.O1.A7 Rikonstrukcion ambiente magazine dhe te jashtme - TE TRASHEGUARA	NSHPP	Perfunduar	-	9,182	6,259
	P06260.Q3.O1.A8 Tualet publike, pika turistike - TE TRASHEGUARA	NSHPP	Perfunduar	-	2,016	1,957
TOTALI QELLIMI 3				240,511	286,868	232,677
06260 - Shërbime publike vendore				304,129	360,606	273,076
V637AAA. Kanalizime të Ujërave të Bardha të Mirëmbajtura	P.AE141.Q8.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB)	NSHPP	Perfunduar	15,000	15,000	15,000
Totali 6370 Furnizimi me uje dhe kanalizime				15,000	15,000	15,000
P.AE141 Shërbimet Publike Vendore				835,331	1,126,489	793,297
Të trashëguara				281,630	-	-
Totali				1,116,961	1,126,489	793,297

P.AE141.Q1.O1.A1 - Menaxhimi dhe funksionimi i sektorit të kullimit dhe ujitjes. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q1.O1.A2-Pastrim kanalesh kulluese në Nj.A. Ky aktivitet gjatë këtij 12-mujori është përfunduar.

P.AE141.Q1.O1.A3- Pastrim kanalesh ujitëse. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q1.O1.A4-Mirëmbajtje, rehabilitim i skemës ujitës. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q1.O1.A5-Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q2.O1.A1 - Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes - Rrjeti rrugor urban është përfunduar.

P.AE141.Q2.O1.A2. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për mirëmbajtjen e infrastrukturës

- Blerje karburanti është lidhur kontrata.

-Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit, është përfunduar.

- Shpenzime për sigurimin e automjeteve, është përfunduar.

P.AE141.Q2.O1.A3- Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës është përfunduar.

P.AE141.Q2.O1.A4 - “A Lujmë Bashkë?” është lidhur kontrata për Projektimin. Zbatimi do mbartet në 2026.

P.AE141.Q2.O2.A1. Mirëmbajtja e rrugëve rurale është përfunduar.

P.AE141.Q3.O1.A1: Paga dhe sigurime të stafit të sektorit të sinjalistikës, është përfunduar.

P.AE141.Q3.O1.A2: Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit.

- Blerje karburanti është lidhur kontrata.

- Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit, është përfunduar.

- Shpenzime për sigurimin e automjeteve, është përfunduar.

P.AE141.Q3.O1.A3: Lëvizshmëria dhe sinjalistika. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q4.O1.A1. Shërbimi i Stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit, është përfunduar.

P.AE141.Q4.O2.A1: Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit.

- Blerje karburanti është lidhur kontrata.

- Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit, është përfunduar

- Shpenzime për sigurimin e automjeteve. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q4.O2.A2. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane. Ky aktivitet është në vazhdim gjatë gjithë vitit.

- Blerje kazanësh, lidhur kontrata.

- Ndërtim xhepa kazanash, është përfunduar.

P.AE141.Q4.O3.A1. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q4.O4.A1-A2. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q4.O5.A1. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q5.O1.A1. Paga dhe sigurime të stafit - Gjellërim Varreza, është përfunduar.

P.AE141.Q5.O2.A1. Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q6.O1.A1. Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta, është përfunduar.

P.AE141.Q7.O1.A1. Shërbim i stafit të mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe dekorit, është përfunduar.

P.AE141.Q7.O1.A2. Dekorimi i mjediseve publike, është përfunduar.

P.AE141.Q7.O1.A3. Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet bazë të NSHPP.

- Blerje Kancelarie është përfunduar.

- Blerje materiale për pastrim ambienti është përfunduar,

- Blerje pajisje zyre është përfunduar

- Mirëmbajtje objekti është parashikuar për tu realizuar deri në dhjetor por për arsye kohe dhe klimaterike nuk është përfunduar.

- Shërbim Interneti është përfunduar,

- Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri është përfunduar.

- Shërbime postare është përfunduar.

- Shërbime të printimit dhe publikimit në media është përfunduar.

- Shërbime të tjera (larje automjete,tarifë parkingu, etj) është përfunduar.

- Sigurimi i ndërtesës dhe inventari i tyre ekonomik është parashikuar por nuk është realizuar.
- Mirëmbajtje pajisje informatike është përfunduar.
- Shërbim GPS është lidhur kontrata, është përfunduar.
- Mirëmbajtje rrjeti dhe infrastrukture për ambientin TIK është përfunduar.
- Sistem informacioni i integruar për menaxhimin financiar të NSHPP është përfunduar.
- Shërbime përkthimi është përfunduar.

P.AE141.Q7.O1.A4. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e NSHPP.

- Blerje karburanti është lidhur kontrata.
- Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit, është përfunduar.
- Shpenzime për sigurimin e automjeteve. Ky aktivitet është përfunduar.

P.AE141.Q7.O1.A5. Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit:

- Blerje materiale për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues, është përfunduar.
- Pagesa e konsumit të ndriçimit, është përfunduar.
- Blerje vegla pune dhe dokumentacion Teknik, është përfunduar.
- Blerje materiale për rritjen dhe përmirësimin e sistemit të ndriçimit, është përfunduar.
- Investim në rehabilitimin e ndriçimit në rrugën Jeronim De Rada, është përfunduar.

P.AE141.Q7.O1.A6. Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Njësive Administrative.

- Blerje materiale për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues, është përfunduar.
- Pagesa e konsumit të ndriçimit, është përfunduar.
- Blerje materiale për rritjen dhe përmirësimin e sistemit të ndriçimit, është përfunduar.

P.AE141.Q8.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB). Ky aktivitet është përfunduar.

Programi AF141 - Kultura, Sporti, Argëtim

Ky program përfshin disa institucione dhe konkretisht:

- 1- Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit, Bashkia Shkodër
- 2- Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit Kultura, Sporti dhe Argëtim është:

Q.1 Krijimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet sportive të Vllaznisë. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet synojmë organizimin e përvitshëm të programit “Jeto me sportin”.

Q.2 Menaxhimi dhe administrimi i strukturave kulturore-artistike, aseteve të trashëgimisë kulturore, duke risjellur në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë, si në sektorin arkeologjik, etnografik, historik, të fotografisë, muzikës, teatrit etj. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës. Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përcimi i vlerave kulturore dhe sportive do të jetë një nga politikat e programit. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2025 kanë qenë:

Q1.O1. Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.

Q1.O2. Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.

Q2.O1. Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mirëadministrimi e fuqizimi i strukturave menaxhuese.


Q2.O2. Ruajtja, mirëadministrimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës Marin Barleti.

Q2.O3. Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të Strukturave kulturore dhe artistike të Bashkisë Shkodër. Përmirësimi i mjediseve për zhvillimin e aktiviteteve artistike, rikonstruksione të ambienteve ndihmëse në strukturat e ndryshme të kulturës.

Realizimi i buxhetit të planifikuar:

000/leke


Programi AF141	Paga & sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
PBA 2025	95,633	89,846	97,600	6,191	289,270
Plani fillestar 2025	117,292	126,616	99,391	40,121	383,420
Plani i rishikuar 2025	118,126	112,783	107,050	55,285	393,244
Realizimi viti 2025	85,067	81,560	102,588	37,773	306,987
% e realizimit	72%	72.3%	95.8%	68.3%	78.1%



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 78.1 % sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korrente 79.7%

Shpenzime kapitale 68.3%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Shumica e procedurave janë në proces. Një ndër faktorët shumë pengues në realizimin e shpenzimeve operative dhe atyre të investimeve janë procedurat e prokurimit, zgjatja shumë në kohë deri në përfundimin dhe nënshkrimin e kontratave përkatëse.

Raporti: M3 - Shpenzimet dhe Sasitë e Produkteve: Fakti - Planit (Janar - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AF141 - Kultura, Sporti, Argëtim

Viti: 2025

Vlerat paraqiten në: ALL

KODI	PRODUKTI		KUMULATIVE DERI NË FUND TË			NDRYSHIMI (%)		
			PERIUdhËS					
			PLANI FILLESTAR	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR	
Funksioni 08130 - Sport dhe argëtim								
V813AAA	Shërbimi i Stafit të Sportit dhe Argëtimit		Sasia	29	29	29	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer i stafit	Shpenzimet	27,012,000	34,218,591	26554531	98.31%	77.60%
V813AAB	Disiplinat e Ndryshme Sportive të Mbështetura		Sasia	15	15	15	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numri i disiplinave te mbeshtetura	Shpenzimet	93,236,000	105,592,059	88831949	95.28%	84.13%
Funksioni 08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat								
V822AAA	Shërbimet e Stafit të Trashëgimisë Kulturore, Muzeve, Bibliotekave		Sasia	15	16	16	106.67%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer punonjesve te trashegimise kulturore	Shpenzimet	18,969,000	21,452,500	18086156	95.35%	84.31%
V822AAC	Objekte të Trashëgimisë Kulturore të Mirëmbajtura		Sasia	5	6	5	100.00%	83.33%
	Njësia e Matjes	Numer I objekteve te trashegimise kulturore	Shpenzimet	7,589,000	10,723,120	6511056	85.80%	60.72%
V822AAD	Promovimi i Trashëgimisë Kulturore		Sasia	59	64	64	108.47%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer I aktiviteteteve te muzeve	Shpenzimet	1,382,000	2,202,000	771400	55.82%	35.03%
V822AAK	Funksionimi i Bibliotekës		Sasia	900	1,180	922	102.44%	78.14%
	Njësia e Matjes	Numer I librave te rinj	Shpenzimet	1,200,000	1,404,490	922400	76.87%	65.68%
Funksioni 08230 - Arti dhe Kultura								
KODI	PRODUKTI		KUMULATIVE DERI NË FUND TË			NDRYSHIMI (%)		
			PERIUdhËS					
			PLANI FILLESTAR	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR	
V823AAA	Shërbimet e stafit të Artit dhe Kulturës		Sasia	40	41	41	102.50%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer I punonjesve te artit e kultures	Shpenzimet	49,652,000	63,650,535	40945008	82.46%	64.33%
V823AAB	Objekte të veprimtarisë kulturore dhe artistike të mirëmbajtura dhe funksionale		Sasia	7	7	7	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer I objekteve te veprimtarise kulturore	Shpenzimet	77,389,000	90,937,165	81291188	105.04%	89.39%
V823AAC	Shfaqje teatri		Sasia	95	80	80	84.21%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer Shfaqje teatri	Shpenzimet	8,800,000	11,981,520	6421588	72.97%	53.60%
V823AAE	Shfaqje kinemaje		Sasia	1	200	72	7,200.00%	36.00%
	Njësia e Matjes	Numer i shfaqjeve ne ekran	Shpenzimet	500,000	500,000	0	0.00%	0.00%

M6: Raporti i Realizimit të Objektivave

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AF141 - Kultura, Sporti, Argëtim

OBJEKTIVI 1.1

Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të rinjve ne aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

08130 - Sport dhe argëtim

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.1.A	Pjesëmarrës në aktivitetet sportive	Numer	750	2,000	2,000	1,800	90%
TP 1.1.B	Strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi	Numer	3	3	3	3	100%
TP 1.1.C	Përfaqesues në veprimtarite sportive ne kampionate kombetare(numri i sportistëve)	Numer	850	850	850	850	100%
TP 1.1.D	Përfaqesues në veprimtarite sportive ne kampionate kombetare(Nr.trajnerëve)	Numer	31	31	31	31	100%
TP 1.1.E	Numri isportisteve fitues ne kampionate kombetare qe trajtohen sipas VKM 789	Numer	35	42	42	35	83.33%
TP 1.1.F	Numri i disiplinave sportive te mbeshtetura	Numer	15	15	15	15	100%

OBJEKTIVI 1.2

Manaxhimi dhe mireadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi infrastruktures së pershtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

08130 - Sport dhe argëtim

TP 1.2.A	Numer objekte sportive te ndertuara dhe te rikonstruktura	Numer	2	2	2	2	100%
----------	---	-------	---	---	---	---	------

OBJEKTIVI 2.1

Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mirëadministrimi e fuqizimi i strukturaveve menaxhuese.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat

TP 2.1.A	Numri I strukturave te trashegimise kulturore - ne numer	Numer	6	7	6	5	71.43%
TP 2.1.B	Numri i shfaqjeve kulturore; artistike për trashëgiminë kulturore, të mbështetura me fonde te Bashk	Numer	17	17	67	17	100%
TP 2.1.C	Nr i aktiviteteve rreth informimit dhe promovimit te trashegimise kulturore ne komunitet	Numer	27	21	40	40	190.48%
TP 2.1.D	Numri i vizitroveve ne muze- ne numer	numer	30,860	30,860	30,880	38,450	124.59%
TP 2.1.E	Numrat e revistave/ guidave te botuara	Numer	1	2	3	2	100%
TP 2.1.F	Numri I aktiviteteve letrare	Numer	60	65	12	12	18.46%
TP 2.1.G	Nr. i pjesmarres në takimet tematike letrare	Numer	1,500	1,000	1,000	1,000	100%

OBJEKTIVI 2.2

Ruajtja, mirëadministrimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës Marin Barleti

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat

TP 2.2.A	Numri i librave të reja që pasurohet biblioteka	Numer	900	900	1,180	922	102.44%
TP 2.2.B	Numri i anetareve të regjistruar në Bibliotekë – ndryshimi në numër kundrejt vitit të kaluar	Numer	167	123	123	246	200%

OBJEKTIVI 2.3

Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të strukturave kulturore dhe artistike të Bashkisë Shkodër. Përmirësimi i mjediseve për zhvillimin e aktiviteteve artistike, rikonstrukcione të ambjentëve ndihmëse në strukturat e ndryshme të kulturës.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

08230 - Arti dhe Kultura

TP 2.3.A	Totali i institucioneve kulturore	Numer	7	7	7	7	100%
TP 2.3.B	Nr i aktiviteteve kulturore të Bashkisë Shkodër	Numer	262	254	243	280	110.24%
TP 2.3.C	Numri i ekspozitave të përbashkëta, ekspozitave personale, dhe numri i workshopëve	Numer	8	8	8	7	87.5%
TP 2.3.D	Fonde buxhetore të shpenzuara për aktivitete të trashëgimisë Kulturore (Fonde buxhetore/nr Instit.)	Leke/Aktivitet	571	652	775	637	97.7%
TP 2.3.E	Numri i aktiviteteve në festivalin e filmit	Numer	15	15	15	15	100%
TP 2.3.F	Nr i shfaqjeve që do të realizohen në Teatrin "Migjeni" sipas kalendarit vjetor	Numer	92	95	80	80	84.21%
TP 2.3.G	Numri i shfaqjeve në kinema në ekran	Numer	79	200	200	72	36%

Realizimi i produkteve për periudhën 12 mujore 2025:

Për vitin 2025, në programin Kultura, Sporti dhe Argëtim, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe për përbushjen e objektivave të caktuara, janë parashikuar aktivitetet si më poshtë:

Produktet	Aktivite/Projekte	Institucioni	Statusi I Aktivitetit	Plani Fillestar 2025	Plani I Rishikuar 2025	Realizimi 2025
				Totali	Totali	Totali
V813AAA. Shërbimi i Stafit të Sportit dhe Argëtimit (numri i stafit)	P.AF141.Q1.O1.A1. Paga dhe sigurime shoqerore per stafin administrates per aktivite sportive e të trashëguara	Bashkia shkodër	Realizuar	7,404	9,307	9,214
	P.AF141.Q1.O1.A2. Paga dhe sigurime shoqerore per stafin permirembajtje te terreneve sportive e të trashëguara	DPMOP	Realizuar ne vazhdimesi	19,608	24,912	17,340
V813AAB. Disiplinat e Ndryshme Sportive të Mbështetura (numri i disiplinave te mbeshtetura)	P.AF141.Q1.O1.A3. Aktivite rinore dhe sportive Shkodra ,qyteti europian i sportit 2025 e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	8,000	7,734	7,500
	P.AF141.Q1.O1.A4. Festivali i Shahut Cesk Jubani	Bashkia Shkodër	Realizuar	100	100	100
	P.AF141.Q1.O1.A5 Kupa Agim Tafili e të trashëguara	Bashkia Shkodër	pa realizuar	500	16	-
	P.AF141.Q1.O1.A6 Memorial Vllaznia Boks e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	500	506	500
	P.AF141.Q1.O1.A7 Beach Volley e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	900	55	-
	P.AF141.Q1.O1.A8 Triathlon e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	600	760	600
	P.AF141.Q1.O1.A9 3x3Shkodra e të trashëguara	Bashkia Shkodër	E realizuar	1,400	1,542	1,400
	P.AF141.Q1.O1.A10 Beach Soccer e të trashëguara	Bashkia Shkodër	pa realizuar	900	36	-
	P.AF141.Q1.O1.A11 Shkodra Open Tennis e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	600	617	600
	P.AF141.Q1.O1.A12. Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive e të trashëguara	DPMOP	Realizuar pjeserisht	31,236	39,060	26,464
	P08130.Q1.O1.A12. Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	pa realizuar	-	539	-
	P.AF141.Q1.O1.A13 Mbështetje per ekipet sportive Vllaznia e të trashëguara	Bashkia Shkodër	E parealizuar	44,000	400	-
	P.AF141.Q1.O1.A14 Shpërbllim për rezultatet në arenën kombetare dhe ndërkombetare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	4,500	9,480	7,370
	P.AF141.Q1.O1.A15. Mbeshtetje e ekipit te Basketbollit	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	10,600	10,600
	P.AF141.Q1.O1.A16 Mbeshtetje e ekipit te Volejbollit e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	11,078	11,078
	P.AF141.Q1.O1.A17 Mbeshtetje e ekipit te Atletikes	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	5,500	5,500
	P.AF141.Q1.O1.A18 Mbeshtetje e ekipit te Boksit & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	6,003	6,000
	P.AF141.Q1.O1.A19 Mbeshtetje e ekipit te Çiklizmit	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	2,350	2,350
	P.AF141.Q1.O1.A20 Mbeshtetje e ekipit te Gjymnastikes	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	800	800

	P.AF141.Q1.O1.A21 Mbeshtetje e ekipit te Mundjes e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	805	800
	P.AF141.Q1.O1.A22 Mbeshtetje e ekipit te Notit	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	650	470
	P.AF141.Q1.O1.A23. Mbeshtetje e ekipit te Peshengritjes e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	808	800
	P.AF141.Q1.O1.A24 Mbeshtetje e ekipit te Ping Pongut	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	650	650
	P.AF141.Q1.O1.A25 Mbeshtetje e ekipit te Shahut	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	650	650
	P.AF141.Q1.O1.A26 Mbeshtetje e ekipit te Xhudos	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	900	900
	P.AF141.Q1.O1.A27 Mbeshtetje e ekipit te Taekwondo	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	900	900
	P.AF141.Q1.O1.A28 Mbeshtetje e ekipit te Futsal	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	800	800
	P.AF141.Q1.O1.A29 Mbeshtetje e ekipit te Futbollit te femrave te rritura	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	2,000	2,000
	P08130.Q1.O1.A15 Shkodra Qyteti Evropian I Sportit 2025 - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkoder	E parealizuar	-	253	-
P813AAT - Ndërtim i ambienteve sportive shkolla Dëshmorët e Prishtinës (Jeto me sportin)	P.AF141.Q1.O2 A1 Ndërtimi I Ambienteve Sportive Shkolla "Dëshmorët e Prishtinës" (Jeto me sportin) e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	3,541	9,305	9,262
P813AAZ Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit 28 Nëntori, Shkodër	P.AF141.Q1.O2.A2 Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit "28 Nëntori", Shkodër	Bashkia Shkoder	E parealizuar	-	2,818	-
P813ABA Ndërtim i ambienteve Sportive të Shkollës Tring Smajli	P.AF141.Q1.O2.A3 Ndërtim i ambienteve sportive të Shkollës "Tring Smajli"	Bashkia Shkoder	E parealizuar	-	9,176	-
P813AAX Fusha të pambuluara sportive shkolla Xheladin Fishta	P08130.Q1.O2.A6 Fusha te pambuluara sportive, shkolla "Xheladin Fishta" - TE TRASHEGUARA	DPMOP	E realizuar	-	4,071	4,069
08130 Sport dhe argetim				123,789	165,180	128,717
V822AAA. Shërbimet e Stafit të Trashëgimisë Kulturore, Muzeve, Bibliotekave. (Nr i punonjesve te trashëgimise kulturore)	P.AF141.Q2.O1.A1 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës (Muze+biblioteka+galeria) e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	18,969	21,453	18,086
V822AAC. Objekte të Trashëgimisë Kulturore të Mirëmbajtura. (Nr I objekteve te trashëgimise kulturore)	P.AF141.Q2.O1.A2 Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore e të trashëguara	DPMOP	Realizuar	5,619	8,293	6,018
	P.AF141.Q2.O1.A3 Shpenzime për funksionimin e objekteve të trashëgimisë kulturore e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar pjesërisht	1,970	2,430	493
V822AAD. Promovimi i Trashëgimisë Kulturore (Nr I aktiviteteteve te muzeve)	P.AF141.Q2.O1 .A4 Realizimi I aktiviteteteve te trashëgimise kulturore e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar pjesërisht	632	832	531
	P.AF141.Q2.O1.A7 Mbështetje për funksionimin dhe shërbimin në vazhdimësi të muzeut historik e të trashëguara	Bashkia Shkoder	E parealizuar	-	620	-
	P.AF141.Q2.O1 .A5 Shpenzime promocionale te aktiviteve kulturore	Bashkia Shkoder	Realizuar pjesërisht	750	750	240

V822AAK. Funksionimi i Bibliotekës (Nr I librave te rinj)	P.AF141.Q2.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar pjeserisht	1,200	1,404	922
V823AAA. Shërbimet e stafit të Artit dhe Kulturës. (nr I punonjesve te artit e kultures)	P.AF141.Q2.O3.A1 Paga dhe sigurime te personelit te Teatrit "Migjeni" dhe Kinema Republika	Bashkia Shkoder	Realizuar	35,076	44,679	28,633
	P.AF141.Q2.O3.A1/1. Paga dhe sigurime shoqërore për stafin për punonjësit mbështetës te Kinema Republika	DPMOP	Realizuar ne vazhdimesi	-	971	259
	P.AF141.Q2.O3.A2 Paga dhe sigurime te personelit te drejtorise se kultures e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	8,873	9,861	8,181
	P.AF141.Q2.O3.A3 Paga dhe sigurime te personelit te Qendres Kulturore "Pjeter Gaci" e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	5,703	8,140	3,872
V823AAB. Objekte të veprimtarisë kulturore dhe artistike të mirëmbajtura dhe funksionale (Nr I objekteve te veprimtarise kulturore)	P.AF141.Q2.O3.A4 Shpenzime per mirembajtjen e plote te Teatrit Migjeni e të trashëguara	DPMOP	Realizuar	2,141	2,421	1,400
	P.AF141.Q2.O3.A5 Shpenzime per mirefunksionimitt e plote te Teatrit Migjeni e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	2,880	2,880	2,759
	P.AF141.Q2.O3.A6 Shpenzime per mirembajtjen dhe sigurimin e funksionimitt e plote te Qendres Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie e të trashëguara	DPMOP	Realizuar	265	430	197
	P.AF141.Q2.O3.A7 Shpenzime sigurimin e funksionimitt e plote te Qendres Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar pjeserisht	2,065	2,611	601
	P.AF141.Q2.O3.A8 Orkestra Frymore Honorare vjetore e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	7,139	7,236	6,990
	P.AF141.Q2.O3.A9 Aktivitete te realizuara nga Qendra Kulturore "Pjeter Gaci" e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	2,924	2,924	2,493
	P.AF141.Q2.O3.A10 "Honorare " Grupi i Valleve"	Bashkia Shkoder	Realizuar	960	960	960
	P.AF141.Q2.O3.A11 Festivali i Këngës "Luleborë" e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	7,030	7,270	5,435
	P08220.Q1.O3.A12 Realizimi i aktiviteve te organizuara nga Drejtoria e Kultures e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	18,000	22,260	22,100
	P.AF141.Q2.O3.A13 Ndërmendje	Bashkia Shkodër	Realizuar	1,500	1,500	1,500
	P.AF141.Q2.O3.A14 Karnavalet	Bashkia Shkodër	Realizuar	8,000	8,000	8,000
	P.AF141.Q2.O3.A15 Festivali Mbarekombetar i Humorit ne Shkoder e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	3,995	4,036	3,757
	P.AF141.Q2.O3.A16 Realizimi I aktiviteve t e Galerise se Arteve e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	1,490	1,490	1,147
	P.AF141.Q2.O3.A17 Orkestra Simfonike	Bashkia Shkodër	Realizuar	10,800	10,800	10,620
	P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete ne partneritet me te trete	Bashkia Shkodër	Realizuar	6,000	12,000	11,243
	P.AF141.Q2.O3.A19 Honorare Këshilli Arstistik I Bashkisë Shkodër e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	200	220	180

	P.AF141.Q2.O3.A20 Sherbime fonie,scene dhe ndricimi per aktivitetet e kultures e të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	2,000	2,000	1,909
	P08220.Q1.O3.A26 Blerje paisje fonie, ndricimi dhe materiale skenike per Teater Migjeni - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	-	49	-
	P08220.Q1.O3.A37 Aktivitete artistike kulturore ne mbeshtetje te grupeve rinore artistike - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	-	350	-
	P08220.Q1.O3.A44 "Shkodra qyteti i festave" - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Pa realizuar	-	1,500	-
P823AAC Blerja e shtepizave	P08220.Q1.O3.A12 Realizimi i aktiviteve te organizuara nga Drejtoria e Kultures (Blerja e shtepizave)	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	3,400	2,640
V823AAC. Shfaqje teatri	P.AF141.Q2.O3.A21 Realizim I aktiviteve te Teatrit Migjeni e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	8,800	11,661	6,422
	P.AF141.Q2.O3.A16 Realizimi I aktiviteve t e Galerise se Arteve e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Pa realizuar	-	321	-
V823AAE. Shfaqje kinemaje. (numer i shfaqjeve ne ekran)	P.AF141.Q2.O3.A22 Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e kinemase publike e të trashëguara	DPMOP	Eshte prokuruar, ne proces	500	500	-
P822ABA Rikonstruk sion Biblioteka Marin Barleti	P.AF141.Q2.O3.A23 Rikonstrukcion Biblioteka Marin Barleti	DPMOP	Realizuar	-	6,000	5,278
P822AAX Instalimi I sistemit te kondicinimit Teatri Migjeni	P08220.Q1.O3.A27 Instalimi I sistemit te kondicinimit Teatri Migjeni - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkoder	Realizuar	-	15,414	15,404
	Transferim fondi nga Teatri. Shkrese transferimi nr.19296 date 27.09.2024	Bashkia Shkoder	pa realizuar	-	292	-
	Blerje paisje TIK (shkrese transferimi nr.9203 date 02.05.2024) Kodi 1410201	Bashkia Shkoder	pa realizuar	-	36	-
	Zhvillimi dhe pasurimi I fondit te biblitekes (shkrese transferimi nr.9203 date 02.05.2024) Kodi 1410295	Bashkia Shkoder	pa realizuar	-	15	-
	Blerje kondicioner (shkrese transferimi nr.9203 date 02.05.2024) Kodi 1410876	Bashkia Shkoder	pa realizuar	-	56	-
8220 Trashëgimia kulturore, monumentet, kopshtet zoologjike e botanike dhe bibliotekat				165,481	228,064	178,270
Totali Pr 6 Kultura, sporti. Argetim				289,270	393,244	306,987
Të trashëguara				94,150	-	-
Totali				383,420	393,244	306,987

Përshkrimi i aktiviteve për përmbushjen e secilit objektiv:

P.AF141.Q1.O1.A1. Paga dhe sigurime shoqërore për stafin administratës për aktivitete sportive.

Janë paguar pagat dhe sigurimet për personelin administrativ të sportit nga Bashkia Shkodër për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

P.AF141.Q1.O1.A2. Paga dhe sigurime shoqërore për stafin për mirëmbajtje të terreneve sportive

Janë paguar pagat dhe sigurimet për personelin e mirëmbajtjes së terreneve sportive të Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike.

P.AF141.Q1.O1.A3. Aktivitete rinore dhe sportive Shkodra, qyteti evropian i sportit 2025 e të trashëguara

Maratona e Shkodrës/ Kupa e ikonave - Në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit 2025 dhe promovimit të sportit të atletikës, këtë vit u organizua për herë të tretë Kupa Ikonave “Gëzim Mema”.

Ky kampionat e mori iniciativën nga Shoqata Sportive e Atletikës “Atletikë-Vllaznia”, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Atletikës me mbështetjen e Bashkisë Shkodër dhe u konceptua si një kampionat i hapur për të gjithë atletët nga të gjitha vendet e rajonit. Ky aktivitet sportiv u zhvillua në nderim të një prej figurave më të shquara të atletikës shkodrane dhe shqiptare ndër vite – Gëzim Mema – sportist, trajner dhe ikonë e atletikës shqiptare.

Në aktivitet morën pjesë atletë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë si dhe nga trevat shqiptare të Kosovës. Pjesëmarrësit përfaqësuan ekipet më të mira të atletikës nga:

Ekipi i Prizrenit, Ekipi i Malishevës, Ekipi i Roganës dhe përfaqësues nga ekipe të Shqipërisë si Tirana, Durrësi, Elbasani, Korça, Lushnja, Lezha.

U zhvilluan gara në disiplinat:

- 100m – Meshkuj
- 100m – Femra
- 200m – Meshkuj
- 200m – Femra
- 400m – Meshkuj
- 400m – Femra
- Kërcim së gjati – Meshkuj
- Kërcim trehapësh – Meshkuj
- Stafeta 4×100m – Meshkuj

Speed Masters - Në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit 2025 dhe promovimit të sportit të atletikës, këtë vit u organizua për herë të dytë Speed Masters Athletics (Kampionati Botëror për Veteranë).

Ky kampionat e mori iniciativën nga AMA Albanian Masters Athletics dhe u bë pjesë e aktiviteteve të mbështetura nga EMA European Masters Athletes dhe u konceptua si një kampionat i hapur për të gjithë atletët nga të gjitha vendet e botës që përfaqësojnë Atletët Master. Këto ditë

Shkodra u vu në epiqendër të botës sportive të Atletëve Master. U bë një publicitet i jashtëzakonshëm për këtë aktivitet. Faqet zyrtare të internetit të EMA European masters Athletics <https://european-masters-athletics.org>, Faqja zyrtare e Aktivitetit <https://speed-masters-athletics.com/> Rrjetet sociale etj. Mbas përfundimit të regjistrimeve në datën 5 Maj 2025 ishin regjistruar rreth 520 atletë. Rreth 400 atletë kanë marrë pjesë nga 26 vende të ndryshme të botës. Nga data 5 Maj deri 22 Maj 2025 u përpunuan të dhënat dhe u bë gati infrastruktura e organizimit të aktivitetit. Cilësia e zhvillimit të këtij kampionati ishte e standarteve Europiane. U krijuan Accreditation room, Call room, Warming area, Medal distribution area. U vendosën shënimet e duhura në stadium që orientonin atletët (Dhomat e zhveshjeve, Tualetet, Call room, Accreditation room, Warming Area etj). Në mjediset e stadiumit që nga ora 09:00 u ngrit grupi i Akreditimit dhe u pritën Atletët. Ky grup funksionoi deri në ditën e fundit të aktivitetit. Mjediset e stadiumit ishin në dispozicion të Atletëve për tu stërvitur. Shumë nga atletët kanë mbërritur në Shkodër që nga data 20 maj 2025.

Data 24 Maj 2025. Dita e parë e Kampionatit:

U zhvilluan garat:

100m M/W, 800m M/W, 400m, 300m. 200m Pengesa (garat e gjata me pengesa) M/F, Stafeta 4 X 100m MIX INTERNATIONAL

Në orën 11:30 u zhvillua Ceremonia e hapjes së aktivitetit. Atletët u përshëndetën dhe u falenderuan për pjesëmarrjen, u bënë foto me vajzat Shkodrane me veshje popullore etj

Data 25 Maj 2025. Dita e dytë e Kampionatit

U zhvilluan garat:

400m M/F, Long Jump M/F

Data 26 Maj 2025. Dita e tretë e Kampionatit

U zhvilluan garat:

80m/h. 100m/h. 110m/h

Triple Jump

Stafeta 4 X 400m MIX INTERNATIONAL

200m M/F, Stafeta Ballkanike 800m X 400m X 200m X 100m MIX INTERNATIONAL ku morën pjesë një numër rekord rreth 15 stafeta.

Rreth orës 13:00 deri 14:00 u ndanë medaljet dhe u shpallën sportistët më të mirë duke kryer kështu edhe ceremoninë e mbylljes së aktivitetit.

Kampionati ishte një perfeksion në fushën e organizimit. Call room, Elektronika që për 2 minuta i shpallte rezultatet online, Dhomat e zhveshjesh.

ORGANIZIMI I GARAVE TË KAMPIONATIT

- 1. WARMING AREA** Zona e nxehjes së atletëve: Për atletët u improvizua një zonë nxemje jashtë stadiumit e cila shërbeu si zonë kryesore e nxemjes. Gjithashtu u shfrytëzuan dhomat e nxemjes poshtë dhomave të zhveshjesh. Pallati i Sportit nuk u shfrytëzua megjithëse u sugjerua.

2. **CALL ROOM** Vendi i konfirmimit dhe regjistrimit për garë të atletëve funksionoi shumë mirë. Orari i hyrjes në Stadium të atletëve ishte perfekt.
3. **GJYQTARIA** U kryesua nga gjyqtarët më të mirë kombëtarë me ndihmën e atyre të IAAF.
4. **GJYQTARËT E SISTEMIT ELEKTRONIK TË MATJEVE.** Malvin Nikolla përfaqësues i Federatës Shqiptare të Atletikës Klevis Murizi, Marius Murizi, Arben Feshti nga gjyqtarë të licensuar ndërkombëtarisht. Puna e tyre ishte perfekte dhe ishte pika e fortë e kampionatit. Ata menaxhuan garat me shpejtësi dhe rezultatet ishin online për 2 minuta nga përfundimi i garave.
5. **SEKRETARIA.** Përpunimi dytësor i rezultateve dhe plotësimi i diplomave ishte perfeksion së bashku me ndihmën e vullnetarëve.
6. **NDARJA E MEDALJEVE DHE NDERIMI I ATLETËVE FITUES.** U organizuan në pjesën e jashtme të stadiumit menjëherë pas përfundimit të çdo disipline gare.
7. **KOMENTATORI DONALD BROWN** një nga më të mirët në Europë i dha hijeshi Kampionatit por u bë edhe një drejtues dhe informues për garat.

MEDIAT TELEVIZIVE kanë qenë të pranishme pothuaj gjatë gjithë ditëve të aktivitetit. Aktiviteti u pasqyrua me kronika nga televizionet KOMBËTARE RTSH dhe TOP CHANNEL, por dhe nga shumë televizione të tjera lokale.

PËRFAQËSUESE E EMA European Masters Athletics Maria Clarise Duarte nga Portugalia.

PRESIDENTI I NDERIT TË EMA Kurt Kaschke nga Gjermania

KOMENTATORI i EMA Donald Brown nga GB

SPORTISTJA MË E MIRË e 2024 e EMA Snezana Behtina nga Irlanda e Veriut, nderuan aktivitetin me prezencën e tyre.

Në përfundim sportistët më të mirë u shpallën Franko Burraj i Vllaznisë për meshkuj dhe Rexhina Bajrami e Partizanit.

Ky aktivitet shërbeu jo vetëm si garë atletike, por edhe si një platformë për të nderuar kontributin e sportistëve të mëdhenj shqiptarë dhe për të motivuar brezat e rinj në rrugën e sportit.

Turneu Ndërkombëtar i futbollit për Veteranë - Në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit si dhe promovimit të sportit të futbollit dhe të përcjelljes së vlerave të cilat ky sport mbart, këtë vit u organizua **Turneu Ndërkombëtar i Futbollit për Veteranë**.

Aktiviteti u zhvillua në stadiumin “Loro Boriçi” në datat 1-3 Maj.

Turneu Ndërkombëtar i Futbollit për Veteranë u zhvillua në formë ndeshjeje për veteranët e ekipeve të Vllaznisë dhe Real Valadollid ku morën pjesë emra të shquar të futbollit Shqiptar dhe atij Spanjoll si: Avenir Dani, Hysen Zmijani, Edmond Doçi, Safet Osja, Rudi Vata, Auron Miloti, Nikolin Thana, Altin Xhahysa, Armando Cungu, Saimir Patushi, Valdano Nimani, Denis Zmijani, Arber Shytani, Kujtim Shaba, Ndririm Shtubina, Amir Gjakoviç, Rudin Beka, Abel Munoz Martin, Valdet Rama, Alberto Marcos Rey, Eduard Marashi, Alberto Mato Margarida, Juan

Manuel Rodriguez Riera, Cristian Martin Vaquerizo, Jesus Angel Turier De La Cruz, Juan Carlos Rodrigues Morena, Juan Carlos San Jose Navarres, Oscar Rodrigues Riera. Jose Manuel Jimenez Sancho, Fernando Arroyo Vidal, Jose Luis Rodrigues Fernandes, Eusebio Sacristian Mena, Javier Jimenez Pozo.

Ekipi i Real Valladolid ka mbërritur në Shqipëri në datën 1 Maj në darkë dhe ka udhëtuar menjëherë për në Qytetin e Shkodrës.

Në datën 2 Maj u zhvillua pritja zyrtare nga Kryetari i Bashkisë Shkodër në zyrën e tij ku u shkëmbyen edhe simbolet zyrtare të Real Valladolid si dhe Bashkisë Shkodër. Menjëherë pas takimit, ekipi mik u shoqërua për vizita në objektet kryesore kulturore dhe sportive të qytetit.

Në orën 18:00 u zhvillua ndeshja e futbollit, aktiviteti kryesor i cili priti rreth 1000 qytetarë dhe sportdashës për të shijuar klasin e futbollit spanjoll por edhe të legjendave të ekipit të Vllaznisë. Ndeshja përfundoi me rezultatin 2-0 në favorin e miqve.

Turneu Ndërkombëtar në boks Fists of Fire - Bashkia Shkodër në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit 2025 dhe promovimit të sportit të boksit profesionist, ka organizuar turneun ndërkombëtar “Fists of Fire” në datat 8-9 Qershor për disiplinën e boksit profesionist. Me datën 8 ishte mbërritja, akomodimi dhe peshimi zyrtar i pjesëmarrësve. Në këtë turne u zhvilluan 3 ndeshje të boksit profesionist: Julia Igel (GER) vs Ana Reye (COL) në kategorinë 67 kg; Senad Drini (ALB) vs Aro Schwart (GER) në kategorinë 72.5 kg dhe Alban Beqiri (ALB) vs Roberto Casado (ESP) në kategorinë 76.2 kg.

Ndeshja e parë hapëse e eventit ishte ndeshja e femrave e cila u fitua nga sportistja Julia Igel në raundin e 2-të. Eventu vijoi me ndeshjen e sportistit të ekipit Kombëtar Shqiptar Alban Beqiri, ndeshje e cila dhuroi emocione dhe spektakël për sportdashësit e pranishëm. Ndeshja zgjati 6 raunde të plota dhe fituesi doli Alban Beqiri nga pikët e gjyqtarisë. Ky sportist arriti fitoren e tij të 15 në boksion profesionist. Ndeshja e 3 dhe e fundit e aktivitetit ishte ajo e Senad Drinit sportist i Kombëtares Shqiptare dhe Kampion Kombëtar i ekipit të Vllaznisë. Ndeshja u përcoll me shumë brohoritje nga tifozëria Shkodrane për sportistin e Vllaznisë i cili arriti ta rrëzojë kundërshtarin në raundin e 2-të duke u shpallur edhe fitues i ndeshjes. Senad Drini arrin fitoren e 8-të rradhazi në boksion profesionist dhe renditet në vendin e 106-të në renditjen botërore të boksit profesionist.

Interesi ishte i lartë nga sportdashësit shkodranë, por kishte edhe tifozë të huaj të cilët kishin ardhur për të mbështetur miqtë e tyre në ndeshjet e boksit profesionist.

Kampionati Kombëtar i Ping Pongut - Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën Sportive të Ping Pongut Vllaznia, në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit 2025 dhe promovimit të sportit ping pongut për herë të parë ka organizuar turneun tre-ditor “Kampionati Kombëtar i Ping Pongut” në datat 14-16 Korrik. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte zhvillimi i sportit të ping pongut në nivele të ndryshme si në aspektin garues ashtu edhe promovues si dhe përfshirja e komunitetit të gjerë përmes aktiviteteve argëtuese dhe ndërvepruese

Dita I – 14 Korrik 2025 Kampionati Kombëtar në Pallatin e Sportit “Qazim Dervishi”, Shkodër

Kjo ditë shënoi zhvillimin e Kampionatit Kombëtar të Ping Pongut, me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve zyrtare nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Aktiviteti u organizua në ambientet e Pallatit të Sportit “Qazim Dervishi”, me një pjesëmarrje të gjerë të sportistëve në kategori të ndryshme (fëmijë, të rinj dhe seniorë).

Dita II – 15 Korrik 2025 Aktivitet promovues pranë Bashkisë Shkodër

Në këtë ditë u zhvillua një aktivitet i hapur për publikun në sheshin përpara Bashkisë Shkodër. Qëllimi i kësaj dite ishte promovimi i ping pongut tek qytetarët, me theks të veçantë tek përfshirja e të rinjve dhe kalimtarëve. Janë vendosur tavolina ping pongu ku të gjithë të interesuarit patën mundësinë të provojnë lojën, të sfidojnë njëri-tjetrin dhe të marrin informacion mbi përfshirjen në klube sportive.

Dita III – 16 Korrik 2025 Promovim në plazhin e Velipojës

Dita e tretë ishte e dedikuar për promovimin e sportit të ping pongut në një ambient turistik: plazhi i Velipojës. Qëllimi ishte të afroheshin pushuesit me këtë sport në një formë argëtuese dhe relaksuese. Tavolina ping pongu u vendosën në zonat e aksesueshme të plazhit, dhe shumë fëmijë, të rinj e të rritur morën pjesë në lojëra miqësore dhe sfida spontane.

Aktiviteti i realizuar dëshmoi sukses të plotë në të gjitha dimensionet: sportiv, promovues dhe komunitar. Ai përmbushi objektivat e vendosura dhe shërbeu si një model i mirë për zhvillimin dhe përhapjen e sportit të ping pongut në rajonin e Shkodrës dhe më gjerë.

Kampionati Kombëtar i Gjimnastikës - Në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit 2025 dhe promovimit të sportit të gjimnastikës, këtë vit u organizua për herë të parë Kampionati Kombëtar i Gjimnastikës në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Gjimnastikës.

Në aktivitet morën pjesë 9 shoqata anëtare të FSHGJ-së me 190 sportistë nga qytete si Berat, Lushnje, Tirana, Kruja, Shkodra dhe rreth 30 shkolla të Bashkisë Shkodër.

Në aktivitet të pranishëm për të ndjekur këtë event ishin Presidenti i FSHGJ-së, përfaqësues të Zyrës Arsimore Vendore dhe të Bashkisë Shkodër, Presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shiptar si edhe Presidenti i FIG (Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës) i cili kishte ardhur për vizitë zyrtare në Shqipëri.

Aktiviteti zgjati për 6 orë në pallatin e sportit “Qazim Dervishi” dhe kishte rreth 500 spektatorë e sportdashës të cilët e ndoqën me mjaft interes. Sportistët garuan në 4 disiplina të ndryshme dhe në përfundim të aktivitetit u shpallën edhe fituesit dhe sportistët më të mirë të secilës disiplinë.

Trofeu Gilman Bakalli MTB XC-Në datën 26 tetor 2025 u zhvillua gara sportive “MTB XC – Trofeu Gilman Bakalli”, në zonën Bardhaj-Bleran, në kuadër të aktiviteteve sportive të qytetit të Shkodrës. Aktiviteti kishte për qëllim promovimin e sportit të biçikletës, forcimin e turizmit sportiv dhe evidentimin e vlerave natyrore e kulturore të zonave përreth qytetit.

Gjatë monitorimit u konstatua se aktiviteti u organizua sipas planit dhe rregullores së paraqitur nga organizatori, duke respektuar standardet e sigurisë, itinerarin e parashikuar dhe orarin e zhvillimit të garës.

Vëzhgimet e grupit të monitorimit:

- Regjistrimi i pjesëmarrësve ishte kryer paraprakisht online dhe në vend, me pjesëmarrje të mirë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe disa garues nga jashtë vendit.
- Shënjimi i itinerarit të garës ishte i qartë dhe i sigurt, ndërsa mbikëqyrja gjatë garës u krye nga stafi teknik dhe vullnetarë të trajnuar.
- U sigurua ndihma e parë mjekësore në rast nevojë dhe nuk u raportuan incidente gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Stafi organizator u tregua bashkëpunues me grupin e monitorimit dhe me strukturat vendore të bashkisë Shkodër.
- U vlerësua pozitivisht kontributi në promovimin e destinacionit turistik dhe përfshirja e komunitetit lokal.

Rezultatet e garës:

Gara u zhvillua sipas tri kategorive: **Femra, Meshkuj dhe Veteranë**. Fituesit u shpërblyen me kupa dhe medalje për tre vendet e para në secilën kategori. Distanca e garës ishte 31 km me disniveli 1138 m.

Grupi i monitorimit konstaton se aktiviteti “MTB XC – Trofeu Gilman Bakalli” është realizuar me sukses, në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe me një nivel të mirë organizimi teknik dhe sportiv.

Eventi kontribuon në nxitjen e sportit të biçikletës dhe në promovimin e Shkodrës si destinacion për turizëm sportiv

P.AF141.Q1.O1.A4. Festivali i Shahut “Çesk Jubani”

Në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit si dhe promovimit të sportit të shahut dhe të përcjelljes së vlerave të cilat ky sport mbart, këtë vit u organizua për të 7-in vit radhazi Festivali i Shahut “Çesk Jubani”. Aktiviteti u zhvillua në hollin e Bashkisë Shkodër në datat 14-15-16 Mars 2025, nga Qendra Lulebora. Festivali i Shahut “Çesk Jubani” ishte i hapur për të gjithë, dhe morën pjesë 70 lojtarë dhe lojtare, të rinj dhe të reja, veteranë, amatorë dhe dashamirës të këtij sporti të cilët për 3 ditë u ndeshën për të zënë një vend mes më të mirëve.

Aktiviteti ishte i regjistruar në FIDE (Federata Internazionale e Shahut) dhe lojtarët në varësi të rezultateve, patën mundësi të fitojnë pikë për renditjen e tyre në zyrtare. Si sistem loje u aplikua sistemi Blitz dhe Rapid (20 min + 5sec) dhe metodologjia e ndeshjeve ishte zyrtari, ai Zviceran.

Me 14 Mars 2025 u zhvillua kampionati i shkollave të Bashkisë Shkodër

Aktiviteti filloi në orën 9 e 30 minuta dhe zgjati deri në orën 14:00. Shahistët nga shkolla Oso Kuka, 28 Nëntori, Jordan Misja, Shejnaze Juka dhe Pjetër Meshkalla morën pjesë këtë vit. Për të

nxitur nxënësit për pjesëmarrje në kampionat u dhanë në ceremoninë e mbylljes 20 bileta trageti për Koman të cilët u sponsorizuan nga Rozafa Ferry.

Fitues i kësaj kategorie u shpall Nesar Aruçi

Me 15 Mars 2025 u zhvillua kampionati në disiplinën Blitz dhe Rapid.

Me 15-16 Mars filloi kampionati Blitz në orën 09:30 dhe mbaroi në orën 13:00. Morën pjesë shahistë Shkodranë prej 8 vjeç deri 73 vjeç, amatorë dhe profesionistë. Pjesëmarrësit ishin edhe nga qytetet e tjera të Shqipërisë si Lezha, Durrësi, Tirana por edhe nga Ulqini e Tuzi.

P.AF141.Q1.O1.A5 Kupa Agim Tafili Nuk është realizuar

P.AF141.Q1.O1.A6 Memorial “Vllaznia”, boks

Bashkia Shkodër në kuadër të titullit Shkodra Qyteti Evropian i Sportit 2025 dhe promovimit të sportit të boksit si çdo vit ka organizuar turneun ndërkombëtar “Memorial Vllaznia 2025” në datat 5-7 Qershor për disiplinën e boksit. Me datën 5 ishte mbërritja dhe akomodimi i pjesëmarrësve dhe në datën 6 ishte fillimi i aktivitetit. Shtetet si Italia, Kosova, Polonia, Mali i Zi dhe Shqipëria ishin pjesëmarrës në aktivitetin 3 ditor. Interesi ishte i lartë nga sportdashësit shkodranë, por kishte edhe spektatorë të huaj nga vendet pjesëmarrëse.

Boksierët garuan në 4 pesha të ndryshme 55kg, 65kg, 75 kg dhe 90+kg me boksierë si: Emanuel Koco (ALB), Antonio Zamboni (ITA), Timoslav Dinovic (MNE), Loris Idrizi (KOS), Tarik Krug Mansor (ITA), Anton Torres (ITA), Ani Haxhillari (ALB), Dian Ourycavazini (ITA), Bashkim Bajoku (KOS), Mauro Cani (ALB), Pietruszka Maciej (POL), Milos Roganovic (MNE), Piega Oskar Cuba (POL), Lumturim Xhoxhaj (KOS), dhe Elvis Selmani (ALB).

Fitues u shpallën: Mauro Cani në kategorinë 55kg, Kristian Bala në kategorinë 65kg, Besian Karaj në kategorinë 75kg dhe Elvis Selmani në kategorinë 90+kg.

Gjithashtu u shpallën edhe boksierët më të mirë të turneut ku boksieri më teknik u shpall Besian Karaj. Ndërsa ekipi më i mirë i aktivitetit u shpall ekipi i Shqipërisë.

P.AF141.Q1.O1.A7 Beach Volley Nuk është realizuar

P.AF141.Q1.O1.A8 Triathlon

Në kuadër të titullit “Shkodra – Qyteti Evropian i Sportit 2025”, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Qendrën e Sporteve Ujore dhe Kundrimet të Shpendëve, organizoi më datë 7 shtator 2025 aktivitetin sportiv Triathlon Labeat, i zhvilluar në sheshin qendror të Shirokës.

Ky aktivitet synoi Zhvillimin dhe promovimin e sportit të triathlon-it si në aspektin garues ashtu edhe promovues; nxitjen e pjesëmarrjes së komunitetit në sport përmes aktiviteteve argëtuese dhe ndërvepruese; rritjen e imazhit sportiv të Shkodrës në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në garë morën pjesë 80 sportistë nga Shqipëria dhe rajoni, duke garuar në tre disiplina:

- Not – 750 m
- Çiklizëm – 20 km
- Vrapim – 5 km

Gara u zhvillua në 3 kategori kryesore:

- Të rritur (meshkuj)
- Të rritur (femra)
- Stafetë

Ky vit shënoi një rritje të ndjeshme të interesit dhe pjesëmarrjes, si nga sportistë vendas ashtu edhe të huaj, çka tregon për konsolidimin e këtij aktiviteti si një traditë sportive me ndikim.

Fituesit sipas kategorive

- Meshkuj – *Eduard Dalla* me kohën 01:10:49
- Femra – *Irma Temali* me kohën 01:40:40
- Stafetë – *Invincibles Kuq e Blu* me kohën 01:09:07

P.AF141.Q1.O1.A9 3x3Shkodra

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën Sportive të Basketbollit Vllaznia, në kuadër të titullit Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit 2025 dhe promovimit të sportit të basketbollit, për herë të katërt ka organizuar turneun 4-ditor “3x3Shkodra” në datat 31 Korrik - 3 Gusht. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte zhvillimi i sportit të basketbollit në nivele të ndryshme si në aspektin garues ashtu edhe promovues si dhe përfshirja e komunitetit të gjerë përmes aktiviteteve argëtuese dhe ndërvepruese. Aktiviteti u organizua në sheshin “Nënë Tereza” në qendrën e qytetit. Këtë vit morën pjesë 26 ekipe të rinjsh dhe profesionistë nga vendi dhe rajoni.

Pjesëmarrja ishte e gjerë me ekipe nga Tirana, Durrësi, Elbasani, Mali i Zi, Kosova dhe Austria. Aktiviteti u gjykua nga gjyqtarë profesionistë të licensuar nga FSHB.

Ditën e parë dhe të dytë të aktivitetit u zhvilluan 15 ndeshje për moshat U-18 dhe fitues arriti të shpallej ekipi Glaktikking nga Durrësi.

Në ditën e tretë dhe të katërt u zhvilluan ndeshjet për profesionistët, ku në total numërohen 43 ndeshje dhe interesi i qytetarëve ishte shumë i lartë duke afruar rreth 1000 spektatorë dhe kalimtarë të rastit. Në ditën e fundit u zhvilluan finalet dhe garat e zhytjeve dhe e 3-pikëshave ku nga këto fitues dolën:

Fitues të aktivitetit ekipi Dangerous Meridian nga Mali i Zi: Marko Koljevic, Petar Dragovic, Bogdan Cebalovic, Aleksandar Bulatovic

Vend i dytë ekipi 040 nga Austria.

Fitues i garës së 3-pikëshave- Eljan Memçaj

Fitues i garës së zhytjeve - Ajet Cahani

P.AF141.Q1.O1.A10 Beach Soccer Nuk është realizuar

P.AF141.Q1.O1.A11 Shkodra Open Tennis

Në kuadër të titullit “Shkodra – Qyteti Evropian i Sportit 2025”, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Shkodra Tennis dhe Federatën Shqiptare të Tenisit organizuan në datat 12-14 dhjetor 2025 aktivitetin sportiv Shkodra Indoor 2025, i zhvilluar në kompleksin sportive Adriatic Tennis Park.

Ky aktivitet synoi Zhvillimin dhe promovimin e sportit të tenisit si në aspektin garues ashtu edhe promovues; nxitjen e pjesëmarrjes së komunitetit në sport përmes aktiviteteve argëtuese dhe ndërvepruese; rritjen e imazhit sportiv të Shkodrës në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në garë morën pjesë 57 tenistë nga vendet e ndryshme përveç nga Shqipëria edhe nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja dhe Hercegovina, të cilët garuan në 4 kategori të ndryshme:

Fituesitë dhe finalistët sipas kategorive:

Women's Singles 30+

Winner: Elonia Gjata

Finalist: Angela Karamano

Men's Singles 30+

Winner: Granit Bajraliu

Finalist: Nikolaev Svyatoslav

Men's Singles 45+

Winner: Maliq Dervishi

Finalist: Loris Hanxhari

Men's Singles 55+

Winner: Andi Bilali

Finalist: Arjan Shanaj

P.AF141.Q1.O1.A12. Shpenzime për mirëmbajtjen e funksionimin e terreneve sportive.

Kontratë e lidhur nga Drejtoria e përgjithshme e mirëmbajtjes së Objekteve Publike, në proces realizimi. DPMOP ka realizuar pagesat për shërbimin e rojeve dhe shërbimet utilitare si uji, energjia elektrike, interneti, kolaudimi i fikëseve të zjarrit, ruajtja e godinave, karburant dhe disa shpenzime të tjera operative për godinat e stadiumit “Loro Boriçi”, pallatin e sportit “Qazim Dervishi” dhe fushën sportive “Reshit Rusi”.

P.AF141.Q1.O1.A13. Mbështetje për ekipet sportive Vllaznia.

Bashkia Shkodër, në zbatim të ligjit për sportin, mbështet zhvillimin e tij nëpërmjet projekteve sportive që shoqatat sportive kanë paraqitur e janë përzgjedhur nga bashkia për të përfaqësuar Vllazninë në kompeticionet sportive kombëtare dhe ndërkombëtare. Drejtoria e sportit mbështet

15 shoqata sportive për pjesëmarrje në Kampionate Kombëtare nëpërmjet 24 ekipeve të përfshirë në keto shoqata që kontribuojnë në zhvillimin e sportit në bashkinë tonë.

P.AF141.Q1.O1.A14 Shpërblim për rezultatet në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës e të trashëguara

Janë paguar shpërblimet për sportistët e ekipeve të altetikës, xhudos dhe peshëngritjes. (më konkretisht prsh për secilën kategori).

P.AF141.Q1.O1.A15. Mbështetje e ekipit të Basketbollit

Janë 6 ekipe dhe 250 sportistë meshkuj dhe femra që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A16 Mbështetje e ekipit të Volejbollit

Janë 6 ekipe dhe 250 sportistë meshkuj dhe femra që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A17 Mbështetje e ekipit të Atletikës

Janë 150 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A18 Mbështetje e ekipit të Boksit

Janë 30 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A19 Mbështetje e ekipit të Çiklizmit

Janë 10 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A20 Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës

Janë 100 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A21 Mbështetje e ekipit të Mundjes

Janë 30 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A22 Mbështetje e ekipit të Notit

Janë 27 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A23. Mbështetje e ekipit të Peshëngritjes

Janë 7 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A24 Mbështetje e ekipit të Ping Pongut

Janë 11 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A25 Mbështetje e ekipit të Shahut

Janë 9 sportistë që mbështeten nga bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A26 Mbështetje e ekipit të Xhudos

Janë 27 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A27 Mbështetje e ekipit të Taekwondo

Janë 150 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A28 Mbështetje e ekipit të Futsal

Janë 15 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P.AF141.Q1.O1.A29 Mbështetje e ekipit të Futbollit të femrave

Janë 150 sportistë që mbështeten nga Bashkia Shkodër, procedura e cila vijon nga muaji mars deri në fund të vitit.

P08130.Q1.O1.A15 Shkodra, Qyteti Evropian i Sportit 2025 - TË TRASHËGUARA. Nuk është realizuar.

P.AF141.Q1.O2.A1. Studim për ngritjen e një kompleksi olimpi Nuk është realizuar.

P.AF141.Q1.O2.A2 Bashkëfinancim për projekte sportive Nuk është realizuar.

P813AAT- Ndërtimi i Ambienteve Sportive Shkolla "Dëshmorët e Prishtinës" (Jeto me sportin) e të trashëguara është realizuar dhe është në proces likuidimi.

P813AAZ Ndërtimi i Ambienteve Sportive të gjimnazit "28 Nëntori" Shkodër. Nuk është realizuar.

P813ABA Ndërtimi i Ambienteve Sportive të shkollës "Tring Smajli". Nuk është realizuar.

P813AAU- Ndërtimi i Ambienteve Sportive Shkolla "Preng Jakova" (Jeto me sportin) e të trashëguara është realizuar dhe është në proces likuidimi.

P813AAV- Ndërtimi i Ambienteve Sportive Shkolla "Adem Haxhija" (Jeto me sportin) e të trashëguara është realizuar dhe është në proces likuidimi

P813AAX Fusha të pambuluara sportive, shkolla "Xheladin Fishta" - TË TRASHËGUARA
Realizuar nga DPMOP.

P.AF141.Q2.O1.A1 Administrim dhe menaxhim i objekteve të trashëgimisë së kulturës (Muze+bibliotekë+galeria)

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit të trashëgimisë kulturore dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

P.AF141.Q2.O1.A2 Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore e të trashëguara janë realizuar pjesërisht nga DPMOP shpenzime për Energji elektrike, Ujë, Shërbim Interneti dhe Telefonie. Si çdo vit është realizuar kontrata me shoqëritë e sigurimit për siguracionin e ndërtesës si dhe rimbushja dhe kolaudimi i fikësve të zjarrit. Në muzeun historik “Oso Kuka” është bërë ndërhyrje në portën kryesore si dhe është pastruar dhe lyer fasada e ndërtesës. Janë në proces shpenzime për Mirëmbajtje e ndërtesave të trashëgimisë Kulturore dhe materiale pastrimi/sanitare.

P.AF141.Q2.O1.A3 Shpenzime për funksionimin e objekteve të trashëgimisë kulturore e të trashëguara, janë realizuar shpenzime për prodhim dhe shtypje biletash, shpenzime për pagesën e anëtarësimit të 2 përdoruesve nga Biblioteka Marin Barleti në platformën e përbashkët bibliotekare Cobiss, si dhe shpenzim për procedurën e prokurimit të blerjes së vogël për kondicioner dhe deumidifikator.

P.AF141.Q2.O1.A4 Realizimi i aktiviteteve të trashëgimisë kulturore e të trashëguara.
Jnae realizuar aktivitete të trashëgimisë kulturore si: “Narracioni, fotografia dhe përvoja e Kujtesës”, Festat e 28-29 Nëntori, Letërsia Shqipe e pas viteve 90, Anderseni dhe letërsia për fëmijë si dhe një sërë aktiviteteve të realizuara nga Biblioteka “Marin Barleti” si më poshtë:

8 Janar Dhënia e çertifikatave “Miku i vogël i librit”, për fëmijë 5-14 vjeç

18 Janar Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

23 Janar Koncert-bisedë “Fenomeni artistik e psikologjik Moxart në kohën e kompjuterit”

25 Janar Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

1 Shkurt Aktiviteti “Detektivët e bibliotekës” për fëmijë 5-14 vjeç

7 Shkurt Promovim i librit: “Edi Rama, Neuroestetika e një artisti”, të autorit Oltsen Gripshi

12 Shkurt Siguria në internet-Aktivitet Ndërgjegjësues me nxënësit e shkollës Trush dhe Bërdicë.

13 Shkurt Promovim i librit: “Zërat e së ardhmes”, të autores Seli Alushi

14 Shkurt Aktivitet me gjimnazistët e shkollës “Oso Kuka”, Orë Letrare “Letrat e Dashurisë”

15 Shkurt Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

22 Shkurt Aktiviteti “Detektivët e bibliotekës” për fëmijë 5-14 vjeç

28 Shkurt Promovim i librit: “Marshi funebër i gjelave të detit”, të autorit Koloreto Cukali

1 Mars Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

7 Mars Promovim i librit: “Kolana për Mjedën, pasqyrë vlerash”, Valbona Quku Lisha

7 Mars Ceremoni e organizuar me rastin e dhënies së Titullit të Mirënjohjes nga Bashkia Shkodër, mësuesit Luigj Shabani

11 Mars Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

13 Mars Aktiviteti “Detektivët e bibliotekës” për fëmijë 5-14 vjeç

13 Mars Në kuadër të 21-Marsit Dita Ndërkombëtare e Poezisë, aktivitet me nxënësit e gjimnazit “Dituria”

18 Mars Inagurimi i sallës së Aktiviteteve të Fëmijëve nga Rotary Club Shkodra

19 Mars Në kuadër të 21-Marsit Dita Ndërkombëtare e Poezisë, aktivitet me nxënësit e gjimnazit “28 Nëntori”

20 Mars Në kuadër të 21-Marsit Dita Ndërkombëtare e Poezisë, aktivitet me nxënësit e gjimnazit “Shejnaze Juka”

21 Mars Në kuadër të 21-Marsit Dita Ndërkombëtare e Poezisë, aktivitet me nxënësit e gjimnazit “At. Pjetër Meshkalla”

21 Mars Në kuadër të 21-Marsit Dita Ndërkombëtare e Poezisë “E këndueme n’vargje”, Mbrëmje Poetike

22 Mars Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

22 Mars Promovim i librit: “Epoka e ndërtimit të hidrocentraleve në Shqipëri”, të autorit Frederik Mustafaraj

29 Mars Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”

1 Prill Ekspozitë “Brandenburgu dhe Prusia, pikëtakime me Shqipërinë”

2 Prill Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

2 Prill Aktivitet me fëmijë në kuadër të 2 Prillit, Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë, i ftuar shkrimtari dhe studiuesi Xhahid Bushati

2 Prill Aktivitet me fëmijët organizuar me rastin e një numri të konsiderueshëm librash për fëmijë dhuruar nga Bashkia Shkodër, me rastin e 2 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë

19 Prill Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”

26 Prill Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç

26 Prill Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”

2 Maj Aktiviteti “Detektivët e bibliotekës” për fëmijë 5-14 vjeç

3 Maj Aktivitet kushtuar Nexhmi Bushatit, “Nexhmi Bushati, intelektual i qetë e dashunoi Shkodrën”

5 Maj Promovim i librit “Labirinth në tru”, të autorit Evans Drishti
 19 Maj Ekspozitë pikturë “Emocion Jete” Sidita Islami
 21 Maj Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”
 24 Maj Festivali Letrar: “ZaNa Literature Fest”
 27 Maj Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç
 31 Maj Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”
 31 Maj “Lexojmë së bashku” – aktivitet me fëmijët në kuadrin e 1 Qershorit
 2 Qershor Në mbretërinë e përrallave” – aktivitet me fëmijët në kuadrin e 1 Qershorit, e ftuar poetja, gazetarja dhe moderatorja Arjola Zadrime
 24 Qershor Takim me autoren Armenida Qyqja
 30 Qershor Bisedë për librin “Këngë të ahengut shkodran”, të autorit Fahri Djepaxhija, Esmerald Djepaxhija
 21 Korrik 100 vjetori i lindjes së Martin Camaj
 13 Shtator Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç
 18 Shtator Aktivitet “Kasem Taipi mbledhësi më i madh i folklorit”
 20 Shtator Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç
 27 Shtator Ekspozitë pikturë me fëmijë “Ne jemi çka ju na edukoni”
 10 Tetor Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç
 16 Tetor Aktivitet me gjimnazistët e shk. “Shejnaze Juka” në bashkëpunim me COD “Fjalët që marrin frymë”
 21 Tetor Promovim i librit: “Rrënjët në zemër”, të autores Rudina Çupi
 25 Tetor Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç
 31 Tetor Festivali i Letërsisë
 1 Nëntor Festivali i Letërsisë
 8 Nëntor Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç
 14 Nëntor Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”
 21 Nëntor Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”
 25 Nëntor Ekspozita “Ngjyra që shërojnë”, Dita Botëtare e eliminimit të dhunës ndaj grave
 26 Nëntor Çmimi “Koliqi” për Autorin e Karrierës & Autorin e Ri
 27 Nëntor Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”
 03 Dhjetor Prezantim i librit “Etnoletra shqipe”, të autorit Vehbi Myftari
 06 Dhjetor Klubi i librit për fëmijë 5-14 vjeç
 06 Dhjetor Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”
 11 Dhjetor Panair dhurim libri në bashkëpunim me Fondacionin Alsar dhe Shtëpinë Botuese Logos-A
 12 Dhjetor Prezantim i librit “Idromeno kostumografia”, të autores Merita Toçila
 13 Dhjetor Klubi i librit për të rinj “BibliOmania”
 19 Dhjetor Prezantim i librit “Zërat e italofonisë shqiptare”, të autorit Fabio Rocchi
 30 Dhjetor Dhënia e çertifikatave “Miku i vogël i librit”, për fëmijë 5-14 vjeç

P.AF141.Q2.O1.A5 Shpenzime promionale për aktivitetet e kulturës.

Është procedura e cila përmbledh të gjitha shpenzimet promovionale të rrjetit muzeal, Galerisë së Arteve, Qendrës Kulturore Pjetër Gaci, Biblioteka “Marin Barleti” për të gjithë aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit. Kjo procedurë është realizuar si blerje e vogël për shkak të anulimit të procedurës së prokurimit të hapur të thjeshtuar të planifikuar fillimisht me vlerë më të lartë.

AF141Q2.O1.A7 Mbështetje për funksionimin dhe shërbimin në vazhdimësi të muzeut Historik e të Trashëguara Nuk është realizuar

P.AF141.Q2.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës e të trashëguara

Procedura e Blerjes së Librave për të gjitha fondet përkatëse: Libra për fëmijë, Fondi i Hapur, Fondi shqip, Blerje shtypshkrimesh, Fondi i Huaj etj është likuiduar procedura për blerje rafta për bibliotekën.

P.AF141.Q2.O3.A1 Paga dhe sigurime të personelit të Teatrit Migjeni Janë realizuar pagesat për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e Teatrit Migjeni dhe trupën teatrale.

P.AF141.Q2.O3.A1/1 Paga dhe sigurime të personelit të Kinema Republika

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit të Kinemasë dhe pagesat e sigurimeve shoqërore

P.AF141.Q2.O3.A2 Paga dhe sigurime të personelit të drejtorisë së kulturës e të trashëguara

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit të Drejtorisë së Kulturës dhe pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

P.AF141.Q2.O3.A3 Paga dhe sigurime të personelit të Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" e të trashëguara

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit të Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" dhe pagesat e sigurimeve shoqërore.

P.AF141.Q2.O3.A4 Shpenzime për mirëmbajtjen e plotë të Teatrit Migjeni e të trashëguara

Janë realizuar pjesërisht dhe janë në proces likuidimi nga DPMOP Energji elektrike, Ujë, Internet dhe janë në proces: Furnizim me materiale higjene, shpenzime për Mirëmbajtje e ambienteve të Teatrit Migjeni dhe Siguracion ndërtese.

P.AF141.Q2.O3.A5 Shpenzime për mirëfunksionimin e plotë të Teatrit Migjeni e të trashëguara.

Janë realizuar pjesërisht shërbime për mirëfunksionimin e teatrit. Është realizuar pjesërisht Prodhim dhe shtypje biletash për shfaqjet në Teatër.

Janë likuiduar procedurat: Shpenzime Akomodimi dhe Trajtim Ushqimor, Shpenzime Transporti, Udhëtimet jashtë vendit si dhe Prodhim publikim dhe botim i materialeve promocionale.

P.AF141.Q2.O3.A6 Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të Qendrës Kulturore "P.Gaci" të trashëguara

Janë realizuar pjesërisht dhe janë në proces likuidimi nga DPMOP Energji elektrike, Ujë, Internet dhe janë në proces realizimi i shpenzimeve për Siguracion ndërtese dhe Furnizim me materiale pastrimi.

P.AF141.Q2.O3.A7 Shpenzime sigurimin e funksionimit të plotë të Qendrës Kulturore "P.Gaci" e të trashëguara

Janë likuiduar procedurat për Shpenzime Transporti si dhe Prodhim dhe shtypje biletash për aktivitetet.

P.AF141.Q2.O3.A8 Orkestra Frymore Honorare vjetore e të trashëguara

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë dhe si formacion ka realizuar disa aktivitete, duke filluar nga aktiviteti Karnavale - parakalim në qytet, 2 Prilli– Ceremonial zyrtar, 5 Maji- Ceremonial zyrtar, 9 shtator – Lëvizja e Posttribës, 28-29 Nëntor – Ceremoniali zyrtar dhe parakalim, pjesëmarrje në aktivitetin “Swing Marathone” dhe në vazhdim do të ketë pjesëmarrje në koncerte të ndryshme. Sipas marrëveshjes me Bashkinë Shkodër, ky formacion bën prova rregullisht rreth programit për aktivitete të ndryshme të cilat janë realizuar gjatë vitit 2025.

Janë kryer pagesat Shkurt-Shtator të vitit 2025.

P.AF141.Q2.O3.A9 Aktivitete të realizuara nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" e të trashëguara

1. Çmimi “Pjetër Gaci” është një takim i interpretuesve të rinj në fushën e muzikës së kultivuar. Këtë vit ky aktivitet u zhvillua në datat 11-15 qershor në ambientet e Teatrit “Migjeni”. Për 5 ditë me radhë Shkodra mirëpriti mbi 120 pjesëmarrës, talente të rinj, interpretues të muzikës klasike.

Konkurentët pjesëmarrës erdhën nga treva të ndryshme të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, surprizë ishte dhe ardhja e konkurrenteve nga Amerika dhe Italia.

Ky aktivitet është i hapur për interpretues me aftësi solistike nga mosha 7 deri në 23 vjeç, të ndara në kategori sipas grupmoshave në specialitetet:

- Piano, Fizarmonikë, instrumente të drunjtë dhe të tunxhit.
- Harqe, Kitarë dhe Kanto.

Juria: Piano/Fizarmonikë, instrumentet e drunjtë dhe të tunxhit e përbërë nga :

- -Nikola Vuckovic, pianist. Pedagog në shkollat muzikore në Kotorr dhe Budva
- -Rudina Jakova, pianiste. Pedagogë në Shkollën artistike “P.Jakova” Shkodër.
- -Senad Gaçeviç, kompozitor. Pedagog në Universitetin e Arteve Cetinje
- -Shkumbin Bajraktari, klarinetist. Pedagog në Universitetin e Arteve Prishtinë.

Juria: Harqe/Kitarë/Kanto e përbërë nga:

- -Profesor Bujar Sykja, violinist. Pedagog në Universitetin e Arteve Tiranë
- -Dushica Kordic, violiniste. Drejtore e Shkollës artistike Budva, Mali i Zi.
- -Gjulan Bytyqi, kitarrist. Pedagog i Kitarrës në Shkollën e Muzikës “Lorenc Antoni” Prizren dhe në Universitetin e Arteve “Haxhi Zeka” Pejë
- -Mimoza Rakaj- Pedagogë e kantos në Shkollën artistike “P.Jakova” Shkodër dhe Universitetin “Luigj Gurakuqi”

U realizuan rreth 40 orë audicione për 5 ditë.

Audicionet u mbajtën në ambientet e Teatrit “Migjeni” dhe u ndoqën nga rreth 400 artdashës dhe në natën finale rreth 350 artdashës.

Në natën finale me 21 fitues në kategori dhe degë të ndryshme juria e përbashkët ndau këto cmime të mëdha:

Çmimi i parë: Gabriel Darragjati, Piano, ardhur nga Amerika

Çmimi i dytë: (interpretues cikël i lartë):Krisa Gjika, Kanto nga UAT.

Çmimi i tretë: (Cikël i mesëm): Sibora Resyli, Violinë nga Prishtina.

Stafi realizues i aktivitetit dhe institucionet që organizuan dhe e mbështetën:

Drejtore Artistik: Profesor Lorenc Radovani

Drejtore Organizativ: Dritan Mlika

Konsulent Artistik: Bardhyl Hysa

Konferenciere: Kristi Ndoja

Ahengu Shkodran

P.AF141.Q2.O3.A10 Honorare “Grupi i Valleve”.

1. Çmimi “Pjetër Gaci“ është një takim i interpretuesve të rinj në fushën e muzikës së kultivuar. Këtë vit ky aktivitet u zhvillua në datat 11-15 qershor në ambientet e Teatrit “Migjeni“. Për 5 ditë me radhë Shkodra mirëpriti mbi 120 pjesëmarrës, talente të rinj, interpretues të muzikës klasike.

Konkurentët pjesëmarrës erdhën nga treva të ndryshme të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi. Surprizë ishte dhe ardhja e konkurentëve nga Amerika dhe Italia.

Ky aktivitet është i hapur për interpretues me aftësi solistike nga mosha 7 deri në 23 vjeç, të ndara në kategori sipas grupmoshave në specialitet:

- Piano, Fizarmonikë, instrumente të drunjta dhe të tunxhit.
- Harqe, Kitarë dhe Kanto.

Juria: Piano/Fizarmonikë, instrumentet e drunjta dhe të tunxhit e përbërë nga:

- -Nikola Vuckovic, pianist, Pedagog në shkollat muzikore në Kotorr dhe Budva
- -Rudina Jakova, pianiste, Pedagoge në Shkollën artistike “P.Jakova“ Shkodër.
- -Senad Gaçević, kompozitor, Pedagog në Universitetin e Arteve Cetinje
- -Shkumbin Bajraktari, klarinetist, Pedagog në Universitetin e Arteve Prishtinë.

Juria: Harqe/Kitarë/Kanto e përbërë nga:

- -Profesor Bujar Sykja, violinist, Pedagog në Universitetin e Arteve Tiranë
- -Dushica Kordic, violiniste, Drejtore e Shkollës artistike Budva, Mali i zi.
- -Gjulan Bytyqi, kitarrist, Pedagog i Kitarrës në Shkollën e Muzikës “Lorenc Antoni” Prizren dhe në Universitetin e Arteve “Haxhi Zeka” Pejë
- -Mimoza Rakaj, Pedagoge e kantos në Shkollën artistike “P. Jakova“ Shkodër dhe Universitetin “Luigj Gurakuqi“

U realizuan rreth 40 orë audicione për 5 ditë.

Audicionet u mbajtën në ambientet e Teatrit “Migjeni“ dhe u ndoqën nga rreth 400 artdashës dhe në natën finale rreth 350 artdashës.

Në natën finale me 21 fitues në kategori dhe degë të ndryshme, juria e përbashkët ndau këto cmime të mëdha:

Çmimi i parë: Gabriel Darragjati, Piano, ardhur nga Amerika

Çmimi i dytë (interpretues cikël i lartë): Krisa Gjika, Kanto nga UAT.

Çmimi i tretë (Cikël i mesëm): Sibora Resyli, Violinë nga Prishtina.

Stafi realizues i aktivitetit dhe institucionet që organizuan dhe e mbështetën:

Drejtor Artistik: Profesor Lorenc Radovani

Drejtor Organizativ: Dritan Mlika

Konsulent Artistik: Bardhyl Hysa

Konferenciere: Kristi Ndoja

Ahengu Shkodran

P.AF141.Q2.O3.A10 Honorare "Grupi i Valleve".

Grupi artistik i Valleve është një grup me traditë disa vjeçare dhe pjesëmarrje të gjerë në aktivitetet e zhvilluara nga Bashkia Shkodër. Janë kryer pagesat për të gjithë trupën gjatë muajve.

P.AF141.Q2.O3.A11 Festivali i Këngës “Luleborë” e të trashëguara

Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” në bashkëpunim me Teatrin “Migjeni” organizuan edicionin e X- të të Festivalit të Këngës “Luleborë”, në datat 27-28 Tetor 2025. Drejtor Artistik i këtij viti ishin Zef Çoba dhe Inva Mula, të cilët janë marrë me detajet artistike të festivalit.

Elda Laro u bë pjesë e stafit të Festivalit si dirigjent, duke drejtuar me profesionalizëm dhe shumë korrektesë të gjitha krijimet e reja që u paraqitën në festival.

Këngët e festivalit, ishin 16, ku sipas rregullave të festivaleve një kompozitor kishte të drejtë të përfaqësohej veç me një krijim.

Bashkia Shkodër realizoi me sukses publikimin e të gjitha këngëve në Reels 30 sekondash në faqen zyrtare të Teatrit Migjeni në mënyrë që publiku të njihet paraprakisht me këngët.

Skenari i festivalit u punua nga Arjola Shehu, e cila me shumë seriozitet dhe përgjegjësi, prezantoi më së miri çdo komponent të këtij festivali si dhe për çdo mesazh promovuese në mbështetje të vlerave artistike të dhëna gjatë netëve live të festivalit.

Moderatore e festivalit – Arjola Shehu

Skenografia e këtij edicion u realizua nga Mensur Gushta.

Regjisor- Bojken Lako

Pjesëmarrja e publikut ishte shumë e lartë, rreth 900 spektatorë në sallë në të dyja netët.

Media partner i këtij aktiviteti ishte Televizioni Publik Shqiptar.

Juria e këtij viti ishin personalitete të fushës së artit.

1. Osman Mula

2. Eli Fara

3. Rosela Gjylbegu

4. Armando Likaj

5. Bashkim Alibali

Këtë vit Festivali i Këngës “Luleborë” erdhi me një format të ri, në formë konkursi. Pas performancës së 16 këngëve pjesëmarrëse në natën e parë, juria zhvilloi procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes, duke kualifikuar për në natën finale 8 këngët më të vlerësuara.

Në natën e parë të festivalit, përshendeti publikun me performancë artistike Frederik Ndoci i cili interpretoi një kolazh me këngët e tija më të mira ndër vite.

Nata e dytë e Festivalit “Luleborë” u zhvillua në një atmosferë festive dhe plot emocion, ku publiku shijoi finalen e madhe me 8 këngët konkurrese që kishin kaluar nga nata e parë.

Mbrëmja u pasurua edhe me interpretimet e artistëve të ftuar, të cilët me praninë dhe zërin e tyre i dhanë shkëlqim skenës së festivalit.

Në skenë u ngjitën emra të njohur të muzikës shqiptare si Eli Fara, Rosela Gjylbegu, Armando Likaj, Bashkim Alibali, Mukadeze Çanga, Gjergj Leka, Eduard Jubani dhe për ta mbyllur natën Nimet Begu dhe Manola Çezma.

Juria e edicionit të X “Luleborë” në fund vendosi:

Çmimi i parë – “Ta dish”, kompozuar nga Leon Lekaj, teksti Leon Lekaj, këndoi Glerdit Turmetaj.

Çmimi i dytë - “Shkodër Loce”, kompozuar nga Laorjan Ejlli, teksti Melita Vjerdha, këndoi Laorjan Ejlli.

Çmimi i tretë – “Në rrugicat e Shkodrës”, kompozuar nga Florent Boshnjaku, teksti Arjola Zadrime, këndoi Martina Serreqi.

P.AF141.Q2.O3.A12 Realizimi i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kulturës e të trashëguara Janë realizuar aktivitetet:

“Dita e Luleve”, u zhvillua gjatë gjithë javës 1-6 maj 2025 dhe organizimi tij u shtri përgjatë rrugës “28 Nëntor” deri në sheshin para Bashkisë Shkodër.

Aktiviteti filloi me datë **1 Maj** ku u organizua Panairi i luleve i vendosur përgjatë rrugës 28 Nëntori me pjesëmarrjen e 14 subjekteve që prezantuan variatete dhe kompozime të ndryshme lulesh në stendat që ju mundësuan. Ky panair zgjati gjatë gjithë javës së aktiviteteve dhe pati interes dhe pjesëmarrje të lartë të qytetarëve. Gjithashtu është dekoruar me lule dhe logo të aktivitetit e gjithë rruga 28 Nëntori deri te sheshi para Bashkisë. Pjesë e dekorit ishin edhe këndi për foto ku të gjithë kalimtarët kishin mundësinë të kishin një kujtim të kësaj dite. Gjatë pasdites u organizua Koncerti festiv me pjesëmarrjen e këngëtarëve të mirënjohur Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Savjana Vjerdha dhe Leonard Guli. Skena, fonia dhe ndriçimi për festivalin të pozicionuar në pedonale, rruga 28 Nëntori dhe atmosfera e krijuar nga interpretimi i këngëve mbushi sheshin duke i shtuar nota festive këtij aktiviteti shumë të dashur për qytetarët e Shkodrës dhe jo vetëm.

Gjatë datës **2 Maj** atmosfera festive ka vazhduar, Panairi i luleve ka vijuar të ketë interes të lartë duke u vizituar nga qytetarët çdo ditë në vijimësi. Në mbrëmje, në bashkëpunim me bizneset e zonës është organizuar koncert festiv me pjesëmarrjen e këngëtarëve grek, Andreas Drakopolus, Mikki dhe Athena. Eventi krijoi atmosferë elektrizuese në shesh.

Me datë **3 Maj** krahas panairit të luleve, fëmijët e shkollave performuan në skenën e ngritur në shesh duke dhuruar emocione të bukura përmes performancave artistike dhe luleve shumëngjyrëshe. Fëmijët u angazhuan në një aktivitet edukues “Duart e vogla mbjellin lule”, një moment edukues dhe argëtues për të vegjlit që mësuan për bimët dhe rëndësinë e kujdesit për natyrën. Atmosferës festive ia bashkua eventi Swing Marathon organizuar në bashkëpunim me Hemingway Fun Club Albania, me pjesëmarrjen e disa artistëve të huaj nën ritmin e muzikës së viteve 20-30.

4-5 Maj panairi dhe aktivitetet kanë vazhduar në qytet, duke e kthyer Shkodrën në atraksion për të gjithë vizitorët.

Atmosfera festive ka vijuar me një kalendar të pasur aktiviteteve për të gjitha grupmoshat, duke e kthyer Shkodrën në një pikë atraksioni për artin, argëtimin dhe atmosferën e gjallë në qytet, duke kulmuar me datë **6 Maj**, që ishte dhe dita përmbyllëse e këtij event. Gjatë ditës 6 Maj fëmijët e shkollave zhvilluan paradën e luleve. Ky aktivitet i ishte dedikuar fëmijëve dhe u organizua në koordinim me Drejtorinë e Kulturës dhe bashkëpunimin në mënyrë të suksesshme me Zyrën Vendore Arsimore Shkodër, duke angazhuar fëmijët e sistemit parashkollor dhe shkollor parauniversitar. Gjithashtu, pjesë e këtij bashkëpunimi u bënë edhe subjekte arsimore private të qytetit tonë. Parada e grupeve të ndryshme të fëmijëve, të cilët të veshur në përshtatje me tematikën e ditës, performuan gjatë gjithë ditës. “Festivali i Luleve” – Festës iu bashkua edhe performanca e fëmijëve të Bilbilave të Vegjël” të cilët performuan në skenë. Një hapësirë e veçantë iu dedikua tërësisht shkollave 9-vjeçare të cilët sollën në skenë performanca vallëzimesh me ritme shqiptare dhe moderne.

“Koncert Recital”, u zhvillua me datë 21 qershor 2025 tek sheshi para Bashkisë Shkodër.

Më datë 21 qershor 2025, qyteti i Shkodrës u bë mikpritës i një prej ngjarjeve më të rëndësishme muzikore të sezonit veror – koncerti madhështor i artistit të mirënjohur të muzikës qytetare, Bujar Qamili. Aktiviteti u zhvillua në sheshin para Bashkisë Shkodër, ku u krijua një atmosferë mbresëlënëse dhe tepër emocionuese për të gjithë të pranishmit.

Skena ishte ngritur në qendër të sheshit, me një strukturë moderne metalike, ndriçimi ishte i konceptuar me kujdes për të nxjerrë në pah artistët, pa prishur karakterin tradicional të koncertit.

Pas skenës ishte vendosur një ekran digjital i madh, ku shfaqeshin pamje nga performancat, emrat e artistëve. Përkrah Bujar Qamilit, në këtë koncert morën pjesë edhe emra të njohur të skenës muzikore shqiptare si: Artjola Toska, Shkëlzen Jetishi, Mateos Frroku.

Koncerti përfshiu mbi 20 numra muzikorë, duke alternuar këngë të njohura qytetare, duete dhe momente solo me pjesë instrumentale të orkestrës së drejtuar nga profesionistë të njohur. Orkestra përbëhej nga 8 muzikantë profesionistë, nën drejtimin e Vis Shkodrani, duke garantuar një performancë të gjallë dhe autentike të repertorit qytetar shkodran.

Koncerti u pasurua me elementë të humorit shkodran, të cilët shtuan atmosferën festive dhe sollën të qeshura në publik: Aktorët e humorit: Akil V. Arafi, me interpretimet e tij humoristike spontane. Drande Xhaj dhe Muhamet Cekini, të cilët ndërhyjnë me skeçe dhe batuta të përshtatura për publikun shkodran. Koncerti u ndoq nga rreth 2,000 persona, përfshirë qytetarë të Shkodrës, artdashës nga qytete të tjera të Shqipërisë si dhe vizitorë të huaj që ndodheshin në qytet.

Moderatore të koncertit ishin: Drande Xhaj dhe Linda Kavaja

“Festivale të Artit Audiovizual”, u zhvillua në datat 18 deri me 22 Qershor 2025 në pika të ndryshme të qytetit. “Festivale të Artit Audiovizual” e titulluar “Ekran i Artit” nga subjekti, u konceptua mbi temën Postcards from elsewhere.

18 Qershor (E Mërkurë) – Hapja zyrtare

19:00 – Hapje zyrtare – Kinema Republika

Shfaqja e filmit “ARSA” nga MASBEDO (2025, 96’), në prani të regjisorëve.

11:00–18:00 – Ekspozita

- “Covers” – Art House, nga Barbara Prenka, kuruar nga Zef Paci

- “REWIND – Glimpses of Video Art in Albania” – Civic Art Gallery, kuruar nga Edi Muka

19 Qershor (E Enjte) – Ditë ekspozitash dhe programesh filmike

11:00–18:00 – Ekspozita dhe loop screenings

- “REWIND”, “Covers”, “How the name emerged from stone”

- Programi i Riar Rizaldi – Franciscan Auditorium

16:00 – Shorts Program – Kinema Republika

Kuruar nga Tea Paci (Kieslowski, Radu Jude, Morzaniel Tramari)

18:00 – War and Peace – Screening

Massimo D’Anolfi & Martina Parenti (2020, 128’)

20:00–01:00 – Loop Screening – Gjuhadol Street

Programi “What You Want to Call Them?” kuruar nga MASBEDO

21:00 – The Dream & The Lie – Screening

Elena Dorfman (2024, 69’) + Q&A në Kinema Republika

20 Qershor (E Premte) – Biseda, ekspozita dhe projeksione

11:00 – Talk – Bar Tore

“Echoes of the Archive” me Elena Dorfman, Iris Elezi, Thomas Logoreci

11:00–18:00 – Ekspozita dhe Protocinema – Loop screenings

- “REWIND”, “Covers”, “How the name...”, “I’m Glad You Exist” – curated by Mari Spirito

16:00 – Shorts Program – Kinema Republika

Kuruar nga Tea Paci – Kieslowski, Radu Jude etj.

21:00 – Shorts Program – Screening

Daphné Hérétakis, Maha Haj

21 Qershor (E Shtunë) – Artist Talk dhe mbyllja e festivalit

11:00 – Artist Talk – Franciscan Auditorium

“Poetics of Presence” me Valentina Furian, Giorgio Andreotta Calò, Basir Mahmood, Ari Benjamin Meyers

16:00 – Screening – Kinema Republika

Preemptive Listening, Aura Satz, 2024, 89’

18:00 – Shorts Program

Claudia Lomoschitz, Catarina Vasconcelos, Giulia Cosentino

21:00 – Mbyllje – Screening

Filmi “Temo Re” nga Anka Gujabidze (2025) – Kinema Republika

22 Qershor (E Diel) – Dita e fundit

11:00 – Talk – Art House

“Reshaping Patterns” me Barbara Prenka dhe Zef Paci

12:00 & 17:00 – Shorts Program – Replikime

Tea Paci: Kieslowski, Radu Jude, Daphné Hérétakis, Maha Haj

11:00–18:00 – Loop Screening – Ars Electronica

Franciscan Auditorium – New Animation Art (Beatie Wolfe, Bavari, Maclean etj.)

20:00–01:00 – Loop Screening – Gjuhadol

Programi “What You Want to Call Them?”

Programi Muzikor – Ekrani i Artit 2025

Përveç filmave dhe ekspozitave, festivali “Ekrani i Artit” solli edhe një dimension të gjallë muzikor përmes programit “Program from Elsewhere” dhe “Ekrani i Muzikës”. Këto netë dhe ditë muzikore i dhanë jetë atmosferës së qytetit, duke krijuar hapësira për relaks dhe argëtim në natyrë dhe në hapësira alternative urbane.

19 Qershor (E Enjte) – 22:00

Lokacioni: Bed Station

Artistë: Kole Laca – SANTNIGA

Kole Laca, i njohur për eksperimentimin e tij muzikor dhe performanca vizuale, solli projektin SANTNIGA – një përvojë ku zëri, tingulli dhe imazhi krijuan një hapësirë reflektimi dhe shprehjeje bashkëkohore.

20 Qershor (E Premte) – 22:00

Lokacioni: Bed Station

Artistë: Malo B2B Vasso (Silur)

Dyshja energjike Malo dhe Vasso sollën një set bashkëpunues që përfshinte ritme elektronike, eksperimentale dhe atmosferike, duke krijuar një ambient intim për adhuruesit e muzikës underground.

21 Qershor (E Shtunë) – 22:00

Lokacioni: Ishulli në Zues

Artistë: Leart Rama, Leo, Treg Elektronik (Live)

Mbrëmja finale muzikore në Ishullin e Zuesit solli një line-up të pasur. Leart Rama dhe Leo sollën performanca të kuruara me finesë, ndërsa Treg Elektronik prezantoi një set live, ku analogjia dhe improvizimi u bashkuan në një eksperiencë unike audio-vizuale.

22 Qershor (E Dielë) – 12:00

Lokacioni: Ishulli në Zues (Day Party)

Artistë: The Funky Villainz & Hektor Jubani

Një festë ditore nën ritmet e funky, groove dhe elektronikës së lehtë. The Funky Villainz dhe Hektor Jubani sollën energji pozitive në një mjedis të hapur dhe natyror, duke krijuar një atmosferë çlodhëse dhe ritmike për publikun.

Koncertet e Verës- Gjatë muajve qershor dhe gusht 2025, Bashkia Shkodër organizoi një seri aktivitesh kulturore dhe koncerte të hapura për publikun, të cilat u pritën me entuziazëm të madh nga qytetarët dhe vizitorët e shumtë. Këto ngjarje u zhvilluan në hapësira publike ikonike të qytetit si pedonalja Gjuhadol dhe sheshi para Bashkisë, duke krijuar një atmosferë të gjallë kulturore dhe festive në qendër të Shkodrës.

14 Qershor – Koncerti i Dren Abazit në Gjuhadol

Koncerti u zhvillua në një mbrëmje të ngrohtë verore në pedonalen historike të Gjuhadolit, ku këngëtari i njohur Dren Abazi solli një performancë të veçantë live për publikun shkodran. Atmosfera ishte intime dhe artistike, me pjesëmarrje të lartë të të rinjve, familjeve dhe turistëve. Ndriçimi ishte i konceptuar për t'i dhënë jetë fasadave historike të rrugës, duke krijuar një sfond të ngrohtë dhe të afërt me artistin. Tingujt e muzikës u përhapën përgjatë gjithë rrugicës, duke shndërruar Gjuhadolin në një skenë kulturore urbane unike.

4 Korrik – Koncert në Sheshin para Bashkisë Shkodër

Ky koncert solli në një skenë të përbashkët emra të njohur të muzikës shqiptare: Rezarta Smaja, Saviana Vjerdha, Leonardi Guga, Laorjan Ejlli si dhe orkestra e teatrit Migjeni: Ilir Zoga-drejtues orkestre, Dritan Mlika-kitarë bass, Daniel Prendi-kitarë, Erion Lishi- saksofon dhe Fatmir Mesidram.

Sheshi para Bashkisë u kthye në një arenë të hapur arti, ku publiku mori pjesë masivisht. Ndriçimi profesional, efekti i skenografisë dhe tingujt e orkestruar mirë krijuan një mbrëmje me nivel të lartë artistik. Repertori i interpretuar përfshiu si hite bashkëkohore ashtu edhe pjesë klasike shqiptare, duke kënaqur shije të ndryshme muzikore dhe krijuar një përmbyllje të shkëlqyer të kalendarit kulturor.

11 Korrik 2025 - Koncerti i Ervin Bushatit

Ky aktivitet u zhvillua ditën e premte, më 11 korrik 2025, në sheshin para Bashkisë Shkodër.

Në skenë u ngjiti këngëtari Ervin Bushati, i cili solli një repertor të pasur me këngë të njohura moderne dhe balada të ndjera. Performanca u shoqërua me një atmosferë të ngrohtë dhe interaktive, ku publiku iu bashkua këngëve, duke krijuar një mbrëmje festive dhe emocionuese.

12 Korrik 2025- Koncerti i Blue Bird Band

Mbrëmjen pasardhëse, më 12 korrik 2025, u mbajt koncerti i dytë në pedonalen e Gjuhadolit.

Në këtë event performoi Blue Bird Band, një grup muzikor me përvojë të gjatë në skenat shqiptare dhe ndërkombëtare. Repertori përfshinte elementë të jazz-it, muzikës soul dhe pop, duke sjellë një stil të rafinuar dhe ndryshe për mjedisin historik të Gjuhadolit.

Publiku shijoi një mbrëmje më intime dhe artistike, me theks në performancën instrumentale dhe cilësinë muzikore.

18 korrik 2025 - “Shkodra Elektronike”- Në sheshin para Bashkisë Shkodër, u zhvillua koncerti i grupit “Shkodra Elektronike”, grupi muzikor që ka përfaqësuar Shqipërinë në festivalin ndërkombëtar Eurovizion. Koncerti nisi në orën 20:30, duke mbledhur një publik të gjerë, të përbërë nga qytetarë shkodranë, vizitorë dhe turistë, të cilët kishin ardhur për të shijuar këtë koncert unik. “Shkodra Elektronike” solli në skenën e hapur një performancë live me tingujt e tyre origjinalë, të cilët ndërthurin elemente elektronike, motive shqiptare dhe energjinë bashkëkohore të muzikës moderne. Repertori përfshinte këngën që përfaqësoi Shqipërinë në Eurovizion, si dhe një seri kompozimesh të tjera të njohura nga publiku. Koncerti u ndoq nga një numër i madh pjesëmarrësish, veçanërisht të rinj, të cilët e përjetuan me entuziazëm çdo interpretim të grupit.

24 Korrik 2025 – “Shpat Kasapi”- Në vazhdimësi të aktiviteteve verore të organizuara në hapësirat publike të qytetit, më 24 korrik 2025, në sheshin para Bashkisë Shkodër, u mbajt koncerti i këngëtarit të njohur shqiptar Shpat Kasapi. Koncerti nisi në orën 20:30 dhe u prit me interes të veçantë nga publiku, sidomos nga të rinjtë dhe adhuruesit e muzikës pop shqiptare.

Shpat Kasapi interpretoi një repertor të zgjedhur me këngët më të njohura të karrierës së tij, duke përfshirë hite të hershme dhe krijime më të reja, të cilat u shoqëruan me entuziazëm nga audienca. Mbrëmja u karakterizua nga një atmosferë festive dhe pjesëmarrje masive e qytetarëve. Publiku reagoi pozitivisht, duke kënduar dhe kërcyer gjatë gjithë koncertit.

2 gusht 2025 - Në sheshin para Bashkisë Shkodër, u mbajt koncerti i këngëtarit të mirënjohur Berti Naraçi së bashku me miqtë e tij muzikantë. Repertori i përzgjedhur përfshinte këngë popullore dhe moderne shqiptare, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe familjare. Ky aktivitet u ndoq nga një publik i gjerë, i cili e shoqëroi me duartrokitje dhe këndim të përbashkët.

7 Gusht 2025- në sheshin para Bashkisë Shkodër, u zhvillua koncerti i reperit të njohur shqiptar Ledri Vula. Aktiviteti filloi në orën 20:30 dhe solli në qytet një atmosferë dinamike dhe rinore. Repertori i tij i mbushur me hite të njohura të muzikës hip-hop dhe rap u prit me entuziazëm të jashtëzakonshëm nga të rinjtë, të cilët morën pjesë masivisht.

14 Gusht 2025-në sheshin para Bashkisë Shkodër, u mbajt një koncert i veçantë me pjesëmarrjen e grupit Blitz Rock dhe grupit Na. Blitz Rock solli në skenë një performancë rock të fuqishme, me interpretim të këngëve të njohura ndërkombëtare dhe krijimeve të tyre origjinale, duke ngjallur entuziazëm tek të apasionuarit pas këtij zhanri. Grupi Na u paraqit me një repertor që kombinon elementë alternativë dhe modernë, duke sjellë një frymë të re dhe origjinale në koncert.

Ky aktivitet u shqua për shumëllojshmërinë muzikore dhe atmosferën rinore që krijoi në qytet.

16 gusht 2025- Në pedonalen Gjuhadol u organizua një mbrëmje elektronike me pjesëmarrjen e DJ Veleje, BtB dhe Amar DJ Turkey. Eventi solli një atmosferë rinore dhe energjike, me sete të ndryshme elektronike që u shoqëruan me ritme moderne dhe vizualizime të veçanta. Pjesëmarrja ishte e lartë, sidomos nga të rinjtë dhe vizitorët që gjallëruan pedonalen deri në orët e vona.

19 gusht 2025- Në sheshin para Bashkisë Shkodër u kthye në një skenë të madhe festive ku u zhvillua koncerti i këngëtarit të njohur Luiz Ejlli dhe grupit “Burn”. Aktiviteti ishte pjesë e kalendarit veror të aktiviteteve kulturore dhe artistike të Bashkisë Shkodër dhe solli një atmosferë të jashtëzakonshme duke mbledhur një publik të gjerë, qytetarë dhe vizitorë të shumtë. Pjesa e parë

e koncertit u çel nga grupi Burn, të cilët sollën energji rock dhe alternative, duke performuar një repertor të pasur me këngë të njohura dhe krijime origjinale. Tingujt e tyre elektrizuan publikun, veçanërisht të rinjtë, duke e përgatitur terrenin për pjesën e dytë të mbrëmjes.

Luiz Ejlli u ngjiti në skenë mes duartrokitjeve dhe entuziazmit të madh të publikut. Ai interpretoi një sërë këngësh të dashura për publikun shqiptar. Publiku mori pjesë masivisht, duke mbushur sheshin para Bashkisë. Atmosfera ishte festive, me energji të lartë dhe komunikim të drejtpërdrejtë mes artistit dhe qytetarëve.

Në përfundim, programi i verës 2025 dëshmoi se Shkodra ka potencialin dhe kapacitetin për të organizuar evente të mëdha publike, me standard të lartë artistik dhe organizativ. Larmia e artistëve, stilet e ndryshme muzikore dhe pjesëmarrja masive e publikut e kthyen qytetin në një skenë të hapur arti dhe argëtimi, duke e përforcuar identitetin e tij kulturor dhe duke krijuar një traditë pozitive për vitet në vijim.

“Festa e trashëgimisë kulturore” – Titulluar nga subjekti fitues “Za Fest” 24 – 26 Korrik 2025 NATA 1 – 24 Korrik 2025 - Muzeu Historik i Shkodrës

Ekspozita udhëtuese “Living Without Leaving” – një hapësirë arti bashkëkohor që trajtoi temat e migrimit, rrënjëve dhe qëndrimit shpirtëror në vend.

Dokumentari “Udha” – shfaqje e dokumentarit me fokus identitetin, udhëtimin dhe lidhjen me atdheun.

“Logu i Zâ Fest” – me Lorik Cana dhe Arbër Agalliu – bisedë frymëzuese mbi kulturën, sportin dhe vetëdijen kombëtare.

Performancë muzikore nga Petrit Çarkaxhiu – natë e mbyllur me muzikë akustike, e ndjerë dhe tradicionale.

Një natë reflektimi, introspektive dhe me përmbajtje të thellë kulturore. Ambienti i Muzeut krijoi një ndjesi intime. Pjesëmarrja ishte e konsiderueshme, me publik të përzier: vendas, artistë, të ftuar dhe vizitorë ndërkombëtarë.

NATA 2 – 25 Korrik 2025 - Kalaja “Rozafa”, Shkodër

Programi:

Rafael Hoxha – performancë eksperimentale që solli kombinim të zërave elektronikë me ambient minimal.

Sahati – grup alternativ që solli frymë të re me një stil të veçantë indie/rock shqiptar.

Armend Rexhepagiqi – këngëtar i njohur kosovar që krijoi emocione të forta me interpretimin e baladave dhe hiteve të tij të njohura.

Reonex – DJ set që mbylli natën me ritme elektronike moderne, duke e shndërruar kalanë në një hapësirë festivali energjik.

Kalaja “Rozafa” ofroi një skenë magjike me ndriçim profesional dhe një prapavijë panoramike të qytetit. Mijëra të rinj dhe artdashës u bënë pjesë e natës, duke krijuar një atmosferë dinamike dhe të gjallë deri në orët e vona të natës.

NATA 3 – 26 Korrik 2025 - Kalaja “Rozafa”, Shkodër

Programi:

Rafael Hoxha (ri-performim) – një set i ri që solli tinguj më eksperimentalë, si hyrje e mbrëmjes.

Casadileto – grup që solli një performancë live plot energji, me ritme të kombinuara ndërmjet pop-it dhe rock-ut alternativ.

Vlashent Sata – artisti i njohur solli një performancë të fuqishme me zë të pastër dhe kompozime të rafinuara.

MC Kresha & Lyrical Son – dyshja e njohur e hip-hop-it shqiptar elektrizuan publikun me një performancë të fuqishme, që solli ritëm, mesazh dhe ndërveprim të fortë me audiencën.

Nata finale ishte kulmi i festivalit. Pjesëmarrja tejkaloi çdo parashikim, me publik që mbushi të gjitha hapësirat e kalasë. Energji, entuziazëm dhe një ndjenjë bashkimi kulturor e bënë këtë natë të paharrueshme. Za Fest 2025 konfirmoi edhe një herë pozicionin e tij si një ndër festivalet më të rëndësishme kulturore në Shqipëri. Me një përzierje të kujdesshme artistësh nga fusha të ndryshme, ambient unik, përmbajtje me vlerë dhe organizim të mirë, festivali u mbyll me sukses të plotë dhe me një jehonë pozitive në publik dhe media.

Info shtesë mbi disa aktivitete që u realizuan në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër gjatë verës:

25 Qershor – “Festa e Dy Popujve”

Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim kulturor midis Shqipërisë dhe Italisë, duke promovuar shkëmbimet kulturore dhe miqësinë mes dy popujve. Festa përfshiu muzikë live, valle tradicionale, performanca instrumentale dhe elementë të folklorit të përbashkët. Skena ishte e vendosur në hapësirë publike me ndriçim të ngrohtë dhe elementë simbolikë të dy flamujve. Publiku mori pjesë në mënyrë aktive, duke duartrokitur, kërcyer dhe ndërvepruar me artistët, duke e kthyer këtë natë në një festë të mirëfilltë ndërkulturore.

27 – 28 Qershor – “Vala Fest”

Festivali dyditor “Vala Fest” mbledhi një sërë artistësh të rinj dhe të njohur nga scena muzikore moderne shqiptare dhe më gjerë. Me një program të pasur artistik, festivali solli energji pozitive në qytet, sidomos për të rinjtë që e mbushën zonën e koncertit. Skena ishte e pajisur me ndriçim profesional dinamik dhe ekran LED, duke krijuar një eksperiencë vizuale bashkëkohore. Atmosfera ishte elektrizuese, me publik që kërcente, këndonte dhe festonte deri në orët e vona të mbrëmjes.

3 Korrik 2025- Koncerti i Bandës së Forcave të Armatosura

Në kuadër të aktiviteteve të verës, në sheshin përpara Bashkisë Shkodër u mbajt një koncert nga Banda Frymore e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Atmosfera ishte festive dhe me ndjesi patriotike, ku qytetarë të shumtë, të rinj e të moshuar, morën pjesë për të ndjekur nga afër këtë aktivitet të veçantë. Banda interpretoi një repertor të përzgjedhur që përfshinte vepra kombëtare, marshe ceremoniale dhe pjesë klasike të njohura.

Performanca e bandës u shoqërua me duartrokitje dhe respekt të veçantë nga publiku Shkodran.

8 Korrik 2025 - Koncerti i Orkestrës Simfonike të RTSH

Në mbrëmjen e 8 korrikut, sheshi para Bashkisë Shkodër u mbush nga dashamirës të muzikës për të ndjekur një koncert të jashtëzakonshëm të Orkestrës Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të kalendarit kulturor të verës dhe solli një program tërheqës me muzikë nga filmat shqiptarë dhe të huaj, duke risjellë emocione dhe kujtime nga kinematografia e njohur vendase dhe ndërkombëtare. Orkestra interpretoi në mënyrë mjeshtërore kolona zanore nga filma të njohur.

“Festival Jazz-it” - projekt i titulluar nga subjekti fitues “Shkodra Universal Sounds -Shkodra Jazz Festival” i cili përfshinte: “Shkodra Sounds” dhe “Rrok Academy”, u zhvillua në datat 11 gusht – 31 gusht 2025. Në datën 11 gusht 2025 në ambientet e Qendrës Rinore “Atelie”, Shkodër, në orën 09:00 u bë hapja "Rrok Academy" Junior e drejtuar nga Brixhilda Martini. Në "Rrok Academy" Junior morën pjesë 15 studentë nga qyteti i Shkodrës, Lezhës, Tiranës, Durrësit dhe Italia. Me datën 11 gusht u hap dhe dega e Fizarmonikës e cila u drejtua nga Bardh Jakova. Në degën e Fizarmonikës morën pjesë 5 studentë dhe dy profesorë të cilët ishin nga Shqipëria, Romania, Mali i Zi dhe Kosova.

"Rrok Academy Klasike" filloi me datën 14 -25 Gusht 2025 në ambientet Galerisë së Arteve Shkodër, nën drejtimin e Paçalin Pavacit. Në "Rrok Academy Klasike" morën pjesë 10 studentë nga Shqipëria, Kosova dhe Italia.

"Rrok Academy Jazz" filloi me datën 18 Gusht 2025, në ambientet e Qendrës Rinore “Atelie” nën drejtimin e Markelian Kapidanit. Në "Rrok Academy Jazz" morën pjesë 16 studentë nga Shqipëria, Kosova dhe Italia. Në “Shkodra Jazz Festival”, u mbajtën orë speciale në “Rrok Academy Jazz” ku leksionet e trombës nga Gabriel Oscar Rosati; leksionet e bass-it nga Flavio Piantoni. Dega New Technology – Multimedia filloi me datën 11-31 Gusht 2024 , në ambientet e Qendrës Rinore “Atelie” nën drejtimin e Fatjon Çelikut. Në degën New Technology – Multimedia morën pjesë 6 studentë.

Më datë 18 gusht 2025, në sallën “Kardinal Mikel Koliqi” u zhvillua koncerti i hapjes së Shkodra Sounds, me pjesëmarrjen e Skanderbeg Chamber Orchestra.

Orkestra u drejtua nga Paçalin Zef Pavaci dhe përbëhej nga muzikantë të shquar si:

Franc Shestani – violinë; Sokol Prekalori – violinë; Fatmira Fati – violinë; Besnik Yzeiri – violë
Etleva Katroshi – violë; Gjorgj Krraqi – violinçel; Rezart Dosti – kontrabas

Programi i koncertit përfshiu vepra të njohura të muzikës klasike, duke sjellë një interpretim të nivelit të lartë artistik dhe duke krijuar një atmosferë të veçantë në sallë.

Aktiviteti u ndoq nga një publik i gjerë, ku morën pjesë qytetarë shkodranë, artdashës dhe vizitorë të huaj. Pjesëmarrja dhe reagimi i publikut ishin mjaft pozitivë, duke e kthyer mbrëmjen në një përvojë të paharrueshme kulturore.

Pas 14 ditësh intensive masterclass-i dhe provash, studentët e "Rrok Academy Accordion" nën drejtimin e Maestro Bardh Jakova.

Tingujt magjik të 8 fizarmonikave performuan një repertor nga pjesë të huaja si: Vals Brilant, Tico- Tico, Suite Bullgare, Libertango dhe pjesë nga repertori shqiptar si: Valle Tiranse, Baresha, Pranvera filloi me ardhë etj.

Koncert filloi në orën 20:30 dhe zgjati për rreth 1 orë e 30 minuta, në oborrin e Muzeut Historik, banesa “Oso Kuka”. Në fund të performancës artistike studentët u pajisën me çertifikata pjesëmarrje.

Muzeu Historik, banesa “Oso Kuka” u “pushtua” nga tingujt e harqeve të klasës “Rrok Academy Junior” dhe “Rrok Academy Classic”.

“Rrok Academy Junior” me artistët më të rinj të akademisë, të cilët pas dy javësh prova dhe masterclase performuan për publikun. Repertori i koncertit ishte zgjedhur me kujdes nga profesoresha Brixhilda Martini, me pjesë klasike por dhe shumë argëtuese.

“Rrok Academy Classic” studentët së bashku me profesor Paçalin Pavaci, performuan muzikë dhome për rreth 1 orë e 30 minuta, me një program të përzgjedhur elitar të muzikës klasike. Në fund të performancës artistike studentët u pajisën me çertifikata pjesëmarrje.

Datë 26 gusht 2025- Slow Klang hapi koncertin me një udhëtim muzikor atmosferik e të rafinuar, ku ritmet e buta dhe tingujt eksperimentalë gërshetohen në mënyrë harmonike.

Koncerti filloi në orën 20:30 tek Muzeu Historik, Banesa “Oso Kuka”.

Datë 26 gusht 2025

Ilaria Pilar Patassini & Alessandro D’Alessandro sollën një performancë të ndjeshme e poetike, ku vokali dhe akordeoni krijuan një dialog artistik plot emocione. Repertori përfshinte pjesë nga muzika franceze, angleze dhe ajo italiane.

Koncerti filloi në orën 20:30 tek Muzeu Historik, Banesa “Oso Kuka”.

Datë 30 gusht 2025- Salla “Kardinal Mikel Koliqi” u mbush me tinguj magjikë në mbrëmjen e fundit të festivalit, ku publiku pati mundësinë të përjetonte dy performanca të jashtëzakonshme.

Amphitrio (Rumani) solli një univers tingujsh modernë, me improvizime të guximshme dhe një harmoni që ndërthurte jazz-in bashkëkohor me elementë eksperimentues. Virtuoziteti i tyre krijoi një atmosferë elegante dhe një udhëtim muzikor që mbajti të mbërthyer çdo dëgjues.

Markelian Kapidani, Flavio Piantoni, Rocco Lombardi Trio me të ftuar special Gabriel Oscar Rosati & Kejdi Barbullushi ndezën sallën me ritme të ngrohta të jazz-it latin. Muzika e tyre ishte një festë energjike, ku melodia dhe ritmi u ndërthurën me pasion, duke e kthyer natën në një përjetim plot jetë dhe lëvizje. Publiku u përfshi nga gjallëria dhe dinamizmi i interpretimit, duke duartrokitur gjatë e me entuziazëm.

Datë 31 gusht 2025 - Studentet e kursit jazz patën mundësinë dhe fatin të luajnë në JamSession me artistët të ftuar në “Shkodra Jazz Festival”. Klasa e frymës, të shoqëruar nga trombetisti me famë ndërkombëtare Gabriel Oscar Rosati, klasa e bass-it me Flavio Piantoni, nën shoqërimin e kompozitorit Markelian Kapidani, dhuruan për publikun një spektakël të vërtetë Jazzi.

Një natë brenda atmoferës Jazz është një eveniment i radhë në qytetin e Shkodrës i cili solli një gjallëri të dukshme si tek studentët e “Rrok Academy Jazz” po ashtu edhe tek publiku.

“Shkodra Universal Sounds- Shkodra Jazz Festival” pasuroi jetën kulturore të Shkodrës duke ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për të shijuar muzikë të cilësisë së lartë në ambientet me karakteristike të qytetit. Nga tingujt e rafinuar të muzikës klasike, tek emocionet e fuqishme të xhazit, Shkodra në gushtin e vitit 2025 ishte një pikëtakim i artistëve të talentuar dhe dashamirësve të muzikës nga mbarë bota. “Rrok Academy” është element i rëndësishëm i “Shkodra Universal Sounds- Shkodra Jazz Festival” i cili ka si synim rritjen e profesionalizmit tek nxënësit të cilët studiojnë muzikë, përmes shkëmbimit të eksperiencave me artistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe njohjes së rrymave dhe stileve të ndryshme muzikore.

Koncert Ndërkombëtar- Koncert i Tenorit Saimir Pirgu- 05.09.2025 Shirokë

Më datë 5 shtator 2025, në Sheshin Qendror të Shirokës, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin “Arte” dhe institucionet e tjera kulturore, i dhuroi qytetarëve një mbrëmje të jashtëzakonshme muzikore me pjesëmarrjen e tenorit me famë botërore Saimir Pirgu dhe Orkestrës Simfonike të Shkodrës, nën dirigjimin e Elda Laro. Saimir Pirgu është një nga tenorët më të suksesshëm shqiptarë në skenat botërore, i njohur për bashkëpunimet me dirigjentë dhe teatro të nivelit më të lartë si La Scala, Metropolitan Opera apo Wiener Staatsoper. Zëri i tij i ngrohtë dhe interpretimi i fuqishëm mbartin një ndjeshmëri të veçantë, e cila u ndje fuqishëm edhe në këtë mbrëmje në Shirokë. Ai solli një performancë që ndërthur mjeshtërinë vokale me emocionin e singertë, duke e bërë publikun pjesë të çdo note dhe fjale të kënduar. Mbrëmja u moderua nga Ema

Ndoja. Skena ishte konceptuar në mënyrë profesionale dhe e pozicionuar në qendër të sheshit, duke ofruar një pamje mbresëlënëse drejt liqenit të Shkodrës. Një moment i veçantë dhe emocionues i koncertit ishte interpretimi i “Ave Maria”, i dedikuar Nënë Terezës, në ditën e shenjtërimit të saj. Ky moment u shoqërua nga Kori i Fëmijëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”, duke krijuar një atmosferë solemne e prekëse që pushtoi të gjithë të pranishmit. Ndërkohë, së bashku me korin, tenori solli edhe interpretime të tjera të paharrueshme si “O Sole Mio”, “Luleborë” dhe “Vincerò”, ku emocionet shpërthyen në duartrokitje të pandërprera nga publiku. Kulmi i mbrëmjes erdhi me këngën “Rrjedh në këngë e ligjërime”, e interpretuar në bashkëpunim me korin dhe orkestrën, ku i gjithë publiku u ngrit në këmbë, duke kënduar së bashku me artistin. Ky koncert gala ishte një dhuratë artistike e rrallë për Shkodrën dhe gjithë artdashësit shqiptarë.

Shkodra N’Fest - Organizatorët e këtij aktiviteti ishin: Bashkia Shkodër dhe shoqata “DoInAlbania” e cila u shpall fituese nga Këshilli Artistiko-Kulturor i Bashkisë Shkodër dhe kishte si synim realizimin e projektit “Shkodra N’fest” gjatë muajit Dhjetor 2025.

Gjatë gjithë muajit Dhjetor u realizuan koncerte me artistë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë të cilët mbushën plot sheshin para Bashkisë Shkodër.

Një vëmendje të veçantë iu është kushtuar fëmijëve përmes krijimit të një hapësire të dedikuar për ta me lojëra të ndryshme, si një mjedis i sigurt, argëtues dhe edukues për ta. Vlen të theksohet dhe shtëpiza e Babagjyshit e cila për fëmijët është një pikë shumë e rëndësishme ndalese për të takuar personazhin e tyre të preferuar të festave të fundvitit duke i treguar atyre që ekziston magjia e festave dhe dhuratave nga ky simbol i Vitit të Ri.

Puna për organizimin e këtij projekti ka vijuar fillimisht në vendosjen e bazës për realizimin e këtyre aktiviteteve si ndërtimi i Skenës Led Ëall si dhe vendosja e pajisjeve të fonisë ndriçimit apo atyre teknike.

02 Dhjetor 2025 ora 20:00 – Klodiana Vata e cila hapi zyrtarisht serinë e koncerteve.

06 Dhjetor 2025 ora 18:00 – Ndezja e dritave të zbukurimeve për festat e Fundvitit në qytetin e Shkodrës.

Aktiviteti vijoi me një performancë mbresëlënëse nga Kori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”.

Ora 20:00– Ndezi skenën e “Shkodra N’fest” Aurela Gaçe & Band

08 Dhjetor 2025 – Dita e Rinisë ku sheshi u mbush me drita dhe entuziazmin e të rinjve që performuan në skenë duke e bërë këtë mbrëmje të paharrueshme.

09 Dhjetor 2025 ora 20:00– Laorjan Ejlli, Savjana Vjerdha

12 Dhjetor 2025 ora 19:00 - festa ka nisur nga DJ Besi për të vijuar në orën 20:00 me performancë nga grupi legjendar Fisnikët.

13 Dhjetor 2025 ora 20:00 – Grupi Bruno, Revolt Klan

14 Dhjetor 2025 ora 20:00 – Urban Band & Eris duke ofruar një natë Rock për të pranishmit.

15 Dhjetor 2025 ora 20:00 – Bert Naraçi & Band

16 Dhjetor 2025 ora 18:00 - Shfaqje e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”.

17 Dhjetor 2025 ora 19:00 – festa ka nisur nga DJ Besi për të vijuar në orën 20:00 me të ftuar Nimet Salabegu & Band.

18 Dhjetor 2025 ora 20:00 – Mark Ujka & Band

19 Dhjetor 2025 ora 19:00 – atmosfera është ndezur nga DJ Besi dhe në orën 20:00 ka vijuar me të ftuarin Gena.

20 Dhjetor 2025 ora 20:00 – Glerdit Turmetaj

21 Dhjetor 2025 ora 19:00 – atmosfera ka vijuar nga DJ Besi dhe në orën 19:30 ka vazhduar me Fest Folk ku në skenë janë ngjitur 2 emra të mëdhenj të muzikës shqiptare motrat Irma dhe Eranda Libohova.

22 Dhjetor 2025 ora 20:00 – Rezarta Smaja, Rosela Gjylbegu

24 Dhjetor 2025 ora 20:00 – u realizua koncerti i Krishtlindjes me të ftuar special Josif Gjipali, Kastriot Tusha dhe Gospel Music të cilët krijuan një atmosferë festive dhe shpirtërore.

31 Dhjetor 2025 ora 23:30 – Nata e ndërrimit të viteve u shoqërua nga këngëtari shkodran Sidrit Bejleri, i cili më vokalën dhe notat e larta dhe të fuqishme përformoi këngë të repertorit të tij po ashtu edhe hite shqiptare dhe të huaja, duke përmbyllur kështu një muaj të jashtëzakonshëm të aktiviteteve Shkodra N’fest.

P.AF141.Q2.O3.A13 Ndërmendje

Aktiviteti u realizua nën drejtimin artistik të Elda Laros, e cila arriti të ndërthurë elementë të muzikës klasike me atë bashkëkohore duke krijuar një atmosferë të veçantë për publikun e pranishëm.

Kjo mbrëmje është një reflektim artistik dhe muzikor mbi identitetin kulturor, mendimin dhe ndjeshmërinë.

Kjo mbrëmje kishte nderin të kishte të ftuar sopranon Marigona Qerkezi, e cila me interpretimin e saj të ndjerë dhe profesionist solli momente kulmore artistike. Gjithashtu përformoi dhe Ardita Meni, e cila kontribuoi në pasurimin e kësaj mbrëmjeje me ndjeshmërinë artistike që e karakterizon.

Moderatore e këtij aktiviteti ishte Evi Reçi, e cila me rrjedhshmërinë e të prezantuarit dhe me elegancë drejtoi këtë aktivitet madhor për nga rëndësia artistiko-kulturore në qytetin e Shkodrës. Në planin e punës së operatorit dhe në projektin e tij, përveç orkestrës simfonike, pjesë e aktivitetit ishin dhe Kori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”. Provat u realizuan në harqe kohore të ndryshme për secilin komponent të koncertit.

Në këtë koncert morën pjesë edhe solistët Ergi Papadhimetri dhe Anton Guri duke interpretuar me profesionalizëm të lartë dhe me bashkëpunim të harmonishëm me orkestrën.

Interpretimet janë shoqëruar nga Orkestra Simfonike e Shkodrës, e cila si gjithmonë me një nivel të lartë artistik, disiplinë dhe ndjeshmëri muzikore, i dha kësaj mbrëmjeje një dimension dinjitoz duke i mbështetur me sukses solistët dhe programin e përzgjedhur.

Me 26 dhjetor në Teatrin Migjeni filloi montimi i skenografisë, audios dhe ndriçimit, sipas standarteve të përcaktuara.

Koncerti gala “Ndërmendje” 2025 filloi në orën 19:00 me datë 28 dhjetor, në ambientet e Teatrit Migjeni.

P.AF141.Q2.O3.A14 Karnavalet

Karnavale 2025 i titulluar “Karnavalet e Shkodrës”, u zhvillua në datat 17-23 Shkurt 2025.

Në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore, Drejtorinë e Kulturës dhe strukturave të kulturës së Bashkisë Shkodër, 24 shkolla 9-vjeçare dhe 5 gjimnaze iu përgjigjën ftesës për pjesëmarrje në projektin “Karnevale” duke performuar nga data 17.02.2025 deri me datë 21.02.2025 tek sheshi “Nënë Tereza” ku ishte vendosur edhe njëra nga skenat.

Gjatë gjithë javës në hollin e Bashkisë Shkodër nga ora 17:00 kishte aktivitete të ndryshme për fëmijë, si facepainting, puntori në ndërtimin e maskave dhe lojra argëtuese nga kllounë profesionistë.

As këtë vit nuk mungoi Mapping Show, i cili çdo darkë kishte spektakël para sheshit të Bashkisë Shkodër dhe Prefekturës.

Mapping show në fasadën e Bashkisë Shkodër dhe Prefekturës për Karnevalet ishte një event artistik dhe festiv që kombinoi teknologjinë e video mapping me atmosferën unike të karnevaleve. Me datë 20.02.2025, nën performancën e artistëve si: Mark Ujka, Marko Prendi, Duliem Puka dhe Ermis Pirani, orkestra lëvizëse e Karnevaleve, një risi e këtij viti, shëtiti rrugët kryesore të Shkodrës duke kënduar këngë shkodrane dhe serenata korçare.

Në darkën e datës 20.02.2025 u realizua koncerti i parë i Karnevaleve, ku të ftuar ishin dy këngëtarët shkodranë Laorjan Ejlli dhe Savjana Vjerdha.

Me datë 21.02.2025 u ngjit në skenën e “Karnevaleve” këngëtarja e mirënjohur Rezarta Smaja e cila me zërin e saj të fuqishëm solli gjallëri tek publiku prezent.

Sheshi para Bashkisë Shkodër ishte plot me të rinj e të reja të cilët prisnin me padurim të dëgjonin performancën e artistit Ylli Limani. Atmosfera e krijuar mes artistit dhe publikut përmes këndimit dhe brohoritjeve ishte e jashtëzakonshme.

Me datë 22.02.2025 ora 11:00, në sheshin para Bashkisë Shkodër u organizua një festë e vërtetë për fëmijë, përmes këngëve dhe kërcimit.

Në orën 18:00, nga sheshi “Nënë Tereza”, nisi udhëtimin parada dhe karvani shëtitës, mes këngëve dhe bejtave duke mbërritur në sheshin para Bashkisë Shkodër ku e priste grupi shkodran “Berti dhe Miqtë”.

Në darkën e datës 22.02.2025, në skenën e “Karnevaleve” ishin të ftuar: Marsela Çibukaj dhe Sidrit Bejleri. Performanca e Marsela Çibukajt, u mirëprit dhe u duartrokoi nga publiku. Ajo prezantoi para publikut këngë nga albumi i saj, hite ndër vite, si edhe këngë të njohura të repertorit botëror. Sidrit Bejleri me prezencën e tij të fortë skenike solli në skenë një energji të veçantë. Ai performoi këngë shkodrane por edhe muzikë të lehtë shqiptare dhe të huaj.

Karnevale 2025 u mbyllën me datë 23 shkurt 2025 përmes një festimi madhështor që u mbështet mbi traditën e përherëshme të prezantimit dekorativ ironizues dhe të bejtës karnevaleske ironizuese. Për realizimin cilësor të këtyre dy komponentëve, Shoqata “Antik” kishte menduar që t’i referohet karvanit karnevalessk lëvizës, traditë e përherëshme e karnevalit në Shkodër dhe kulmimit të këtij festimi me prezantim të një spektakli në përfundim të këtij karvani dhe djegien e dordolecit, si shenjë e largimit të të gjithë të këqijave të vitit.

Për të prezantuar këtë karvan lëvizës cilësor u mendua mbi koncept idenë për prezantimin e makinave alegorike si dhe organizimin e prezencës së artistëve të ndarë në grupe, për të performuar gjatë lëvizjes së karvanit. Element tjetër që karakterizoi këto karnevale ishin edhe butaforitë e ndryshme dhe karrot gjigante që për herë të parë u realizuan në Shkodër.

Për organizimin sa më të plotë të karvanit karnevalessk, butaforive dhe karrove, puna filloi shumë ditë më përpara nga Shoqata “Antik”. Çdo gjë u kurua deri në detaj, duke filluar që nga dizanji

dhe skicat, materialet e përdorura, ndërtimi i strukturave si tek butaforitë si tek karrot, të gjitha ishin të ekuilibruara dhe të sigurta në lëvizje.

Në orën 10:00, nga sheshi “Nënë Tereza” u bë nisja e karvanit lëvizës, i cili kaloi përmes pedonales “Kol Idomendo”, në Gjuhadol, tek Katedralia e Shën Shtjefnit (Kisha e Madhe”, Ish dega, duke vazhduar rrugën tek Kinema Republika dhe rikthimi tek sheshi Nënë Tereza). Gjithë rrugëtimi i karvanit lëvizës u shoqërua nga Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër dhe nga fëmijët e shkollave të ndryshme.

P.AF141.Q2.O3.A15 Festivali Mbarëkombëtar i Humorit në Shkodër e të trashëguara Teatri “Migjeni” realizoi me sukses për pesë netë radhazi, nga data 4 deri më 8 dhjetor Festivalin Mbarëkombëtar të Humorit, një aktivitet tashmë i konsoliduar në jetën artistike dhe kulturore të qytetit të Shkodrës dhe më gjerë.

Festivali u shndërrua në një festë të vërtetë të humorit dhe muzikës, duke mbledhur në skenë emra të njohur të artit shqiptar, aktorë humor, parodistë, këngëtarë dhe artistë të spikatur nga mbarë trevat shqiptare. Përgjatë pesë netëve, publiku shijoi shfaqje plot humor, satirë, batuta, skeçe, parodi dhe interpretime muzikore, duke krijuar një atmosferë festive dhe argëtuese.

Në këtë edicion morën pjesë dhe ishin të ftuar artistët:

Aktorë dhe humoristë:

- Zyliha Miloti
- Besnik Çinari
- Dana Xhaj
- Sandër Ruçi
- Sevdai Radogoshi
- Akil Varfi
- Gent Hazizi
- Edi Oga
- Marin Orhanasi
- Agron Llakaj
- Valina Muçolli
- Hasim Sopi Memishi
- Genc Lleshi
- Avni Shkodra
- Kushtrim Qerimi
- Erand Sojli
- Parodistët e Vlorës

Këngëtarë të ftuar:

- Mukades Çanga
- Orjeta Kelaj Laro
- Rezarta Smaja
- Laorjan Ejlli
- Savjana Vjerdha
- Leonard Guga

Gjatë 5 ditëve humor dhe muzikë, skena e Teatrit “Migjeni” u kthye në një pikëtakim të brezave të ndryshëm të artistëve, duke sjellë një program të pasur artistik dhe duke u mirëpritur me duartrokitje të shumta nga publiku.

Festivali u karakterizua nga pjesëmarrje e gjerë artistike, interes i lartë i publikut, organizim profesional dhe nivel i lartë interpretimi.

P.AF141.Q2.O3.A16 Realizimi i aktiviteteve të Galerisë së Arteve e të trashëguara

1. Galeria e arteve Shkodër në bashkëpunim me Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe Bashkinë Shkodër u përfshinë në një program të përbashkët, në një nga aktivitetet kyçe të Galeria e Arteve Shkodër siç janë "Programet e edukimit 2025"

Hapësira publike, veçanërisht sot shndërrohet në mundësinë e shprehjes emergjente artistike me një qëllim bashkohor dhe human, komunikimin e drejtpërdrejtë të publikut me veprën e Artit të vendosur në hapësirë publike dhe me shndërrimin e qytetit saktësisht, në një "galeri të hapur" me mundësi shprehje për artistët figurativ. Muralet janë një formë bashkohore e marrëdhënies së artit me urbanitetin.

Veprimtaria e udhëheqëses së këtij programi artistja, Lebibe Topalli përfundoi një murale të veçantë e titulluar "Zjerm në Arkë" ku përfitues të teknikës së realizimit po ashtu dhe veprës së realizuar janë studentë dhe Universiteti Shkodrës Luigj Gurakuqi.

2. Takimet Publike- Nga cikli i takimeve për një qasje më njohëse të Ekspozitës "Idromeno, Shkodra mbretëresha e arteve dhe artistët e Alpeve u përqëndruan në dy takime, përkatësisht: Me datë 30 prill 2025 takim e bisedë me Dr. Suzana Varvarica dhe Dr. Olsi Laska

Tema1: "Artistë të rëndësishëm shkodranë të Shek. XX kontribuan në formimin e fizionomisë së artit figurativ shqiptar."

Tema 2: "Zbulohen Veprat e Kolë Idromenos dhe Simon Rrotës përmes proceseve restauruese". Nga Olsi Laska

Me datë 06.05.2025 temat e bisedës:

1. "Artistët shkodranë në kërkimet e një pikturë moderniste" nga Fatmir Juka - Studiues arti dhe Drejtor i GA, Shkodër.

2. "Psikologjia shqiptare në artet pamore - historia e një projekti të shtrirë në 5 ekspozita" nga Ylli Drishti, historian e studiues arti.

3. "150 vite krijimtari, si shprehi figurative e zhvillimit të shkollës së artit në Shqipëri" nga Suzana Varvarica Kuka, studiuese dhe kuratore arti e projektit "Psikologjia shqiptare e artet pamore".

4. Çmimi Idromeno - Me datë 07.11.2025 u çel ekspozita Çmimit Idromeno konkurs i artit bashkohor për të rinj. 11 artistë të ftuar nga kuratori Sidi Kanani iu nënshtruan konkurrimit për çmimin IDROMENO për të rinj që jepet një herë në dy vjet.

Morën pjesë: Arlinda Dushaj –Mali i zi, Besa Mustafaj- Vlorë, Redina Qose- Fier, Elsaida Musiq –Shkodër, Elsamina Musiq- Shkodër, Xhulian Milla- Shkodër, Gerta Xhaferaj- Tiranë, Senad Xhexhovi –Shkodër, Naomi Spathari –Shkodër, Gjovalin Delia –Shkodër, Enza Rripaj –Shkodër. Juria përbëhej nga Klaudia Fagu, Tereza Çuni, Lek Gjelooshi.

Fituese u Shpall nga Juria Artistja Besa Mustafaj

Kurator ishte Sidi Kanani

Përcaktimi i kornizës së jashtme të Idromenos, si ngjarje e një natyre të veçantë të ekspozimit, e cila vazhdon të mbartë pritshmëri pozitive edhe pas kaq viteve, na jep në rastin e këtij edicioni një shtysë tjetër për ta analizuar atë në lidhje me auran e mbiemrit ikonik dhe mundësitë e trajtimit të

aspekteve të ndryshme shumëdimensionale të këtij emri kaq përcaktues - sado që përgjithësues e jo ngushtues - si vazhdim i analizës mbi mënyrën sesi formësohet identiteti, ai sipërfaqësor e zyrtar, dhe ai i vërtetë e shumë më i vështirë për t'u përcaktuar, por që në fund mbetet ai thelbësor (A i ikën, /shmanget thelbësorja përkufizimit, artikulimit?).

Vetë larmia e medimeve duket se respekton disi natyrën e shumëfishtë të artistit Idromeno.

Në një kohë kur, hapësira jonë, por jo vetëm, vuan akoma nga mungesa e një organizimi kritik të mirëfilltë, profesional e nga gjykime të peshuara me integritet, reflektimet që artistët pritët të sjellin, shërbejnë si një fije frymëzyese, të cilat me konsekuencë e ndershmëri mund të shndërrohen në një nxitje e cila t'u bashkohet të ngjashmeve për të përforcuar zonën e kompetencës, jo thjesht atë greenbergiane të pikturës, por të artit e hapësirës qytetare në çdo aspekt.

P.AF141.Q2.O3.A17 Orkestra Simfonike

Orkestra Simfonike e Qytetit të Shkodrës është një formacion simfonik i qëndrueshëm tashmë prej disa vitesh, i cili financohet nga Bashkia Shkodër.

Sipas marrëveshjes me Bashkinë Shkodër, ky formacion bën prova rregullisht rreth programit për aktivitete të ndryshme të cilat do të realizohen gjatë vitit 2025.

Më 7 qershor 2025, në sallën e Teatrit "Migjeni", u zhvillua koncerti i parë zyrtar i Orkestrës Simfonike të Shkodrës, një ngjarje e rëndësishme kulturore për qytetin dhe më gjerë. Ky debutim historik shënoi një etapë të re për jetën muzikore të Shkodrës, duke i dhënë qytetit një trupë artistike profesionale të përhershme në fushën e muzikës klasike.

Programi i koncertit ishte i ndërtuar me kujdes, duke përfshirë vepra të njohura të repertorit klasik evropian, të interpretuara nga muzikantë profesionistë nën drejtimin e dirigjentes Elda Laro, me pjesëmarrjen e artistëve të ftuar: dirigjenti Erio Daja, pianistja dhe dirigjentja Elda Laro dhe sopranoja Ana Naqe.

Koncerti u hap me Uverturën "Coriolan", op. 62 të Ludwig van Beethoven, një vepër dramatike dhe e ngarkuar emocionalisht që vendosi tonin solemn të mbrëmjes, dirigjuar me ndjeshmëri dhe saktësi nga Elda Laro.

Pasoi një moment brilant pianistik me interpretimin nga vetë Elda Laro të veprës "Andante spianato et Grande Polonaise brillante", op. 22 të Frédéric Chopin, një vepër që kërkon mjeshtëri të lartë teknike dhe elegancë të rrallë. Dirigjenti Erio Daja udhëhoqi orkestrën me ekuilibër dhe delikatesë, duke krijuar një harmoni të përsosur me solisten.

Pas pushimit, pjesa e dytë e koncertit solli dy perla të repertorit operistik të Giuseppe Verdit, të interpretuara nga sopranoja Ana Naqe, e cila shkëlqeu në skenën e "Aida"-s me "Ritorna vincitor!", dhe më pas në skenën dramatike nga "Macbeth", me "Nel dì della vittoria... Vieni! t'affretta!". Emocioni dhe fuqia e saj vokale u duartrokitën gjatë nga publiku.

Mbrëmja përfundoi me dy vepra të rëndësishme të muzikës orkestrale të Evropës Qendrore. Fillimisht, "Vltava" (Moldau), poema simfonike e Bedřich Smetana, solli përmes tingujve rrjedhën e një lumi të madh, me ngjyresa të pasura dhe peizazhe tingullore të gjalla, të interpretuara mjeshtërisht nën drejtimin e Elda Laros. Në përmbyllje, koncerti u mbyll me "Valle Sllave nr. 2" të Antonín Dvořák, një moment i ngrohtë, nostalgjik dhe fisnik, që la një ndjesi reflektimi dhe krenarie.

Ky koncert ishte një sukses i plotë artistik dhe organizativ, që tregoi nivelin e lartë të përgatitjes së Orkestrës Simfonike të Shkodrës, si dhe entuziazmin e publikut shkodran për muzikën klasike. Ai hapi një dritare të re për zhvillimin e jetës kulturore të qytetit dhe krijoi një traditë të re për skenën muzikore shqiptare.

Me datë 5.9.2025 Orkestra Simfonike e Shkodrës ishte pjesë e projektit “Koncert i Tenorit Saimir Pirgu”. Ky aktivitet u organizua nga Bashkia Shkodër dhe Fondacioni Arte me pjesëmarrjen e Orkestrës Simfonike, të drejtuar nga dirigjentja Elda Laro.

Ky koncert ishte i përmasave ndërkombëtare, një tjetër sukses për Orkestrën e Shkodrës.

28.12.2025 Orkestra Simfonike e Shkodrës ishte pjesë e projektit “Ndërmendje”. Ky koncert ishte një sukses i plotë artistik dhe organizativ, që tregoi nivelin e lartë të përgatitjes së Orkestrës Simfonike të Shkodrës, si dhe entuziazmin e publikut shkodran për muzikën klasike.

P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete në partneritet me të tretë

1. Shfaqja teatrale "7 Minuta" u zhvillua me datë 2 prill 2025, me autor Stefano Massini, trajton një temë aktuale dhe të ndjeshme mbi të drejtat e punëtorëve dhe ndikimin e vendimeve kolektive në mirëqenien sociale. Ngjarja zhvillohet brenda një fabrike ku një grup punëtorësh përballen me një dilemë të rëndësishme lidhur me një propozim të punëdhënësit për të reduktuar kohën e pushimit ditor me 7 minuta.

Debati i tyre shërben si një reflektim mbi drejtësinë, solidaritetin dhe efektet e politikave ekonomike mbi jetën e përditshme të punëtorëve.

Shfaqja synon të nxisë ndërgjegjësimin mbi çështjet sociale dhe të drejtat e punëtorëve, duke sjellë një debat të hapur mbi vendimmarrjen kolektive dhe efektet e saj në komunitet. Ajo thekson rëndësinë e dialogut dhe ndërgjegjësimin për të drejtat sociale në një shoqëri demokratike. Shfaqja u realizua nga disa prej emrave më të mëdhenj të skenës shqiptare si: Yllka Mujo, Luiza Xhuvani, Zamira Kita, Olta Daku, Anila Bisha, Rudina Dembacaj, Adelina Muça, Alesia Xhemalaj, Paola Kodra, Ajlin Petrela, Xhoana Karaj, të cilët sollën një interpretim të jashtëzakonshëm dhe mbresëlënës.

2. Me datë 18 prill 2025, në ambientet e Kinemasë Republika, u zhvillua aktiviteti përkujtimor me titull "Një ditëlindje pa Mirush Kabashin", organizuar në nderim të aktorit të madh shqiptar Mirush Kabashi. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin artistë të njohur, dashamirës të artit, familjarë të aktorit, studentë, pedagogë dhe përfaqësues të institucioneve kulturore, të cilët ndanë kujtime dhe emocione për një nga personalitetet më të shquara të skenës shqiptare. Programi përfshinte: Prezantim biografik dhe kronologji të jetës artistike të Mirush Kabashit; Recitime të poezive që ai kishte interpretuar me pasion gjatë jetës së tij; Shfaqje videosh dhe fragmente nga rolet më të spikatura në teatër dhe film; Fjalime përshëndetëse nga kolegë dhe miq të ngushtë të aktorit; Një ekspozitë simbolike me fotografi, citate dhe kujtime të tij.

3. Festivali Gegnisht - Shkodra asht Muza e shkrimtarëve më të mëdhenj të letërsisë shqiptare të djeshëm dhe të sotëm. Festivali Gegnisht, organizoi konkursin e krijuesve më të mirë në zhanrin e poezisë, prozës, esesë dhe përkthimit.

12 krijimet më të mira u interpretuan në një mbrëmje në oborrin e shtëpisë së atdhetarit, profesorit, shkrimtarit, përkthyesit, publicistit Sami Repishti, me datë 24 Maj ora 19.00, përmes muzikës së përzgjedhur klasike të huaj dhe shqiptare u interpretuan nga kuatreti i harqeve, instrumentistë të orkestrës së Teatrit të Operas dhe Baletit.

Violinë Elton Tola:

Violinë Romin Tadau;

Violë Xhanina Çela

Violonçelist Mario Guralumi;

Pesë çmimet më të arrirat u vlerësuan nga juria e përbërë:

-shkrimtari dhe përkthyesi z.Primo Shllaku - Republika e Shqipërisë;

-shkrimtarja dhe përkthyesja, Znj. Mimoza Hysa;

-poetja dhe diplomate e kulturës znj. Vlora Ademi nga Republika e Kosovës;

-publicisti dhe gazetari z. Lulzim Haziri nga Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe përkthyesi e prozatori Z. Meritan Spahia nga Republika e Shqipërisë.

Ky Festival Ndërkombëtar shpalli:

-Çmimin “Ndre Mjeda” për poezinë më të mirë;

-Çmimin “Gjon Shllaku” për përkthimin më të mirë;

-Çmimin “Ernest Koliqi” për prozën më të mirë;

-Çmimin “Arshi Pipa” për esenë më të mirë;

-Çmimin "Sami Repishti".

4. Moto Fest Shkodra 2025 u organizua në datat 22-23-24 maj 2025.

Në datat 22-24 maj, Bashkia Shkodër organizoi me sukses aktivitetin treditor “Moto Fest Shkodra”, një ngjarje e veçantë që bashkoi pasionin për motorrët, kulturën, turizmin dhe argëtimin në një atmosferë festive në zemër të qytetit.

Dita e Parë – 22 Maj

Aktiviteti nisi me hapjen zyrtare të ekspozitës së motorëve përpara Bashkisë Shkodër, ku morën pjesë dhjetëra moto-klube nga Shqipëria dhe vendet fqinje. Sheshi përpara Bashkisë u kthye në një hapësirë ekspozimi, duke tërhequr vëmendjen e qytetarëve dhe vizitorëve. Mbrëmja u kurorëzua me një koncert festiv në orën 20:00, ku performuan emra të njohur të muzikës shqiptare si Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli dhe Saviana Vjerdha. Atmosfera u gjallërua më tej nga ritmet moderne të muzikës DJ, duke krijuar një ambient festiv dhe familjar.

Dita e Dytë – 23 Maj

Ekspozita vijoi gjatë gjithë ditës në të njëjtin ambient përpara Bashkisë. Në orën 21:00, skena u ndez nga performanca energjike e grupit Three Dots, e ndjekur nga DJ që mbajtën ritmin e lartë deri në orët e vona të natës. Sheshi u mbush me të rinj dhe dashamirës të muzikës live, duke e shndërruar qytetin në një qendër dinamike kulturore dhe rinore.

Dita e Tretë – 24 Maj

Përveç ekspozitës, dita e tretë solli një dimension më të gjerë turistik dhe kulturor. Në orën 11:00, u organizua një guidë në vendet simbolike të Shkodrës: Kalaja e Rozafës, Ura e Mesit dhe zona piktoreske e Shirokës. Në orën 18:00, qyteti u pushtua nga parada e motorëve, një spektakël që tërhoqi vëmendjen e banorëve dhe vizitorëve me kolona të gjata motoristësh që përshkruan rrugët kryesore të qytetit.

Kulmi i mbrëmjes ishte koncerti madhështor në orën 20:30, ku legjendat e muzikës rock Elita 5 ndezën skenën dhe emocionuan publikun me performancën e tyre unike. Festa u mbyll me muzikë DJ në shesh, duke lënë pas një kujtim të paharruar për të gjithë pjesëmarrësit.

Ky aktivitet jo vetëm që promovoi pasionin për motorrët dhe kulturën urbane, por kontribuoi edhe në gjallërimin e jetës sociale, kulturore dhe turistike të Shkodrës. Bashkia Shkodër tregoi edhe një herë se është një qendër mikpritëse për ngjarje me përmasa kombëtare e ndërkombëtare, duke e vendosur qytetin në hartën e destinacioneve atraktive për aktivitete të këtij lloji.

“Shkodra Art Residence”- Aty ku arti kthehet në identitet” është një projekt artistik ndërkombëtar që u zhvillua në qytetin e Shkodrës nga data 25 deri më 31 maj 2025. Ky projekt synoi të krijojë një hapësirë bashkëpunimi dhe zhvillimi për artistë profesionistë nga fusha të ndryshme të artit, duke përfshirë artin figurativ, artin skenik dhe muzikën.

Objektivat e Projektit ishin promovimi i shkodrës si qendër arti dhe kulture përmes aktiviteteve të ndryshme artistike, duke vendosur Shkodrën në hartën ndërkombëtare të artit bashkëkohor.

Nxjtja e bashkëpunimit ndërkulturore duke sjellë së bashku artistë nga Shqipëria dhe vende të tjera, duke krijuar një platformë për shkëmbim përvojash dhe krijimtari të përbashkët.

Gjatë shtatë ditëve të residencës, artistët morën pjesë në një sërë aktiviteteve, duke përfshirë: Performanca dhe shfaqje skenike, Ekspozita të artit figurative, Punëtori dhe seminare.

“Zbulo rrënjët tuaja” – Në kuadër të Turneut Veror 2025 me moton “Discover Your Path” - “Zbulo rrënjët e tua”, Orkestra Rinore e Ballkanit Perëndimor realizoi fazën përgatitore dhe koncertet hapëse të turit ndërkombëtar në qytetin e Shkodrës, Shqipëri.

Orkestra përbëhej nga muzikantë të rinj profesionistë të moshës 15 deri në 27 vjeç, të cilët këtë vit ishin nga 15 kombe të ndryshme. Përveç përgatitjes së tyre muzikore, pjesëmarrësit sollën me vete përvoja dhe prejardhje të ndryshme kulturore e personale, gjë që e bëri këtë projekt një forum të veçantë për dialog dhe krijimtari të përbashkët artistike.

Faza përgatitore u zhvillua nga 24 korrik deri më 4 gusht 2025.

Provat e përditshme u zhvilluan në ambientet e stadiumit “Loro Boriçi” në Shkodër. Repertori muzikor u punua nën drejtimin e dirigjentit shkodran Desir Sulejmani, si dhe me bashkëpunimin e pedagogëve të nivelit të lartë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe Europa Perëndimore.

Koncerti i datës 2 gusht 2025 – Koncert Muzikë Dhome

Në mbrëmjen e datës 2 gusht u mbajt një koncert muzikor kamertal (muzikë dhome) me anëtarë të përzgjedhur të orkestrës.

Koncerti u zhvillua në Kishën e Motrave Stigmatine, duke sjellë një atmosferë intime dhe emocionale për publikun e pranishëm. Programi përfshinte pjesë të autorëve klasikë dhe modernë, të interpretuara në formacione të vogla, që theksuan individualitetin artistik të pjesëmarrësve dhe bashkëpunimin e tyre muzikor.

Koncerti i datës 4 gusht 2025 – Koncert Orkestral

Përmbyllja e fazës përgatitore u kurorëzua me një koncert madhështor të hapur për publikun, i cili u zhvillua në sheshin para Bashkisë Shkodër, më 4 gusht 2025, ora 21:00. Koncerti u prit me entuziazëm nga publiku vendas dhe vizitorët, duke sjellë një përvojë unike kulturore dhe artistike për qytetin.

“Festivali i Muzikës Moderne”- Në datat 23-26 Korrik.

23 Korrik - Nata e parë e edicionit të 8 të Festivalit të Muzikës Moderne u zhvillua në një atmosferë të jashtëzakonshme përpara Teatrit "Migjeni" në Shkodër. Sheshi u kthye në një skenë të hapur artistike, ku u bashkuan tingujt modernë të jazz-it, muzikës bashkëkohore dhe motiveve shqiptare,

me pjesëmarrjen e artistëve nga Shqipëria, Italia. Skena ishte konceptuar dhe ndriçuar sipas standardeve bashkohore, me sisteme profesionale zërimi dhe ndriçimi, duke ofruar një eksperiencë akustike dhe vizuale të veçantë për publikun. Koncerti u realizua në bashkëpunim me formacionin Big Band Shkodra, nën drejtimin e koncertmaestrit Markelian Kapidani dhe në drejtim artistik nga Gjon Shllaku.

24 Korrik - Nata e dytë e Festivalit të Muzikës Moderne u zhvillua në një ambient sakral dhe akustikisht të përsosur: Kisha Katolike "Zemra e Krishtit" në Tiranë. Artistët nga Shkodra dhe muzikantët e huaj performuan pjesë të përzgjedhura që shkonin në harmoni me ambientin, duke sjellë emocione të thella për të pranishmit. Repertori përfshinte pjesë moderne të përpunuara me nuanca klasike dhe jazz. Pjesëmarrja e publikut ishte dinjitoze, me një audiencë të përqendruar dhe mirëpritëse, që vlerësoi cilësinë dhe nivelin e lartë interpretues të mbrëmjes.

25 Korrik- Mbrëmja e tretë e Festivalit solli një natë në ambientet e ODA-s në lagjen karakteristike të Gjuhadol-it. Ky koncert ishte konceptuar si një takim më i ngushtë me publikun, në një hapësirë që nxit komunikimin e drejtpërdrejtë artist – dëgjues.

Repertori përfshinte krijime më eksperimentale dhe improvizime jazz të interpretuara me shumë finesë nga formacioni ndërkombëtar. Ndriçimi i ngrohtë dhe ambienti artistik i ODA-s e kthyen këtë natë në një nga më të veçantat e festivalit.

Audienca përbëhej kryesisht nga të rinj, turistë artistë lokal dhe artdashës.

26 Korrik- Nata e katërt dhe mbyllëse e Festivalit të Muzikës Moderne u zhvillua në një nga pikat më të frekuentuara të Shkodrës, kryqëzimi mes dy rrugëve më karakteristike të qytetit si Pedonalja “Kol Idromeno” dhe “Gjuhadoli”. Në këtë shesh pedonale, përballë qytetarëve dhe turistëve të shumtë, u mbajt një mbrëmje madhështore finale. Skena ishte e hapur dhe e vendosur në qendër të vëmendjes, me një teknikë të lartë zërimi dhe ndriçimi. Interpretimet finale përfshinë pjesë të përbashkëta nga të gjithë artistët, një lloj përmbledhjeje emocionale të katër netëve të festivalit. Përmbyllja u shënuar me një reagim të jashtëzakonshëm nga publiku që qëndroi deri në fund, duke e kthyer këtë mbrëmje në një festë të vërtetë të muzikës moderne.

Interpretuan gjatë netëve të festivalit

- Fabrizio Scrivano
- Federico Negri
- Emiliano Paterlini
- Mario Careddu
- Pietro Vecchi
- Stefano Aldrovandi
- Markelian Kapidani
- Jetmir Mesi
- Big Band Shkodra
- Daniel Prendi
- Esmerald Cekaj
- Kristian Gajtani

Solistë:

- Rezarta Smaja
- Laorjan Ejlli
- Margerita Shllaku
- Viki Haxhi
- Saviana Vjerdha
- Eugjen Marku
- Ademir Fresku
- Leticia Gargjola
- Domeniko Jakova
- Lidia Gjyshja
- Silvan Frangaj

Moderatorët e festivalit ishin: Ketlin Pjalmi dhe Erlinda Kavaja, të cilat udhëhoqën me finesë dhe prezantim profesional.

Idromeno-Kostumografi – Projekti i realizuar përbën një përpjekje të rëndësishme për dokumentimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Shkodrës në aspektin e turizmit kulturor, duke përqendruar vëmendjen në vlerat e kostumeve tradicionale përmes interpretimit artistik të Kolë Idromenos, një nga figurat më të shquara të artit dhe etnografisë shqiptare. Ky botim i ka dhënë zë një dimension jetik të trashëgimisë kombëtare — kostumografisë, duke e trajtuar atë jo thjesht si një aspekt estetik, por si një dokument historik, social dhe kulturor, të përçuar në mënyrë të rrallë dhe autentike përmes vizatimeve dhe pikturave të Idromenos.

Idromeno International Film Festival – 11-18 Tetor - Idromeno International Film Festival u organizua me synimin për të promovuar artin filmik bashkëkohor, për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e kinemasë dhe për të krijuar një hapësirë dialogu ndërmjet kineartistëve të rinj dhe profesionistëve të fushës. Festivali synon të shndërrohet në një pikë referimi për zhvillimin e industrisë së filmit në Shqipëri dhe rajon, duke mbajtur gjallë frymën artistike të qytetit të Shkodrës si qendër e kulturës dhe artit. Festivali u zhvillua përgjatë 6 ditëve me një program të pasur artistik dhe profesional, i ndarë në disa kategori: a) Masterclass-e dhe diskutime profesionale- Në kuadër të programit “Idromeno Industrial Masterclass”, u organizuan leksione dhe panele me tema që trajtonin historinë e kinemasë, dokumentacionin dhe propagandën në film, ekonominë e industrisë kinematografike, si dhe vizionin për zhvillimin e një kinemaje ndërkombëtare në Shqipëri. Ndër të ftuarit kryesorë ishin Edon Qesari, Blendi Salaj, Rina Plaku dhe Rezart Prifti, të cilët ndanë përvoja dhe analiza të vlefshme me pjesëmarrësit.

b) Shfaqjet filmike- Në sallat “Xhubleta Room” dhe “Rozafati Room” u shfaqën filma nga vende të ndryshme të botës, të ndarë sipas kategorive: Student Screening: Filma të shkurtër nga studentë dhe regjisorë të rinj (nga Libani, India, Franca, Republika Çeke, Iraku, Portugalia, Shqipëria etj.). Short Screening: Përzgjedhje filmash të shkurtër nga Evropa, Azia, Amerika Latine dhe Afrika. Feature Screening: Filma artistikë me metrazh të gjatë nga vende si Meksika, Hungaria, Suedia dhe Polonia. Animation Screening: Filma të animuar nga Irani, Filipinet, SHBA dhe Franca. Në total u shfaqën mbi 70 filma të përzgjedhur nga mbi 25 vende të ndryshme, duke dëshmuar karakterin ndërkombëtar të festivalit.

c) Afterparty & aktivitete shoqëruese - Çdo mbrëmje u organizuan Afterparty tematike në ambientet e “Delja e Zezë”, ku pjesëmarrësit, regjisorët dhe mysafirët patën mundësi të shkëmbenin ide, eksperiencë dhe të ndërtonin bashkëpunime të reja artistike.

d) Ceremonia e mbylljes - Më 18 Tetor 2025, në mbrëmjen përmbyllëse u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve dhe përmbyllja zyrtare e festivalit, me pjesëmarrjen e artistëve, përfaqësuesve institucionalë dhe mediave lokale.

Tefta Tashko Koço – Kënga ime ndaj nat’herë - Në Teatrin “Migjeni” të Shkodrës, u zhvillua një mbrëmje artistike e veçantë me titull “Kënga ime ndaj nat’ herë”, e dedikuar kujtimit të sopranos së shquar shqiptare Tefta Tashko-Koço. Ky aktivitet u konceptua si një podcast skenik nga gazetarja dhe autorja Balina Bodinaku, me qëllim për të sjellë në mënyrë artistike e bashkëkohore figurën, zërin dhe trashëgiminë muzikore të artistes që la gjurmë të pashlyeshme në kulturën kombëtare. Në këtë mbrëmje përkujtimore u prezantua jeta dhe veprimtaria e pasur artistike e Tefta Tashko-Koços, sopranoja që ndërthurte mjeshtërisht stilin klasik evropian me këngën qytetare shqiptare. Përmes interpretimesh muzikore, recitimeve dhe një materiali dokumentar, publiku pati mundësinë të njihnte më nga afër personalitetin dhe vlerën e jashtëzakonshme që ajo mbart në historinë e muzikës sonë.

Në skenë u ngjiten artistët: Renisa Laçka, soprano; Denis Skura, tenor; Merita Rexha Tërshana, në piano

Interpretimet e tyre sollën një atmosferë të ndjeshme e plot elegancë, duke risjellë në kujtesë bukurinë e zërit dhe finesën artistike që karakterizonte Tefta Tashko-Koçon. Aktiviteti u mirëprit me interes nga publiku shkodran dhe u mbështet nga Bashkia Shkodër, Teatri “Migjeni”.

“15 Ditë Prilli” (shfaqja teatrale) solli në skenë një histori të thellë njerëzore që zhvillohet në periudhën e komunizmit, një kohë e mbushur me dhimbje, sakrifica dhe fate të ndërprera. Përmes rrëfimit të ndjeshëm dhe ironik, autorja Anisa Markarian ndërthur fatet e disa personazheve që përballen me pasojat e një sistemi të pamëshirshëm, ku idealet shpesh përplasen me realitetin dhe ku historia, siç thuhet në vetë shfaqjen, “herën e parë vjen si tragjedi, herën e dytë përsëritet si parodi”.

Në qendër qëndron përballja mes kujtesës dhe harresës, mes të kaluarës së errët dhe përpjekjes për të kuptuar arsyet që çuan njerëzit drejt dënimit, tradhtisë apo heroizmit. Ngjarjet zhvillohen në një atmosferë të ngarkuar emocionalisht, ku çdo ditë e prillit bëhet simbol i pritjes, dhimbjes dhe rikthimit të shpresës. Regjisorja Driada Dervishi ka ndërtuar një shfaqje me ritëm të matur dhe me ndjeshmëri të veçantë njerëzore. Ajo ka arritur të ruajë balancën midis dramës dhe ironisë, duke i dhënë veprës një ton realist, por edhe reflektues. Përdorimi i ndriçimit, lëvizjes skenike dhe pauzave dramatike e bëjnë veprën të mbajë publikun të përfshirë gjatë gjithë kohës.

Në skenë spikasin interpretimet e një trupe të përzgjedhur aktorësh, të cilët me mjeshtëri sjellin karaktere të gjalla dhe shumëdimensionale: Yllka Mujo, Hervin Çuli, Alesia Xhemalaj, Romir Zalla, Suela Bako, Mimoza Marjanaku, Amos Zaharia, Adelina Muça, Sanije Hoti, Xhuliano Brisku, Aleksandër Seitaj, Jaho Guma. Çdo aktor jep një kontribut të veçantë në krijimin e atmosferës dramatike, duke përcjellë emocion, forcë dhe reflektim të sinqertë.

Antologji Poetike “Pena e Shkodrës”- Projekti i botimit të vëllimit antologjik “Pena e Shkodrës” përbën finalizimin e një pune të gjatë dhe të qëndrueshme të shoqërisë letrare Pena e Shkodrës, e cila këtë vit shënon dhjetëvjetorin e themelimit të saj.

Që prej vitit 2015, kjo shoqëri ka botuar rregullisht numra voluminozë që kanë krijuar një hapësirë të rëndësishme për krijimtarinë bashkëkohore në poezi, prozë, dramë, studime letrare dhe përkthime nga letërsia botërore.

Ky vëllim i dhjetë përfaqëson kurorëzimin e kolanës, duke përmbledhur integritetin, seriozitetin dhe vlerat artistike të punës së zhvilluar përgjatë një dekade. Në faqet e tij pasqyrohet krijimtaria e autorëve shkodranë dhe mbarëshqiptarë, duke e kthyer këtë botim në një galeri të pasur poetësh, tregimtarësh, studiuesish e përkthyesish.

Një element i rëndësishëm i këtij botimi është se projekti është mbështetur financiarisht dhe institucionalisht nga Bashkia Shkodër, si pjesë e angazhimit të saj për promovimin dhe fuqizimin e kulturës shkodrane, si dhe të krijimtarisë bashkëkohore shqiptare. Ky bashkëpunim tregon përkushtimin e institucionit në ruajtjen dhe zhvillimin e traditës letrare të qytetit, duke e ndihmuar këtë kolanë të arrijë cilësinë dhe shtrirjen që gëzon sot.

Vlerat e botimit “Pena e Shkodrës” qëndrojnë në: Larminë e autorëve, të përzgjedhur nga breza të ndryshëm; Cilësinë e krijimtarisë, që pasqyron nivelin bashkëkohor të shkrimit shqip; Publikimin e materialeve të reja, të botuara për herë të parë në këtë antologji; Përfaqësimin e letërsisë së tre dekadave të para të shekullit XXI, duke ndikuar në dokumentimin dhe studimin e saj.

Ky botim shërben si një kontribut i çmuar kulturor, duke forcuar profilin letrar të Shkodrës dhe duke i dhënë vazhdimësi traditës së shkrimit dhe mendimit letrar të qytetit.

Festival Burimor Treva - është një aktivitet kulturor me karakter të përvitshëm, i cili ka si qëllim kryesor ruajtjen, promovimin dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore jomateriale shqiptare, në veçanti këngën, muzikën dhe vallen burimore. Ky festival synon të evidentojë vlerat autentike të folklorit shqiptar dhe të krijojë një hapësirë bashkëpunimi mes artistëve të zonave të ndryshme. Programi artistik u karakterizua nga larmia e repertorit folklorik, ku u ndërthurën elementë të muzikës burimore me interpretimin skenik bashkëkohor, duke ruajtur autenticitetin dhe frymën tradicionale të festivalit. Interpretimet u shoqëruan me instrumente tradicionale, duke sjellë tingujt karakteristikë të muzikës burimore shqiptare dhe duke pasqyruar pasurinë e trashëgimisë sonë muzikore. Në festival morën pjesë edhe grupe valltarësh, të cilët interpretuan valle tradicionale me kostume karakteristike, duke pasqyruar identitetin kulturor të trevave shqiptare dhe duke sjellë gjallëri në skenë. Një pjesë shumë e rëndësishme e programit ishte edhe segmenti humoristik, i cili kontribuoi ndjeshëm në krijimin e një atmosfere të ngrohtë dhe argëtuese për publikun, e cila u realizua nga: Gac Kodrina dhe Grupet e baletit SH.A.K. “Besa Dinoshë” – Tuz.

Pjesëmarrës në festival:

Këngëtarë dhe instrumentistë:

- Gofle Pappleka
- Ndue Shytani
- Fran Kodra
- Elvira Firza
- Gjovalin Shani
- Zef Bega
- Nexhmije Bytyçi
- Gjolesh Hajdari
- Mirjeta Çelaj
- Rolana Çukaj

Ne sot 60+ - Më datat 19 dhe 20 nëntor, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me shoqatën Think Creative Idea, organizuan aktivitetin kulturor-garues “NE SOT 60+”, një kompeticion i dedikuar posaçërisht për artistët e moshës mbi 60 vjeç.

Ky event synoi të vlerësojë kontributin e tyre shumëvjeçar, duke u krijuar një hapësirë të denjë ku talenti dhe pasioni artistik të vihen në qendër të vëmendjes.

Promovimi dhe vlerësimi i artistëve 60+ që vazhdojnë të mbeten aktivë në muzikë e art.

Krijimi i një atmosfere festive dhe garuese, ku secili artist të ketë mundësi të prezantojë potencialin e tij.

Respektimi i trashëgimisë kulturore shkodrane përmes rikthimit në skenë të figurave të rëndësishme të komunitetit artistik.

Eventi u zhvillua në ambientet e ngrohta dhe mikpritëse të n’Odë – Gjuhadol, ku u krijua një atmosferë fantastike dhe shumë tërheqëse që nga momenti i hapjes. Artistët konkurrentë u prezantuan publikut me këngë, instrumentale dhe interpretime artistike që u pritën me duartrokitje të zjarra.

Garuesit u vlerësuan sipas interpretimit, stilit dhe mjeshtërisë së tyre artistike. Pavarësisht moshës, energjia e tyre në skenë dëshmoi se arti është i përjetshëm.

Pas mbylljes së pjesës garuese, u zhvillua një moment i veçantë dhe shumë i çmuar për publikun: artistët e rinj të qytetit u bashkuan me konkurrentët 60+, duke krijuar një performancë të përbashkët plot gjallëri, muzikë dhe emocione.

Ky ndërveprim mes brezave solli një atmosferë të mrekullueshme dhe të gëzueshme, ku publiku këndoi e u argëtua së bashku me artistët. Ishte një moment kulmor që tregoi fuqinë unifikuese të artit dhe respektin e të rinjve për artistët e brezit të artë.

Rruga e artistëve - Ky aktivitet shërbeu si një formë homazhi për artistët Shkodranë ndër vite, sidomos për ata që nuk jetojnë më, duke i përkujtuar nëpërmjet intervistave, arkivave filmike, materialeve fotografike dhe performancave të ideuara posaçërisht për këte natë.

Disa nga emrat e përzgjedhur për të cilët u realizua dhe reportazhet ishin : Bik Ndoja, Lec Bushati, Rikard Ljarja, Palok Kurti, Kol Idromeno, Ismail Lulani, Kujtim Alija, Shyqyri Alushi, Naile Hoxha, Fitnete Rexha, Fadil Kraja, Bardh Smaja, Zef Deda, Paulin Shtjefni, Agim Molla etj.

Aktiviteti u realizua me regjisore znj.Ketrin Gjoça, Skenar Znj.Vasilika Londo, Drejtor fotografie Z.Shkëlzen Sinani, Post Produksion Z.Ergys Bamçi dhe Drejtore artistike Znj.Alma Hoti.

Disa nga bashkëpunëtorët e këtij projekti ishin disa emra me vlerë dhe dinjitet artistik e njerëzor që i kanë dhënë dhe vazhdojnë t’i japin Shkodrës si: Zef Çoba, Roland Guli, Andi Hila, Rozafa Shpuza, Luçjan Bedeni, Amila Gjyrezi, Entela Troshani Sula, Renato Kodheli dhe Mark Ujka.

Kjo mbrëmje siç është cituar dhe në raportin narrativ të Qendra Social Kulturore “Edukojmë me Art”, është një reportazh artistik dhe historik për artistët e talentuar dhe të paharruar Shkodranë.

Festa e Muzikës - Më datë 22 nëntor 2025, në Teatrin “Migjeni” u zhvillua koncerti me tematikë franceze “Voyage”, një aktivitet i nivelit të lartë artistik që mbledhi në një skenë emra të mirënjohur të muzikës shqiptare dhe solli një repertor të zgjedhur të muzikës klasike dhe moderne

franceze. Koncerti u mbështet nga Bashkia Shkodër, duke vijuar angazhimin institucional për promovimin e vlerave kulturore dhe artistike në qytet.

Në këtë mbrëmje të veçantë, Inva Mula, zë i njohur ndërkombëtarisht, së bashku me pianistin e kompozitorin Genc Tukiçi, të shoqëruar nga Orkestra Simfonike e Shkodrës dhe Kori Polifonik “Prenkë Jakova” i drejtuar nga Gjon Shllaku, sollën një program të kuruar me kujdes dhe të ndërtuar mbi motive franceze.

Nën drejtimin e Elda Laros, orkestrës iu bashkua edhe sopranoja e re Isabel Porro, e cila në një pikë të koncertit performoi krah Inva Mulës, duke krijuar një ndërthurje të këndshme brezash dhe ngjyrash vokale.

Programi i mbrëmjes përfshinte një seri krijimesh të njohura franceze, të cilat sollën në skenë aromën, finesën dhe ngjyrimet e muzikës së Francës.

Ndërkohë, krahas repertorit francez, programi solli edhe një ndërthurje delikate me muzikën shqiptare: “Këngë Shkodrane”, e interpretuar nga Inva Mula, Genc Tukiçi dhe Elda Laro, një moment që riktheu në sallë ritmin, hijeshinë dhe shpirtin karakteristik të traditës së qytetit si “Për mu paska ken kismet”, “Ta Dish” etj.

Interpretimet e Inva Mulës u veçuan për teknikën brilante dhe emocionin e thellë; Genc Tukiçi spikati në interpretimin pianistik dhe në drejtimin muzikor të veprave të tij; ndërsa Isabel Porro solli një freski të dukshme vokale në bashkëpunimin me artistët e mëdhenj. Forca dhe harmonitë e Korit Polifonik shtuan dimensionin solemn të koncertit, duke e kompletuar mbrëmjen në mënyrë të përsosur.

Njerëzorja-Hyjnore - Në ambientet e Teatrit “Migjeni” në Shkodër, u zhvillua aktiviteti artistik-kulturor me titull “Njerëzorja - Hyjnore”, një shfaqje e ndërë dhe thellësisht emocionale, kushtuar figurës së shenjtë të Nënë Terezës, simbolit botëror të dashurisë, mëshirës dhe humanizmit.

Në qendër të kësaj vepre ishte interpretimi i artistes Justina Aliaj, e cila solli në skenë me ndjeshmëri të rrallë shpirtin, përkushtimin dhe madhështinë njerëzore të Nënë Terezës, duke krijuar një lidhje të fortë emocionale me publikun. Përmes fjalës, heshtjes, lutjes dhe gjestit skenik, shfaqja përcolli mesazhe të fuqishme mbi dashurinë për tjetrin, sakrificën dhe besimin.

Shfaqja u realizua nën regjinë e Gëzim Kamës, me tekst nga Bashkim Kozeli dhe Justina Aliaj, ndërsa muzika dhe interpretimi në violonçel nga Rubin Kodheli i dhanë veprës një dimension të veçantë shpirtëror. Ky aktivitet u shndërrua jo vetëm në një ngjarje artistike, por edhe në një moment reflektimi mbi vlerat universale që Nënë Tereza i la trashëgim njerëzimit, duke na kujtuar se dashuria dhe mirësia janë forcat më të mëdha që mund të ndryshojnë botën.

Në përmbyllje të kësaj shfaqje të veçantë, le të kujtojmë fjalët e saj të pavdekshme:

“Jo të gjithë mund të bëjmë gjëra të mëdha, por mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe.”

P.AF141.Q2.O3.A19 Honorare Këshilli Artistik i Bashkisë Shkodër e të trashëguara

Drejtorja e Kulturës dhe Sportit, pranë Bashkisë planifikon dhe organizon aktivitete kulturore, artistike e sportive në bashkëpunim me institucionet e varësisë dhe me partnerë jashtë institucionit të Bashkisë. Në mënyrë që përzgjedhja e mësipërme të jetë transparente dhe në përputhje me standartet ligjore të kërkuara, është ngritur dhe funksionon Këshilli Artistiko-Kulturor i Bashkisë

Shkodër për të përzgjedhur të gjithë subjektet që do të realizojnë aktivitetet artistiko-kulturore të kalendarit kulturor, të shpallura nga Bashkia Shkodër

Këshilli Artistik i Bashkisë Shkodër ka realizuar mbledhje:

Me datë 30.01.2025 është zhvilluar mbledhja në të cilën janë marrë vendimet për shpalljen e fituesve të projekteve si: Karnevalet; Projektet për Teatrin “Migjeni”; Aktivitetet në partneritet me të tretë; Festivali i Shahut “Çesk Jubani”.

Me datë 17.03.2025 është zhvilluar mbledhja në të cilën janë marrë vendimet për shpalljen e fituesve të projekteve si: Dita e Luleve; Festivale Audiovizuale; Aktivitetet në partneritet me të tretë; Turneu Ndërkombëtar i futbollit për veteranë; Mbështetje për ekipet Vllaznia;

Me datë 14.05.2025 është zhvilluar mbledhja në të cilën janë marrë vendimet për shpalljen e fituesve të projekteve si: Koncert Ndërkombëtar; Koncert Recital; Koncertet e Verës; Festival Jazz-I; Festa e Trashëgimisë Kulturore; Aktivitetet në partneritet me të tretë; Maratona e Shkodrës/Kupa e ikonave; Kampionati Kombëtar i Gjimnastikës; Kampionati Kombëtar i Ping Pongut; Turneu Ndërkombëtar në boks Fist of Fire; 3*3 Shkodra; Memorial Vllaznia 2025. Për drejtorinë e Turizmit: Festa e Liqenit; Valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonave turistike përmes aktiviteteve promovuese.

Me datë 31.07.2025 është zhvilluar mbledhja në të cilën janë marrë vendimet për shpalljen e fituesve të fishprojektit “Aktivitete në partneritet me të tretë”- projektet: Tefta Tashko Koço – Kënga ime ndaj nat’herë dhe Idromeno International Film Festival. Drejtoria e Sportit dy projekte: “Triathlon”, dhe “Trofeu Gilman Bakalli Mtb Xc”, ndërsa për projektin “Beach Soccer” nuk kishte aplikime. Drejtoria e Turizmit dy projekte: “Itineraret e Shijes/Promovimi i Slow Food” dhe “Shkodra, histori dhe magji në çdo hap – promovim në lëvizje”.

Me datë 17.09.2025 është zhvilluar mbledhja në të cilën janë marrë vendimet për shpalljen e fituesve të fishprojektit “Aktivitete në partneritet me të tretë”- projektet: “Ne sot 60+”, Festival Burimor “Treva”, Antologjia Poetike “Pena e Shkodrës”, 15 ditë Prilli, Opera Legjendë Rozafa. Teatri Migjeni: Borëbardha (premiere për fëmijë) dhe Miqtë e Pyllit (premierë për fëmijë); Drejtoria e Sportit: “Shkodra Open Air”; Drejtoria e Turizmit: “Java e mobilitetit” dhe “Lojra Popullore Fest”.

Mbledhja e fundit për vitin 2025 u bë me datë 29.10.2025 në të cilën janë marrë vendimet për shpalljen e fituesve të fishprojektit “Aktivitete në partneritet me të tretë”- projekte: Sofilms me projektin “Festa e Muzikës” dhe Qendra Social Kulturore “Edukojmë me art” me projektin “Rruga e Artistëve”. Për “Ndërmendje” u shpall fitues: Enid Bala (PF) (Developing Corner); Për “Shkodra N’fest” u shpall fitues: DoInAlbania; Për “Projektet Artistike të Teatrit Migjeni Premierë për fëmijë u shpall fitues: Anxhelo Shkreli (Person Fizik) – Projekti “Djali i detit”; Për “Shkodra Open Tennis” u shpall fitues: Shkodra Tennis Club

P.AF141.Q2.O3.A20 Shërbime fonie, skene dhe ndriçimi për aktivitetet e kulturës e të trashëguara Bashkia Shkodër zhvillon një seri eventesh dhe festivalesh të një rëndësie domethënëse për këtë qytet i cili pikërisht për tiparin e fortë artistik që e karakterizon, meriton të quhet: Djepi i kulturës. Prandaj është impenjuar të punojë në këtë drejtim, për ta justifikuar këtë titull dhe për të çuar më tej vlerat tona. E përqëndruar ky projekt përfshin realizimin: Ahengu

Shkodran, Koncert premierë i orkestrës frymore, Festivali “Luleborë”, 80 vjet Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” dhe shumë aktivitete të tjera.

Nisur nga kjo, Bashkia Shkodër kërkon që këto aktivitete të realizohen në nivelet më të larta profesionale, duke i dhënë rëndësinë e duhur të gjithë komponentëve si artistikë dhe teknik. Është lidhur kontrata me subjektin fitues.

P08220.Q1.O3.A26 Blerje pajisje fonie, ndriçimi dhe materiale skenike për Teatër Migjeni - TË TRASHËGUARA Nuk është realizuar.

P08220.Q1.O3.A37 Aktivitete artistike kulturore në mbështetje të grupeve rinore artistike - TË TRASHËGUARA Nuk është realizuar.

P08220.Q1.O3.A44 "Shkodra qyteti i festave" - TË TRASHËGUARA Nuk është realizuar.

P08220.Q1.O3.A12 Realizimi i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kulturës (Blerja e shtëpizave) Është likuiduar procedura.

P.AF141.Q2.O3.A21 Realizim i aktiviteve të Teatrit Migjeni e të trashëguara. Më datë 25 prill 2025, ora 19:00, në qytetin e Shkodrës u shfaq komedia teatrale “Kërkohet një Tenor” – një vepër klasike e dramaturgut amerikan Ken Ludwig – realizuar si bashkëpunim ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Teatrit Kombëtar. Ky bashkëpunim solli një prodhim skenik të nivelit të lartë, me një kast të përzgjedhur aktorësh dhe profesionistësh të fushës së teatrit, të cilët bënë të mundur një shfaqje dinamike dhe mjaft të mirëpritur nga publiku shkodran.

Në këtë shfaqje morën pjesë aktorët: Helidon Fino, Pjerin Vlasi, Genti Deçka, Ilirida Bejleri, Elia Zaharia, Flaura Kureta, Niada Saliasi, Fritz Selmani. Shfaqja u vu në skenë nga regjisori i njohur Armand Bora, i cili solli një lexim modern dhe plot ritëm të tekstit origjinal, duke përforcuar elementet komike dhe karakteret e theksuara që sjell vepra.

Ekipi realizues përfshinte gjithashtu:

Skenograf: Divni Gushta

Kostumografe: Laedia Hajdari

Përkthyes i veprës: Durim Taçi

Dizajn Grafik: Klea Mani

Asistent Regjisor: Astiano Shehaj

Shfaqja u karakterizua nga një ritëm i gjallë, ndërthurje e saktë e situatave komike dhe lojë aktoriale profesionale. Reagimi i publikut ishte jashtëzakonisht pozitiv, duke e pritur me të qeshura dhe duartrokitje të shumta gjatë gjithë shfaqjes.

Ky projekt është një shembull i suksesshëm i bashkëpunimit midis institucioneve kulturore lokale dhe atyre qendrore, dhe përforcon nevojën për vazhdimësinë e këtyre iniciativave që e pasurojnë jetën artistike në qytetet shqiptare.

2. Pjesë teatrale 1- “Kërkoj vrasës për nënën”, premierë në Teatrin Migjeni.

Në Teatrin “Migjeni” me datë 25 dhe 26 maj, u dha premiera e shfaqjes teatrale “Kërkoj Vrasës për Nënën”, me autor Ressel Lëts dhe përkthim nga Artur Lena.

Regjia e kësaj vepre u realizua me mjeshtëri nga Naser Shatrolli, duke sjellë në skenë një interpretim të fuqishëm dhe të ngarkuar emocionalisht.

Në këtë prodhim artistik morën pjesë aktorë të talentuar që dhanë një performancë të shkëlqyer: Ermal Sadiku, Jurgen Marku, Jozef Shiroka, Lusi Bregu, Ina Morina.

Asistent regjie: Astrit Fani

Skenografia: Naser Shatrolli & Divni Gushta

Muzika: Drinor Zymberi

Kostumografia: Flutura Dedinaj

Krijimi i posterit: Labinot Ibërdemaj

Dizajni vizual: Valdet Hajdari

Trileri: Dalmat Dobra

Figura dhe posterët: Amar Havziji

Fotografia: Rozafa Shpuza

Shfaqja trajton temat e marrëdhënieve familjare të dështuar, indiferencës dhe absurditetit në shoqëri. Në mënyrë satirike dhe shpesh groteske, tregon historinë e një djali që kërkon një vrasës për të vrarë nënën e tij, duke nxjerrë në pah degradimin moral dhe boshllëkun emocional të njerëzve në një botë moderne e të ftohtë.

Një histori që prek thellë dhe sfidon moralin.

Shfaqja u karakterizua nga një regji dinamike, ndriçim profesional dhe skenografi simbolike që përforcoi tematikën e rëndë të veprës. Mesazhi dramatik, dialogët e ngjeshur dhe loja bindëse e aktorëve e mbajtën publikun të përfshirë gjatë gjithë shfaqjes.

Kjo premierë përfaqëson një sukses të radhës për Teatrin “Migjeni” dhe një dëshmi për përkushtimin artistik të të gjithë stafit realizues.

Kjo shfaqje u dha në Teatrin Migjeni edhe në datat 2-3-4 qershor 2025.

3. Teatri “Migjeni” organizoi “Festivali Teatror i Shkollave të Mesme”, një aktivitet artistik që u zhvillua përgjatë datave 16–19 qershor 2025, me synimin për të promovuar krijimtarinë teatrale të të rinjve dhe për të nxitur shprehjen e lirë artistike ndërmjet gjimnazistëve të qytetit të Shkodrës. Festivali përfshiu pesë shfaqje teatrale, me pjesëmarrjen e disa prej shkollave të mesme aktive në jetën artistike të qytetit.

16 Qershor 2025

1. “Letër fëmijës së palindur kurrë” – Oriana Fallaci

Ora: 13:00

Shkolla: Gjimnazi “Shejnaze Juka”

Regjia: Nikolin Ferketa

Aktorë: Luciana Thana, Sara Hasanaj, Mateos Gilaj, Leonora Molla, Manuela Ndreaj, Olkida Lumi, Armena Brahimi, Regisa Milloa

Një interpretim emocional dhe introspektiv i veprës së njohur të Oriana Fallaci, që solli në skenë dilemat njerëzore dhe mesazhe të thella për jetën dhe ekzistencën.

2. “Swing Mood” – dramatizim me autorë të ndryshëm

Ora: 18:00

Shkolla: Gjimnazi “Oso Kuka”

Dramatizimi: Kristel Pjetri dhe nxënësit

Regjia: Vladimir Doda

Aktorë: Denis Dekovi, Iderisa Duhanxhi, Amar Fishta, Angjela Koja, Egli Lulaj, Marinela Mukuri, Arsi Peku, Kledia Pjolla

Pjesë të përzgjedhura nga autorë si K. Gibran, S. Benni, A. Baricco, C. Churchill, Pessoa, G. Leopardi, që u sollën në një formë moderne dhe konceptuale nga të rinjtë.

17 Qershor 2025

3. “Emigrantët” – Sławomir Mrożek

Ora: 18:00

Shkolla: Gjimnazi “Jordan Misja”

Regjia: Simon Shkreli

Aktorë: Ebis Artunda, Arbër Vata

Një dramë sociale që trajton tematikat e identitetit dhe mërgimit, interpretuar me intensitet dhe ndjeshmëri nga nxënësit aktorë.

18 Qershor 2025

4. “Të jetosh në dashuri” – T. A. Baylan

Ora: 18:00

Shkolla: Shkolla e Mesme “28 Nëntori”

Regjia: Rajmonda Marku

Aktorë: Ajsi Beqiri, Iris Hoxha, Arlind Shehu, Orgen Osja, Evra Efovija, Parid Kalaj, Julia Capa, Enes Balla, Enea Ymeri

Një shfaqje e ndjeshme që trajton temën e dashurisë dhe jetës përmes emocioneve të forta dhe interpretimit të sinqertë nga të rinjtë.

19 Qershor 2025

5. “Jo të gjithë hajdutët vijnë për keq” – Dario Fo

Ora: 18:00

Shkolla: Shkolla Artistike “Prenkë Jakova”

Regjia dhe adaptimi: Aleksandër Prenga

Aktorë: Gabriel Rraposhi, Ariana Mhillaj, Denis Fikaj, Gresilda Guri, Dorotea Larushku, Eldis Miruku

Një komedi plot ritëm, që solli përmes satirës realitete shoqërore me humor inteligjent dhe mjeshtëri skenike.

Juria e “Festivali Teatror i Shkollave të Mesme” ishte e përbërë nga : Zija Vukaj, Mirjam Bruçeti, Gëzim Puka dhe Krist Lleshi, të cilët vlerësuan me këto çmime këtë edicion:

“Shfaqja më e mirë” - Shkolla “Jordan Misja”.

Aktori më i mirë – Arbër Vata

Aktorja më e mirë – Ajsi Beqiri

Aktori më i mirë (Joprotagonist)- Amar Fishta dhe Orgen Osja

Aktorja më e mirë (Joprotagoniste)- Iderisa Duhanxhi.

4. Në skenën e Teatrit “Migjeni” u zhvillua premiera e shfaqjes “Kopshtet e pavarura të lumturisë”, me autor Albri Brahusha dhe regji të Hervin Çulit. Në themel të kësaj shfaqjeje qëndron penë e ndjeshme e autorit Albri Brahusha, i cili ka ditur të përziejë me mjeshtëri ironinë, reflektimin dhe emocionin njerëzor në një tekst që flet me gjuhën e sotme. Nëpërmjet dialogëve të mprehtë dhe situatave të papritura, Brahusha sjell një realitet që na bën të qeshim, por edhe të mendojmë thellë për mënyrën si po jetojmë.

Një tragjikomedi moderne, që shpalos me mjeshtëri absurdin e kohës sonë — një realitet ku gjithçka është e programuar: dashuria, gjumi, madje edhe ëndrrat. Në një botë të pushtuar nga teknologjia, shfaqja ngre pyetjen thelbësore: ku mbetet vendi i njeriut?

Regjia e Hervin Çulit solli një ritëm të qëndrueshëm, me kontraste të forta mes humorit të hidhur dhe momenteve të thella dramatike, duke e mbajtur publikun të përfshirë emocionalisht gjatë gjithë veprës.

Në rolet kryesore spikatën aktorët: Besmir Bitraku, Dajana Nenaj, Xhuliano Brisku dhe Fritz Selmani, të cilët me lojën e tyre të natyrshme dhe të fuqishme arritën të ndërtojnë karaktere të besueshme dhe të ngarkuara emocionalisht.

5. Miqtë e Pyllit - Më datë 15-16 nëntor, në skenën e Teatrit “Migjeni” u zhvillua shfaqja për fëmijë “Miqtë e Pyllit”, një prodhim i mbështetur nga Bashkia Shkodër dhe projekti Dimension Human, me tekst nga Dajana Nenaj dhe regji nga Nikolin Ferketa.

Shfaqja solli në skenë një histori të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun më të vogël, duke trajtuar tema të rëndësishme si miqësia, kujdesi ndaj natyrës dhe bashkëpunimi.

Shfaqja paraqiti botën magjike të pyllit përmes personazheve të interpretuar nga fëmijët, duke e sjellë tregimin me ngjyra, dialogë të lehtë dhe elementë muzikorë. Ideja kryesore ishte nxitja e dashurisë për mjedisin dhe ndërtimi i një raporti pozitiv ndërmjet fëmijëve dhe natyrës.

Shfaqja u ndoq nga një numër i konsiderueshëm fëmijësh të shkollave dhe kopshteve të qytetit, të shoqëruar nga mësues e prindër. Pjesëmarrja ishte tepër e mirë, auditor i mbushur dhe fëmijë mjaft të angazhuar gjatë gjithë shfaqjes.

Interpretuan: Marsel Pappleka, Kristela Lazri, Aleksandër Prenga, Evis Muriqi, të cilët sollën një performancë të gjallë e energjike. Ritmi i shfaqjes ishte i përshtatur me moshën e fëmijëve, me shumë ndërveprim dhe momente humorit. Fëmijët reagues me duartrokitje të shpeshta dhe u përfshinë emocionalisht në rrjedhën e tregimit.

6. Djali i detit - Në ambientet e Teatrit “Migjeni” në Shkodër, u vu në skenë shfaqja për fëmijë “Djali i Detit”, një histori magjike dhe plot fantazi, e cila solli për publikun e vogël një përzierje të veçantë emocionesh, duke bashkuar ngrohtësinë verore me atmosferën festive të dimrit.

Shfaqja u realizua nën regjinë e Anxhelo Shkrelit dhe u ndërtua si një rrëfim i ndjeshëm e njëkohësisht argëtues, ku fëmijët u udhëhoqën drejt botës së ëndrrave, miqësisë dhe besimit në magjinë e së mirës.

Elementët vizualë, kostumet dhe skenografia krijuan një hapësirë përrallore, ku figura simbolike e Babagjyshit dhe bota e detit ndërthuren në mënyrë origjinale.

Interpretimi i aktorëve Jozef Marashi, Amelja Krosaj, Klodiana Vata, Marsel Papplekaj, Denisa Luanaj dhe Marko Prendi u karakterizua nga energjia, loja e gjallë skenike dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me fëmijët, duke i bërë ata pjesë aktive të shfaqjes.

Publiku i vogël e ndoqi shfaqjen me entuziazëm, reagime spontane, buzëqeshje dhe duartrokitje të vazhdueshme. “Djali i Detit” përcolli mesazhe të qarta mbi mirësinë, shpresën, guximin dhe rëndësinë e ruajtjes së botës së imagjinatës tek fëmijët, veçanërisht në prag të festave të fundvitit. Shfaqja u shndërrua në një përvojë artistike edukuese dhe argëtuese, duke i ofruar fëmijëve jo vetëm gëzim, por edhe vlera pozitive njerëzore.

7. Aktiviteti “Shfaqje me humor dhe muzike”, i organizuar nga Teatri Migjeni është një shfaqje që mirëpritet nga spektatori. Humori dhe muzika janë dy nga simbolet e qytetit të Shkodrës. Kjo shfaqje bëri të mundur përfshirjen e aktorëve të rinj, të aktorëve të karrierës, të këngëtarëve më në zë, si dhe të orkestrës së Teatrit “Migjeni”. Në këtë shfaqje morën pjesë aktorët e humorit: Zyliha Miloti, Besnik Cinari, Drande Xhaj si dhe aktorë të tjerë të teatrit dhe aktorë të rinj si Marsel Paplekaj dhe Klodiana Vata. Gjithashtu pjesë e spektaklit ishin këngëtarët e mirënjohur të Teatrit dhe këngëtarë të rinj si Rigersa Loka, Megi Toma, Serxho Toma dhe Klodiana Vata. Skenarist dhe aktor Dritan Brahimi dhe shumë artistë të tjerë. Aktiviteti përfshiu elementë të humorit skenik dhe interpretimit muzikor, të ndërthurura në një program dinamik, duke krijuar një atmosferë festive dhe komunikim të drejtpërdrejtë me publikun. Përmes humorit u trajtuan tema të përditshmërisë sociale, ndërsa pjesa muzikore solli interpretime live, të përshtatshme për të gjitha grupmoshat.

Gjate vitit 2025, trupa e teatrit Migjeni realizoj me sukses turin me shfaqjen “Vizita”, në teatrot e rendesishme të Italisë si: Lecce, Milano, Firenze, Bolzano, Napoli, Gorizia, Cagliari, Nuoro gjithashtu në Budapest- Hungari.

P.AF141.Q2.O3.A22 Shpenzime për mirëmbajtjen e funksionimit të kinemasë publike e të trashëguara

Kinemaja është një strukturë që ka një ndikim të madh në zhvillimin dhe nxitjen e jetës kulturore artistike në qytetin e Shkodrës. Është bërë një rikonstrukcion të ambienteve të Kinemasë, por është e nevojshme mirëmbajtja e vazhdueshme e ambienteve.

Bashkia Shkodër është e angazhuar të kontribuojë si përherë, në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit tonë. Bashkëpunimi me struktura të tjera që janë afër qytetarit, ka qenë në nivel të kënaqshëm. Procedurë në proces e cila do të realizohet nga DPMOP.

P.AF141.Q2.O3.A23 Rikonstrukcion Biblioteka Marin Barleti

Biblioteka Marin Barleti është një strukturë që ka një ndikim të madh në zhvillimin dhe nxitjen e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës. Bashkia Shkodër është e angazhuar të kontribuojë si përherë, në pasurimin e jetës kulturore të qytetit tonë. Bashkëpunimi me struktura të tjera që janë afër qytetarit, ka qenë në nivel të kënaqshëm. Procedurë e realizuar nga DPMOP.

P08220.Q1.O3.A26 Blerje pajisje fonie, ndriçimi dhe materiale skenike për Teatër Migjeni - TË TRASHËGUARA.

Nuk është realizuar.

P08220.Q1.O3.A27 Instalimi i sistemit të kondicionimit Teatri Migjeni- TË TRASHËGUARA Realizuar dhe likuiduar.

Transferim fondi nga Teatri. Shkresë transferimi nr. 19296 datë 27.09.2024 Nuk është realizuar.

Blerje pajisje TIK Kodi 1410201, Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës Kodi 1410295, Blerje kondicioner Kodi 1410876 Nuk është realizuar.

Blerje kondicioner (shkresë transferimi nr. 9203 datë 02.05.2024) Kodi 1410876 Nuk është realizuar.

Programi AG141 - Përkujdesi Social

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës, në fillim të vitit 2016 dhe ristrukturuar në mars të vitit 2024 si Drejtoria e Përgjithshme Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Vizioni i kësaj drejtorie është “Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”.

Shërbimet me bazë komunitare, të cilat filluan të krijohen gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Qendrat Komunitare “Për Familjen” janë njësitë bazë të ngritura dhe që mbulojnë me shërbime sociale çdo lagje të qytetit dhe njësitë administrative. Aktualisht janë të ngritura dhe në funksion 13 qendra komunitare; në zonën urbane dhe nga një në Njësitë Administrative të Gurit të Zi, të Dajçit, Postribës dhe Rrethinave. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Gjatë punës sonë përveç qendrave komunitare “Për Familjen” që ofrojnë shërbime sociale bazë në një territor të përcaktuar kemi arritur të ndërtojmë qendra që ofrojnë shërbime të specializuara për grupe dhe individë në nevojë të tilla si: qendra komunitare Multifunksionale në shërbim të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge; qendra Rinore Atelie, në shërbim të të rinjve; qendra komunitare “Për Familjen” nr. 6 me apartamente sociale për jetimët dhe familjet me njëkryefamiljar dhe fëmijë; qendra multifunksionale Ngjyrat, ku ofrohen disa shërbime si: kopsht dhe çerdhe, qendër shëndetësore për komunitetin e lagjes Nr.1, qendra multifunksionale Xixëllonjat me hapësira për qendër komunitare “Për Familjen”, qendër shëndetësore për lagjen, kopsht&çerdhe dhe zyrë administrative të bashkisë Shkodër, hapësira për të rinj, hapësira për të moshuar.

Në fushën e strehimit social, në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, gjatë vitit 2025, Bashkia Shkodër ka zbatuar disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet në nevojë për strehim. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social. Gjatë këtij viti janë zbatuar disa programe të strehimit social (banesa sociale me qira pranë ish konviktit të pyjores, Subvencionimi i interesave të kredisë dhe subvencionimi i qirasë në tregun

e lirë) për të cilat janë miratuar me vendim të këshillit bashkiak përfituesit. Gjithashtu janë zbatuar disa projekte që kanë si synim përmirësimin e kushteve të banimit për individë dhe familje në nevojë siç janë: Godinat sociale për komunitetin rom, Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit të shkollës veterinare.

Bashkia Shkodër ka krijuar dhe vënë në funksion të plotë Qendrën Harmonia, e cila ofron shërbime të specializuara për spektrin e autizmit. Përgjatë kësaj periudhe kanë marrë shërbim rreth 20 fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Në ushtrim të detyrave funksionale në zbatim të ligjit 139 “Për vërtetëqeverisjen vendore”, Ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, ligjit 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse, Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin Social”, i ndryshuar.

Ky program përfshin 2 drejtori dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik;
2. Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të 07220 “Shërbimet e kujdesit parësor”.

Q1. Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2025 kanë qenë:

O1. Mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

O2 Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes zhvillimit të aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, edukimin e promocionin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve dhe shërbimet e tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

O3. Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Me qëllim përmirësimin e shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përgjatë të gjithë vitit organizohen aktivitetet e edukimit e promovimit shëndetësor, si dhe merren masa për projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimin e infrastrukturës së ndërtuar.

Qëllimi i programit të 10430 Kujdesit social për familjet dhe fëmijët.

Q2 Planifikimi, informimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale multisektoriale dhe të qendrueshme duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit. Gjithashtu synojmë mbulimin sa më të plotë të territorit, të Bashkisë Shkodër, duke promovuar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2025 kanë qenë:

O1. Mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime sociale dhe shërbime për rininë, zhvillimi i aktivitetet edukuese dhe promovuese në nivel vendor që lidhen me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe politikën rinore në bashkërendim dhe harmonizim me strategjitë dhe politikën kombëtare.

Q3. Identifikimi i individëve dhe familjeve në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike. Informimi dhe orientimi i qytetarëve për aplikim në skemën e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë/njesisë administrative, në territorin e së cilës është banor individi.

Q3/1 Informimi i individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për përfitimin e aftësisë së kufizuar. Zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2025 kanë qenë:

O1. Programimi dhe menaxhimi i përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike dhe PAK, duke respektuar parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuara.

Q4/1 Krijimi, ndërtimi dhe administrimi i qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

Q4/2. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me ministrinë përgjegjëse për mirëqënien sociale, donatorët, shoqërinë civile, për krijimin e fondeve për financimin e shërbimeve sociale sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2025 kanë qenë:

O1. Ndërtimi dhe administrimi i qendrave që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e këtyre shërbimeve.

O2. Krijimi i fondit të dedikuar për financimin e shërbimeve sociale në bashkërendim Bashki - Ministri - Donatorë / Shoqëri Civile.

Qëllimi i programit të 10661 Strehimi social.

Q5. Administrimi i programeve të strehimit social.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2025 kanë qenë:

O1. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, të komuniteteve të pafavorizuara, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm

Q6. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2025 kanë qenë:


O1. Përmirësimi i kushteve të banimit për kategoritë e familjeve të pafavorizuara.

Në kuadër të mbulimit sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke siguruar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara, gjinisë, origjinës, minoritetit etj., Drejtoria e Shërbimeve Sociale, ka planifikuar dhe zbaton një sërë aktiviteteve të shpërndara përgjatë të gjithë vitit.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar

Programi AG141: “Përkujdesi Social”


Programi AG141	Paga & sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	000/leke
					Totali
PBA 2025	63,999	15,989	50,371		160,359
Plani fillestar 2025	79,492	30,066	59,890	30,000	206,521
Plani i rishikuar 2025	80,990	25,109	60,001	37,073	196,204
Realizimi viti 2025	55,013	14,956	47,370	30,105	117,437
				98	
% e realizimit	67.9%	59.6%	78.9%	0.3%	59.9%



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 59.85%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) **70.6 %**

Shpenzimet kapitale **0.3 %**



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Fondet e planifikuara janë realizuar në masën 59.85 %.

Një pjesë e fondit është trashëguar ndër vite dhe parashikohet të përdoret për subvencionimin e qirasë nga Bashkia në raste emergjente.

Pjesa tjetër e fondit nuk është përdorur, pasi ministria nuk ka kthyer përgjigje lidhur me projektin përkatës, duke mos i lënë institucionit kohën e nevojshme për ndjekjen dhe përfundimin e procedurës. Fondi do të vijojë të përdoret për të njëjtin qëllim edhe në vazhdimësi.

Raporti: M3 - Shpenzimet dhe Sasitë e Produkteve: Fakti - Planit (Shtator - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër Programi:

AG141 - Përkujdesi Social

Viti: 2025

KODI	PRODUKTI		KUMULATIVE DERI NË FUND TË PERIUdhËS			NDRYSHIMI (%)		
			PLANI FILLESTAR	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR	
Funksioni 07220 - Sherbimet e Kujdesit Paresor								
V722AAA	Qendra shëndetësore të mirëmbajtura		Sasia	1	3	3	300.00%	100.00%
	Njësia e mMatjes	Numer i qendrave shendetesore te mirembajtura	Shpenzimet	3,000,000	5,994,528	5366808	178.89%	89.53%
V722AAB	Promovim dhe edukim për mbrojtjen e shëndetit		Sasia	60	60	37	61.67%	61.67%
	Njësia e mMatjes	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet	0	0	0	N/A	N/A
Funksioni 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara								
V014AAA	Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social		Sasia	6	8	8	133.33%	100.00%
	Njësia e mMatjes	Numri i stafit	Shpenzimet	7,073,000	11,544,184	7194432	101.72%	62.32%
V014AAB	Persona që Përfitojnë Kujdesin Social		Sasia	1,146	987	1,259	109.86%	127.56%
	Njësia e mMatjes	Numri i personave perfitues	Shpenzimet	46,945,042	52,833,871	44545010	94.89%	84.31%
Funksioni 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët								
V043AAA	Shërbimi i Stafit të Kujdesit për Fëmijët dhe Familjet		Sasia	19	20	20	105.26%	100.00%
	Njësia e mMatjes	Numri i stafit	Shpenzimet	26,649,000	33,806,781	19384517	72.74%	57.34%
V043AAB	Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social		Sasia	3,093	3,093	3,012	97.38%	97.38%
	Njësia e mMatjes	Numri i femijeve	Shpenzimet	7,678,000	11,758,488	6611716	86.11%	56.23%
V043AAD	Familje dhe Individë në nevojë që Përfitojnë nga Skema e NE		Sasia	17	17	17	100.00%	100.00%

	Njësia e mMatjes	Nr i familjeve\individeve	Shpenzimet	22,907,000	24,851,359	20807928	90.84%	83.73%
KODI	PRODUKTI			KUMULATIVE DERI NË FUND TË PERIUDHËS			NDRYSHIMI (%)	
				PLANI FILLESTAR	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR
V043AAF	Objekte të Shërbimit të Kujdesit Social për Familje dhe Fëmijë të Mirëmbajtura		Sasia	13	13	13	100.00%	100.00%
	Njësia e mMatjes	Numri i objekteve	Shpenzimet	4,679,000	4,709,160	3363464	71.88%	71.42%
Funksioni 10661 - Strehimi social								
V066AAA	Shërbimi i Stafit të Strehimit Social		Sasia	3	3	3	100.00%	100.00%
	Njësia e mMatjes	Numri i stafit	Shpenzimet	3,890,000	4,871,632	3782880	97.25%	77.65%
V066AAB	Familje në Nevojë/Individë të Subvencionuar për Qeranë		Sasia	75	59	59	78.67%	100.00%
	Njësia e mMatjes	Numri i familjeve perfituese	Shpenzimet	5,468,000	10,990,528	3854599	70.49%	35.07%
V066AAC	Familje/Individë të Subvencionuar për Interesin e Kredisë		Sasia	40	40	21	52.50%	52.50%
	Njësia e mMatjes	Numri i familjeve perfituese	Shpenzimet	0	0	0	N/A	N/A
V066AAE	Banesa Sociale me Qera të Mirëmbajtura		Sasia	79	79	79	100.00%	100.00%
	Njësia e mMatjes	Numri i njesive te banimit	Shpenzimet	1,450,000	1,657,001	455626	31.42%	27.50%

M6: Raporti i Realizimit të Objektivave

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AG141 - Përkujdesi Social

OBJEKTIVI 1.1

Mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

07220 - Sherbimet e Kujdesit Paresor

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.1.A	Nr. i qendrave shëndetësore funksionale.	numër	14	14	14	14	100%
TP 1.1.B	Nr. i qendrave shëndetësore të mirëmbajtura	numër	0	1	3	3	300%

OBJEKTIVI 1.2

Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes zhvillimit të aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, edukimin e promocionin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve dhe shërbimet e tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

07220 - Sherbimet e Kujdesit Paresor

TP 1.2.A	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit: Nr. i Temave të zhvilluara.	numër	17	20	20	21	105%
TP 1.2.B	Nr. i aktiviteteve informuese dhe promovuese për shëndetin.	numër	61	60	60	37	61.67%
TP 1.2.C	Nr. i pjesëmarrësve në takime e aktivitete.	numër	1,062	1,200	1,200	1,050	87.5%
TP 1.2.D	Nr. i pjesëmarrësve në takime e aktivitete vajza/gra.	numër	639	800	800	740	92.5%

OBJEKTIVI 2.1

Mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime sociale dhe shërbime për rininë, zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese në nivel vendor që lidhen me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe politikat rinore në bashkërendim dhe harmonizim me strategjitë dhe politikat kombëtare.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

TP 2.1.A	Numri i punonjësve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror	Numër	15	19	20	20	105.26%
TP 2.1.B	Numri i fëmijëve të trajtuar në situatë rruge–Trendi vjetor ne %	Numër	44	45	45	40	88.89%
TP 2.1.C	Numri i familjeve të mbështetura në situatë rruge	Numër	50	20	20	20	100%
TP 2.1.D	Nr. i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të përfshirë në programet e përfshirjes sociale	Numër	192	70	70	74	105.71%
TP 2.1.E	Nr i takimeve të organizuara të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN)	Numër	12	30	30	17	56.67%
TP 2.1.F	Nr. i aktiv ndërgjegjësuere për promovimin e të drejtave të fëmijëve, parandalimin e keqtrajtimit	Numër	10	10	10	12	120%
TP 2.1.G	Nr. i aktiv ndërgj të organizuar në kuadër të ditës së familjes, 1 Qershorit, 20 Nentorit	Numër	17	15	20	20	133.33%
TP 2.1.H	Nr. i pjesëmarrësve në aktv e organizuara për ditën e familjes, 1 Qershorit, 20 Nentorit	Numër	766	800	800	810	101.25%
TP 2.1.I	Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki.	Numër	26	12	12	8	66.67%
TP 2.1.J	Nr. i takimeve periodike të tryezës konsultative	Numër	13	12	12	12	100%
TP 2.1.K	Nr i organizatave pjesëmarrëse në tryezat konsultative.	Numër	20	25	15	15	60%
TP 2.1.L	Nr. i familjeve që do të marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian	Numër	420	500	500	510	102%
TP 2.1.M	Fëmijë pa përkujdes prindëror që kanë përfituar nga shërbimi social Nr. i jetimëve përfitues	Numër	8	8	8	8	100%
TP 2.1.N	Numri i fëmijëve përfitues që jetojnë në institucionet rezidenciale	Numër	58	80	80	81	101.25%
TP 2.1.O	Numri i fëmijëve me masë mbrojtëse të mbështetur nga NJMF	Numër	13	5	5	9	180%
TP 2.1.P	Numri i të rinjve përfitues në shërbimet e Qendrës Rinore	Numër	2,580	3,000	3,000	2,914	97.13%
TP 2.1.Q	Numri i aktiviteteve që zhvillon sektori i rinisë	Numër	0	300	300	324	108%

OBJEKTIVI 3.1

Programimi dhe menaxhimi i përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike dhe PAK, duke respektuar parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

TP 3.1.A	Numri I Stafit të drejtorisë së ND dhe PAK	Numër	17	17	17	17	100%
TP 3.1.B	Numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike	Numër	1,797	2,400	2,100	1,660	69.17%
TP 3.1.C	Numri i personave të asistuar me PAK	Numër	6,762	7,090	3,929	3,956	55.8%

OBJEKTIVI 4.1

Ndërtimi dhe administrimi i qendrave që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e këtyre shërbimeve

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

TP 4.1.A	Nr. i qendrave sociale komunitare funksionale	Numër	13	13	13	13	100%
TP 4.1.B	Numri i përfituesve të shërbimeve në qendrat komunitare “Për Familjen”	Numër	5,982	7,000	7,000	6,439	91.99%
TP 4.1.C	Nr. i fëmijëve që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershëm të autizmit	Numer	27	25	25	25	100%

OBJEKTIVI 4.2

Krijimi i fondit të dedikuar për financimin e shërbimeve sociale në bashkërendim Bashki - Ministri - Donatorë / Shoqëri Civile.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

TP 4.2.A	Nr. i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK.	Numër	8	8	8	8	100%
TP 4.2.B	Numri i përfituesve Opera Madonnina del Grapa + Projekti Shpresa	Numër	83	82	83	85	103.66%
TP 4.2.C	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjëse në kuadër të ditës ndërkombëtare të PAN.	Numër	5	7	7	11	157.14%
TP 4.2.D	Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin	Numër	33	25	25	24	96%
TP 4.2.E	Nr. i jetimëve të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit	Numër	39	50	50	31	62%
TP 4.2.F	Numri i rasteve të identifikuar / të referuara të dhunës në familje	Numër	140	80	80	165	206.25%
TP 4.2.G	Nr i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit	Numër	420	180	180	495	275%

TP 4.2.H	Nr i takimeve të organizuara të ekipit Teknik i Ndërdisciplinor (ETN)	Numër	9	10	14	12	120%
TP 4.2.I	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjëse për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.	Numër	50	35	35	35	100%
TP 4.2.J	Numri I femijeve qe ndjekin klasat passhkollore	Numër	106	105	105	105	100%
TP 4.2.K	Numri I viktimave të dhunës me bazë gjinore te mbeshtetura	Numër	93	200	200	79	39.5%
TP 4.2.L	Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse në kuadër të 8 Marsit.	Numër	14	17	17	12	70.59%
TP 4.2.M	Nr i pjesëmarrësve në aktivitete, 8 Marsi	Numër	375	250	250	235	94%
TP 4.2.N	Nr i pjesëmarrësve vajza/gra në aktivitete, 8 Marsi	Numër	365	200	200	220	110%
TP 4.2.O	Të moshuar të trajtuar në vit në qendrat e shërbimeve sociale.	Numër	143	50	50	40	80%
TP 4.2.P	Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse, Mosha e trete	Numër	3	3	4	4	133.33%
TP 4.2.Q	Numri i përfituesve të projekteve	Numër	0	204	204	237	116.18%

OBJEKTIVI 5.1

Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, të komuniteteve të pafavorizuara , permes ofrimit te alternativave per nje strehim te gatshem, te arritshem, te perballueshem dhe te pershtatshem

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

10661 - Strehimi social

TP 5.1.A	Numri i punonjesve tek sektori i strehimit social	Numer	3	3	3	3	100%
TP 5.1.B	Numri i aplikimeve për subvencionim qiraje	Numër	141	140	120	154	110%
TP 5.1.C	Numri i përfituesve për subvencionim qiraje	Numër	47	75	59	59	78.67%
TP 5.1.D	Numri i aplikimeve për subvencionimin e interesave të kredisë	Numër	60	100	80	80	80%
TP 5.1.E	Numri i familjeve perfituese nga subvencionimi i interesave të kredive nga shteti për familjet në n	Numër	21	40	40	21	52.5%

OBJEKTIVI 6.1

Përmiresimi i kushteve të banimit për kategoritë e familjeve të pafavorizuara.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

10661 - Strehimi social							
TP 6.1.A	Numri i njësive të banimit pranë banesave sociale me qira.	Numër	79	79	79	76	96.2%
TP 6.1.B	Të ardhurat nga qeraja e banesave sociale	Numër	1,038	1,057	1,057	800	75.69%
TP 6.1.C	Numri i familjeve që perfitojnë banesa sociale me qira	Numër	79	79	79	79	100%
TP 6.1.D	Nr i aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	Numër	1	3	3	3	100%

Shënime:

^[1] Ky TP është planifikuar gjatë Fazës III të finalizimit të PBA 2025-2027, por është fshirë gjatë rishikimit Deklaratës së Politikës së Programit gjatë vitit 2025.

^[2] Ky TP nuk është planifikuar gjatë Fazës III të finalizimit të PBA 2025-2027, por është shtuar gjatë rishikimit Deklaratës së Politikës së Programit gjatë vitit 2025.

* Nëse TP ka pësuar ndryshime në njesinë matëse, midis planifikimit fillestar (PBA 2026-2028) dhe rishikimit (PBA 2026-2028), atëherë të dy versionet shfaqen në dy rreshta të ndryshëm për shkak se nuk ka më bazë krahasimi dhe secili prej të dy versioneve do të marrë shënimin [1] ose [2].

Përshkrimi I Aktiviteteve						
Produktet	Aktivite/Projekte	Institucion i	Statusi I Aktivitetit	Buxheti Fillestar 2025	Buxheti I Rishikuar 2025	Realizimi 12 muhor viti 2025
V722AAA. Qendra shëndetësore të mirëmbajtura(në numër)	P.AG141.Q1.O1.A1 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	3,000	5,995	5,367
V722AAB. Promovim dhe edukim për mbrojtjen e shëndetit(nr. aktiviteteve)	P.AG141.Q1.O2.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	-	-
V722AAC. Qendra shëndetësore të rikonstruara (në numër)	P.AG141.Q1.O3.A1 Rikonstruksioni I ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor	Bashkia Shkodër	Parashikuar për t'u zbatuar në kuadër të thirrjeve nga donatorët	-	-	-
07220 Shërbimet e kujdesit parësor				3,000	5,995	5,367
V043AAA. Shërbimi i stafit të Kujdesit për fëmijët dhe Familjet (nr. I stafit)	P.AG141.Q2.O1.A1 Paga dhe sigurime per ofrimin I shërbimeve të kujdesit shoqëror për familjet dhe fëmijët (Qendra komunitare) & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	8,735	12,146	7,996
	P.AG141.Q2.O1.A1/1 Paga dhe Sigurime per ofrimin e kujdesit shoqeror per familjet dhe femijet (Qendra Komunitare)	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	503	138
	P.AG141.Q2.O1.A2 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi te shërbimit per administrimin e Kujdesit social per femije dhe familjet & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	16,534	19,639	10,169
	P.AG141.Q2.O1.A3 Masat për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	150	185	51.286
	P.AG141.Q2.O1.A4. Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve) & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	100	200	-
	P.AG141.Q2.O1.A5. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	200	201	164
	P.AG141.Q2.O1.A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	Bashkia Shkodër	Realizuar	50	50	37

	P.AG141.Q2.O1.A7. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori" & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	200	202	165
	P.AG141.Q2.O1.A8. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	-	-
	P.AG141.Q2.O1.A9. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;	Bashkia Shkodër	Realizuar	80	80	73
	P.AG141.Q2.O1.A10 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	100	101	100
	P.AG141.Q2.O1.A11 Kampi Veror	Bashkia Shkodër	Realizuar	500	500	491
V043AAB. Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social (nr. I fëmijeve) burimet e veta	P.AG141.Q1.O1.A12. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror- Burimet e veta& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	5,878	9,661	5,199
	P.AG141.Q2.O1.A13. Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	-	-
	P.AG141.Q2.O1.A14 Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	100	300	-
	P.AG141.Q2.O1.A15. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	26	-
	P.AG141.Q2.O1.A17 Realizimi i Aktiviteteve për Rininë	Bashkia Shkodër	Realizuar	300	300	242
	P.AG141.Q2.O1.A18 Koncerti "Youth Èave"	Bashkia Shkodër	Realizuar	830	830	740
	P.AG141.Q2.O1.A19 Panairi për të rinjtë	Bashkia Shkodër	Nuk është realizuar	-	-	-
	P.AG141.Q2.O1.A20 Personazhe në fokus	Bashkia Shkodër	Realizuar	270	270	240
	P.AG141.Q2.O1.A21 Zhvillimi i konkurseve për rininë	Bashkia Shkodër	Realizuar	300	300	120
	P.AG141.Q2.O1.A22 Karta e studentit	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	-	-
	P.AG141.Q2.O1.A22 Shërbime Shtese për integrimin e fëmijeve në komunitet dhe lehtësimin e Deinstitutionalizimit	Bashkia Shkodër	Realizuar		71	71
V043AAD. Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE(nr. I famijleve/individëve)	P.AG141.Q3.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbyshjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësisë të shërbimit për administrimin e drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paafëtisë & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	22,907	24,851	20,808
V043AAF. Objekte të shërbimit të kujdesit social për familje dhe fëmijë të mirëmbajtura (nr. I objekteve)	P.AG141.Q4.O1.A1. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare "Për Familjen" & të trashëguara	Drejt e përgjithshme me Mirembajtjet e Objekteve Publike	Realizuar pjesërisht	4,679	4,709	3,363

V014AAA. Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social(nr. I stafit)	P.AG141Q4.O1.A2. Blerje Kancelari për Qendrat Komunitare “Për Familjen”& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	312	312	213
	P.AG141.Q4.O1.A3. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare Mutifunkionale & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	6,761	9,835	6,481
	P.AG141.Q4.O1.A3/1 Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare Mutifunkionale	Drejt e pergjithshme Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	971	256
	P10430.Q4.O1.A4 Shpenzime per mirembajtjen dhe sigurimin e funksionimit te plote te Qendres Rinore Atelier -TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	426	245
V014AAB. Persona që përfitojnë Kujdesin Social(nr. I personave perfitues)	P.AG141.Q4.O2. A1. Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	19,532	21,563	19,416
	P.AG141.Q4.O2.A2. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuar. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	24,971	26,890	23,625
	P.AG141.Q4.O2.A3. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, më 3 Dhjetor. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	390	424	368
	P.AG141.Q4.O2. A4. “Asnjë Fëmijë Jashtë”& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Vlere mbetur nga vitet meparshme	-	200	-
	P.AG141.Q4.O2. A4. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi të kufizuar”& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	369	451	364
	P.AG141.Q4.O2. A5. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	400	400	317
	P.AG141Q4.O2. A6. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	150	158	108
	P.AG141Q4.O2.A7. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.& të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	100	155	84

	P.AG141.Q4.O2.A8. TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	883	1,095	83
	P.AG141.Q4.O2.A9. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	100	120	63
	P.AG141.Q4.O2.A10. Kujdesi social ndaj moshës së tretë & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	50	52	48
	P.AG141.Q4.O2.A11. "Kafe me gjyshërit" në Qendrën Komunitare "Për Familjen" Nr.4	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	-	-
	P.AG141.Q4.O2. A12. Punësim dhe mësim për përfshirje sociale- Fondet tona - të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	243	69
	P.G141.Q4.O2.A13. HOLD ON - Nxitje e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë financiar në kuadër të programit Erasmus - Fondet tona - të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	817	-
	P10430.Q4.O2. A16 Realizimi I aktiviteteve per rinine -TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Vlere e mbetur nga vitet e meparshme	-	265	-
	P10430.Q4.O2. A17. "Vizë studimore nga eksperte nga Italia per ndarjen e modeleve ne lidhje me te moshuarit me nevoja te vecanta" - Blerje bileta avioni per transportin ajror. - TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Vlere e mbetur nga vitet e meparshme	-	2	-
P043AAR Fuqizimi i komunitetit permes ofrimit te sherbimeve ditore te alternuara per femije dhe familje	P.AG141.Q4.O2.A14. "Fuqizimi i komunitetit permes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen"- BRENDIA THESARI & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	620	1,838	1,658
P043AAT Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë	P10430.Q4.O2.A12. "Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë" -TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	412	412
P043AAU - Çdo fëmijë në shkollë mbështetur nga UNICEF	Çdo fëmijë në shkollë mbështetur nga UNICEF -TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Vlere e mbetur nga vitet e meparshme	-	3	-
P043AAV - PEOPLE- Histori personale te diskriminimit dhe persekutimit nen regjimet totalitare te shekullit XX	PEOPLE- Histori personale te diskriminimit dhe persekutimit nen regjimet totalitare te shekullit XX-TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Vlere e mbetur nga vitet e meparshme	-	111	-
P043AAX - FARO- Trashegimi te ndryshme ne qytetet europiane	FARO-Trashegimi te ndryshme ne qytetet europiane -TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkodër	Vlere e mbetur nga vitet e meparshme	-	822	-

10430 Kujdesi social per familjet dhe femijet				116,551	142,690	103,977
V066AAA. Shërbimi i Stafit të Strehimit Social (nr. punonjësish)	P.AG141.Q5.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të stafit të strehimit social në funksion të përmbushjes së misionit qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësi për ofrimin e programeve të strehimit ndaj qytetarëve.	Bashkia Shkodër	Realizuar	3,890	4,872	3,783
V066AAB. Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë (numri I familjeve) me burimet e veta	P.AG141.Q5.O1.A2 Zbatimi I instrumentit financiar "Subvencionimi i qerasë në tregun e lirë" & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Listepagese e Llogaritur	5,468	10,991	3,855
V066AAC. Familje / Individë të subvencionuar për interesin e Kredisë. (numri I familjeve)	P.AG141.Q5.O1.A3 Zbatimi I instrumentit financiar "Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti"	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	-	-
V066AAE. Banesa sociale me qera të mirëmbajtura (numri I njesive të banimit)	P.AG141.Q6.O1.A1 Menaxhimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik në pronësi të bashkisë.& të trashëguara	Drejt e pergjithsh me e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar pjeserisht	1,450	1,655	456
	P10661.Q2.O1.A1/1 Menaxhimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik në pronësi të bashkisë & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	-	2	-
P066AAD - Rikonstruksion i ish-konviktit të shkollës Veterinare, shtesë kati II	P.AG141.Q6.O1.A2 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II)	Drejt e pergjithsh me e Mirembajtjes se Objekteve PublikeBashkia Shkodër	Nuk është realizuar	30,000	30,000	-
P066AAM Nderitim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj	P.AG141.Q6.O1.A3 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit. (Nderitim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj)	Bashkia Shkodër	Fondi është parashikuar për vitin 2026-2028	-	-	-
10661 Strehimi social				40,808	57,520	8,094
Totali P.AG141 Perkuajdesi Social				160,359	196,204	117,437
Të trashëguara				46,162	0	0
Totali				206,521	196,204	117,437

Aktivite/Projekte (me transfertë të kushtëzuar)	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i rishikuar 000/Lekë	Realizimi 12 mujor i vitit 2025 000/Lekë
P.AG141.Q2.O1.A12. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror me transfertë të kushtëzuar	4,159	4,159	3,352
P.AG141.Q3.O1.A2 Ndihma ekonomike me transfertë të kushtëzuar	185,000	188,045	183,303
P.AG141.Q3.O1.A3 Pagesë PAK me transfertë të kushtëzuar	810,000	762,857	760,946
P6190.Q1.O1.A1 Zbatimi I instrumentit financiar "Subvencionimi i qerasë në tregun e lirë"	12,758	9,441	8,589
Pagese per perfituesit e Vendimit te Gjykates Administrative Shkalla e Pare Shkoder	-	27,412	27,411
Totali	1,011,917	991,914	983,601

Aktivite/Projekte (me llogari jashtë thesari)	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i rishikuar 000/Lekë	Realizimi 12 mujor i vitit 2025 000/Lekë
P.AG141.Q4.O2.A8. TVESA@SH– Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër	-	1,349	831
P.AG141.Q4.O2.A12. Punësim dhe mësim për përfshirje sociale	53	3,484	3,484
P.G141.Q4.O2.A13. HOLD ON - Nxitje e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë financuar në kuadër të programit Erasmus+	-	259	227
Totali	53	5,091	4,542

Për vitin 2025 në Programin AG141 “Përkujdesi Social”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar aktivitete.

P.AG141.Q1.O1.A1 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor & të trashëguara

Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, pjesë e së cilës është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, ristrukturimi i tyre, planifikimi dhe projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Bashkia e Shkodrës tashmë ka krijuar një database të qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. Pjesë e këtij database, i cili është në përditësim të vazhdueshëm, është projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore në territor. Janë organizuar disa takime me stafin e NJVKSH për të përcaktuar nevojat e territorit. Është punuar për hartimin e preventivave përkatës, është realizuar procedura e prokurimit, lidhur kontrata dhe aktualisht po kryhen punimet. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa takime me të gjithë drejtorët e qendrave shëndetësore, përfaqësues të Operatorit dhe NJVKSH-së Shkodër, si dhe disa

vizita në terren me qëllim evidentimin e nevojave për ndërhyrje dhe përcaktimin e prioritetëve për vitin 2025. Aktualisht në bashkinë e Shkodrës janë 14 qendra shëndetësore funksionale.

P.AG141.Q1.O2.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm

Shërbimi i shëndetit publik pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka organizuar një sërë takimesh informuese me synim përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës së komunitetit. Këto takime janë organizuar pranë qendrave komunitare “Për Familjen” dhe gjithashtu në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të bashkisë së Shkodrës. Temat e referuara janë në përputhje me kalendarin kombëtar të promocionit shëndetësor të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Organizimi dhe zhvillimi i këtyre aktiviteteve është realizuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor dhe atij arsimor me moton “Së bashku për shëndetin tuaj”. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar tema të shëndetit, të cilat janë prezantuar në takime të organizuara në qendrat komunitare “Për Familjen”, në qendrën rinore “Atelie”, në shkolla, në zonën urbane dhe në njësitë administrative Dajç, Gur i Zi, Postribë, Ana e Malit, Rrethina dhe Bërdicë.

P.AG141.Q1.O3.A1 Rikonstruksioni i ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor

Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, pjesë e së cilës është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, rristurimi i tyre, planifikimi dhe projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Rikonstruksioni i ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor është parashikuar për t'u zbatuar në kuadër të thirrjeve nga donatorët.

P.AG141.Q2.O1.A1 Paga dhe sigurime për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për familjet dhe fëmijët (Qendra komunitare) & të trashëguara

Është realizuar sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të qendrave komunitare “Për Familjen” në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P.AG141.Q2.O1.A1/1 Paga dhe sigurime për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për familjet dhe fëmijët (Qendra komunitare) & të trashëguara.

Në këtë aktivitet do të përfshihet shtesa për sanitare dhe gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me pagesën për punonjësit sanitare për mirëmbajtje të shërbimeve të kujdesit shoqëror për familjet dhe fëmijët (Qendra komunitare) & të trashëguara.

Paga dhe shtesat mbi paga. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të pages bazë minimale në shkallë vendi, Vendimit nr.113, datë 01.03.2023 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar , në mbështetje të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar ; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike”, i ndryshuar.

P.AG141.Q2.O1.A2 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të shërbimit për administrimin e Kujdesit social për fëmijë dhe familjet & të trashëguara

Është realizuar sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të drejtorise se Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P.AG141.Q2.O1.A3 Masat për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge. & të trashëguara

Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit “Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge”, është hartuar dhe vazhdon të zbatohet Plani lokal i veprimit, ku bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit.Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me

përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qendrave komunitare, përfaqësues të Policisë të cilët janë trajnuar, kanë qenë dhe janë prezent në territor sipas një kalendari të paracaktuar. Në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Bashkia Shkodër po koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere ku janë diskutuar rastet për çdo fëmijë që ka nevojë për mbrojtje. Gjithashtu janë hartuar plane individuale mbrojtje për të gjithë fëmijët që marrin masë mbrojtëse. Gjate gjithë periudhës ka ndërhyrjeje për fëmijët në situatë ruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë ruge si dhe të mbështetur është 40. Për secilën familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, regjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë sipas vlerësimeve dhe planeve individuale të ndërhyrjes.

Në kuadër të javës Rome **8-12 prill** janë realizuar aktivitete socio-kulturore dhe ndërgjegjësuere. Më datë 8 prill, “Dita ndërkombëtare e Romëve”, Qendra Komunitare Multifunkionale “Për familjen” në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe me shkolla të ndryshme të qytetit kanë realizuar aktivitete për të promovuar kulturën e traditat rome, integrimin dhe përfshirjen e tyre sociale.

Më 12 prill në “Ditën ndërkombëtare të fëmijëve në situatë ruge”, me moton “**Kujdes! Mos Dhuro Para, Fëmija po shfrytëzohet**” janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese, ndërgjegjësuere, të cilat kishin si qëllim rritjen e ndërgjegjesimit ndaj fenomenit të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve duke përfshirë dhe fëmijët në situatë ruge.

Janë planifikuar dhe realizuar aktivitete ndërgjegjësuere në pedonalen e qytetit dhe pika tjera hot spot ku janë shpërndahen informacion edhe fletëpalosje.

Gjithashtu edhe me datën 30 korrik “Dita ndërkombëtare kundër fenomenit të trafikimit” u planifikua dhe u realizua një aktivitet gjithëpërfshirës duke e kthyer në një ditë sensibilizuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe informimin për fëmijët në situatë ruge, si një kontigjent potencial i mundshëm për trafikim. Aktivitetet janë shtrirë në të gjithë pikat e qytetit dhe pikat kufitare. Gjatë kësaj periudhe skuadrat e terrenit janë më të shtuara me qëllim monitorimin dhe identifikimin e fëmijëve në situatë ruge në pikat me “hot spot” të qytetit. Me qëllim uljen e numrit të fëmijëve në situatë ruge janë realizuar tryeza pune me Drejtorinë Vendore të Policisë, Policinë Bashkiake, Prokurorinë dhe Sektorin e Trafikeve, ku janë përcaktuar nevojat dhe problematikat që janë hasur gjatë monitorimit të terrenit deri tani si dhe po punohet për hartimin e planit të përbashkët të ndërhyrjes për monitorimin e fëmijëve në situatë ruge gjatë sezonit turistik të verës në pikat më problematike si Ura Bunës, Zona e Muriqanit dhe disa pika kyçe në qytet.

P.AG141.Q2.O1.A4. Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve) & të trashëguara

Njësitet e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në bashkinë Shkodër vazhdon të jetë

funkionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial (GTN) të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.

Janë organizuar mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative ose mase mbikqyrje te specializuar pranë familjes Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 59 pika 4 punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Me qëllim marrjen e vendimit të gjykatës për caktimin e kujdestarisë ligjore të të miturit në nevojë për mbrojtje, kërkohet mendimi i një eksperti psikolog i paanshëm sipas listës të vënë në dispozicion nga ana e Gjykatës që të realizojë vlerësimin lidhur me kujdestarinë ligjore të të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Caktimi i shpenzimeve për ekspertët në gjykatë bazohet në Udhëzim nr 4 datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesat e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

P.AG141.Q2.O1.A5. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj & të trashëguara.

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përmbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë. Në territorin e bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Si pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie. Duke qenë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura ”Për Familjen”, duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, sivjet në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen janë planifikuar një javë me aktivitete nën moton ”Punojmë së bashku në

forcimin e familjes”. Janë planifikuar dhe realizuar një serë aktivitetesh sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie etj., si në qytet ashtu dhe në njësité administrative.

Është realizuar panairi social në qendër të qytetit me pjesëmarrjen e të gjithë organizatave dhe institucioneve vendore, si dhe një ekskursion në Rec, me qëllim kalimin e kohës cilësore prind-fëmijë për përfituesit e shërbimeve të Qendrës Komunitare “Për Familjen” Nr.5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat.

P.AG141.Q2.O1.A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

20 Nëntori “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve” synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve.

Janë realizuar disa aktivitete që kanë qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve dhe promovimin e tyre. Fëmijët janë një target grup që shumë lehtë mund të jenë pre e keqtrajtimit dhe dhunës e për këtë është e nevojshme që të informohen në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre. Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me qendrën Kulturore të Fëmijëve si dhe në të gjithë qendrat komunitare “Për Familjen”.

P.AG141.Q2.O1.A7. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori" & të trashëguara

Një Qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave tyre. Kjo ditë përveç se është një ditë festive, është një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Bashkia e Shkodrës ka organizuar aktivitete festive dhe ndërgjegjëse që lidhet me mirëqenien e fëmijëve, njohjen dhe respektimin e të drejtave në familje, shkollë, shoqëri dhe në të gjitha shërbimet që ofrohen për fëmijët. Transmetojmë mesazhe sensibilizuese për fëmijët që janë e ardhmja e shoqërisë sonë.

Në kuadër të kësaj dite, në sheshin para Bashkisë Shkodër janë planifikuar dhe realizuar një sërë aktivitetesh argëtuese dhe edukuese për fëmijët dhe prindërit e tyre duke promovuar respektimin e të drejtave, dëshirave, përgjegjësi dhe barazisë. Gjatë kësaj dite pati një numër shumë të madh fëmijesh, të cilët bashkë me prindërit u përfshinë në aktivitetet e larmishme që u zhvilluan.

P.AG141.Q2.O1.A8. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale

Në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në degët e psikologjisë, punës sociale, fizioterapisë dhe infermierisë, çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën

e “Praktikumit”. Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimin e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit. Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qenë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. 2 studentë të nivelit master janë duke zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimeve sociale dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit të tyre.

P10430.Q1.O1.A9. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;

Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Gjatë këtyre viteve është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile. Gjatë kësaj periudhe tryezat konsultative janë organizuar për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të kartës evropiane për barazinë gjinore, 8 marsit, 8-12 prillit, javës së familjes, 1 qershorit dhe në zbatim të projekteve të reja që po zbatohen në Bashkinë e Shkodrës nga organizatat partnere. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime.

P.AG141.Q2.O1.A10 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian & të trashëguara

Ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025 ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë Qendrës Komunitare Multifunksionale “Për Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian.

Qendra Komunitare Multifunksionale “Për Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë që nga muaji tetor i vitit 2018 dhe ofron shërbime specifike për këtë komunitet siç janë:

- Informim mbi regjistrimi civil dhe mbështetje në nevojat administrative;
- Arsimimi dhe promovimi i dialogut;

- Kujdesi shëndetësor;
- Strehimi dhe integrimi;
- Punësimi;
- Mbrojtja sociale;
- Gjithëpërfshirje dhe Integrim.

Qendra Multifunksionale bashkëpunon që prej vitit 2018 me Fondacionin “Shpresë për Botën”, “FoodBank” për ofrimin e shërbimeve integruese për këtë komunitet.

Gjithashtu Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin OSFA po implementojnë në këtë qendër edhe projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale” me financim të Bashkimit European, i cili ka në fokus komunitetin rom/egjiptjan. Nga ky projekt përfitojnë shërbime mbështetëse integruese bursë 30 fëmijë dhe familjet e tyre janë të përfshirë në programet e punësimit.

Numri total i përfituesve të shërbimeve në Qendrën Multifunksionale është 160 përfitues, nga të cilat 130 i përkasin komunitetit rom dhe 30 komunitetit egjiptian. Fëmijët që përfitojnë shërbime gjatë frekuentimit ditor të qendrës Multifunksionale janë 50 fëmijë të regjistruar si përfitues ditor nga të cilët 40 janë nga shkollat 9 vjecare “Isuf Tabaku”, “Liria” dhe “Mati Logoreci” si dhe 10 fëmijë nga kopshtet brenda brenda këtyre Shkollave.

Fëmijë që frekuentojnë qendrën Multifunksionale mbështeten me:

- Transport në shkollë-kopësht-qendër dhe anasjelltas(kostot mbulohen nga Fondacioni “Shprese per Boten”.
- Vakt ushqimor në qendër cdo ditë (dreka, kostoja mbulohet nga FoodBank).
- Klasa passhkollore dhe përgaditore.
- Organizimi dhe festimi i ditëlindjes për çdo fëmijë.
- Lojra dhe aktivitete psiko-sociale çdo ditë.
- Mjete shkollore për përdorim të përditshëm.
- Rroba/këpucë dhe nevoja të tjera të përditshme.
- Çanta dhe materiale shkollore çdo fillim vit shkollor.
- Pako ushqimore për çdo familje të fëmijëve që frekuentojnë rregullisht kopësht/shkollë gjatë muajt.

Në dispozicion të fëmijëve të komunitetit rom gjatë vitit 2025 janë dy mjete transporti të cilët shoqërojnë fëmijët nga vendqëndrimet rome për në shkollë-kopësht me itinerar:

- Mjeti 1 (K/Dubai, Bahcallek – shkolla 9 vjecare “Isuf Tabaku” / Kopshti “Mjelmat” – qkmf - k/Dubai);
- Mjeti 2 (Shkolla Pashko Vasa dhe Mati Logoreci - Qkmf – Banesat Sociale, Godinat Rome.

Kostot e transportit dhe pagesa për shoferat mbulohen nga Fondacioni “Shpresë për Botën”.

Përvec itinerarit të përditshëm transporti është në dispozicion edhe për aktivitetet që zhvillohen me fëmijët dhe familjet romë brenda dhe jashtë qendrës Multifunkionale

Gjithashtu, për fëmijët e komunitetit rom/egjiptjan të Banesave Sociale, Godinat Rome, ka vazhduar programi i passhollorit në kuadër të projektit “TRILL” Higjena është elementi i rëndësishëm që lehtëson integrimin e fëmijëve rom, duke marrë në konsideratë faktin se shpesh është shkak për qëndrime diskriminuese.

Për këtë pranë qendrës komunitare multifunkionale janë në funksion dushe, makina larëse për fëmijët që frekuentojnë këtë qendër. Për këtë qëllim pranë qendrës Multifunkionale janë realizuar vazhdimisht aktivitete për kujdesin e higjenes si: larja e dhëmbëve, duarve etj.

Ka vazhduar rregullisht edhe gjatë vitit 2025 koordinimi ndërinstitutional për identifikimin e fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën ose e kanë braktisur atë duke përfshirë takime në institucione dhe vizita në terren (kampet romë) të grupit të edukimit që përfshijnë drejtorë të institucioneve arsimore, përfaqësues të Zyrës Vendore Arsimore Shkodër, mësues kujdestar, psikolog, punonjës social, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, staf të qendrës multifunkionale dhe staf nga organizatat.

Bashkia Shkodër në zbatim të Planit Vendor të Veprimit për fëmijët në situatë rruge ka aktive skuadrat e terrenit të përbërë nga punonjës social të qendrave komunitare, të cilët kanë vazhduar intensivisht punën për identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge, të cilët shfrytëzohen për lypje. Sipas një kalendari të hartuar, janë aktive në terren në çdo ditë të javës punonjës, të cilët monitorojnë terrenin në shtatë ditë të javës në zonat: Urës Bunës, pika Doganore e Muriqanit si edhe monitorimi i terrenit në qytet.

Në mbështetje të skuadrave të terrenit gjatë gjithë verës kanë qënë edhe Policia e Shtetit, Policia Bashkiake si dhe Specialistët e Policimit në Komunitet.

Janë identifikuar 40 raste të fëmijëve në situatë rruge dhe mbështetja e familjeve të tyre.

Në kuadër të planit të përbashkët të masave për identifikimin, referimin dhe vlerësimin e fëmijëve në situatë rruge, në bashkëpunim me strukturat e policisë janë shoqëruar në komisariat raste të përsëritura nga komuniteti rom të cilët po ushtronin lypësi në kushte dhe zona ku rrezikohet siguria dhe mirëqenia e të miturve si dhe duke u bërë burim aksidenti për shkak të qëndrimit tyre.

Në Qendrën Multifunkionale çdo vit festohet 8 Prilli, Dita Ndërkombëtare e Romëve.

Në kuadër të kësaj feste, Bashkia në bashkëpunim me aktorët e tjerë vendor organizon aktivitete të ndryshme përgjatë një jave, aktivitete të natyrave të ndryshme ndërgjegjësuere, edukuese dhe promovuese. Temat dhe mesazhet që përçojnë janë të ndryshme, por të gjitha synojnë promovimin e diversitetit dhe dialogut ndërkulturor.

12 qershori “Dita Botërorë kundër shfrytëzimit të mituve për punë është aktiviteti ndërgjegjësues dhe sensibilizues që bashkon të gjithë institucionet dhe organizatat në mbrojtje të fëmijëve dhe të drejtave tyre.

Më 30 korrik 2025 në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore janë planifikuar fushata ndërgjegjësuese në Muriqan dhe Ura e Bunës dhe qytet ku specialist nga shërbimi social kanë marrë nismën për ndërgjegjësimin e qytetarëve për pasojat negative të dhurimit të parave dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

“KUJDES! Mos Dhuro Para! Fëmija po shfrytëzohet! është slogani i serisë së aktiviteteve që organizohen çdo vit nga Bashkia, Qendra Multifunkionale dhe Organizatat partnere.

Fushatat dhe aktivitetet ndërgjegjësuese organizohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me partnerët jo vetëm në ditët e shënuara ndërkombëtare apo kombëtare, por janë pjesë e vazhdueshme e planeve të punës të Drejtorisë dhe Qendrave Komunitare “Për familjen”, me synim rritjen e ndërgjegjësimin të komunitetit në lidhje me të drejtat e tyre, por edhe me qëllim njohjen dhe promovimin e shërbimeve që ofrohen për mbështetjen e grupeve vulnerabël.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve, aftësive dhe përgjegjësive prindërore, në këtë qendër zhvillohen takime ku diskutohen dhe trajtohen tema në përshtatje me problematikat e hasura më shpesh nga ky komunitet si: braktisja e shkollës, martesat e hershme, trafikimi, prindërimi pozitiv etj. Përfitues të klasave të prindërimit janë 20-25 prindër të komunitetit rom dhe egjiptian.

Gjatë vitit 2025 fëmijët e komunitetit rom/egjiptian kanë vizituar ambjente të ndryshme si: Kompleksi sportiv “Zmijani”, Shirokë etjer. Janë zhvilluar aktivitete edhe në shkolla ku frekuentojnë fëmijët rom, Shkolla “Isuf Tabaku” – Ajasëm dhe kopshti brenda shkollës.

Në Kuadër të muajt të Punonjësit Social, studentet e departamentit Psikologji-punë sociale Shkodër kanë vizituar Qendrën Multifunksionale, duke kaluar një ditë ndryshe me lojra dhe dhurata për fëmijët frekuentues të kësaj qendre.

Gjithashtu fëmijët rom/egjiptian janë pjesë e aktiviteteve sociale dhe argëtuese, lojrave psiko- sociale që zhvillohen në qendër dhe jashtë saj, por jo vetëm pasi Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizatat partnere.

Çdo muaj në Qendrën Multifunksionale “Për Familjen” organizohen së paku 3 (tre) aktivitete në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Fondacionin “Shpresë për Botën dhe organizata tjera me fokus integrimin dhe gjithëpërfshirjen e komunitetit.

- Aktivitete (brenda ose jashtë qendrës) me fëmijët frekuentues të qendrës ;

- Të mitur në konflikt/kontakt me ligjin.
- Kujdesemi per natyrën.
- Mbetjet ushqimore.
- Dita Botërore e Mjedisit
- Dita e alfabetit
- Aktivitet (brenda ose jashtë qendres) me prindër.
- Takime mujore në qendër dhe në kampet rome.
- Takime, fokus grupe të prindërimit pozitiv.
- Organizimi i datëlindjeve të muajt përkatës për fëmijët që frekuentojnë qendrën.
- Organizim I Festave të fundvitit

Familjet rome/egjiptjane, fëmijët e të cilave frekuentojnë rregullisht shkollën/kopshtin, rastet me Urdhër Mbrojtje dhe rastet e referuar nga Avokati i Popullit janë mbështetur çdo muaj me pako ushqimore ofruar nga Fondacioni Shpresë për Botën dhe Foodbank.

Gjatë kësaj periudhe të vitit 2025 janë mundësuar mesatarisht 80 pako ushqimore për familjet përfituese të Qendrës Multifunkionale. Mbështetja ushqimore është ofruar nga “Shpresë për Botën”, Food Bank.

Gjatë vitit 2025 janë menaxhuar dhe ndjekur në total 2 raste UMM/UM të dhunës në familje.

Janë referuar për vlerësim nga Avokati i Popullit 2 raste, për të cilët është bërë vlerësim i situatës social-ekonomike dhe përfshirja e tyre në shërbime mbështetëse. Në bashkëpunim me Shërbimin e Provës monitorohen 2 raste të mitur për veprat penale “Vjedhje” dhe “Drejtimit i mjetit në mënyrë të parregullt”.

Gjithashtu monitorohen 6 nëna/gra rome të cilat janë të dënuara për veprën Penale “Shfrytëzim të fëmijëve për lypje”.

Gjithashtu për këtë kategori përfituesit kanë marrë pjesë në projektin “Bazat për Sukses: Fuqizimi i të rriturve përmes aftësive bazë”, i zbatuar nga Qendra për Aftësi Konkurruese (CCS) në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Gjatë përfshirjes në projekt, individit ka përfituar një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse, përfshirë trajnime në aftësi bazë (shkrim-lexim, matematikë dhe aftësi digjitale), këshillim psiko-social, orientim në karrierë dhe pjesëmarrje në punëtori për zhvillimin e aftësive të buta. Përfituesit janë asistuar në procesin e vlerësimit të nevojave dhe është ndjekur me mentorim individual gjatë gjithë periudhës së trajnimit. Në kuadër të mbështetjes sociale, projekti ka ofruar gjithashtu pako ushqimore dy herë në muaj për të lehtësuar barrën ekonomike të familjeve pjesëmarrëse. Të gjitha shërbimet e ofruara kanë synuar fuqizimin personal, zhvillimin e aftësive dhe rritjen e mundësive për përfshirje në arsim, trajnim profesional dhe tregun e punës.

P.AG141.Q2.O1.A11 Kampi Veror

Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim edhe me OJF partnere organizon çdo vit kampe verore për fëmijët përfitues të Qendrave Komunitare “Për Familjen” dhe jo vetëm. Qëllimi i këtij aktivitetit është të ofrojmë një ambient të sigurt, argëtues dhe edukativ për fëmijët gjatë pushimeve verore, ku ata mund të zhvillojnë aftësitë sociale, emocionale dhe krijuese përmes lojës dhe bashkëveprimit. Kampi veror shërben si një hapësirë ku fëmijët marrin pjesë në aktivitete të larmishme si: lojëra në

natyrë, sport, punë kreative, lexime, ushtrime fizike, vizita kulturore, aktivitete ndërgjegjësuere si dhe tema edukative, të gjitha të udhëhequra nga staf i trajnuar dhe me përvojë. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve kemi synuar të ndihmojmë fëmijët të rriten të lumtur, të sigurt dhe të ndërgjegjshëm, duke ofruar mundësi për të mësuar në mënyrë argëtuese, për të ndërtuar miqësi dhe për të krijuar kujtime të paharrueshme gjatë veres. Edhe këtë vit u realizua kampit veror, i cili u zhvillua përgjatë muajit Qershor me pjesëmarrje të **150 fëmijë në total që** kaluan një aventurë të paharrueshme.

P.AG141Q1.O1.A12. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror- Burimet e veta & të trashëguara

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4307 Prot., datë 10.12.2021 për Fondin Social për Shërbime me Bazë Komunitare 2022 me projekt – propozimin “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror, strukturë e ngritur nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me ACLI-IPSIA.

E përzgjedhur si bashki fituese dhe e vlefshme për financim përmes shkresës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) Nr. 1134/19 Prot., datë 04.05.2022 “Njoftim për përzgjedhjen fitues të projekt propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror””, Strehëza filloi funksionimin e saj të plotë më 01.06.2022.

Me anë të këtij shërbimi të ri dhe alternativ synojmë të ofrojmë një mundësi për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët nuk mund të rriten në një mjedis familjar, duke synuar gjithashtu përfshirjen brenda procesit të deinstitutionalizimit dhe të decentralizimit të nisur në Shqipëri, kryesisht referuar Planit Kombëtar të De-Institutionalizimit 2020-2022 të miratuar së fundmi me VKM Nr. 706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022” dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij. Struktura përmbush standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Strehëza përdor një model marrëdhëniesh, që paraqitet si alternativë e përkohshme ndaj modeleve institucionale të qendrave rezidenciale dhe në përgjithësi, ndaj institucioneve të mëdha, modele që fatkeqësisht vazhdojnë të funksionojnë në vendin tonë. Organizimi i strukturës, duke filluar prej hapësirave fizike deri te veprimtaritë ditore, janë pjesë përbërëse e ndërhyrjes edukative dhe synojnë riparimin e dështimeve të mëparshme ambientale. Gjithashtu, ky shërbim synon të ofrojë edhe strehim emergjent të sigurtë dhe rehabilitues për fëmijët në situata emergjente apo në rrezik të lartë deri në rehabilitimin e plotë të fëmijëve dhe të familjes biologjike me qëllim që të minimizohet koha e qëndrimit të të miturit në Strehëz.

Në strehëz është planifikuar që të ofrohet shërbim deri në kapacitet maksimal për 8 fëmijë të moshës 6 deri në 18 vjeç. Aktualisht pranë kësaj strukture është përmbushur kapacitetit, janë sistemuar 8 fëmijë, me vendim të Komisionit Multidisiplinar të Bashkisë Po ashtu

në Strehëz ofrohet dhe shërbimi emergjent. Ku herë pas herë janë sistemuar raste në shërbimin emergjent, Rastet janë referuar nga NJMf Bashkia Shkodër.

Shërbimi ofrohet nga 7 (shtatë punonjës) i përbërë nga 3 specialistë (në rolin e edukatorëve të cilët punojnë me tre turne) , 2 ndihmës specialiste, sipas standartit 1 edukator për 4 fëmijë, 1 kuzhinier/sanitar, 1 përgjegjës i Strehëzës, personel pjesë e strukturës së Bashkisë Shkodër.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka transferuar fondin për projektin fitues të Bashkisë Shkodër më datë 11.05.2022, përmes shkresës me Nr. 2084 Prot., “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022” dhe shkresës Nr. 69/43 Prot., datë 16.05.2022 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Akordim i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki për vitin 2022”. Deri në datë 31.05.2022 financimi dhe vënia në funksion e strehëzës është siguruar nga financimi i projektit “Komunitetit të së ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës”.

Sipas aplikimit kohëzgjatja e projektit ka qenë 36 muaj (Janar 2022 – Dhjetor 2024), dhe transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër është bërë në tre këste:

Financimi i vitit të parë në masën 90% të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit, ku në fakt ky financim është disbursuar në maj të vitit 2022 në shumën 7,841,995 Lekë që përkon në mënyrë përpjestimore me 7 muaj shërbim.

Viti i dytë i zbatimit të projektit është financuar në masën 60% të vlerës së projektit.

Viti i tretë i zbatimit të projektit është financuar në masën 30% deri sa shërbimi pjesa tjetër mbulohet nga Bashkia Shkodër.

Për shkak të tipologjisë së shërbimit të strehëzës dhe mirëfunksionimit të saj ka qenë e domosdoshme që për ofrimin e shërbimit, financimi në masën 30% të vlerës së projektit të transferohet në buxhetin e Bashkisë Shkodër që në fillim të muajit janar 2025 për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit rezidencial dhe mbulimin e të gjitha kostove operative jetësore të parashikuara me këtë fond sipas linjave të buxhetit më poshtë.

Ndaj Bashkia Shkodër i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale me shkresën Nr.28230 Prot, datë 12.12.2024 me lëndë “Vënie në dijeni dhe kërkesë për kalim fondi”.

Streheza për fëmijët pa kujdes prindëror vepron si një komunitet me dimension familjar, me karakter edukativ me qëllim edukimin fëmijëve pa familje ose me familje në vështirësi, me asistencë përkujdesjeje ditë e natë, organizimi dhe ndihma e kohës së lirë, mbështetje arsimore, formimin kulturor, shoqërimin dhe integrimin e fëmijëve nepërmjet kurseve të ndryshme.

Struktura synon të mbështesë procesin e zhvillimit të fëmijëve, nëpërmjet një organizimi të jetës që lejon marrëdhënie të qëndrueshme dhe emocionalisht të rëndësishme, dhe t'i shoqërojë dhe mbështesë drejt një procesi gradual të autonomisë.

Strehëza ndodhet në lagjen 3 Heronjtë, dhe ka kapacitet të strehojë deri në tetë fëmijë, me dy vende shtesë të rezervuara për rastet emergjente.

Aktualisht në Strehëzën për fëmijët pa kujdes prindëror që me datë 19 Dhjetor 2023 jetojnë 8 fëmijë. Gjashtë nga të cilët janë djem dhe dy vajza (nga mosha 6-17 vjeç)

Gjashtë fëmijë frekuentojnë shkollën 9-vjeçare “Mati Logoreci. Njëri nga fëmijët do të fillojë klasën e parë

Dy më të rriturit frekuentojnë Shkollën Profesionale “Ndre Mjeda” në Bushat në deget Teknologji Ushqimore dhe Bujqesi. (Viti II)

Organizimi: Organizimi i jetës së përditshme është i strukturuar në mënyrë që:

Të favorizojë realizimin e një përvojë individuale vendimtare për fëmijët për zhvillimin dhe maturimin e tyre personal nëpërmjet një organizimi që lejon marrëdhënie të qëndrueshme mes njeri-tjetrit dhe edukatorëve. Çdo ditë në shtëpinë familje është intensive: me disa angazhime, momente loje, përgatitja e vakteve, pastrimi, këshillimi dhe bashkëndarje që e bëjnë çdo ditë unike. Jeta e përditshme nuk është vetëm tërësia e veprimeve të kryera nga pjestarët që jetojnë në shtëpinë familje, por gjithashtu në kushtojmë rëndësi të madhe arsimit dhe edukimit. Brenda një ditë plotësohen së pari nevojat parësore, si të lahët, ushqehet dhe pushojë, nevoja që shumica prej nesh i marrin si të mirëqena, por të cilat nuk janë gjithmonë automatike. Prandaj dita është e strukturuar në mënyrë treguese si ajo e një fëmijë që jeton në një familje "normale", ku ritmet janë lineare dhe shprehite e fituara të sjelljes së përditshme kanë një rol qetësues, dhe një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e secilit.

Qëllimi i këtij organizimi është që në një të ardhme fëmijët të kenë arritur autonominë dhe vendosjen e marrëdhënieve më të shëndetshme me familjet biologjike.

Të inkurajojë pjesëmarrjen e të gjithëve, secili në raport me rolin që luan, me organizimin dhe rregulloren e brendshme për menaxhimin e jetës së shtëpisë, duke shfrytëzuar në maksimum momentet e takimit me njëri tjetrin për një dialog autentik edukativ.

Të favorizojnë arritjen e përvojave të rëndësishme që mbështesin zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe ta shoqërojnë atë drejt një përvetësimi gradual të mjeteve dhe burimet që synojnë promovimin e autonomisë së tij në një të ardhme.

Dosja personale: për çdo fëmijë është mbajtur dhe përditësohet dosja personale, e cila përbëhet nga sa vijon, seksionet:

Administrative - për dokumentacionin e regjistrimit, vendimet e Komisionit Multidisipinar si dhe vendimet e gjykatës.

Sociale dhe psikologjike - për raportet e ndryshme psiko-sociale, si: FID formular i informacionit të domosdoshëm, raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (RVNE), plani i kujdesit, raporte psikologjike.

Janë plotësuar dhe Vlerësimet psiko-social.

Për të gjashtë nga fëmijët gjatë muajit Maj është plotësuar:

-PEI-Plani Individual i Kujdesit

-RVNE-Raporti i Vlerësimit të Nevojave dhe Ecurisë

-Raport psikologjik

-Raport Individual Arsimor

-Po ashtu gjatë kësaj periudhe nga stafi përgjegjës është bërë rishikim i:

--PEI-Plani Individual i Kujdesit

-RVNE-Raporti i Vlerësimit të Nevojave dhe Ecurisë

-Raport psikologjik

-Raport Individual Arsimor

Arsimor - për dokumentimin e punës edukative; Plani i arsimit që është bërë në bashkëpunim me shkollën, Rishikimi i planit të Arsimit, Raport mujor i arsimit nga edukatorët. etj., relacionet nga takimet e shkollës me mësuesit përkatës.

Fëmijët janë asistuar nga stafi për ecurinë në mësim dhe kemi marrë pjesë në çdo takim me mësuesit përkatës.

Janë plotësuar dhe raportet në lidhje me ecurinë mësimore të secilit.

Shëndetësore –Cdo fëmijë është i pajisur me kartelen shëndetësore për dokumentimin e kontrolleve shëndetësore, vizitat rutinë, vaksinimet, fletoret shëndetësore për raportimin nga edukatorët të medikamenteve të administruara në rastet e rekomanduara nga mjekja. Gjatë këtyre muajve fëmijet nuk kanë patur probleme shëndetësore, përveç ndonjë temperature apo viroze të lehta stinore.

Vizita shëndetësore kanë bërë tre fëmijë, për viroze stinë

Djali më i rritur në muajin Qershor pat vrarë kycin e këmbës dhe i është bërë vizitë tek mjeku Ortoped, se bashku më 1 grafi për këmbë dhe ku ortopedi rekomandoi çizmen ortopedike për 4 javë. Me ndihmën e Drejtorit të Shoqatës Madonina del Grappa u bë e mundur gjetja e çizmes

-3 fëmijëve pastrim gurezash në muajin Maj i kemi cuar tek dentistja tek Poliklinika për pastrim gurezash dhe 2 më të rriturit kanë bërë mbushje dhëmballësh tek Poliklinika.

-Po në Muajin Maj është bërë e mundur nga Organizata ‘Shpresa Për Botën’, vizita tek klinika Gjermane e syrit për një fëmijë ku i janë vendosur dhe syzet

Në fund të muajit Prill 8 fëmijëve u janë bërë vizita rutinë nga dy mjek Italian vizita të përgjithshme

2 prej fëmijëve vizite tek Neuropediatria

Aktivitetet e ndryshme: Momentet rikrijuese të përfaqësuara nga udhëtimet dhe shëtitjet konsiderohen jashtëzakonisht të rëndësishme dhe pasuruese si nga pikëpamja e marrëdhënies ndërmjet fëmijëve me njëri tjetrin po ashtu edhe nga pikëpamja e marrëdhënies edukator- fëmijë. Gjatë këtyre muajve, janë organizuar dalje të ndryshme ku fëmijet janë argëtuar, kanë mësuar gjëra të reja dhe janë përfshirë në një realitet ndryshe nga ai i shtëpisë familje. Fëmijët kanë marrë pjesë në aktivitetet të ndryshme për të promovuar argëtimin dhe socializimin.

P.AG141.Q2.O1.A13. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, që ka si qëllim mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit, është arritur që të përmirësohet cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, si dhe është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar festimet e ditëlindjeve për fëmijët në këto institucione rezidenciale. Vazhdon të ofrohet mbështetje me transport për të mundësuar takimet e fëmijët me prindërit biologjikë me qëllim mbajtjen dhe fuqizimin e lidhjeve afektive mes tyre. Këto aktivitete janë organizuar gjatë kësaj periudhe në të tre institucionet rezidenciale të Bashkisë Shkodër. Për disa fëmijë është mundësuar të realizohet takimi me familjet biologjike pranë banesave të tyre në qytete të tjera të Shqipërisë.

P.AG141.Q2.O1.A14 Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve & të trashëguara

Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në bashkinë Shkodër vazhdon të jetë funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.

Gjatë vitit 2025 janë organizuar disa mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 46 pika gj bashkitë janë përgjegjëse për financimin

e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe Planit për Aftësim Prindëror. Në këtë kuadër për funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, Bashkia Shkodër ka planifikuar të financojë shërbimet sociale mbështetëse, si pako ushqimore dhe higjieno-sanitare, si dhe veshmbathje për fëmijët me masë mbrojtëse dhe familjen me qëllim fuqizimin social ekonomik të familjes si qeliza bazë e shoqërisë.

P.AG141.Q2.O1.A15. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen & të trashëguara.

Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre është një ndër sfidat më të rëndësishme për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar familje me fëmijë në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre me qëllim parandalimin e institucionalizimit, dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim deinstitutionalizimin e tyre.

Në bashkëpunim me organizatat “Nisma Arsis” dhe “SOS- Fshatrat e Fëmijëve”, janë realizuar takime, fokus grupe dhe fushata ndërgjegjësuere me fokus fuqizimin e familjes si bërthama bazë e shoqërisë dhe parandalimin e institucionalizimit.

Gjithashtu janë realizuar sesione informuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe informacionin mbi shërbimin e kujdestarisë ligjore si mundësia më e mirë për fëmijët pa kujdes prindëror. Janë realizuar trajnime për stafet e Shërbimeve Sociale dhe stafet që punojnë në IPSH, stafet psiko-sociale të shkollave në Shkodër mbi për procesin e DE-I. Fokusi i këtyre trajnimeve është zgjerimi i formave alternative me bazë familjen për fëmijët, drejt deinstitutionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Informimi mbi këtë shërbim dhe advokimi i familjeve kujdestare të interesuara, vazhdon të jetë sfida e cila do të ketë vëmendjen e veçantë të Bashkisë Shkodër, në mënyrë që paralelisht ky shërbim të sigurojë mbrojtjen shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe respektimin e të drejtave të tyre.

P.AG141.Q2.O1.A16 Realizimi i Aktiviteteve për Rininë.

Gjatë vitit 2025, Qendra Rinore “Atelie” në Shkodër u shndërrua në një qendër aktive zhvillimi për të rinjtë, duke ofruar një program gjithëpërfshirës aktiviteteve edukative, sociale, kulturore dhe profesionale. Nëpërmjet një qasjeje të integruar që kombinon edukimin joformal, kreativitetin, ndërgjegjësimin qytetar dhe orientimin drejt punësimit, Qendra kontribuoi në fuqizimin e të rinjve dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në komunitet.

Në fokus të veçantë ishin iniciativat mujore rinore si “Super Youth”, podcasti “Jepi Za” dhe “Kinerinore”, të cilat krijuan hapësira të reja komunikimi, reflektimi dhe argëtimi për të rinjtë. Përmes ciklit të diskutimeve “Ta tham n’Shkodër”, të zhvilluara në ambientet e Kinema “Republika”, të rinjtë patën mundësinë të bashkëbisedojnë drejtpërdrejt me

profesionistë dhe figura frymëzuese, duke ndarë përvoja, sfida dhe vizione për të ardhmen.

Në kuadër të zhvillimit të sipërmarrjes rinore dhe inovacionit, u realizuan një sërë trajnimesh dhe workshop-esh, përfshirë “Shkëmbim idesh dhe gjetje idesh”, “Public Speaking & Pitching”, YEA Talk dhe StartUp Stories, të cilat synuan forcimin e aftësive prezantuese, komunikimin efektiv dhe ndërtimin e ideve të qëndrueshme. Këto iniciativa kulmuan me konkursin YEA Aëards, që shërbeu si platformë konkrete për promovimin e ideve të reja dhe angazhimin e të rinjve në sipërmarrje.

Një shtyllë e rëndësishme e punës së Qendrës ishte orientimi profesional dhe përgatitja për tregun e punës. U zhvilluan trajnime mbi shkrimin e CV-së dhe letrës motivuese, këshillim karriere dhe menaxhim të aftësive personale, si dhe Panairi i Punës dhe Karrierës në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Përmes kurseve pas-shkollore “YEA! Afterschool” dhe trajnimeve profesionale në turizëm dhe mikpritje, programim, gjermanisht, matematikë, sisteme teknike dhe teknike mediatike, të rinjtë fituan aftësi konkrete për integrim në tregun lokal të punës. Paralelisht, u realizuan projekte që synojnë punësimin e denjë dhe vetëpunësimin, si “Të rinjtë PRO punësimit të denjë” dhe “Të rinjtë sfidojnë papunësinë në Ballkan”.

Në aspektin social dhe të mirëqenies, Qendra Rinore “Atelie” u angazhua në projekte me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin mendor dhe përfshirjen sociale. Projekti Erasmus+ “Hold On” shënoi një hap të rëndësishëm për institucionet publike vendore, ndërsa Inclusive EduJobs ofroi trajnime për psikologë dhe punonjës socialë në mbështetje të fëmijëve romë dhe egjiptianë. Përmes YOU(th) CARE dhe Poëer4AY, u zhvilluan sesione mbi mirëqenien, përfshirjen dhe fuqizimin e të rinjve, duke përfshirë edhe Këshillin Vendor Rinor dhe administratorët lokalë.

Një tjetër komponent i rëndësishëm ishte ndërgjegjësimi qytetar dhe mjedisor. Në kuadër të projekteve Youth Care for Change, “Hot and Happening – Fëmijët Kampionë të Klimës” dhe aktiviteteve mbi ekonominë qarkulluese dhe aftësitë e gjelbra, të rinjtë u përfshinë në module edukative mbi ndryshimet klimatike, qëndrueshmërinë dhe rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit. Ata kontribuan në hartimin dhe finalizimin e Planit Lokal për Mbrojtjen e Mjedisit të Bashkisë Shkodër, realizuan aktivitete pastrimi në Velipojë, mbjellje pemësh, vizita studimore dhe fushata sensibilizuese në Liqenin e Shkodrës.

Në fushën kulturore dhe artistike, Qendra organizoi konkurse fotografie dhe poezie, ekspozita, promovime librash, biseda letrare dhe klube poezish, duke krijuar hapësira të qëndrueshme për shprehjen kreative të të rinjve. Shkolla Verore 2025 përfshiu aktivitete si Ëikimedia/Editathon, yoga, stilim, Arts & Crafts dhe punëtori reflektuese “Dritëhije pa filtra”, duke kombinuar edukimin joformal me mirëqenien dhe zhvillimin personal.

Gjatë vitit u zhvilluan gjithashtu aktivitete ndërgjegjëse mbi antikorrupsionin, sigurinë online, trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhunën me bazë gjinore, si dhe iniciativa sociale si Pedalimi Rozë, Shtepiza Rinore për familje në nevojë, shpërndarje ndihmash për të moshuarit e vetmuar, aktivitete festive për fëmijë dhe realizimi i muraleve në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit.

Në përmbyllje, përmes këtij spektri të gjerë aktiviteteve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucione publike, organizata kombëtare dhe partnerë ndërkombëtarë, Qendra Rinore “Atelie” gjatë vitit 2025 kontribuoi në ndërtimin e një komuniteti rinor më aktiv, më të ndërgjegjshëm dhe më të përgatitur për sfidat sociale, ekonomike dhe mjedisore, duke fuqizuar rolin e të rinjve si aktorë kyç në zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Shkodrës.

P.AG141.Q2.O1.A17 Koncerti "Youth Wave"

Koncerti "Youth Wave" është realizuar me datë 12 Gusht 2025 në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, duke vënë në qendër të vëmendjes të rinjtë si një forcë aktive në zhvillimin e komunitetit. Ky aktivitet është pjesë e një angazhimi të Bashkisë Shkodër për të mbështetur dhe promovuar talentet e reja, sipërmarrësit e rinj dhe shërbimet që u ofrohen të rinjve, në një mjedis ku rinia nxit inovacion dhe ndryshim.

Qëllimi i këtij eventi është të krijojë një hapësirë ku të rinjtë e talentuar nga Shkodra të kenë mundësinë të tregojnë aftësitë e tyre artistike dhe profesionale. Koncerti përfshin një kombinim të performancave artistike nga të rinjtë në formë koncerti ku u zgjodhën tre këngëtarët më të mirë nga një juri profesionale, si dhe performanca nga artistë të mirënjohur që frymëzojnë brezat e rinj. Ky aktivitet jo vetëm që ofron argëtim dhe kulturë, por gjithashtu shërben si një mundësi për të rinjtë që të angazhohen me publikun dhe të ndajnë talentet e tyre në një platformë të madhe.

P.AG141.Q2.O1.A18 Panairi për të rinjtë

Panairi për të rinjtë është një nismë rinore e fokusuar në krijimin e mundësive konkrete për punësim, orientim karriere dhe zhvillim profesional për të rinjtë. Ky projekt ka si synim të mbledhë në një vend të përbashkët të rinj në kërkim të mundësive të reja dhe përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të punësimit, përfshirë kompani private, institucione publike, organizata joqeveritare dhe ofrues të programeve trajnuese. Eventi është projektuar për të inkurajuar të rinjtë të eksplorojnë fusha të reja dhe të identifikojnë mundësi të përshtatshme për zhvillimin e tyre profesional në një treg pune gjithnjë e më dinamik. Ky projekt nuk është realizuar në 2025 por pritet të realizohet përgjatë vitit 2026 përmes mbështetjes së OJF-ve, donatorëve, bizneseve dhe institucioneve lokale.

P.AG141.Q2.O1.A19 Personazhe në fokus

Projekti "Personazhe në Fokus" është një nismë e përmuajshme dedikuar të rinjve dhe ka si synim krijimin e një platforme të qëndrueshme për dialog, inspirim dhe shkëmbim përvojash me personalitete të njohura. Çdo muaj, figura publike nga fusha të ndryshme, si arti, kultura, biznesi, politika, sporti etj, janë ftuar për të ndarë rrugëtimin dhe sfidat e tyre përmes një diskutimi të hapur përpara të rinjve. Ky projekt vjen si përgjigje ndaj nevojës për modele të reja, reale dhe të prekshme, të cilat do të mund t'i japin një perspektivë të re dhe të ndihmojnë brezin e ri për t'u rritur dhe për të gjetur një rrugë të tyre drejt suksesit dhe përmbushjes personale. Janë realizuar 8 edicione me të ftuar të ndryshëm si: Arlinda Causholli, Irena Topalli, Islami Islami, Aledia Bilali, Bekim Balaj, Fjona Bashi, Altin Prenga dhe Nelson Hysa.

P.AG141.Q2.O1.A20 Zhvillimi i konkurseve për rininë

Zhvillimi i konkurseve është realizuar me qëllim krijimin e një ambienti sa më stimulues, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për të rinjtë e komunitetit, duke synuar nxitjen e pjesëmarrjes aktive dhe zhvillimin e potencialit të tyre krijues. Përmes këtyre iniciativave, është synuar promovimi dhe vlerësimi i talenteve të reja, si dhe ofrimi i një hapësire ku të rinjtë mund të shprehin lirshëm idetë, emocionet dhe aftësitë e tyre artistike e kulturore. Konkursat janë organizuar në fusha të ndryshme si muzikë, fotografi dhe poezi, duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë të eksplorojnë forma të ndryshme të shprehjes kreative dhe të angazhohen në aktivitete që i frymëzojnë dhe motivojnë. Këto aktivitete kanë shërbyer jo vetëm si platformë prezantimi për talentet e tyre, por edhe si një mjet për forcimin e vetëbesimit, ndërtimin e aftësive sociale dhe krijimin e lidhjeve pozitive mes të rinjve.

P.AG141.Q2.O1.A21 Karta e studentit

Karta e Studentit është një projekt për të cilin akoma po punohet për t'a finalizuar dhe ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e jetës së studentëve, duke krijuar mundësi për të përfituar lehtësi dhe zbritje në një gamë të gjerë shërbimesh dhe produkteve. Përmes Kartës së Studentit, studentët do të kenë akses të zgjeruar në shërbime publike dhe private me kostot të reduktuara, duke përfshirë transportin publik, libraritë, shërbimet shëndetësore dhe ato të mirëqenies, aktivitetet kulturore dhe artistike, si dhe shumë fushat të tjera që ndikojnë në përditshmërinë e tyre.

P.AG141.Q3.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të shërbimit për administrimin e drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paaftësive & të trashëguara

Është realizuar në kohë sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë, të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i

punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P.AG141.Q3.O1.A2 Ndhimë ekonomike me transfertë të kushtëzuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin Janar – 1774 familje, nga të cilat: 1573 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 201 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shkurt - 1776 familje, nga të cilat: 1573 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 203 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars - 1726 familje, nga të cilat: 1525 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 201 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill - 1704 familje, nga të cilat: 1507 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 197 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Maj - 1715 familje, nga të cilat: 1518 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 197 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Qershor - 1657 familje, nga të cilat: 1467 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 190 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Korrik - 1617 familje, nga të cilat: 1435 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 182 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Gusht - 1602 familje, nga të cilat: 1424 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 178 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shtator - 1582 familje, nga të cilat: 1399 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 183 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Tetor - 1582 familje, nga të cilat: 1397 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 185 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Nëntor - 1580 familje, nga të cilat: 1396 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 184 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Dhjetor - 1596 familje, nga të cilat: 1410 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 186 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Gjithashtu duhet të theksojmë faktin se pagesa e muajit Dhjetor 2024, për familjet që trajtohen me fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës deri në 6%, për 199 familje në vlerën 793 507 lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2025.

Ndërsa pagesa e muajit Dhjetor 2025, për familjet që trajtohen me fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës deri në 6%, pas miratimit në mbedhjen e Këshillit Bashkiak të muajit janar 2026 do të paguhet me çeljen e fondeve të reja të vitit kalendarik 2026.

Për kryerjen e këtyre pagesave fondet mujore të çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

Ndihma Ekonomike: Janar-Shkurt 31 362 000 lekë, Mars-Prill 28 210 00 lekë, Maj-Qershor 28 349 000 lekë, Korrik-Gusht 27 252 000 lekë, Shtator-Tetor 26 840 000 lekë, Nëntor-Dhjetor 22 317 000 lekë, shpërblimi i fundvitit 23 715 000 lekë.

Fondet faktike për pagesën e ndihmës ekonomike për vitin 2025 janë: 183 302 622 lekë.

Në zbatim të Vendimit nr. 835, datë 30.12.2025 “Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta, për vitin 2025”, përfitues të shpërblimit të fundvitit kanë qenë 1596 familje/individë me fond total 23 940 000 lekë.

P.AG141.Q3.O1.A3 Pagesë PAK dhe Invaliditeti me transfertë të kushtëzuar

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar; Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar.

Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 3841, në Shkurt 3883, në Mars 3921, në Prill 3911, në Maj 3963, në Qershor 3963, në Korrik 3937, në Gusht 4014, në Shtator 4004, në Tetor 4018, në Nëntor 4021, në Dhjetor 3993.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempit ka qenë: në muajin Janar 24 persona.

Referuar vendimit nr.722 dt. 13.12.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 869, dt.18.06.2008, të Këshillit të Ministrave, “ Për Zbatimin e ligjit nt. 7889, dt. 14.12.1994, “Statusi i invalidit”, të ndryshuar” shtesa mujore e invalidit paguhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore së bashku me pensionin e invalidit apo të pleqërisë duke filluar nga muaji janari 2025.

Gjithashtu duhet të theksojmë faktin se pagesa e muajit Dhjetor 2024 invalidë pune për 84 persona me fond 272 600 lekë për mungesë fondi janë paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2025.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

PAK: Janar - Shkurt 119 758 000 lekë, Mars - Prill 113 729 000 lekë, Maj - Qershor 113 819 000 lekë, Korrik - Gusht 115 437 000 lekë, Shtator - Tetor 116 578 000 lekë, Nëntor - Dhjetor 136 571 000 lekë, shpërblimi i fundvitit 46 965 000 lekë.

Fondet faktike për pagesën e aftësisë së kufizuar për vitin 2025 janë: 760 945 918 lekë.

Në zbatim të Vendimit nr. 854, datë 26.12.2024 “Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta, për vitin 2024”, përfitues të tjerë shtesë për shpërblimet e fundvitit 2024 kanë qenë 48 persona, me fond 720 000 lekë.

Në zbatim të Vendimit nr. 835, datë 30.12.2025 “Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta, për vitin 2025”, përfitues të shpërblimit të fundvitit kanë qenë 4005 persona, me fond 60 075 000 lekë.

P.AG141.Q4.O1.A1. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare “Për Familjen” & të trashëguara.

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare “Për Familjen”, janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

P.AG141Q4.O1.A2. Blerje Kancelari për Qendrat Komunitare “Për Familjen” & të trashëguara

Është kryer procedura e prokurimit dhe lidhur kontrata dhe mare ne dorezim.

P.AG141.Q4.O1.A3. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare Multifunkionale & të trashëguara

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psiko- sociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimive sociale në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Në kuadër të rrjetit për ofrimin e shërbimive sociale dhe gjithashtu në kuadër të nevojave të territorit, përveç qendrave komunitare, Bashkia e Shkodrës, është angazhuar edhe në ngritjen e qendrave multifunkionale të specializuara si më poshtë:

- Qendra Rinore”Atelie” – e cila i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni, etj. Kjo qendër është realizuar në kuadër të zbatimit të projektit YES Future, financuar nga programi IADSA.
- Qendra komunitare multifunkionale “Për Familjen” – është një qendër e është ndërtuar, në tetor 2018, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” në bashkëpunim me UNDP, financuar nga BE.
- Qendra “Harmonia” për ofrimin e shërbimit të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm- e ngritur në vitin 2021, në kuadër të projektit “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në

Bashkinë e Shkodrës” në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e cila ofron shërbime për fëmijët e diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik.

- Qendra Multifunkionale Xixëllonjat me hapësira për qendër komunitare “Për Familjen”, qendër shëndetësore për lagjen, kopsht & çerdhe dhe zyrë administrative të bashkisë Shkodër, hapësira për të rinj, hapësira për të moshuar. Kjo ndërhyrje është kryer në zbatim të projektit “Shërbime multi-funkionale të Shkodrës – Model i përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”, të financuar nga Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA), i qeverisë Italiane dhe Bashkisë Shkodër dhe projektit EU4Municipalities “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”.
- Çdo Qendër Komunitare “Për Familjen” (13 qendra) dhe Qendra Multifunkionale kanë në përbërje personel specialistësh të fushës sociale që shërbejnë, të financuar nga Bashkia e Shkodrës e cila njëkohësisht financon edhe kostot operative të funksionimit të këtyre qendrave.

P.AG141.Q4.O1.A3/1. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare Multifunkionale & të trashëguara.

Në këtë aktivitet është përfshirë shtesa për sanitare dhe gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me pagesën për punojësit sanitare për mirëmbajtje të qendrave Komunitare, Multifunkionale.

Paga dhe shtesat mbi paga. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të pages bazë minimale në shkallë vendi, Vendimit nr.113, datë 01.03.2023 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar, në mbështetje të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar ; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike”, i ndryshuar.

P10430.Q4.O1.A4 Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të Qendrës Rinore Atelie -TË TRASHËGUARA

Janë në proces gjatë gjithë vitit pagesat për shërbime nga të tretë nga Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike për Qendren Rinore Atelie. Është realizuar mirëmbajtje e objekteve social kulturore.

P.AG141.Q4.O2.A1. Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa & të trashëguara

Opera Madonnina del Grappa, është një organizatë e licensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të personave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloj ristrukturimin i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjellë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit të fëmijëve, por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoi krijimin për herë të parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe të krijimit të Shtëpisë Familje. Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 20 persona me aftësi të kufizuar. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integruar duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e linjës. Mbështetja e shtëpive – familje të “Opera Madonnina del Grappa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër mbështet “Opera Madonnina del Grappa” duke mbuluar shpenzimet operative për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë “Opera Madonnina del Grappa”, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Bashkisë Shkodër dhe “Opera Madonnina del Grappa”.

P.AG141.Q4.O2.A2. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuar. & të trashëguara

Projekti Shpresa, është një organizatë e licensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK-të e braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti “Shpresa” ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 65 persona me aftësi të kufizuara. Projekti “Shpresa”, duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit “Shpresa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuar dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetësore 65 individë me aftësi të kufizuara.

P.AG141.Q4.O2.A3. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar, më 3 Dhjetor. & të trashëguara

3 Dhjetori - Dita Botërore e Personave me Aftësi të kufizuar, synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integrimit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar janë realizuar disa aktivitete. Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Kjo ditë synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integrimit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore.

P.AG141.Q4.O2.A4. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi të kufizuar"& të trashëguara

Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit. "Trupa muzikore e PAK-ve" përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi të kufizuara, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale "3 Dhjetori". Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin: Mundësi integrimi për të gjithë. Trupa Muzikore përbëhet nga 24 të rinj me aftësi të kufizuar. Gjatë kësaj periudhe kjo bandë ka punuar dhe vazhduar provat dhe ka arritur të marrë pjesë dhe të performojë në aktivitete të ndryshme.

P.AG141.Q4.O2.A5. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit & të trashëguara

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmoshave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Në ndihmë të kësaj shtrese është realizuar si vitet parardhëse shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale, dhe jo vetëm, banorë të Bashkisë Shkodër, me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.

P.AG141Q4.O2.A6. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. & të trashëguara

Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr.9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe

mënyrën e procedimit tij”, i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021). Në bashkinë e Shkodrës, që në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për riorganizimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjëse në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Krahës këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

P.AG141Q4.O2.A7. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore. & të trashëguara.

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t’u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, pas nënshkrimit të kartës evropiane për barazi gjinore, është angazhuar në hartimin dhe miratimin e planit vendor gjinor si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet

e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjëse në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

P.AG141.Q4.O2.A8. TVESA@SH– Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër & të trashëguara

Projekti: “Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@SH)”, zbatohet nga organizata Të Ndryshëm të Barabartë në rolin e Liderit të Projektit, ku Bashkia Shkodër dhe organizata KMOP (Greqi) janë partnerë. Projekti është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime: EuropeAid/170610/DD/ACT/AL – “Partneritete në nivel lokal për avancimin e përfshirjes sociale në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian me fonde të programit IPA. Ky projekt sa i takon pjesës së Bashkisë Shkodër parashikon ndërhyrjen në infrastrukturën e qendrës komunitare “Për Familjen” Nj.A. Dajç, fshati Shirq, si dhe fuqizimin e kësaj qendre duke ofruar shërbime në ndihmë të grave dhe fëmijëve viktimë të dhunës të të gjithë bashkisë.

Buxheti total i projektit është 39,651,431.8 Lekë, nga të cilat financimi i Bashkimit Evropian do të jetë në masën 90% të kostove të pranueshme në vlerën 35,686,290.3 Lekë. Buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 8,739,629.5 Lekë nga të cilat 90% në vlerën 7,865,673.7 Lekë do të financohen nga donatori dhe 10% do të jetë bashkëfinancim i Bashkisë Shkodër me anë të burimeve të veta (staf ekzistues).

Shpenzimet e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve nuk njihen si kosto të pranueshme nga donatori. Fondi me vlerë 447,000 lekë i cili mbulon vlerën e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve, është marrë nga teprica e fondeve nga buxheti i miratuar tek programi 9240 “Arsimi i mesëm profesional”, artikull 231, me kod projekti 1410562 me emërtim “Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës veterinarë”, kontrata me Nr. 18397/12 Prot., datë 20.12.2021 me vlerë 10,056,694 lekë. Ky fond kalon tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, kod 231, me emërtim “Mbulim i vlerës TVSH dhe 5% garanci”. Fondi me vlerë 200,000 lekë i cili mbulon vlerën e TVSH-së është marrë nga teprica e fondeve nga buxheti i miratuar tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” nga fondi i zërave shpenzime korrente të trashëguara nga viti 2023.

Projekti është miratuar me VKB nr. 49, datë 27.09.2022 “Për miratim shtesë plani ne buxhetin e Bashkisë Shkodër”.

Qëllimi i aktiviteteve ka qenë që të zhvillojmë sa më shumë aktivitete prind-fëmijë pasi kanë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve. Përmes këtyre aktiviteteve synojmë përfshirjen e pjesëmarrësve, bashkëpunimin dhe qasjen me komunitetin, krijimi i grupeve vullnetar, ofrimin e mbështetjes psiko-emocionale, riintegrimin e përfituesve në komunitetin ku jetojnë dhe në tërësi mbështetje për fuqizimin e tyre. Projekti ka perfunduar.

P.AG141.Q4.O2.A9. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi & të trashëguara

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash. Në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas u realizua një fushatë ndërgjegjësuere e shtrirë përgjatë të gjithë javës. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare "Për Familjen", shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka "Marin Barleti", Muzeu "Oso Kuka", Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

P.AG141.Q4.O2.A10. Kujdesi social ndaj moshës së tretë & të trashëguara

Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve është një ditë e veçantë për personat e moshës së tretë në të gjithë botën. Pleqëria është një prej rregullave të pandryshueshme të krijimit dhe një nga periudhat e rëndësishme të ciklit të jetës. Diskutimet janë përqendruar në tema të tilla si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat e kësaj moshe, puna vullnetare, kujdesi social dhe gjetja e mënyrave sa më përfshirëse për personat e moshuar, në fuqinë punëtore. Një problem shqetësues në vendin tonë është ndryshimi i dinamikave brenda familjes shqiptare, ku si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve social-ekonomike, kulturore, etj, fëmijët kanë prirje për të jetuar vetëm, për të emigruar dhe për t'u shkëputur nga familja. Një ndryshim i tillë në konceptin dhe traditën e familjes shqiptare, ka bërë që të kemi një rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm, pa përkujdesjen dhe vëmendjen e nevojshme. Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të moshuarve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme. Pranë qendrës komunitare "Për Familjen" Nr.4, Bashkia e Shkodrës ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambjentet e qendrës dhe jashtë saj.

P.AG141.Q4.O2.A11. “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”- BRENDA THESARIT

Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë” është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nëpërmjet këtij projekti është financuar krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të moshës së tretë, që synojnë e tyre, rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre. Janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të projektit.

P.AG141.Q4.O2.A11. “Kafe me gjyshërit” në Qendrën Komunitare “Për Familjen” Nr.4

Pranë qendrës komunitare “Për Familjen”Nr.4, Bashkia e Shkodrës ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambjentet e qendrës dhe jashtë saj. Në kuadër të iniciativave për përmirësimin e shërbimeve sociale për të moshuarit, Bashkia Shkodër, nëpërmjet Qendrës Komunitare për Familjen Nr. 4, ka fuqizuar shërbimet aktuale një anë të nismës të quajtur "Kafe me Gjysherit". Ky shërbim ka për qëllim të shërbejë si një shtysë për krijimin e një hapësirë edhe më sociale dhe mbështetje për të moshuarit, ku ata mund të mblidhen, të ndajnë eksperiencat e jetës, dhe të përfitojnë aktivitete të ndryshme kulturore dhe sociale. "Kafe me Gjysherit" ofron mundësi për krijimin e lidhjeve miqësore, zhvillimin e aftësive dhe ofron mbështetje psikologjike për ata që mund të kenë nevojë. Kjo nismë synon të përmirësojë cilësinë e jetës për të moshuarit, duke i inkurajuar ata të jenë aktivë dhe të angazhuar në aktivitete që kontribuojnë në mirëqenien e tyre fizike dhe mendore.

P.AG141.Q4.O2.A12. Punësim dhe mësim për përfshirje sociale- LLOGARI JASHTË THESARI & të trashëguara

Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e Skemës së Granteve “Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri”, ku Autoriteti Financues përfaqësohet nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, më 14.07.2024 me projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale”. Projekti me nr. ref: IPA/2022/432-813 është përzgjedhur fitues për lidhjen e kontratës së grantit. e cila u nënshkrua më 28.09.2024

Buxheti i financuar nga Autoriteti Financues (donatori) për Bashkinë Shkodër është 60,000 Euro (6,404,700 Lekë), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Projekti është duke u zbatuar me llogari jashtë thesari. Kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% dhe kosto të tjera në vlerën 300,000 lekë sipas nenit 14.4 të kontratës së grantit.

Nëpërmjet projektit “Puno dhe Mëso për Përfshirjen Sociale” synojmë të reduktojmë hendekun socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian për të rritur pjesëmarrjen e tyre në komunitetin e Shkodrës.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është:

Ulja e hendekut socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian drejt integritetit konkret në shoqërinë e qytetit.

1. Krijimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim;
2. Rritja e numrit dhe performancës së fëmijëve të regjistruar në shkolla duke i mbështetur me bursë.

Aktivitetet kryesore:

- **Puna në Komunitet**

- Aktiviteti 1- Krijimi i procedurave të brigadës***

- A1.1 Procedurat e përzgjedhjes së punonjësve në Programin e Punëve në Komunitet***

- Për shkak të çështjeve administrative, implementimi i Programit të Punëve në Komunitet ka patur vonesa. Këto çështje kanë gjetur zgjidhje në muajin gusht 2024 për të vazhduar me aplikimin e Bashkisë Shkodër për PPPK, në datën 29 gusht 2024.

- Koordinatori i projektit ka realizuar takime në zonat e qytetit ku jetojnë komuniteti R/E për t’i informuar për programin e punësimit. Bazuar në listat e ofruara nga AKPA për punëkërkes të papunë të komunitetit R/E janë përzgjedhur 13 persona të interesuar për punësim të cilët plotësojnë edhe kriteret e VKM-Nr.535 për PPPK. Këto punonjës kanë nënshkruar kontratat individuale të punës dhe Marrëveshjen tripalëshe mes Bashkisë Shkodër dhe AKPA me 30 shtator 2024.

- Aktiviteti 2- Punët në komunitet***

- A.2.1 Punët në zonat turistike***

- Në zbatim të Programit të Punëve Publike në Komunitet, punonjësit e përzgjedhur nga listat e AKPA janë të punësuar nga data 1 tetor në pozicionet e punëve si më poshtë:

- 1. Lulzime Karmeshtna, sanitare te shkolla Pashko Vasa
 2. Aferdita Behari, sanitare te konvikti i shkollës së Muzikës

3. Nuriye Rexha, ndihmëse te kopshti Bep Tusha
4. Rexhep Hamzi, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
5. Melidjon Domi, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
6. Anjeza Muhaxhiri, sanitare tek Qendra Multifunksionale “Për familjen”
7. Suela Shkallina, sanitare tek Qendra Multifunksionale “Për familjen”
8. Muhamet Kapllani, roje te shkolla Pyjore
9. Durim Liku, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
10. Lutfi Muharremi, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
11. Laura Liku, sanitare tek Qendra Komunitare Qendra Komunitare nr. 5
12. Rrezartë Muharremi, sanitare tek qendra “Harmonia”
13. Gjergji Jashari, Magazina e ushqimeve për kopshtet e cerdhet.

Sipas projektit, paga e punonjësve është me dy burime financimi, nga AKPA dhe nga fondet e projektit. Shtesë kontrate për shtesën e pagës për punonjësit, e cila paguhet me fondet e projektit është nënshkruar me 1 dhjetor 2024.

Gjatë kësaj periudhe tetor-dhjetor të gjithë punonjësit janë paraqitur në punë duke patur si evidencë listë- prezencat dhe foto gjatë punës. Gjithashtu, përsoneat përgjegjës në vendet e punës ku ata punojnë janë të kënaqur me punën e tyre!

Në projekt është parashikuar që të këtë një mbikqyrës për punonjësit e përfshirë në programin e punëve në komunitet.

Përzgjedhja e mbikqyrësit/ ekspertit të punës në komunitet është bërë me procedurë prokurimi; kontrata e shërbimit është lidhur me 26.12.2024.

Për realizimin e punëve në komunitet, sipas buxhetit të parashikuar janë blerë materiale si prerëse bari me procedurë prokurimi. Nga fillimi i vitit 2025 Programi i Punëve në Komunitet ka vazhduar normalisht, punonjësit e angazhuar në program kanë vazhduar punën sipas pozicioneve të përcaktuara të punës. Mbikqyrësi i Punëve në Komunitet ka raportuar pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik me listë- prezencat dhe foto gjatë punës. Gjatë muajit janar 2025 ka patur largim të një punonjësi, Gjergji Jashari, i cili ka dhënë dorëheqjen. Më pas, kanë dhënë dorëheqjen me 1 korrik 2025 punonjësit Durim Liku dhe Laura Liku. Me 1 gusht 2025 është larguar nga programi edhe një punonjës tjetër, Rexhep Hamzi. Punonjësit janë paguar pjesërisht nga AKPA, në shumën 20,000 lekë dhe pjesërisht me fondet e projektit, në shumën 15,520 lekë, duke realizuar pagën minimale të miratuar me ligj. Në projekt kemi patur raste ku një familje është njëkohësisht përfituese e programit të punësimit dhe programit të bursave, me prindërit të punësuar dhe fëmijën që ka përfituar bursën. Programi “Punë në komunitet” ka përfunduar me 31 gusht 2025, ku punonjësit kanë realizuar 8 muaj punë sipas shtesës së kontratës për shtesë page, që është financuar me fondet e donatorit.

- **Bursat**

Aktiviteti 1 – Përzgjedhja e fëmijëve/ familjeve përfitues të skemës së bursave

A1.1- Hartimi i skemës së pjesëmarrjes – Aktivitet i realizuar

Bashkia Shkodër ka shpallur thirrjen publike për Programin e Bursave “Back to school” në datën 26 mars 2024 në faqen ëeb. Shkollat e caktuara në thirrjen publike janë:

1. Pashko Vasa

2. Ndre Mjeda
3. Liria
4. Ali Lacej
5. Mati Logoreci
6. Isuf Tabaku
7. Edith Durham
8. Ruzhdi Daca

Shkolla Liria ka numrin më të madh të nxënësve R\E me rreth 105 nxënës dhe gjithashtu numrin më të madh të aplikantëve.

A1.2 Procedurat e përzgjedhjes së nxënësve – Aktivitet i realizuar

Pas fazës së aplikimeve, janë dorëzuar në total 83 aplikime, konkretisht: 59 aplikime nga shkolla Liria; 19 aplikime nga shkolla Ali Lacej; 2 aplikime nga shkolla Ndre Mjeda, 2 aplikime nga shkolla Isuf Tabaku; 1 aplikim nga shkolla Pashko Vasa. Në vazhdim është krijuar një komision vlerësimi me urdhër të brendshëm me 2 maj 2024. Grupi i punës vendosi kriteret e vlerësimit si më poshtë:

Rezultatet mësimore

Frekuentimi në shkollë

Situata ekonomike e familjeve të nxënësve

Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit të aplikantëve, komisioni i vlerësimit vendosi miratimin e listës së përfituesve të programit të bursave “Back to school” me 21 maj 2024. 30 nxënës janë përzgjedhur , konkretisht : 21 nxënës nga shkolla Liria, 7 nxënës nga shkolla Ali Lacej, 1 nxënës nga shkolla Isuf Tabaku dhe një nxënës nga shkolla Pashko Vasa.

Aktiviteti 2- Implementimi i skemës së bursave

A2.1- Blerja e materialeve shkollore për nxënësit - Aktivitet i realizuar

Për të ndihmuar familjet e nxënësve përfitues të programit të bursave është planifikuar të jepen materiale shkollore. Blerja e materialeve shkollore si canta, materiale didaktike, libra paisje kancelarike për 30 nxënësit është realizuar me procedurë prokurimi. Këto materiale shkollore u shpërndanë me fillimin e vitit të ri shkollor 2024- 2025 pranë Qendrës Multifunkionale “Për familjen” me 6 shtator 2024.

Skema e bursave gjithashtu përfshin një pagesë prej 50 euro për cdo nxënës për një periudhë 10 mujore. Për realizimin e këtyre pagesave, Bashkia Shkodër ka lidhur një Akt-Marrëveshje me Postën Shqiptare, filiali Shkodër që është nënshkruar me 24 maj 2024.

Janë realizuar disbursime të pagesave të bursave për muajt: maj 2024, shtator 2024, tetor 2024, nëntor 2024, dhjetor 2024, janar 2025, shkurt 2025, mars 2025, prill 2025, qershor 2025 për 30 nxënësit përfitues.

Nga programi i bursave kanë përfituar të gjithë nxënësit deri në përfundimin e tij duke realizuar disbursimet e pagesave për 10 muaj, sic ishte planifikuar në projekt.

A2.2 Mbështetja për nxënësit

Në zbatim të planit për klasat pas shkolle, Ekspertja e zgjedhur me procedurë prokurimi për programin e Bursave, ka zhvilluar takime me nxënësit përfitues të bursave. Gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor 2024, janë zhvilluar klasat pas shkolle në ambjentet e shkollës "Liria" me nxënësit e kësaj shkolle të cilët përbëjnë edhe numrin më të madh të përfituesve të bursave (21 nxënës). Ekspertja ka raportuar rregullisht me foto dhe ka ndjekur ecurinë e të gjithë nxënësve në lidhje me frekuentimin dhe rezultatet. Ekspertja ka vazhduar me klasat pas shkolle gjatë muajve janar 2025- prill 2025 me nxënësit në shkollën Liria sipas planit që ka hartuar dhe ka raportuar me foto tek koordinatori i projektit. Janë realizuar 60 ditë pune nga ekspertja, sic është planifikuar në projekt. Kjo mbështetje për nxënësit ka ndikuar në përmirësimin e dijeve, aftësive krijuese dhe formimit të përgjithshëm të tyre.

Projekti ka përfunduar në fillim të muajit shtator të vitit 2025.

P.AG141.Q4.O2.A13. HOLD ON - Nxitje e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë financiar në kuadër të programit Erasmus+ LLOGARI JASHTË THESARI & të trashëguara

HOLD ON do të kontribuojë në rritjen e aksesit të të rinjve në shërbimet joformale të shëndetit mendor të bashkëmoshatarëve në pika shërbimi që nuk ofrohet shërbimi mjekësor, siç janë institucionet arsimore, organizatat rinore, qendrat e punës, qendrat sportive dhe qendrat kulturore, duke siguruar që të arrihen të rinjtë më vulnerabël.

Për më tepër, do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit mendor, ofrimin e trajnimeve dhe burimeve për profesionistët që punojnë me të rinjtë, por nuk lidhen me shëndetësinë, në mënyrë që të rinjtë të njohin problemet e shëndetit mendor dhe të krijojnë mjedise mbështetëse për ofrimin e mbështetjes joformale të bashkëmoshatarëve të tyre.

Projekti do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për mirëqenien mendore të të rinjve. Projekti synon që përfituesit të jenë rinjtë e moshës 14-29 vjeç, si dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë, jo në fushën e mjekësisë.

Në këtë kuadër, qëllimi i përgjithshëm i projektit është: Përmirësimi i aksesit e të rinjve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor dhe angazhimi proaktiv i tyre në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor.

Projekti ka përfunduar. Është zhvilluar faza e parë e pilotimit të projektit. Projekti është në fazën e takimeve të grupeve në "Ted Talk" me profesionistët e fushave të shëndetit mendor dhe të punës me të rinjtë. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të krijojnë grupe mbështetëse që të rinjtë të krijojnë një hapësirë ku mund të flasin dhe përmirësojnë shëndetin e tyre mendor përtej barrierave kulturore dhe sociale.

P.AG141.Q4.O2.A14. "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen" - BRENDA THESARI & të trashëguara

Projekti "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen", është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte "Askush të Mos Mbetet Pas", një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Objektivat e projektit:

OS.1 Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve ditore për fëmijët dhe familjen pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" Nr.5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat.

OS.2 Përfshirja dhe fuqizimi i familjeve përmes shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen" pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" Nr.5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat.

Aktivitetet kryesore të projektit:

A.1: Ofrimi i shërbimeve edukative passhkollore pranë hapësirave të Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 1 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

A.2: Zhvillimi i një kampi veror për fëmijët përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

A.3: Zhvillimi i një aktiviteti final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

Projekti ka përfunduar. Përgjatë kësaj periudhe janë realizuar të gjithë aktivitetet e planifikuara në kuadër të projektit.

P.AG141.Q5.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të stafit të strehimit social në funksion të përmbushjes së misionit qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësi për ofrimin e programeve të strehimit ndaj qytetarëve.

Është realizuar sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të sektorit të strehimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P.AG141.Q5.O1.A2 Zbatimi i instrumentit financiar "Subvencionimi i qerasë në tregun e lirë" & të trashëguara

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

“Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” si një instrument financiar i programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”, mbështet individë/familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë. Subvencionimi i qirasë realizohet nga Bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Bashkia Shkodër do të vlerësojë në vazhdimësi nivelin e të ardhurave të përfituesve në raport me vlerën e qirasë për të siguruar që qiraja është e përballueshme për përfituesit.

Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362, datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, shtojca “A”, dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB. Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues, përcaktohen sipas kontratave të qirasë, të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës “A” të VKM-së 362, datë 20.05.2019.

Referuar Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave “*Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë) financohen deri në 70% nga buxheti i shtetit.*”

Ndërkohë për këtë instrument financiar, për vitin 2025, në zbatim të programit të banesave sociale me qira, aplikimet kanë qenë të hapura sipas shpalljes së bërë në faqen e zyrtare të Bashkisë.

Në funksion të këtij instrumenti është miratuar nga Këshilli Bashkiak vendimi nr.61 datë 30.9.2024 “Miratimi i vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2024”.

Në fazën e dytë të këtij programi aplikantët janë njoftuar për plotësimin e dokumentacionit sipas përcaktimeve ligjore. Sipas njoftimit për thirrjen e mbledhjes së Komisionit të Strehimit me shkresë nr. 29063 prot, datë 24.12.2024, u mbledh komisioni me datë 27.12.2024. Nga ana e strukturës përgjegjëse të strehimit në bashki, u prezantua lista e aplikuesve dhe dosjet përkatëse të paraqitura për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025, në zbatim të programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”.

Në zbatim të VKM-së nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë,

nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes” është hartuar lista e aplikuesve me të dhënat sipas dosjeve të aplikuesve të renditura sipas sistemit të pikëzimit të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Në zbatim të VKM-së nr. 459, datë 03.07.2019, struktura përgjegjëse e strehimit në bashki ka dërguar në ministri kërkesën për shtesë të fondeve sipas numrit të aplikimeve për këtë program/instrument financiar.

Struktura përgjegjëse e strehimit, vuri në dispozicion informacionin e hollësishëm për çdo aplikant i cili ka përmbushur kriteret për këtë instrument. Komisioni verifikoi dokumentacionin sipas dosjeve individuale të aplikuesve.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikuesve, Komisioni i Strehimit sipas rendit të ditës vendosi:

Miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit “Banesa sociale me qira” për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025”.

Lista e propozuar për miratim përmban 74 aplikues të renditur sipas sistemit të pikëzimit, nga të cilët 38 janë përfitues të këtij programi/instrumenti financiar për vitin 2024, dhe pas përditësimit të dokumentacionit do të risubvencionohen për vitin 2025. Pas miratimit në Komisionin e Strehimit, aplikuesit janë njoftuar për depozitimin e Kontratës së Qirasë edhe pse të gjithë aplikuesit janë vënë në dijeni paraprakisht që kriter kryesor është depozitimi i Kontratës së Qirasë me akt noterial.

Me depozitimin e kontratave, Komisioni i Strehimit dërgon për miratim në Këshillin Bashkiak listën e përfituesve dhe vlerat përkatëse të subvencionimit sipas kontratave të qirasë të depozituara.

Në mbledhjen e Komisionit të Strehimit të datës 21.01.2025, u bë shqyrtimi dhe propozimi për miratim në Këshill Bashkiak të listës së përfituesve dhe vlerave të subvencionimit të qirasë për përfituesit që kanë depozituar kontratat për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025, në mbështetje të programit të strehimit social “Banesa sociale me qira”, listë e cila përmbante 59 familje përfituese.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.7, datë 30.01.2025 “ Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit “Banesa sociale me qira” për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025 është miratuar lista e përfituesve për këtë instrument financiar për vitin 2025.

Lista e përfituesve për këtë program social të strehimit i është përcjellur Ministrisë së Ekonomisë, me kërkesën për parashikimin e fondeve për financim për vitin 2025, sipas nenit 35, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, dhe sipas Shtojca A “Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit, kriteret përkatëse dhe informacioni për kategoritë, numrin e aplikimeve dhe planifikimin e fondeve nga NJVV”.

Referuar Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave “Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë) financohen deri në 70% nga buxheti i shtetit.”

Sa më sipër, Bashkia Shkodër bashkëfinancon për këtë instrument financiar të strehimit jo më pak se 30% të vlerës totale të subvencionimit të qirasë në treg të lirë. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij programi social të strehimit janë në shumën totale **13,490,552** lekë dhe do të përballohen nga fondi i buxhetit të shtetit (grant i kushtëzuar), me bashkëfinancim të Bashkisë Shkodër, që do të jetë jo më pak se 30% të vlerës totale, sipas thirrjes së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 15900 prot, datë 18.12.2024.

Me shkresën nr.3822/2 prot, datë 21.03.2025, me lëndë “Njoftim mbi transferimin e fondit nga Buxheti i shtetit për programin e subvencionimit të qirasë.”, ardhur nga MEKI janë kaluar fondet për likuidimin e qirasë për familjet përfituese, për periudhën e parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.

Procedura e likuidimit të qirasë ka filluar me ardhjen e fondeve dhe vijon të kalohet çdo muaj për familjet përfituese.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale me shkresën nr.3468/b prot., datë 03.09.2025 me lëndë “Njoftim për shpallje në faqen web për aplikime për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Shkodër ” ka hapur shpalljen për aplikime të cilat kanë qënë të hapura deri me datë 07.11.2025, për vitin 2026.

Sipas emailit të ardhur nga Drejtoria e Strehimit pranë MEI me datë 18.09.2025, Bashkia Shkodër rezulton me të ardhura vjetore për frymë në vlerën 7,136 mijë lekë që sipas Tabelës nr.2 të Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019: “*Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë) në vlerat 6,001-8,000 lekë financohen deri në 60% nga buxheti i shtetit.*”

Sa më sipër, Bashkia Shkodër duhet të bashkëfinancojë për këtë program social të strehimit jo më pak se 40% të vlerës totale të subvencionimit të qirasë në treg të lire, për vitin 2026.

Me VKB-në nr.62 datë 31.10.2025 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025“ është miratuar vlera maksimale e subvencionimit, që do të përdoret për vitin 2026.

Me shkresë nr.23874 prot, datë 19.11.2025, me lëndë “Njoftim”, aplikuesit janë njoftuar për plotësimin e dokumentacionit, hap i cili përkon me fazën e dytë të procedurës.

Procedura është në proces zhvillimi.

P.AG141.Q5.O1.A3 Zbatimi i instrumentit financiar "Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti"

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

“Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti”, është një instrument financiar në zbatim e mbështetje të programit social të strehimit “Banesa me kosto të ulët”.

Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtë të përfitojnë kredi me kushte lehtësuese që jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesat e kredisë të ofruara nga institucionet financiare për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit të përcaktuara.

Në zbatim të VKM nr. 384, datë 12.6.2019 ndiqen procedurat e parashikuara për zbatimin e programeve sociale të strehimit. Informacioni në lidhje me programet sociale të strehimit në zbatim është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Gjithashtu, specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë i gatshëm për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët. Kuotat e vëna në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë instrument financiar për vitin 2020, janë 100.

Gjatë kater viteve të zbatimit të këtij instrumenti financiar, janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak pesë lista përfituesish. Listat e përfituesve, sipas marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bashkisë Shkodër dhe tre institucioneve financiare/bankave (BKT, Intesa Sanpaolo dhe Raiffeisen Bank), në zbatim të procedurave ligjore u janë dërguar për zbatim institucioneve financiare dhe Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Shkodër.

Deri tani ka disa përfitues të kredituar nga bankat dhe disa përfitues në proces të kreditimit.

Meqënëse Bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota të miratuara, dhe këto kuota nuk janë plotësuar akoma edhe pse janë miratuar katër lista përfituesish nga Bashkia Shkodër, në lidhje me kuotat në dispozicion për vitin aktual, **Bashkia ka shpallur përsëri Thirrje.**

Drejtoria e Sherbimeve Sociale me shkresën nr.12442 prot., datë 07.06.2024 me lëndë “Njoftim për shpallje në faqen ëeb për aplikime për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Shkodër ” ka hapur shpalljen për aplikime.

Aplikimet janë kryer online në portalin qeveritar E-albania dhe kanë qënë të hapura deri në muajin nëntor. Gjatë kësaj periudhe ka patur rreth 60 aplikime. Me shkresën me nr.15406 prot. dt. 06.12.2024 me lëndë “Mbi programin për subvencionimin e interesave të kredisë”, administruar nga Bashkia Shkodër me nr.27991 prot. dt 10.12.2024 si dhe me shkresën 15406/2 prot, dt. 16.01.2025 me të njëjtën lëndë, administruar nga Bashkia Shkodër me nr.1082 prot, dt.21.01.2025, jemi informuar për kuotat e reja që bashkia ka në dispozicion dhe kushtet për të cilat ato vlejné. Duke qënë se ishim brenda afatit 4-mujor parazgjedhor, me datë 13.03.2025 si dhe me datë 03.04.2025, i jemi drejtuar me

email KQZ-së të na udhëzonin nëse mund të vijonim apo jo me procedurën e lartpërmendur, por që deri tani nuk kemi asnjë përgjigje.

Në vijim është proceduar me fazën e dytë të plotësimit të dokumentacionit.

Bashkia Shkodër ka shpallur në faqen zyrtare ëeb të internetit njoftimin me listën e aplikuesve për instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti” dhe ka vijuar me procedurën e njoftimit shkresor për të gjithë aplikuesit, për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit pranë sporteleve të Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë.

Pas plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga qytetarët/aplikuesit, vijoi procedura e shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit dhe miratimit të dokumentacionit me listën e përfituesve..

Për këtë program kanë aplikuar në total 58 aplikues. Nga të cilët 30 kanë dorëzuar dokumentacion, 21 kanë depozituar dokumentacionin e rregullt, 5 aplikues kanë patur mungesë dokumentacioni, dhe 4 aplikues kanë patur tejkalim të ardhurash.

Nga informacionet e përditësura, të marra nga Enti Kombëtar i Banësive, me postë elektronike zyrtare me datë 14.07.2025, rezulton se nga 100 kuotat të cilat kanë qënë të parashikuara, 63 kuota janë ezauruar, 3 përfitues janë në proces kreditimi dhe 15 përfitues kanë bërë kërkesë për shtyrjen e afatit për vazhdimin e procedurave të kreditimit, por që e dhëna e fundit mund të ndryshojë pasi përfituesit nga lista e fundit e miratuar në 2024 kanë pasur akoma afat për të bërë shtyrjen.

Me datë 11.07.2025 është njoftuar mbledhja e Komisionit të Strehimit ngritur me VKB-së nr. 2, datë 22.01.2020 “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”; Urdhrit nr.836, datë 10.07.2025 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër” ;Vendimit nr. 144, datë 14.07.2020 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit” , i cili vendosi që të paraqesë për miratim Këshillit të Njesisë të Vetëqeverisjes Vendore, listën e përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredisë për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, e cila u dërgua pranë strukturës përgjegjëse për strehimin në bashki, e shoqëruar me Procesverbalin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Shkodër me nr. 2750/b/1, datë 14.07.2025.

Në zbatim të pikës 18 të VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, struktura përgjegjëse e strehimit në bashki ka dërguar për miratim listën e përfituesve pranë Këshillit Bashkiak. Lista e përfituesve është miratuar me [vendim të Këshillit Bashkiak Nr.: 50 Dt.: 04.08.2025](#) “Për miratimin e listës së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti ”.

Pas miratimit në Këshill Bashkiak, lista e përfituesve, i është dërguar Entit Kombëtar të Banesave dhe institucioneve financiare që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e linjës për zbatimin e këtij programi.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale me shkresën nr.3469/b prot., datë 03.09.2025 me lëndë “Njoftim për shpallje në faqen eeb për aplikime për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Shkodër ” ka hapur shpalljen për aplikime të cilat kanë qënë të hapura deri me datë 31.10.2025, për vitin 2026.

P.AG141.Q6.O1.A1 Menaxhimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik në pronësi të bashkisë.& të trashëguara

Që nga viti 2016, Bashkia Shkodër ka krijuar fondin publik të banesave sociale me qira, përmes zbatimit të projekteve të ndryshme të bashkëfinancuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kryesisht përmes përshtatjes së objekteve të dala jashtë funksionit, adaptim i objekteve ekzistuese, por edhe me ndërtim të ri, duke aplikuar sipas Thirrjeve për projekte të shpalluara nga Ministria çdo vit.

Bashkia Shkodër administron tre Banesa Sociale me Qira, pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë, të cilat, kanë 79 njësi banimi në total. Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 2691 prot., datë 07.03.2016 që Bashkia Shkodër ka lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Urban është realizuar rikonstrukcioni i ish-konviktit të shkollës Pyjore, me qëllim përshtatjen në banesa sociale me qira për strehimin e jetimëve që kanë dalë nga institucionet e përkujdesit shoqëror dhe aktualisht jetojnë në konviktet e qytetit, si dhe familjeve njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë dhe ndodhen në situatë të vështirë social-ekonomike. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 26, datë 10.05.2022 “Për disa shtesa në VKB-në nr. 49, datë 30.10.2020 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6” (pranë ish-konviktit të shkollës Pyjore) janë miratuar listat e përfituesve që kanë nënshkruar kontrata qiraje 1-vjeçare. Lidhja e kontrata është në proces, pasi familjet janë njoftuar disa herë për rinovimin e dokumentacionit dhe shlyerjes së detyrimeve por për shkak të kategorisë vulnerabël që i përkasin akoma nuk kanë arritur ta konkludojnë këtë proces. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese. Përfituesit pranë këtyre banesave përfitojnë edhe shërbime integruese dhe zhvilluese, me qëllim fuqizimin social-ekonomik, shërbime që ofrohen nga Qendra Komunitare “Për Familjen” nr. 6. Janë rreth 24 njësi banimi me qira mes të cilave edhe familje në kushtet e nevojës emergjente për strehim, miratuar me VKB nr. 60, datë 07.11.2022.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.47, datë 31.07.2024 është miratuar edhe vendimi “Për strehimin emergjent të zj. Xh. B dhe të miturve të saj në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare “Për familjen” nr. 6 (ish-konvikti i shkollës Pyjore)”.

Gjithashtu me vendim të Këshillit Bashkiak nr.63, datë 30.09.2024 është miratuar edhe vendimi “Për strehimin emergjent të familjes Bejtja në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë qendrës komunitare ” Për Familjen” nr.6 (Ish konvikti i shkollës Pyjore).

Në administrimin e Bashkisë Shkodër janë edhe 27 kontenier (godina sociale, me kontenier 1+1 dhe 2+1)”, që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të minoritetit kombëtar Rom për 27 familje të këtij minoriteti në Bashkinë Shkodër. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 29, datë 03.06.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin Rom dhe për miratimin e “Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin Rom”, është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar. Lidhja e kontrata është në proces, pasi familjet janë njoftuar disa herë për rinovimin e dokumentacionit dhe shlyerjes së detyrimeve por për shkak të kategorisë vulnerabël që i përkasin akoma nuk kanë arritur ta konkludojnë këtë proces. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 3 (tre) familje përfituese.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 23, datë 08.04.2025, ‘Për strehimin emergjent të familjes SH.M dhe O.H. (Banesat sociale me qira të ngritura për komunitetin rom), është miratuar dhe strehimi i dy familjeve rome. Me datë 18.06.2025 për shkak të renies së një zjarri, u dogjën 3 nga banesat sociale rome. Familjeve që kanë jetuar në këto 3 banesa, i është siguruar një strehim alternativ i përkohshëm.

Sa i përket ish-konviktit të shkollës Veterinare si banesa sociale nën administrimin e Bashkisë Shkodër me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 24, datë 10.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira tek ish-konvikti i shkollës Veterinare dhe të “Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër”, është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar përveç dy familjeve. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese.

Me vendime të Këshillit Bashkiak janë miratuar Rregulloret përkatëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër, për zbatimin dhe funksionimin e këtyre programeve sociale të strehimit, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet përfituesve dhe strukturës përgjegjëse administruese.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.12, datë 03.03.2025 është miratuar edhe vendimi “Për strehimin emergjent të zj. G. T. dhe të miturve të saj në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë Ish Konviktit të Shkollës Veterinare.

Është miratuar në Këshillin Bashkiak Shkodër vendimi nr.22 date 08.04.2025 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për Banesat Sociale me Qira, në administrimin e Bashkisë Shkodër”.

Niveli i qirasë për BSQ miratohet çdo vit dhe është i vlefshëm deri më 31 janar të vitit pasardhës.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.77, datë 27.11.2025 është miratuar edhe vendimi “Për strehimin emergjent të z. L.Selja dhe të z.T.Gomila në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë Ish Konviktit të Shkollës Veterinare.

Referuar nenit 19 të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar”, VKM-së nr.325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, Bashkia Shkodër përfiton sipërfaqe ndërtimore apo në këmbim të saj, vlerën monetare e cila kalon në llogarinë e posacme të Bashkisë Shkodër në favor të fondit të banesave sociale.

Gjatë kësaj periudhe kanë kaluar në fondin e banesave sociale **117 878 040** lekë.

Eshte realizuar blerje materiale pastrimi, hidraulike, elektrike, pagesa e ujit dhe energjise elektrike si dhe sherbimi i dezenfektimit. Nuk eshte realizuar mirmbajtja e zakonshme.

P.AG141.Q6.O1.A2 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II)

Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave.

Referuar nenit 19 të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar”, VKM-së nr.325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, Bashkia Shkodër përfiton sipërfaqe ndërtimore apo në këmbim të saj, vlerën monetare e cila kalon në llogarinë e posacme të Bashkisë Shkodër në favor të fondit të banesave sociale.

Bazuar ne vleresimin e bere nga Drejtoria e Kontrollit te zhvillimit te territorit, bashkia Shkoder, mbi ndertimet qe parashikohen te behen ne territorin e bashkise, nga te ardhurat qe do te mblidhen, te perdoren per rikonstruksionin e kesaj ndertese.

Bashkia Shkodër prej disa vitesh, po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike, pronë të Bashkisë Shkodër, si në ish-konviktin e shkollës Pyjore dhe në ish- konviktin e shkollës Veterinare.

Projekti parashikohet të realizohet në një godinë ekzistuese, e cila është rikonstruktuar dhe përshtatur në banesë sociale si rezultat i financimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pas aplikimit e në bashkëfinancim me Bashkinë Shkodër në vitin 2020. Aktualisht janë ndërtuar 28 njësi banimi, pjesë e fondit publik të banesave sociale në pronësi të Bashkisë.

Projekti "Shtese kati i dyte banesa sociale te "ish Konviktit te shkolles veterinare)" shtesë i një kati, në një godinë publike dhe funksionale, do të rriste më tej efektivitetin e godinës, duke rritur numrin e njërive të banimit dhe numrin e individëve dhe familjeve përfituese që nuk mund të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm.

Nga vlerësimet e specialistëve, rezulton se në këtë objekt është e mundur të realizohet një shtesë kati dhe të përfitohen edhe 14 njësi banimi të tjera, duke e kthyer këtë godinë në një pallat me 42 apartamente, e duke shtuar me tej kontigjentin e banesave sociale me qira në Bashkinë Shkodër.

Sipas thirrjes së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 15900 prot, datë 18.12.2024, Bashkia Shkodër ka aplikuar për projektin "Shtese kati i dytë, banesa sociale te "ish Konviktit te shkolles veterinare", i përshtatur për strehim, me kërkesë për financim me nr. 1950 prot., datë 31.01.2025. Vlera e preventivit në total është 56,563,064.00 lekë me TVSH. Referuar Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave "Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë), financohen deri në 70% nga buxheti i shtetit."

Sa më sipër, Bashkia Shkodër bashkëfinancon për këtë projekt të strehimit jo më pak se 30% të vlerës totale të projektit.

Gjatë vitit kemi qënë në pritje të një përgjigjeje zyrtare për aplikimin e bërë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përgjigje e cila nuk na është kthyer.

P.AG141.Q6.O1.A3 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit. (Ndertim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj)

Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave.

Referuar nenit 19 të ligjit nr.22/20218 "Për strehimin social", i ndryshuar", VKM-së nr.325, datë 29.05.2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, Bashkia Shkodër përfiton sipërfaqe

ndërtimore apo në këmbim të saj, vlerën monetare e cila kalon në llogarinë e posacme të Bashkisë Shkodër në favor të fondit të banesave sociale.

Projekte për ndërtim i banesave për strehim social/ blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj.

Fondi që do të mbledhet nga kontributi i sektorit privat, do të përdoret për ndërtimet që parashikohen të bëhen në territorin e Bashkisë Shkodër në vitet 2026-2028.

Programi AI141 - Arsimi

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

- 1- Drejtorinë e Arsimit
- 2- Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

Realizimi i qëllimeve dhe objektivave të politikës së programit:

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit

Arsimi parauniversitar:

Qëllimi i programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit është:

Q1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar;

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2025 janë:

- 1.1.** Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor
- 1.2.** Organizimi i aktiviteteve dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre aktiviteteve.
- 1.3.** Krijimi i ambienteve dhe mjediseve të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor, të sigurtë konform standarteve ligjore.

Qëllimi

Q2. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe profesional.*

O1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

O2. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Qëllimi

Q3. *Administrimi, rregullimi dhe zhvillimi i shërbimeve të sistemit parashkollor për mirërritjen e fëmijëve 0-3 vjeç.*


Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2025 janë:

O1. *Krijimi, zgjerimi dhe zhvillimi i shërbimeve për fëmijët e moshës 0-3 vjeç.*

Realizimi i Buxhetit të planifikuar:


000/leke

Programi AI141	Paga &sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
PBA 2025	472,474	192,702	16,000	58,131	739,307
Plani fillestar 2025	572,396	327,218	25,443	216,206	1,141,263
Plani i rishikuar 2025	574,037	300,786	17,598	325,154	1,217,574
Realizimi viti 2025	402,329	180,343	15,656	168,947	767,275
% e realizimit	70.1%	60.0%	89.0%	52.0%	63.0%



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 63 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korrente	67.0%
Shpenzime kapitale	52.0%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Mosrealizimi i plotë i fondeve të planifikuara gjatë kësaj periudhe lidhet kryesisht me kohën e fillimit të aktivitetit të njësisë, si dhe me domosdoshmërinë e përmbushjes së disa procedurave paraprake administrative dhe teknike, të cilat janë të nevojshme për të mundësuar nisjen e investimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Mirmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP) dhe sektori i Arsimit, për shkak të fazës fillestare të organizimit dhe strukturimit të aktivitetit, janë përballur me procese të tilla si hartimi i dokumentacionit teknik, përgatitja e termave të referencës, realizimi i procedurave të prokurimit, si dhe koordinimi ndërinstitucional për miratimet përkatëse. Këto hapa janë të domosdoshëm për të garantuar transparencë, ligjshmëri dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, por njëkohësisht kërkojnë kohë dhe kanë ndikuar në shtyrjen e afateve të realizimit.

Raporti: M3 - Shpenzimet dhe Sasitë e Produkteve: Fakti - Planit (Janar - Dhjetor 2025)

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

Programi: AI141 - Arsimi

Viti: 2025

Vlerat paraqiten në: ALL

KODI	PRODUKTI			KUMULATIVE DERI NË FUND TË			NDRYSHIMI (%)	
				PERIUDHËS	PLANI I RISHIKUAR	FAKTI	FAKTI VS. FILLESTAR	FAKTI VS. RISHIKUAR
				PLANI FILLESTAR				
Funksioni 09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor								
V912AAA	Shërbime Mbështetëse të Stafit të Arsimit Bazë		Sasia	343	347	347	101.17%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer punonjesish	Shpenzimet	367,074,418	452,946,077	313883870	85.51%	69.30%
V912AAB	Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funksionale		Sasia	67	67	67	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	numer objektesh	Shpenzimet	82,405,000	111,037,402	51364921	62.33%	46.26%
V912AAD	Fëmijë që Ndjekin Kopështin		Sasia	2,000	2,000	2,000	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer i femijeve	Shpenzimet	39,779,000	66,087,768	44230971	111.19%	66.93%
V912AAF	Fëmijë që Frekuentojnë Qendrat Kulturore të Fëmijëve		Sasia	14,000	14,000	7,000	50.00%	50.00%
	Njësia e Matjes	Numer i femijeve	Shpenzimet	17,625,000	19,135,511	16202414	91.93%	84.67%
V912AAK	Objekte të Arsimit Bazë dhe Parashkollor të Rikonstruktura		Sasia	1	1	0	0.00%	0.00%
	Njësia e Matjes	Numer i shkollave dhe kopshteve	Shpenzimet	0	2,400	0	N/A	0.00%
Funksioni 09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm								
V923AAA	Shërbime Mbështetëse të Stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm		Sasia	50	50	50	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer punonjesish	Shpenzimet	43,054,746	55,290,821	38900605	90.35%	70.36%

V923AAB	Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale		Sasia	13	13	13	100.00%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer i shkollave të mesme të përgjithshme	Shpenzimet	22,936,000	55,668,840	33612128	146.55%	60.38%
V923AAF	Nxënës të Akomoduar në Konvikt		Sasia	18	14	14	77.78%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numeri i nxenesve	Shpenzimet	57,448,000	73,516,000	49957454	86.96%	67.95%
Funksioni 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët								
V043AAC	Fëmijë që Frekuentojnë Çerdhet		Sasia	260	310	310	119.23%	100.00%
	Njësia e Matjes	Numer i femijeve	Shpenzimet	69,159,000	83,086,016	57166473	82.66%	68.80%

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi: AI141 - Arsimi

OBJEKTIVI 1.1

Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilesore per zhvillimin e procesit mesimor ne sistemin parauniversitar dhe parashkollor.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor

Nr.	Tregues Performance të lidhur me OBJEKTIVIN	Njësia e Matjes	2024 Fakt	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2025 Fakt	(%) e Plotësimit të TP-së
TP 1.1.A	Raporti numrit të nxenesve kundrejt numrit total të mesuesve në arsimin bazë	Nr. nx/Nr.mesuesve	8	8	8	8	99.13%
TP 1.1.B	Numri i shkollave në arsimin 9-vjecar; qytet/fshat	Nr. Shkollave	67	67	67	67	100%
TP 1.1.C	Numri mesatar i nxënësve në një klasë arsimit bazë	Rap. nr. nx/nr. klasave	14	14	14	14	100%
TP 1.1.D ^[2]	Numri i shkollave që ngrohen me dru zjarri arsimit bazë	Nr. shkollave	N/A	N/A	64	64	N/A
TP 1.1.D ^[1]	Numri i shkollave që ngrohen me dru zjarri arsimit bazë	Nr. shkollave	64	64	N/A	N/A	N/A
TP 1.1.E ^[2]	Numri i shkollave që ngrohen me kalldaja dhe naftë arsimit bazë	Nr. shkollave	N/A	N/A	5	5	N/A
TP 1.1.E ^[1]	Numri i shkollave që ngrohen me kalldaja dhe naftë dhe gaz arsimit bazë	Nr. shkollave	5	5	N/A	N/A	N/A
TP 1.1.F	Numri i mjeteve të transportit në shërbim	Nr. automjeteve	3	4	4	4	100%
TP 1.1.G	Numri i shkollave që i shërbejnë fëmijëve me aftësi të veçanta	Nr. shkollave	1	1	1	1	100%
TP 1.1.H	Numri i shkollave me shërbim sigurie arsimit bazë	Nr. Shkollave	50	50	50	50	100%
TP 1.1.I	Numri mesatar i fëmijëve për kopësht (Raporti numrit të fëmijëve kundrejt numrit total të kops)	Nr. femij./Nr. Kopshteve	34	39	39	39	100%
TP 1.1.J	Numër kopshte	Nr. kopshte	51	51	51	51	100%
TP 1.1.K	Numri i kopshteve me dreke	Nr. kopshte me dreke	7	7	7	7	100%
TP 1.1.L	Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet me drekë	Nr. femijeve	370	370	370	370	100%
TP 1.1.M	Sipërfaqe në m2 në shërbim të kopshteve që mirëmbahet	Sipërfaqja m2	6,972	6,972	6,972	6,972	100%

TP 1.1.N	Numri i femijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar të mbështetur nga bashkia në kopshte	Nr. i femijeve	45	45	45	14	31.11%
----------	---	----------------	----	----	----	----	--------

OBJEKTIVI 1.2

Organizimin e aktiviteteve dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre aktiviteteve.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor

TP 1.2.A	Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argetuese për fëmijë.	Nr.nx pjesmarres	14,000	14,000	14,000	7,000	50%
TP 1.2.B	Numri i vajzave në total në të gjitha aktivitetet	Nr i vajzave	8,460	8,460	8,460	4,700	55.56%

OBJEKTIVI 1.3

Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor, të sigurtë konform standardeve ligjore.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor

TP 1.3.A	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të nxenesve të arsimit	Rap.shpenzime/ nr .nx	42	45	45	46	103.21%
TP 1.3.B	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të	Rap.shpenzime/Nr i institucioneve	4,159	4,542	4,542	4,723	103.99%
TP 1.3.C	Numri mesatar i fëmijëve për kopësht	Nr i femijeve ne kopshte	34	39	39	39	100%

OBJEKTIVI 2.1

Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm

TP 2.1.A	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme	Nr i shkollave	13	13	13	13	100%
TP 2.1.B	Përmirësimi i tërheqjes së nxënësve që mbarojnë arsimin bazë në arsimin e mesëm të përgjithshëm: N	Nr nx arsimi mesem/nx ar. baze	43	43	43	43	100%
TP 2.1.C	Mësimi në klasat e arsimit të mesëm të përgjithshëm.	Nr.nx /nr klasave	34	34	34	34	100%
TP 2.1.D	Shpenzime mesatare për një nxënës në shkollën e mesme kundrejt numrit total të	Shpenzime/nr.nx	35	34	34	34	100%
TP 2.1.E	Numri i shkollave që ngrohen me dru zjarri ne arsimin e mesem	Nr i shkollave	8	8	8	8	100%

TP 2.1.F	Nr i shkollave qe kanë shërbimin e ruajtjes se objektit	Nr i shkollave	13	13	13	13	100%
TP 2.1.G	Mbështetje për të rinjtë me bursë financiare: Numri i nxënësve që përfitojnë	Nr i nxenesve	18	18	18	14	77.78%
TP 2.1.H	Numri i godinave që i shërbejnë arsimit profesional	Nr i godinave	4	4	4	4	100%
TP 2.1.I	Përmirësimi i akomodimit të nxënësve në konviktet e shkollave profesionale:	Nr nx/Nr dhome	1	1	1	1	83.33%
TP 2.1.J	Shpenzime për një nxënës të akomoduar në konvikt në sistemin publik	Shpenzime/Nr i nxenesve	3,021	3,022	3,022	3,022	100%
TP 2.1.K	Numri i konvikteve me ngrohje me kalidajë	Nr . i konvikteve	1	1	1	1	100%
TP 2.1.L	Numri I panarireve te shkollave profesionale te organizuara.	Nr. i panaireve	1	1	1	1	100%

OBJEKTIVI 2.2

Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm

TP 2.2.A	Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat ne qytet e arsimit të mesëm të përgjithshëm	Nr. i punimeve/nr. i shkollave	50	50	50	50	100%
TP 2.2.B	Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm ne njesi administrativ	Nr. i punimeve/ nr shkollave adm	57	57	57	57	100%
TP 2.2.C	Ndryshimi në % i numrit të nxënësve të akomoduar në konvikte	Nr i nxenesve	0	0	0	0	N/A

OBJEKTIVI 3.1

Krijimi, zgjerimi dhe zhvillimi i shërbimeve për fëmijët e moshës 0-3 vjeç.

Funksioni i Qeverisjes Vendore:

10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

TP 3.1.A	Përmirësimi i shërbimit në çerdhet: Numri i fëmijëve përfitues të shërbimi	Nr i femijeve	260	310	310	310	100%
TP 3.1.B	Numer vajza që frekuentojnë çerdhet	Nr i vajzave	117	117	150	150	128.21%
TP 3.1.C	Numri I femijeve te perjashtuar nga tarifa e çerdheve	Nr . i femijeve	25	25	25	0	0%

Tabela e produkteve / aktivitete ne ne 000/leke dhe realizimi i tyre

Për 12- mujorin e vitit 2025 janë planifikuar dhe realizuar produktet e mëposhtme:

Produktet	Aktivite/Projekte	Institucioni	Statusi I Aktivitetit	Plani Fillestar 2025	Plani I Rishikuar 2025	Realizimi 2025
				Totali	Totali	Totali
V912AAA. Shërbime Mbështetëse të Stafit të Arsimit Bazë	P.AI141.Q1.O1 .A1. Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor (paga/sigurime shoqerore) & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	192,264	234,949	167,204
	P.AI141.Q1.O1 .A2. Mbështetja e personelit mbështetës për arsimin bazë. (paga/sigurime shoqerore) dhe stafi i drejtorise & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	12,235	16,774	11,693
	P.AI141..Q1.O1 .A3. Mbështetja e personelit mbështetës te arsimit baze (paga/sigurime shoqerore) & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	162,576	201,222	134,986
V912AAB.Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funksionale	P.AI141.Q1.O1 .A4. Mbeshtetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshtetese te arsimit baze e të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	14,585	16,485	11,848
	P.AI141.Q1.O1 .A5. Mbeshtetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshtetese te arsimit baze (kancelari) & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	700	1,013	259
	P.AI141.Q1.O3 .A6. Ngrohje me dru zjarri për sistemin e arsimit bazë. & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	25,000	26,489	24,728
	P.AI141.Q1.O1 .A7. Ngrohje me lende djegese karburante për sistemin e arsimit baze dhe furnizim për mjetet transporti (nafte + benzine) & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Mbartet per ne 2026	2,000	4,000	-
	P.AI141.Q1.O1 .A8. Mirembajtje e mjeteve te transportit per sherbimet mbeshtetese te sistemit arsimor baze & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	720	936	720
	P.AI141.Q1.O1 .A9. Mirembajtje e zakonshme e objekteve arsimore ,arsimi baze & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Kontrate e lidhur ne proces	10,000	10,717	1,344
	P.AI141.Q1.O1 .A10. Sigurimi i objekteve per raste te ngjarjeve te jashtezakonshme si zjarr dhe termete arsimi baze (siguracioni i ndertes)	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	1,000	1,000	945

	P.AI141.Q1.O1 .A11..Shërbim I sigurisë në objekte, arsimit bazë dhe parashkollor & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Realizuar	11,400	21,117	8,562
	P.AI141.Q1.O1 A12.Mirëmbajtje e objekteve arsimore -Bojatisja & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Kontrate e lidhur në proces	7,000	8,001	-
	P.AI141.Q1.O1.A13. Mirëmbajtje e rrethimeve objekteve arsimore e arsimit bazë. & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Kontrate e lidhur, është likuiduar sit 1 në proces	10,000	14,000	2,959
	P.AI141.Q1.O1.A15. Mirembajtje fasada, sistemim kapote shkolla 9-vjeçare Tringe Smajli & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Nuk është realizuar	-	6,000	-
	P.AI141.Q1.O1.A16. Mirembajtje Terrace shkolla 9-vjeçare Edith Durham & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Nuk është realizuar	-	1,279	-
V912AAD. Fëmijë që Ndjekin Kopështin	P.AI141.Q1.O1.A14. Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor. materiale pastrimi dhe pajisje orëdi) e të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Realizuar mat. Pastrimi dhe materiale të ndryshme, blerje orëdi në proces	5,540	5,540	1,786
	P.AI141.Q1.O1.A15. Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor.(kancelari) & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	219	329	219
	P.AI141.Q1.O1.A16. Ngrohje dhe gatim me lëndë djegëse (dru zjarri, dru pellet, nAlte dhe gaz) për arsimin parashkollor & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Realizuar	3,000	3,363	3,331
	P.AI141.Q1.O1.A17. Sigurimi i objekteve të arsimit parashkollor (siguracioni i ndërtesës) & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Realizuar	80	80	80
	P.AI141..Q1.O1.A18. Dezinfektim i mjediseve të objekteve në arsimin parashkollor. & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Realizuar	60	60	60
	P.AI141.Q1.O1.A19 Furnizim me EE dhe ujë për arsimin parashkollor	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Realizuar	3,200	3,200	3,200
	P.AI141.Q1.O1.A20.Sigurimi i transportit për shërbimet e arsimit parashkollor. & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike	Realizuar	650	650	400
	P.AI141.Q1.O1.A21. Furnizim me ushqime për kopshtet në Bashkinë e Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	14,995	22,300	10,265

	P.AI141.Q1.O1.A22.Mirëmbajtje e zakonshme për ndërtesat e arsimit parashkollor. & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	10,000	12,445	9,311
	P.AI141..Q1.O1.A23 Shpenzime per mirembajtjen e aparateve teknike & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	125	179	124
	P.AI141.Q1.O1.A24 .Mbeshtetje e femijeve ne nevojë dhe Altesi te kufizuar per perjashtim nga tarifa e pageses. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	1,910	3,087	600
	P09120.Q1.O1.A30 Blerje materiale per mirembajtje tualete, terraca, rrjete elektrike, shkolla dhe kopshte -TE TRASHEGUARA	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	14,855	14,855
V912AAF. Fëmijë që Frekuentojnë Qendrat Kulturore të Fëmijëve	P.AI141.Q1.O2 .A1. Mbështetja për punonjësit e Qendres Kulturore e Femijeve Kujtim Alija & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	7,178	7,963	6,342
	P.AI141.Q1.O2 .A2. Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	725	803	683
	P.AI141.Q1.O2 .A3. Festivali i 63-të mbarëkombëtar për fëmijë & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	5,840	6,035	5,532
	P.AI141.Q1.O2 .A4. “Veprimtari masive” (sportive, artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	608	762	674
	P.AI141.Q1.O2 .A5. “Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore” & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	2,079	2,268	1,822
	P.AI141.Q1.O2 .A6. Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 vjeçare. & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	445	545	409
	P.AI141.Q1.O2 .A7. Mbeshtetje shkolla Prenke Jakova & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	750	760	740
P912ABU Instalimi i sistemit të ngrohjes shkolla Branko Kadia, shkolla Azem Hajdari, shkolla Mati Logoreci	P.AI141.Q1.O3 .A2 Instalimi i sistemit të ngrohjes shkolla “Branko Kadia”,shkolla “Azem Hajdari”,shkolla “ Mati Logoreci” - TE TRASHEGUARA	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	26,371	25,328
P912ABO Projekte Rikonstruksion i shkollave dhe fusha sporti	P.AI141.Q1.O3 .A2.Projekte Rikonstruksion i shkollave dhe fusha sporti	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	4,000	4,687	4,687

P912ABV Nderti mi i tualeteve te reja shkolla Skenderbej	P.AI141.Q1.O3 .A5 Ndertimi i tualeteve te reja shkolla "Skenderbej" -TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	5,876	5,874
P912ABX Rikonstruksion I pjesshem i kopshtit " Ton Alimhilli "	Rikonstruksion I pjesshem i kopshtit " Ton Alimhilli " -TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Nuk eshte realizuar	-	1,949	-
P912ABP - Rikonstruksion i kopshtit Bep Tusha	P.AI141.Q1.O3 .A3 Rikonstruksion I kopshtit Bep Tusha	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar, ne proces zbatimi	1,227	58,685	1,571
P912ABT - Instalimi I ngrohjes qendrore ne shkolla 9-vjecare	P09120.Q1.O3.A8. Instalimi I ngrohjes qendrore ne shkolla 9-vjecare - TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	27,924	20,418
P912ABN - Shkolla e hapur Ndre Mjeda	P.AI141.Q1.O3.A4. "Shkolla e hapur Ndre Mjeda" e te trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	23,876	62,391	62,268
	P09120.Q1.O3 .A1. Rikonstruksion i pjesshem Shkolla "Azem Hajdari" - TE TRASHEGUARA	DPMOP	Pa realizuar	-	3	-
P912ACD Rikonstruksion Kopshti Ton Alimhilli	P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"	DPMOP	Realizuar	-	1,227	967
P912ACD Rikonstruksion Kopshti Ton Alimhilli	P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"	Bashkia Shkodër	Kontrate e lidhur	-	7,612	-
P912ACE Rikonstruksion dhe ndërtim palestere Shkolla e hapur Ismail Qemali	P.AI141.Q1.O3.A8. Rikonstruksion dhe ndërtim palestere "Shkolla e hapur "Ismail Qemali"	Bashkia Shkodër	Kontrate e lidhur	-	46,852	-
P912ACF Rikonstruksion Shkolla Salo Halili	P.AI141.Q1.O3 .A9 Rikonstruksion Shkolla Salo Halili	DPMOP	Realizuar	-	6,000	5,279
P912ACG Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi	P.AI141.Q1.O3 .A10 Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi	DPMOP	Realizuar	-	6,000	5,279
	09120 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.			535,986	904,784	557,354
V923AAA.Shërbi me Mbështetese të Stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm. (Numer punonjeshish)	P.AI141.Q2.O1.A1 Mbështetje për punonjësit e shërbimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	4,952	7,029	4,637
	P.AI141.Q2.O1.A2 Mbështetje për punonjësit e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	4,953	5,073	4,641
	P.AI141.Q2.O1 .A3. Mbështetja per punonjesit e shërbimit ne arsimin e mesem te pergjithshem & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	33,150	43,188	29,622

V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale	P.AI141.Q2.O1.A4. Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse në arsimin e mesëm të përgjithshëm e të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	4,880	7,978	5,117
	P.AI141.Q2.O1.A5. Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse në arsimin e mesëm të përgjithshëm (Kancelari) & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	300	431	300
	P.AI141.Q2.O1.A6.Ngrohje me dru zjarri për arsimin e mesëm të përgjithshëm. & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	5,000	6,777	5,946
	P.AI141.Q2.O1.A7. Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe termete për arsimin e mesëm të përgjithshëm & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	500	509	500
	P.AI141.Q2.O1.A8. Shërbim I Sigurisë në objekte & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	3,804	7,608	2,481
	P.AI141.Q2.O1.A10.Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Kontrate e lidhur ne proces	1,537	3,074	898
	P.AI141.Q2.O1.A11.Mirëmbajtje e objekteve arsimore -Bojatisja & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Kontrate e lidhur ne proces	415	830	-
V923AAF Nxënës të Akomoduar në Konvikt (numri i nxenesve ne konvikt)	P.AI141.Q2.O1.A12.Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse arsimit te mesem profesional & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	918	1,742	1,742
	P.AI141.Q2.O1.A13.Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse arsimit te mesem profesional (kancelari) & të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	25	33	25
	P.AI141.Q2.O1.A14. Mbështetje e Ndermarrjes se Trajtimit te Studenteve e të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	16,000	16,000	14,059
	P.AI141.Q2.O1.A15 Materiale në shërbim të konvikteve	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	160	160
	P.AI141.Q2.O1.A14 Mobilim i konviktit "Preng Jakova"	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Procedure e prokuruar, ne proces	6,600	6,600	-
	P.AI141.Q2.O1.A15. Ngrohje dhe transport me lëndë djegëse karburante e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara	Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	6,554	13,108	12,187

	P.AI141.Q2.O1.A16 Furnizim me energji elektrike, uje, shërbime postare, hostim web, internet e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	21,855	25,260	21,334
V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale	P09230.Q1.O2.A5 Ndricim I oborrit te shkolles Jordan Misja - TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Nuk eshte realizuar	-	59	-
	P.AI141.Q2.O1.A17. Mirëmbajtje e rrethimeve objekteve arsimore e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	2,000	2,596	2,500
V923AAF Nxënës të Akomoduar në Konvikt (numri i nxenesve ne konvikt)	P.AI141.Q2.O1.A18. Dezinfektimi, higjienizim dhe sigurimi i ndërtesave e arsimit të mesëm profesional & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	450	454	450
	P.AI141.Q2.O1.A19 Mirëmbajtje e objekteve arsimore -Bojatisja & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Kontrate e lidhur ne proces	5,026	10,119	-
V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale	P.AI141.Q2.O1.A20. Mirëmbajtje e objekteve arsimore & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	4,500	9,000	9,000
V923AAF Nxënës të Akomoduar në Konvikt (numri i nxenesve ne konvikt)	P.AI141.Q2.O1.A21. Organizimi i panairit të shkollave te mesme profesionale në Bashkinë Shkodër & të trashëguara	Bashkia	Nuk eshte realizuar Mbartet per 2026	20	40	-
V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale	Supervizim & Kolaudim Rikonstruktion shkolla Skenderbeg- TE TRASHEGUARA	Bashkia Shkoder	Pa realizuar	-	204	-
	P.AI141.Q2.O2.A1 Mirembajtje (Shtrim oborre 5 shkolla)	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Kontrate e lidhur ne proces	-	8,780	-
	P.AI141.Q2.O2.A2 Mirembajtje (riparim kaldaja te shkollave)	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	1,000	370
	P09230.Q1.O2.A7. Blerje materiale per mirembajtjen e tualeteve te shkollave te mesme- TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	6,500	6,500
	P09230.Q2.O1.A12. Nxitja e Perfshirjes Sociale dhe Zhvillimit te komunitetit -TE TRASHEGUARA	Bashkia shkodër	Pa realizuar	-	323	-
P923AAM - Shkolla e hapur Kolë Idromeno	P.AI141.Q2.O2.A2 Shkolla e hapur “Kolë Idromeno” & të trashëguara	Bashkia	Realizuar	7,723	34,901	26,968
P923AAN - Projektim, rikonstrukcion shkolla të mesme të përgjithshme	P.AI141.Q2.O2.A5 Projektim Rikonstrukcion shkolla te mesme te pergjithshme & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	3,000	3,800	3,316

P923AAP - Rikonstruksion shkolla Mehmet Shpendi Nj Ad Shale	PO9230.Q1.O2.A7. Rikonstruksion shkolla Mehmet Shpendi Nj Ad Shale- TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Nuk eshte realizuar	-	6,528	-
09230 Arsimi I mesëm I përgjithshëm				134,162	229,705	152,753
V043AAC. Fëmijë që frekuentojnë çerdhet (nr. I fëmijeve)	P.AI141..Q3.O1.A1 Mbështetja e personelit te cerdheve (paga/sigurime shoqerore)& të trashëguara	Bashkia Shkoder	Realizuar	55,167	59,435	44,799
	P.AI141..Q3.O1.A2. Materiale mbështetëse për Cerdhet. (kancelari,). & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar	135	191	135
	P.AI141.Q3.O1.A3 Furnizim me ushqime për Cerdhet në Bashkinë e Shkodrës & të trashëguara	Bashkia Shkodër	Realizuar ,likuiduar kontrata e pare	7,306	12,340	5,672
	P.AI141.Q3.O1.A4. Materiale mbështetëse për mirembajtje per Cerdhet & të trashëguara	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	4,660	6,302	3,632
	P10430.Q2.O1.A7. Rikonstruksioni i çerdhes “Manush Alimani” - TE TRASHEGUARA	Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Realizuar	-	2,928	2,928
	P.AI141.Q3.O1.A5. Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijët me Altësi të kufizuar	Bashkia Shkodër	Nuk esht realizuar	891	891	-
	P.AI141.Q3.O1.A6. Tarifa/Taksa për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të Bashkise Shkoder	Bashkia Shkodër	Nuk eshte realizuar mbartet 2026	1,000	1,000	-
Cerdhe				69,159	83,087	57,166
Totali Arsimi AI141				739,307	1,217,574	767,275
Të trashëguara				401,956	0	-
Totali				1,141,263	1,217,574	767,275

Transferta e kushtezuar

Përshkrimi	Statusi	Buxheti fillestar 000/lekë	Buxheti i rishikuar 000/lekë	Realizimi 12-mujori 000/lekë
P09120.Q1.O1.A13 Fëmijë me aftesi te vecanta që përfitojnë shërbim arsimor cilësor - (Transferte te kushtezuar)	Realizuar		4,033	2,532
PAI141.Q2.O1.A24 Nxenes qe regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesem te larte ne inst arsimore (transferte te kushtezuar) (Bursa shkoll. e mesme Profes.)	Realizuar		15,383	14,514
P09230.Q1.O1.A11 Nxenes qe regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesem te larte ne inst arsimore (Transferte te kushtezuar) (Bursa shkoll. Mesme. Pergjithsh.)	Realizuar		1,449	1,449

P09230.Q2.O2.A3 Shkolla e hapur "Kol Idromeno"	Kontrate e mbyqyrjes e lidhur		66,477	46,477
P.AI141.Q1.O3.A4. "Shkolla e hapur Ndre Mjeda"	Realizuar		58,442	58,442
P.AF141.Q1.O2.A2 Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit "28 Nëntori", Shkodër	Kontrata e lidhur		2,513	
P.AF141.Q1.O2.A3 Ndërtim i ambienteve sportive të Shkollës "Tring Smajli"	Kontrata e lidhur		8,007	
Totali			156,305	123,414

Llogarite jashte thesari

Përshkrimi	Statusi	Buxheti fillestar 000/lekë	Buxheti i rishikuar 000/lekë	Realizimi 12-mujori 000/lekë
P09230.Q2.O1.A12. Nxitja e Perfshirjes Sociale dhe Zhvillimit te komunitetit LLOGARI JAShte THESARI dhe te trashguara	Realizuar		7	7

Përshkrimi i aktiviteteve:

V912AAA. Shërbime Mbështetëse të Stafit të Arsimit Bazë

P.AI141.Q1.O1 .A1. Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor (paga/sigurime shoqerore) & të trashëguara, Bashkia Shkoder, Listepagese te llogaritur.

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak per personelin edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor per periudhen 12 mujore vitit 2025.

P.AI141.Q1.O1 .A2. Mbështetja e personelit mbeshtetes për arsimin bazë. (paga/sigurime shoqerore) dhe stafi i drejtorise & të trashëguara, Bashkia Shkoder, Listepagese te llogaritur

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak per periudhen 12 mujore te vitit 2025.

P.AI141.Q1.O1 .A3. Mbështetja e personelit mbeshtetes te arsimit baze (paga/sigurime shoqerore) & të trashëguara

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak per personelin mbeshtetes te arsimit baze per periudhen 12 mujore te vitit 2025.

V912AAB.Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funksionale

P.AI141.Q1.O1 .A4. Mbeshtetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshtetese te arsimit baze e të trasheguara. Sigurimi i bazës materiale në shkollat 9-vjecare në qytet dhe njësi administrative është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës në kushte optimale.

Jane te nevojshme blerje materiale elektrike si celësa, priza, tel elektrik, llampa, portollampa, materiale hidraulike si grupe dushi, lavamana, pompa uji, bojë për lysterje të ambienteve të brendshme, dezinfektimi i shkollave, materiale pastrimi si kova fshesa, shtupa, detergjentë, materiale ndërtimi, kancelari për nevojat e shkollave në Bashkinë Shkodër. Eshte realizuar.

P.AI141.Q1.O1 .A5. Mbeshtetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshtetese te arsimit baze (kancelari) & të trashëguara

Jane bere blerje e materialeve kancelarike per arsimin baze sipas kerkesave dhe jane realizuar per vitin 2025.

P.AI141.Q1.O3 .A6. Ngrohje me dru zjarri për sistemin e arsimit bazë. & të trashëguara

Është e nevojshme te blihen dru zjarri qe shërbejnë për ngrohje në 13 shkolla qytet dhe 47 shkolla në njësitë administrative. Eshte realizuar.

P.AI141.Q1.O1 .A7. Ngrohje me lende djegese karburante për sistemin e arsimit baze dhe furnizim për mjetet transporti (nafte + benzine) & të trashëguara

Është e nevojshme furnizimi me lende djegese nafte ne 7 shkolla qytet. Eshte zhvilluar procedura e prokurimit por nuk eshte realizuar per arsye se nuk ka patur operator ofertues.

P.AI141.Q1.O1 .A8. Mirembajtje e mjeteve te transportit per sherbimet mbeshtetese te sistemit arsimor baze & të trashëguara.

Shpenzimi për mirëmbajtje realizohet sipas nevojave që kanë mjetet. 1 mjet ,furgoni për transportin e fëmijëve në shkollën 3-Dhjetori dhe 3 automjete për transport të bazës materiale në shkolla. Eshte realizuar mirmbarjtja dhe sigurimi i automjeteve, pagesa e taksave, kolaudimi i tyre.

P.AI141.Q1.O1 .A9. Mirembajtje e zakonshme e objekteve arsimore ,arsimi baze & të trashëguara.
Kontrate e lidhur ne proces realizimi.

P.AI141.Q1.O1 .A10. Sigurimi i objekteve per raste te ngjarjeve te jashtezakonshme si zjarr dhe termete arsimi baze (siguracioni i nderteses). Bëhet sigurimi i ndërtesave të shkollave për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe tërmete. Eshte realizuar.

P.AI141.Q1.O1 .A11.Shërbim I sigurisë në objekte, arsimi baze dhe parashkollor & të trashëguara.
Mbështeten me shërbim sigurie 22 shkolla në qytet, QKF, magazinat dhe 28 shkolla në njësitë administrative si shkolla Ismail Qemali, Azem Hajdari, Xheladin Fishta, Skenderbeg, Dëshmorët e Prishtinës, Martin Camaj, Ndoc Mazi, Salo Halili, Ali Lacej, Ndre Mjeda etj. Eshte realizuar.

P.AI141.Q1.O1 A12.Mirëmbajtje e objekteve arsimore -Bojatisja & të trashëguara. Eshte e nevojshme sipas kerkesave te shkollave mirembajtja e tyre me bojatisje. Kontrate e lidhur në proces.

P.AI141.Q1.O1.A13. Mirëmbajtje e rrethimeve objekteve arsimore e arsimit baze. & të trashëguara.

Eshte e nevojshme gjate vitit mirembajtja e rrethimeve te objekteve arsimore. Kontrate e lidhur, likujduar situacioni i pare dhe eshte ne proces.

P.AI141.Q1.O1.A15. Mirembatje fasada ,sistemim kapote shkolla 9-vjecare Tringe Smajli & të trashëguara. Nuk eshte realizuar per arsye se nuk ka patur operator oferues.

P.AI141.Q1.O1.A16. Mirembatje Terrace shkolla 9-vjecare Edith Durham & të trashëguara.

Nuk eshte realizuar per arsye se nuk ka patur operator oferues.

V912AAD. Fëmijë që Ndjekin Kopështin

P.AI141.Q1.O1.A14. Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor. materiale pastrimi dhe paisje orendi) e të trashëguara.

Është realizuar pjesërisht blerje materialet e pastrimit: detergjentë dhe materiale për pastrim dhe materiale higjeno- sanitare për të gjitha Kopshtet e Bashkisë Shkodër. Sigurimi i bazës materiale në kopshte është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës. Për këtë arsye duke konstatuar situatën në kopshte janë parashikur për tu blerë rafte, tavolina, batanije, carcafë, enë kuzhine etj. Jane realizuar blerja e materialeve te pastrimit dhe per paisje orendi eshte lidhur kontrata dhe eshte ne proces.

P.AI141.Q1.O1.A15. Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor.(kancelari) & të trashëguara Eshte realizuar blerja e mjeteve kancelarike per zhvillimin mesimor gjate vitit per arsimin parashkollor.

P.AI141.Q1.O1.A16. Ngrohje dhe gatim me lëndë djegese (dru zjarri, dru pelet, nafte dhe gaz) për arsimin parashkollor & të trashëguara.

Realizuar pjesërisht, janë blerje dru zjarri për arsimin parashkollor për të gjitha kopshtet që përdorin soba me dru për ngrohje gjithashtu dhe pelet për Kopshtin Ngjyrat. Eshte realizuar

P.AI141.Q1.O1.A17. Sigurimi i objekteve të arsimit parashkollor (siguracioni i ndërtesës) & të trashëguara.

Eshte realizuar

P.AI141..Q1.O1.A18. Dezinfektim i mjediseve të objekteve në arsimin parashkollor. & të trashëguara.

Për të patur ambiente sa më higjenike dhe të mbrojtura ndaj infektiveve të ndryshme, realizohet dizinfektimi i ambienteve të të gjithë godinave të kopshteve. Eshte realizuar

P.AI141.Q1.O1.A19. Furnizim me EE dhe ujë për arsimin parashkollor.

Faturat e furnizimit me energji elektrike për godinat e kopshteve si më poshtë: "16 Shtatori", "Bep Tusha", "Ton Alimhilli", "Ismet Sali Bruçaj", tek "Veterinarja", "Ngjyrat", "Isa Jakupi" dhe "Mati Logoreci" dhe "Shtoj i ri" të cilat janë me linjë dhe matës të veçantë janë realizuar.

Faturat e furnizimit me ujë për godinat e kopshteve si më poshtë:

Kopshti "16 Shtatori", Kopshti "Ngjyrat", Kopshti "Bep Tusha", Kopshti "Ton Alimhilli", Kopshti "Soros", Kopshti "Mati Logoreci", Kopshti "Oblikë" Kopshti "Bahcallek" jane likuiduar cdo muaj sipas faturave mujore përkatëse. Realizuar

P.AI141.Q1.O1.A20.Sigurimi i transportit për shërbimet e arsimit parashkollor. & të trashëguara.

Duhet të realizohet kolaudimi, taksat, dhe siguracioni i automjetit që furnizon me ushqime kopshtet. Eshte realizuar.

P.AI141.Q1.O1.A21. Furnizim me ushqime për kopshtet në Bashkinë e Shkodrës & të trashëguara.

Në 7 kopshtet me drekë (“Bep Tusha”, “Ton Alimhilli”, “I.S.Bruçaj”, “Ngjyrat”, “1 Qershori”, ”Edit Durham” dhe “Njomëzat”) frekuentojnë mesatarisht 370 fëmijë. Kopshtet janë furnizuar me ushqime deri 31.12.2025 nga kontrata e pare furnizimit te vitit 2025 dhe eshte lidhur kontrata e dyte per vazhdimin e furnizimit me ushqime per periudhen e mbetur.

P.AI141.Q1.O1.A22. Mirëmbajtje e zakonshme për ndërtesat e arsimit parashkollor. & të trashëguara.

Ndërtesat e sistemit arsimor parashkollor për të qenë sa më të përshtatshme dhe komode për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve kanë nevojë për mirëmbajtje, si lysterje me bojë dhe riparime të ndryshme, aty ku është më e domosdoshme në Kopshte. Eshte realizuar.

P.AI141..Q1.O1.A23 Shpenzime per mirembajtjen e aparateve teknike & të trashëguara.

Gjatë procesit të punës në kopshtet me drekë, kërkohet mirëmbajtje e aparateve dhe pajisjeve teknike, si lavatricet dhe frigoriferët, në kopshtet e ndryshme. Këto pajisje kanë nevojë për riparime gjatë vitit, sipas nevojës. Është realizuar.

P.AI141.Q1.O1.A24 .Mbeshtetje e femijeve ne nevoje dhe aftesi te kufizuar per perjashtim nga tarifa e pageses. & të trashëguara.

Referuar rasteve të fëmijëve ne nevoje që perjashtohen nga tarifa , nga mosha 3-6 vjeç rezulton që janë rreth 45 fëmijë(Plani fillestar) dhe 14 prej tyre kane perfituruar nga përjashtimi i detyrimit mujor në Kopshte që llogaritet me kuote 160 leke në dite per 22 dite në muaj per 12 muajt në vit.

P09120.Q1.O1.A30 Blerje materiale per mirembajtje tualete, terraca, rrjete elektrike, shkolla dhe kopshte & të trashëguara. Jane blere materiale hidraulike, elektrik si dhe materiale per mirembajtjen e tarracave.

Eshte realizuar

V912AAF. Fëmijë që Frekuentojnë Qendrat Kulturore të Fëmijëve

P.AI141.Q1.O2 .A1. Mbështetja për punonjësit e Qendres Kulturore e Femijeve Kujtim Alija & të trashëguara

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak te vitit 2025.

P.AI141.Q1.O2 .A2. Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë & të trashëguara

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Kujtim Alija”, me mbështetje nga Bashkia Shkodër, organizoi konkursin e zërave “Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë”, edicioni i 30-të, si pjesë e planit vjetor të veprimtarive. Ky konkurs, përveç nxjerrjes në pah të talenteve, shërben për promovimin e muzikës shqiptare për fëmijë, duke u mundësuar atyre mësimin e këngëve tradicionale për një periudhë të gjatë.

Aktiviteti kaloi në pesë faza nga janari deri në prill 2025, duke përfshirë rreth 1600 fëmijë nga shkollat publike dhe jopublike në Bashkinë Shkodër. Gjatë fazës së parë, specialistët e QKF-së u angazhuan pranë shkollave të qytetit, ndërsa një risi këtë vit ishte përzgjedhja e fëmijëve të talentuar në këndim nga disa njësi

administrative si Berdicë, Guri i Zi, Postrinë dhe Velipojë.

Grupi i punës evidentoi një numër të madh fëmijësh të talentuar.

Fëmijët u vlerësuan nga një juri profesioniste e përbërë nga figura të njohura të muzikës.

Në fazën e tretë, në konkurrim u bashkuan edhe formacionet korale, një risi kjo në këtë edicion të 30-të. Ky aktivitet është një mundësi e shkëlqyer për të promovuar talentet e reja dhe për të ruajtur traditat muzikore të vendit.

Risi ishte konkurrimi i nëntë formacioneve korale (330 fëmijë pjesëmarrës), si edhe konkurrimi me këngën qytetare, si dhe organizimi i gjysmëfinaleve dhe finaleve në teatrin “Migjeni”. Kjo tregon për një angazhim të madh dhe një nivel të lartë të talentit të fëmijëve. Kategoritë e ndara sipas grupmoshave kanë ofruar mundësi të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit, duke inkurajuar zhvillimin e talentit të tyre.

Në realizimin e këtij aktiviteti u angazhuan antarë jurie, mësues muzike, specialistët të fushës, dhe të ftuar të cilët u përzgjedhën nga Këshilli Artistik mbi bazën e përvojës, kontributeve dhe të rezultateve në punën që kanë bërë gjatë viteve.

P.AI141.Q1.O2 .A3. Festivali i 63-të mbarëkombëtar për fëmijë & të trashëguara

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Kujtim Alija”, me mbështetjen e Bashkisë Shkodër, në zbatim të planit vjetor të veprimtarive organizoi Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë, edicioni 63-të. Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë u zhvillua me datat 30, 31 maj dhe 1 qershor 2025. Realizimi i këtij Festivali, i vetmi i këtij lloji në realitetin shqipfolës, edhe këtë vit ruajti dhe përçoi përpara traditën e gjatë e të suksesshme të këtij zhanri, gjithashtu stimuloi talentin e fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe punës së kualifikuar në të kënduarit live (direkt).

Ky festival për fëmijë shënoi një ngjarje të veçantë dhe të paharrueshme, duke arritur të promovojë kreativitetin dhe talentin e fëmijëve, me interpretimet më të mira të krijimeve më të zgjedhura të kompozitorëve, poetëve, aranzhuesve dhe këngëtarëve nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Diaspora, duke përfshirë një numër të madh fëmijësh, që sollën me vete një shumëllojshmëri kulturash, që pasuruan atmosferën e festivalit.

Festivali prezantoi krijime origjinale, të cilat të ndara në dy kategori të ndryshme ofruan një platformë për fëmijët që të shprehin veten përmes këngëve, performancave dhe artit skenik, duke reflektuar emocione dhe përvojat e tyre.

Në realizimin e këtij aktiviteti u angazhuan specialistë të fushës, dhe të ftuar të cilët u përzgjedhën nga ekipi realizues mbi bazën e përvojës, kontributeve dhe të rezultateve në punën që kanë bërë gjatë viteve.

Kori i fëmijëve të QKF “Kujtim Alija” i përbërë nga 90 fëmijë nga mosha 5 – 14 vjeç, mbajti pjesën më të rëndësishme të festivalit, duke sjellë harmoninë dhe energjinë e grupit, duke e bërë çdo performancë të paharrueshme.

31 solistë të talentuar patën mundësinë të shfaqin aftësitë e tyre vokale në skenë, duke sjellë një gamë të gjerë emocionesh dhe stilesh muzikore.

Mbi 200 fëmijë pjesëmarrës në këtë edicion, i shtuan bukurinë qytetit tonë për gjatë gjithë ditëve të zhvillimit të Festivalit Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë.

Edhe këtë vit çmimet u ndanë për dy kategori (grupmosha): Kategoria e grupmoshës 5 - 8 vjeç dhe kategoria e grupmoshës 9 - 14 vjeç.

Risi e kësaj edicioni ishte marrëveshja që Bashkia Shkodër bëri me Radio Televizionin Shqiptar , për pjesëmarrjen në JUNIOR EUROVISION CONTEST, të këngës fituese për kategorinë 9-12 vjeç të festivalit, e cila ka përfaqësuar Shqipërinë në këtë konkurrim të rëndësishëm.

Festivali, për tri netë me radhë u ndoq nga një numër i madh spektatorësh, si dhe u transmetua drejtpërdrejt nga valët e RTSH-së , si dhe u pasqyrua në shumë media lokale dhe kombëtare.

P.A141.Q1.O2 .A4.“Veprimtari masive” (sportive, artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve. & të trashëguara

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Kujtim Alija” Shkodër, në zbatim të planit vjetor të veprimtarive , zhvilloi veprimtaritë masive sportive:

Kampionati i shahut dhe pingpongut 2025

Kampionati i shahut (vajza dhe djem)

Kampionati i pingpongut (vajza dhe djem)

Ky aktivitet pati për qëllim promovimin e sporteve, duke përfshirë 150 nxënës nga 32 shkolla të qytetit në garën e shahut dhe rreth 110 nxënës nga 28 shkolla në garën e pingpongut.

Kampionatet pranverore 2025, në të disa disiplinat sportive :

Basketboll,Volejboll, Minifutboll dhe Patina (vajza dhe djem) . Në këto veprimtari sportive u angazhuan 1400 nxënës nga mbi 40 shkolla 9-vjeçare publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër, gjithashtu edhe një numër i madh mësuesish të edukimit fizik.

Finalet e këtyre disiplinave sportive do të zhvillohen gjatë muajit maj 2025 , ku u shperndane trofe, medalje dhe certifikata për fituesit.

“Zbavitimi me gjuhët e huaja”

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Kujtim Alija”, me mbështetje nga Bashkia Shkodër, në zbatim të planit vjetor të veprimtarive organizoi veprimtarinë “Zbavitimi me gjuhët e huaja”, si një mundësi për të hapur dyert për përvetësimin e reja, duke zgjeruar perspektivat dhe duke pasuruar jetën e fëmijëve në komunikimin, kuptimin kulturor, përfitimet njohëse, mundësitë e karrierës dhe rritjen personale të tyre.

Veprimtaria “Zbavitimi me gjuhët e huaja” është një nga veprimtaritë më të rëndësishme dhe të përvetshme që zhvillohet në Qendrën tonë Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”.

Kjo veprimtari sjell së bashku nxënësit që frekuentojnë kurset e gjuhëve të huaja në këtë institucion, konkretisht të gjuhëve angleze, italiane, frënge dhe gjermane.

Veprimtaria “Zbavitimi me gjuhët e huaja”,u realizua me datën 07.05.2025, duke shënuar edicionin e 26-të. Ky aktivitet vjen si përmblyllje e aktiviteteve të zhvilluara në përputhje me programin vjetor, si dhe me atë të veprimtarive zbavitëse të realizuara në këto kurse të shpërndara sistematikisht gjatë gjithë vitit të realizuara në rrethet e sektorit tekniko-shkencor, duke përfshirë mbi 200 fëmijë, pjesë e rretheve të gjuhës angleze, gjermane, frënge dhe italiane, si dhe fëmijët e rretheve të sektorit të arteve.

Gara me biçikleta 2025

Ky aktivitet është zhvilluar në muajin tetor 2025 ku kanë marrë pjesë fëmijet e kopshteve moshë 3-6 vjeç.

Gara vrapimi 2025

Më datë 9 Dhjetor 2025, në Stadiumin "Loro Boriçi", u zhvillua aktiviteti sportiv "Gara vrapimi 2025", me pjesëmarrjen e 125 nxënësve nga rreth 40 shkolla 9-vjeçare të Bashkisë Shkodër.

Fjala artistike 2025

Ky aktivitet u zhvillua në tri faza. Faza e parë u realizua nëpër shkolla nën kujdesin e specialistëve të QKF-së, ndërsa faza e dytë u zhvillua për shtatë ditë radhazi, nga 10.11.2025 deri më 18.11.2025, në ambientet e QKF "Kujtim Alija". Në këtë fazë morën pjesë 288 konkurrentë nga 32 shkolla 9-vjeçare, publike dhe jopublike, të Bashkisë Shkodër.

Fëmijët pjesëmarrës u vlerësuan nga një juri profesioniste, e përbërë nga figura të shquara të artit. Risi e këtij edicioni ishte futja e kategorisë së Dramatizimit.

Për natën finale u përzgjedhën 25 konkurrentë dhe 8 grupe, të cilët konkurruan në katër kategori.

Nga këta:

- 10 nxënës nga Arsimi Fillor (AF),
- 14 interpretues nga Arsimi i Mesëm i Ulët (AMU),
- 1 interpretues i humorit,
- 4 grupe humori,
- 4 grupe në kategorinë e dramatizimit.

Finalja e konkursit u zhvillua më datë 26 nëntor 2025 dhe u ndoq nga një numër i madh spektatorësh. Aktiviteti u pasqyrua gjithashtu nga mediat lokale, duke i dhënë rëndësi dhe jehonë veprimtarisë.

Përveç konkurrimit në katër kategoritë (AF, AMU, humor dhe dramatizim), nata finale u shoqërua me elementë spektakli. Fëmijët e QKF "Kujtim Alija" interpretuan këngë, valle dhe luajtën në instrumente muzikore, duke pasuruar artistikisht aktivitetin. Në përfundim të konkursit u ndanë 11 çmime, ku për fituesit u akorduan stimuj motivues dhe dhurata.

P.A1141.Q1.O2 .A5. "Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore" & të trashëguara

Qendra Kulturore e Fëmijëve "Kujtim Alija", e mbështetur nga Bashkia Shkodër, vazhdon traditën 78 -vjeçare të punës me kurset jashtëshkollore më të kërkuara, me rezultate dhe te dashura nga fëmijët. Pranë QKF "Kujtim Alija", janë afruar fëmijë të talentuar në fushat respektive të cilët argëtohen, aftësohen dhe sterviten nga një grup mësuesish dhe specialistësh të përkushtuar në fushën e artit, sportit edhe shkencës. Në QKF "Kujtim Alija", u përfshinë në kurset jashtëshkollore fëmijë nga të gjitha shkollat dhe si rezultat i shtimit të tre kurseve të reja në fushat e edukimit Piano, Volejboll dhe Trashëgimia e këngës qytetare. (nga

data 15 .04. 2025) Pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” Shkodër, gjatë muajve janar – prill 2025, vijoi aktiviteti i rretheve artistike, tekniko-shkencore dhe sportive sipas planit të punës. Gjatë këtyre muajve, pranë QKF-së janë ofruar 33 kurse të mbuluara nga instruktorë me honorare. Fushat e edukimit ku instruktorët ushtrojnë veprimtarinë me fëmijët pranë Qendrës Kulturore për Fëmijë “Kujtim Alija”, Bashkia Shkodër janë: Kërcim (dy kurse), Trombë, Fizarmonikë, Kitarë (dy kurse), Pikturë (dy kurse), Piano (dy kurse), Aktrim, Perkusion, Këndim, Basketboll (vajza dhe djem), Volejboll (dy kurse), Futboll (dy kurse), Shah, Aerobi, Anglisht (tre kurse), Frëngjisht, Italisht, Gjermanisht, Skenografi/Dizajn, Arte & zeje, Atletikë, Violinë dhe Trashëgimia e këngës qytetare.

Muaji prill 2025 mbyllet me 33 kurse që drejtohen nga instruktorë me honorare. Gjate muajit dhjetor janë angazhuar edhe instruktorët e rinj . Konkretisht, në fushën e edukimit italisht, në disiplinën e pingpongut, në disiplinën e patinazhit, në disiplinën e volejbollit.

P.AI141.Q1.O2 .A6. Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 vjeçare. & të trashëguar

Në këtë veprimtari morën pjesë mbi 230 fëmijë dhe të rinj, të cilët interpretuan në disiplina të ndryshme artistike, si: këngë, humor, interpretim instrumental dhe vallëzim. Aktiviteti u ndoq nga një numër i madh artdashësish shkodranë, duke dëshmuar interesin e lartë të komunitetit për veprimtaritë kulturore të QKF-së. Gjithashtu, mbrëmja nxiti bashkëpunimin me artistë të afirmuar, të ftuar nderi, të cilët rritën interesin dhe pëlqyeshmërinë e publikut, duke e bërë këtë aktivitet mjaft argëtues dhe të mirëpritur nga komuniteti.

P.AI141.Q1.O2 .A7. Mbeshtetje shkolla Prenke Jakova & të trashëguara

Shkolla Artistike "Prekë Jakova", në bashkëpunim me Shoqatën Kulturore Artistike "Mark Kaftalli" dhe të gjitha shkollat 9-vjeçare të qytetit të Shkodrës, ka zhvilluar në muajin Maj festivalin lokal të fëmijëve "Akulllore Fest-Edicioni 11-të " me datë 08 /05/2025".

V912AAK Objekte të Arsimit Bazë dhe Parashkollor të Rikonstruktura

P912ABU Instalimi i sistemit të ngrohjes shkolla Branko Kadia, shkolla Azem Hajdari, shkolla Mati Logoreci

P.AI141.Q1.O3 .A2 Instalimi i sistemit të ngrohjes shkolla “Branko Kadia”, shkolla “Azem Hajdari”, shkolla “Mati Logoreci” - TE TRASHEGUARA

Është realizuar projekti për instalimin e sistemit të ngrohjes në shkollat “Branko Kadia”, “Azem Hajdari” dhe “Mati Logoreci” i cili përbën një ndër investimet më të rëndësishme në kuadër të përmirësimit të kushteve infrastrukturore dhe garantimit të një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor.

Realizimi i këtij investimi pritet të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor, në rritjen e komoditetit dhe sigurisë për nxënësit, si dhe në uljen e kostove afatgjata përmes përdorimit të teknologjive më efikase dhe më ekonomike. Gjithashtu, ky projekt kontribuon në ruajtjen dhe mirëmbajtjen më të mirë të infrastrukturës shkollore, duke parandaluar dëmtimet që mund të shkaktohen nga lagështira dhe temperaturat e ulëta

P912ABO Projekte Rikonstruksion i shkollave dhe fusha sporti

P.AI141.Q1.O3 .A2.Projekte Rikonstruksion i shkollave dhe fusha sporti.

Eshte e nevojshme, përshtatja e godinës për rastet e emergjencave dhe evakuimeve, krijimi i një ambienti të shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina, krijimin i një ambienti më të sigurtë për fëmijët dhe arsimtarët me sistemin e MNZ (mbrojtjes ndaj zjarrit) , krijimin i një ambienti të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara si dhe instalimi i rrjetit të ngrohjes

Realizuar.

P912ABV Ndertimi i tualeteve te reja shkolla Skenderbej.

P.AI141.Q1.O3 .A5 Ndertimi i tualeteve te reja shkolla “Skenderbej” & të trashëguara.

Shkolla Skenderbej ka vetëm një banjë, prandaj këtë vit është planifikuar ndërtimi i banjove të reja në këtë shkollë duke përmirësuar kushtet higjeno-sanitare. Eshtë realizuar.

P912ABX Rikonstruksion I pjesshëm i kopshtit " Ton Alimhilli " .

Rikonstruksion I pjesshëm i kopshtit " Ton Alimhilli " & të trashëguara. Eshte e nevojshme përshtatja e godinës për rastet e emergjencave dhe evakuimeve ,krijimi i një ambienti te shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina ,krijimi i një ambienti me te sigurve për fëmijët dhe arsimtarët me sistemin e MNZ (mbrojtjes ndaj zjarrit), krijimi i një ambienti te përshtatshëm për personat me aftësi te kufizuara, krijimi i një ambienti konformë ligjeve dhe standarti Shkoder dhe kombëtare përmësimdhënie, ngrohje si dhe instalimi i rrjetit LAN në çdo klase. Realizuar.

P912ABP - Rikonstruksion i kopshtit Bep Tusha.

P.AI141.Q1.O3.A3 Rikonstruksion i kopshtit Bep Tusha. Eshte e nevojshme përshtatja e godinës për rastet e emergjencave dhe evakuimeve ,krijimi i një ambienti te shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina ,krijimi i një ambienti me te sigurve për fëmijët dhe arsimtarët me sistemin e MNZ (mbrojtjes ndaj zjarrit). Krijimi i një ambienti te përshtatshëm për personat me aftësi te kufizuara, krijimi i një ambienti konformë ligjeve dhe standarti Shkoder dhe kombëtare përmësimdhënie, ngrohje si dhe instalimi i rrjetit LAN në çdo klase. Kontrate e lidhur ne proces.

P912ABT - Instalimi i ngrohjes qendrore ne shkolla 9-vjecare.

P09120.Q1.O3.A8. Instalimi I ngrohjes qendrore ne shkolla 9-vjecare& të trashëguara.

Për sigurimin e kushteve më komode për ngrohje dhe eliminimin e ngrohjes me gaz për këtë vit është planifikuar ngrohja me kaldajë me naftë për këto shkolla. Realizuar

P912ABN - Shkolla e hapur Ndre Mjeda

P.AI141.Q1.O3.A4. "Shkolla e hapur Ndre Mjeda" e të trashëguara. Eshte e nevojshme përshtatja e godinës për rastet e emergjencave dhe evakuimeve ,krijimi i një ambienti te shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina ,krijimi i një ambienti me te sigurve për fëmijët dhe arsimtarët me sistemin e MNZ (mbrojtjes ndaj zjarrit),krijimi i një ambienti te përshtatshëm për personat me aftësi te kufizuara, krijimi i një ambienti konformë ligjeve dhe standarti Shkoder dhe kombëtare përmësimdhënie, ngrohje si dhe instalimi i rrjetit LAN në çdo klase. Eshte realizuar.

V912AAK Objekte te arsimit baze dhe parashkollor te rikonstruktura

P09120.Q1.O3 .A1. Rikonstruksion i pjesshem Shkolla “Azem Hajdari” - TE TRASHEGUARA

I realizuar . Teprice plani nga viti 2024 .

P912ACD Rikonstruksion Kopshti Ton Alimhilli

P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion “Kopshti Ton Alimhilli”

Eshte realizuar projektimi i objektit “Kopshti Ton Alimhilli” I cili perben nje nder investimet strategjike ne kuader te permiresimit dhe zgjerimit te infrastrukturës së arsimit parashkollor, me synim krijimin e një ambienti bashkëkohor, të sigurt dhe funksional për zhvillimin e fëmijëve.

Ky projekt synon hartimin e një dokumentacioni të plotë teknik dhe arkitektonik, i cili do të garantojë ndërtimin ose rikonstruksionin e një objekti që plotëson standardet kombëtare për institucionet parashkollore, si dhe kërkesat për siguri, aksesueshmëri dhe eficiencë energjetike.

P912ACD Rikonstruksion Kopshti Ton Alimhilli

P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion “Kopshti Ton Alimhilli”

Kontrate e lidhur, ne proces.

P912ACE Rikonstruksion dhe ndërtim palestre Shkolla e hapur Ismail Qemali

P.AI141.Q1.O3.A8. Rikonstruksion dhe ndërtim palestre “Shkolla e hapur “Ismail Qemali”

Kontrate e lidhur, ne proces.

P912ACF Rikonstruksion Shkolla Salo Halili

Eshtë realizuar Projektimi i shkollës “Salo Halili” që perben një hap të rëndësishëm në drejtim të permiresimit të infrastrukturës arsimore dhe krijimit të kushteve bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor. Ky projekt synon hartimin e një dokumentacioni të plotë teknik, i cili do të shërbejë si bazë për ndërtimin e ri ose rikonstruksionin e objektit ekzistues, në përputhje me standardet aktuale të sigurisë dhe cilësisë

P.AI141.Q1.O3 .A9 Rikonstruksion Shkolla Salo Halili

Në proces prokurimi

P912ACG Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi

P.AI141.Q1.O3 .A10 Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi

Realizuar projektimi

V923AAA.Shërbime Mbështetese të Stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm.

P.AI141.Q2.O1.A1 Mbështetje për punonjësit e shërbimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm & të trashëguara

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak Per periudhen 12 mujore te vitit 2025.

P.AI141.Q2.O1.A2 Mbështetje për punonjësit e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak Per periudhen 12 mujore te vitit 2025.

P.AI141.Q2.O1 .A3. Mbështetje për punonjësit e shërbimit arsimit të mesëm te pergjithshem.

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak Per periudhen 12 mujore te vitit 2025.

V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale.

P.AI141.Q2.O1.A4. Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse në arsimin e mesëm të përgjithshëm e të trashëguara.

Në sistemin arsimor të mesëm të përgjithshëm të Bashkisë Shkodër ndodhen 13 shkolla nga të cilat 6 shkolla të mesme në qytet dhe 7 shkolla të mesme në njesitë Administrative. Në këtë zë perfshihen blerje materiale hidraulike si lavamane, pompa, nipla, materiale elektrike si celësa, priza, tel elektrik, bojë për lysterje të ambienteve të brendshme, dezinfektim që realizohet 2 herë në vit, materiale pastrimi higjeno-sanitare dhe materiale të tjera. Jane realizaur te gjithë zerat e ketij projekti, blerje paisje për mobilim është në proces likujdimi.

P.AI141.Q2.O1.A5. Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse në arsimin e mesëm të përgjithshëm (Kancelari) & të trashëguara

Për zhvillimin e metodikave mesimore dhe për mbarëvajtjen e punës kërkohet furnizimi me kancelari në Shkolla dhe zyre. Per kete eshte parashikur blerja e materialeve kancelarike si letra format A4, makine kapese aktesh, dosje, goma, stilolapsa, vizore, etj. Eshtë realizuar

P.AI141.Q2.O1.A6. Ngrohje me dru zjarri për arsimin e mesëm të përgjithshëm. & të trashëguara.

Për krijimin e kushteve sa më të favorshme të nxënësve që mësojnë në shkollat e Bashkisë Shkoder, kemi parashikuar blerjen e lendës dru zjarri për ngrohje për 6 shkollat të arsimit të mesem të përgjithshëm në Njësiti Administrative.

Shkolla e mesme “Adem Haxhija”, Njësia Administrative Postribë dhe Shkolla e mesme “Lucë Agraja”, Njësia Administrative Dajç. Gjimnazi “Oblike”, NjA Ana Malit, Shkolla “Nikolle Zagorjani”, NjA Velipojë, Shkolla “At Gjon Karma” NjA Gur i Zi, Shkolla “Mehmet Shpendi”, NjA Shalë. Eshte realizar

P.AI141.Q2.O1.A7. Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtezakonshme si zjarr dhe termete për arsimin e mesëm të përgjithshëm & të trashëguara.

Per kete vit jane planifikuar te sigurohen 11 shkolla. Prokurime qe jane ne proces.

P.AI141.Q2.O1.A8. Shërbim I Sigurisë në objekte & të trashëguara. Eshte realizuar.

P.AI141.Q2.O1.A10. Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm & të trashëguara.

Për vitin 2025 është menduar për të ndërhyre në ato objekte që kane nevojën më të madhe dhe numrin më të konsiderueshëm të nxënësve. Eshte realizuar.

P.AI141.Q2.O1.A11.Mirëmbajtje e objekteve arsimore -Bojatisja & të trashëguara.

Eshte e nevojshme sipas kërkesave të shkollave mirembajtja e tyre me bojatisje. Kontrate e lidhur, në proces.

V923AAF Nxënës të Akomoduar në Konvikt. (numri i nxenesve ne konvikt).

P.AI141.Q2.O1.A12.Mbështetje për infrastrukturen dhe shërbimet mbështetëse arsimit të mesëm profesional & të trashëguara.

Për krijimin e kushteve sa më të favorshme të nxënësve që jetojnë në konvikt të shkollës Artistike Prekë Jakova, janë parashikuar blerja e materialeve mbështetëse në shërbim të tyre.

Për realizimin e ndërhyrjeve është e nevojshme të parashikohen materiale si: Brava dyer druri (konvikti në shkollën artistike dhe atë Industriale) drynj, mjete punë të ndryshëm (sharra, lopata, kazma, pinca, çekiç, traponë.etj) Nisur nga problemet e paraqitura janë parashikuar këto materiale hidraulike: Pompa uji, rubinete (problem që shfaqet vazhdimisht në shkollë nga dëmtimet e nxënësve), mishilatorë të ndryshëm, shkarkues banjo, tuba të ndryshëm fresibel (element që konsumohet nga të gjitha shkollat), vegla punë (çelësa hidraulike, pince hidraulike), lavamanë dhe WC që thyhen, shkarkues uji në banjo, rubinete të natyrave të ndryshme, pjesë ndërrimi për pompa uji dhe pompa që digjen nga përdorimi kur mungon uji në rrjet, tuba të ndryshëm fresibël.Për të krijuar një situatë sa më normale të kushteve higjienike kemi vlerësuar nevojën e atyre materialeve që do mundësojnë mbajtjen në kushte higjienike normale në ambientet e konviktit. Pjesë e ndërhyrjeve në konvikt është dhe riparimi i pajisjeve dhe orëdivë (lavatrice, frigorifere, shporete). Kjo ndërhyrje është e nevojshme edhe për të ulur shpenzimet për blerja të pajisjeve (orëdivë). Është bërë planifikimi për energjinë elektrike. Është bërë planifikimi për konsumin e ujit të pijshëm. Për realizimin e ndërhyrjeve është e nevojshme të parashikohen materiale elektrike si: llampa ekonomike, neon, portollampa e aksesore të tjerë të nevojshëm për përmirësimin e kushteve në ambientet e konvikteve. Eshte realizuar.

P.AI141.Q2.O1.A13.Mbështetje për infrastrukturen dhe shërbimet mbështetëse arsimit të mesëm profesional (kancelari) & të trashëguara

Për zhvillimin e metodikave mesimore dhe për mbarëvajtjen e punës kërkohet furnizimi me kancelari në Shkollë .Per kete eshte parashikur blerja e materialeve kancelarike si letra format A4, makine kapese aktesh, dosje, goma, stilolapsa, vizore, etj. Eshte realizuar.

P.AI141.Q2.O1.A14. Mbeshtetje e Ndermarrjes se Trajtimin te Studenteve e të trashëguara

Me synimin e përmirësimit të situatës, rritjes së numrit të studentëve për akomodim, tërheqjen e personave të tretë dhe zgjerimin e fushës së interesit për akomodim në shoqëri tone, Bashkia Shkodër ka mbështetur Trajtimin e Studentëve sha. Shkodër.

P.AI141.Q2.O1.A15 Materiale në shërbim të konvikteve.

Eshte e nevojshme blerja materiale në shërbim të konvikteve si dhe blerja materiale kuzhine. Eshte realizuar.

P.AI141.Q2.O1.A14 Mobim i konviktit "Preng Jakova". Per krijimin e kushteve optimale eshte e nevojshme blerja e mobiljeve per arredimin e konviktit. Eshte prokuruar si procedure dhe është në proces.

P.AI141.Q2.O1.A15. Ngrohje dhe transport me lëndë djegëse karburante e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara.

Në këtë zë blihet karburant (naftë) për ngrohje për kaldajën e konviktit. Gjithashtu përdoret dhe për ngrohjen e shkollave të mesme të përgjithshme që janë me kaldajë. Eshtë realizuar.

P.AI141.Q2.O1.A16 Furnizim me energji elektrike, uje, shërbime postare, hostim web, internet e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara.

Ky zë, zë peshë në shpenzimet e arsimit profesional sepse përfshihen shpenzimet për të gjitha shkollat.

Është bërë pagesa në vazhdim për të gjitha shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit.

Ky zë është realizuar sipas faturave të furnitorit.

V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale

P09230.Q1.O2.A5 Ndricim I oborrit te shkolles Jordan Misja. & të trashëguara.

Eshte e nevojshme blerja e materialeve elektrike per ndrcimin e shkolles. Nuk është ralizuar per arsyje se nuk ka patur ofrues ekonomik..

P.AI141.Q2.O1.A18. Mirëmbajtje e rrethimeve objekteve arsimore e arsimit të mesëm profesional. & të trashëguara. Eshte realizuar.

V923AAF Nxënës të Akomoduar në Konvikt. (numri i nxenesve ne konvikt)

P.AI141.Q2.O1.A18. Dezinfektimi, higjienizim dhe sigurimi i ndërtesave e arsimit të mesëm profesional & të trashëguara. Eshte realizuar.

P.AI141.Q2.O1.A19 Mirëmbajtje e objekteve arsimore -Bojatisja & të trashëguara. Eshte lidhur kontrata dhe eshte ne proces realizimi.

V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale

P.AI141.Q2.O1.A21. Mirëmbajtje e objekteve arsimore & të trashëguara.

Eshte e nevojshme gjate vitit mirembajtja e rrethimeve te objekteve arsimore. Eshte realizuar.

V923AAF Nxënës të Akomoduar në Konvikt. (numri i nxenesve ne konvikt)

P.AI141.Q2.O1.A22. Organizimi i panairit te shkollave te mesme profesionale ne Bashkine Shkoder.

Eshte hedhur si procedure nuk ka pasur ofertues dhe vlere eshte mbartur per vitin 2026.

V923AAB. Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale

P.AI141.Q2.O2.A1 Mirembajtje (Shtrim oborre 5 shkolla).

Gjatë inspektimeve në shkolla ka rezultuar se gjatë periudhës së dimrit disa oborre shkollash përmbyten dhe vështirësojnë kalimin e nxënësve të shkollës.

Prandaj për këtë është planifikuar shtrimin e pesë oborreve të shkollave
Kontrate e lidhur ne proces.

P.AI141.Q2.O2.A2 Mirembajtje (riparim kaldaja te shkollave).

Gjate vitit eshte e nevojshme riparimi i difekteve qe shfaqen ne shkolla perkatese. Eshte realizuar sipas nevojave.

PO9230.Q1.O2.A7. Blerje materiale per mirembajtjen e tualeteve te shkollave te mesme & të trashëguara.

Shkollat e mesme kane nevojë per mirembajtjen e banjove duke përmirësuar kushtet higjeno-sanitare. Eshte realizuar.

P09230.Q2.O1.A12. Nxitja e Perfshirjes Sociale dhe Zhvillimit te komunitetit -TE TRASHEGUARA

P923AAM - Shkolla e hapur Kolë Idromeno.

Eshte e nevojshme krijimi i një ambienti te shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina, krijimi i një ambienti te përshtatshëm për personat me aftësi te kufizuara ,krijimi i një ambienti konformë ligjeve dhe standartit përmësimdhënie.

Eshte realizuar rikonstruksioni i plote i shkolles Kolë Idromeno. Eshte lidhur kontrata e mbikqyrjes per objektin "Rikonstruksion Kole Idromeno".

P923AAO Rikonstruksion shkolla te mesme te pergjithshme

P.AI141 .Q2.O2.A3 Rikonstruksion shkolla te mesme te pergjithshme.

Eshte e nevojshme nderhyrja per shkak te amortizimi te palestrës se godinës, lagështise ne ambientet e brendshme te godinësi dhe mungesa e sisitemit te ngrohjes.

Gjithashtu dhe dëmtimi i pjesshëm i disa dritareve dhe dyerve dhe amortizimi i suvatimeve te godinës. Mungesa e rrjetit të ngrohjes në shkollë.

Prokurime qe jane ne proces.

V923AAB Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funkionale

P923AAN - Projektim, rikonstruksion shkolla të mesme të përgjithshme

P.AI141.Q2.O2.A5 Projektim Rikonstruksion shkolla te mesme te pergjithshme & të trashëguara.

Eshte realizuar projekti për shkollen Shejnaze Juka.

P923AAP - Rikonstruksion shkolla Mehmet Shpendi Nj Ad Shale

PO9230.Q1.O2.A7. Rikonstruksion shkolla Mehmet Shpendi Nj Ad Shale & të trashëguara.

Eshte e nevojshme përshtatja e godinës për rastet e emergjencave dhe evakuimeve, krijimi i një ambienti te shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina, krijimi i një ambienti me te sigurte për fëmijët dhe

arsimtares me sistemin e MNZ (mbrojtjes ndaj zjarrit), krijimi i një ambienti të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara etj. Nuk është realizuar për arsye se nuk ka patur ofertues ekonomik.

V043AAC. Fëmijë që frekuentojnë çerdhet

P.AI141..Q3.O1.A1 Mbështetja e personelit të cerdheve (paga/sigurime shoqërore)& të trashëguara

Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore sipas pagave të miratuara në Këshillin Bashkiak për periudhën 12 mujore të vitit 2025.

P.AI141.Q3.O1.A2. Materiale mbështetëse për Cerdhet. (kancelari,). & të trashëguara.

Eshtë realizuar blerja me materiale kancelarike për cerdhet sipas kërkesave.

P.AI141.Q3.O1.A3 Furnizim me ushqime për Cerdhet në Bashkinë e Shkodrës & të trashëguara

Në 7 cerdhet me drekë frekuentojnë mesatarisht 260 fëmijë. Cerdhet janë furnizuar me ushqime nga kontrata e vitit 2025. Eshtë lidhur kontrata për 2025-en dhe është realizuar. Cerdhet janë furnizuar me ushqime deri 31.12.2025 nga kontrata e parë furnizimit të vitit 2025 dhe është lidhur kontrata e dytë për vazhdimin e furnizimit me ushqime për periudhën e mbetur.

P.AI141.Q3.O1.A4. Materiale mbështetëse për mirembajtje për Cerdhet & të trashëguara.

Për krijimin e kushteve sa më të favorshme për qëndrimin e fëmijëve është e domosdoshme blerja e materialeve sipas kërkesave të drejtorive si: (Enë kuzhine, karrige, shtretër, çarçafë, peshqirë, batanije, grirese perimesh, grirëse mishi, detergjente për pastrim etj.) Është bërë planifikimi për energjinë elektrike në bazë të Kilovat të konsumuar në çerdhe. Eshtë bërë një planifikim për konsumin e ujit për cerdhet. Gjithashtu shumë orë janë të amortizuara në çerdhe dhe për këtë arsye është parashikuar dhe blerja pajisje orë, është e nevojshme blerja e pajisjeve si kondicioner, sobë gatimi, aspirator, fshesë me korent etj. Janë realizuar zërat e përmendur më sipër, blerja orë është në proces.

P10430.Q2.O1.A7. Rikonstruksioni i çerdhes “Manush Alimani” & të trashëguara. Eshtë realizuar.

P.AI141.Q3.O1.A6. Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijët me Aftësi të kufizuara

P.AI141.Q3.O1.A6. Tarifa/Taksa për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të Bashkisë Shkoder.

Nuk është realizuar mbartet për vitin 2026. Fonde që do të mbarten për likuidimin e faturave mbi oponencat e kopshtit Ton Alimhilli, Bep Tusha dhe shkolles Ismail Qemali si dhe projekte të tjera të Bashkisë për vitin 2026.

Transferta të Kushtezura

P09120.Q1.O1.A13.Fëmijë me aftësi të vecanta që përfitojnë shërbim arsimor cilësor - (Transferte të kushtezuar)

Eshte zhvilluar procedura e tenderimit per blerjen e artikujve ushqimor per nxenesit e shkolles speciale 3 dhjetori. Kane perfituar nga kuota ushqimore mesatarisht 73 nxenes.

P09230.Q1.O1.A11 Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet arsimore (Transfertë e kushtëzuar)

Kane perfituar bursa 19 nxenes nga shkollat e mesme te pergjithshme. Realizuar.

P09230.Q1.O1.A24 Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet arsimore (Transfertë e kushtëzuar)

Kanë përfituar bursa 254 nxënës nga shkollat e mesme profesionale. Realizuar

Kane perftuar burse ushqimore 14 nxenes te konviktit.

P09230.Q1.O2.A3 Shkolla e hapur "Kol Idromeno" Eshte e nevojshme krijimi i një ambienti te shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina, krijimi i një ambienti te përshtatshëm për personat me aftësi te kufizuara ,krijimi i një ambienti konformë ligjeve dhe standartit për mësimdhënie.etj

Kontrate e mbikqyrjes e lidhur , ne zbatim.

P09230.Q1.O2.A4 Rikonstrukcion i shkolles "Ndre Mjeda" Bashkia Shkoder.

Eshte krijuar një ambient i shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina, krijimin i një ambienti te përshtatshëm për personat me aftësi te kufizuara ,krijimi i një ambienti konformë ligjeve dhe standartit për mësimdhënie.etj . Eshte realizuar

P.AF141.Q1.O2.A2 Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit “28 Nëntori”, Shkodër

Eshte lidhur kontrata kane filluar punimet.

P.AF141.Q1.O2.A3 Ndërtim i ambienteve sportive të Shkollës “Tring Smajl

Eshte lidhur kontrata eshte ne pritje te lejes.

Llogari Jashte Thesari

P09230.Q2.O1.A12. Nxitja e Perfshirjes Sociale dhe Zhvillimit te komunitetit LLOGARI JASHTHE THESARI dhe te trasheguara - Realizuar